

Vlerësimi  
i Bashkëpunimit Austriak  
me Shqipërinë  
1991/1992 - 2004

*Versioni përfundimtar*

---

Me porosi të:  
***Austrian Development Agency ADA***  
Njësia e Vlerësimit  
Zelinkagasse 2  
A - 1010 Vienna

Claudia Conrad  
Markus Engler  
KEK-CDC Consultants  
e-mail: [conrad@kek.ch](mailto:conrad@kek.ch)

# PËRMBAJTJA

<b>FALENDERIM</b> .....	<b>V</b>
<b>0 PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>VI</b>
0.1.    Rezultatet kryesore .....	VI
0.2.    Rekomandimet kryesore .....	VII
<b>1 HYRJE</b> .....	<b>1</b>
1.1    Qëllimi dhe objektivi i Vlerësimit .....	1
1.2    Kompozimi i grupit të Ekspertëve dhe periudha e Vlerësimit.....	2
1.3. Metodologjia e Vlerësimit.....	3
1.4. Përfshirja e Zyrës së Koordinimit dhe e partnerëve .....	4
1.5. Faktorët kufizues gjatë Vlerësimit.....	4
<b>2 KUADRI I KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME NË VEND</b> .....	<b>6</b>
2.1    Kuari Politik, Ekonomik, Shoqëror dhe Kulturor .....	6
2.2    Analizë e shkurtër e sektorëve relevantë .....	9
2.2.1    Ndihma humanitare .....	9
2.2.2    Energjia.....	10
2.2.2    Sektori i furnizimit me ujë.....	11
2.2.3    Arsimi dhe Formimi Profesional .....	11
2.2.5.    Zhvillimi social.....	12
2.3    Analizë e shkurtër e kuadrit institucional .....	13
2.3.1.    Partnerët kombëtarë .....	13
2.3.2    Partnerët implementues.....	14
2.4    Vlerësimi i kushteve që lidhen me programimin .....	15
<b>3 BASHKËPUNIMI AUSTRIAK ME SHQIPËRINË</b> .....	<b>16</b>
3.1    Principet .....	16
3.2 Struktura institucionale.....	18
3.3.    Portofoli financiar, rajonal dhe sektorial i Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë që në vitet 1991/1992 .....	21
3.4.    Vlerësimi i partnerëve aktualë (Sinteza e vlerësimeve të projekteve) .	27
3.4.1    Agjencitë implementuese.....	27
3.4.2    Konsiderimi i barazisë gjinore në projektet e financuara nga ADA.....	28
3.4.3    Cilësia në planifikim .....	32
3.4.4    Implementimi i projektit .....	33
3.4.5    Drejtimi i projektit .....	34
3.4.6    Impakti lidhur me zhvillimin për burrat dhe gratë .....	34
3.4.7    Rekomandime (lidhur me projektet).....	35

3.5.	Koordinimi dhe Bashkëpunimi i Donatorëve me aktorët relevantë .....	36
3.6.	Mekanizmat drejtues të Programeve kombëtare.....	41
3.7.	Impakti i programit në lidhje me zhvillimin .....	43
<b>4.</b>	<b>PROGRAMIMI NË TË ARDHMEN I BASHKËPUNIMIT AUSTRIAK .....</b>	<b>45</b>
4.1.	Konkluzione të përgjithshme ( <i>mësimet e nxjerra</i> ) .....	45
4.2.	Rekomandimet.....	47
4.2.1	Nga projektet tek Programi për mbështetjen e strategjisë së partnerit.....	47
4.2.2	Përcaktimi i orientimit tematik .....	48
4.2.3	Përfaqshet dhe kërkesat operacionale .....	51
4.2.4	Kërkesat organizatve / institucionale .....	52
4.3	Opinione plotësuese për implementimin e rekomandimeve .....	54
4.3.1	Nevoja e pozicionimit të Bashkëpunimit Austriak në kuadrin politik .....	54
4.3.2	Analizë e sektorëve potencialë .....	56

### **Shtojcat**

Shtojca 1	Lista e partnerëve të intervistuar (telefon/me raportim dhe/ose direkt)
Shtojca 2	Termet e Referencës
Shtojca 3	Raportet e Vlerësimit të Projekteve (1) Vlerësimi i Projektit të Hidrocentraleve të Kaskadës së Drinit (2) Furnizimi me ujë i katër fshatrave në Shkodër (3) Hapa drejt rehabilitimit urban dhe integritetit të komunitetit të zonës informale të Kënetës, Durrës (4) Programi i Arsimit Profesional në Shqipëri (5) Ndërtimi i kapaciteteve për gratë drejtuese në Pushtetin Lokal (6) Rikonstruksioni i shkollave në Shqipëri
Shtojca 4	Karakteristika e vlerësimit të Programit

**LISTA E SHKURTIMEVE**

ADA	Austrian Development Agency – Agjencia Austriake për Zhvillim
ADC	Austrian Development Cooperation – Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim
CEEC	Central and Eastern European Countries – Vendet e Evropës Juglindore
CIVET	Centre for Information, Vocational Education and Training – Qendra për Informim, Arsimit dhe Formim Profesional
COOF	Co-ordination Office – Zyra e Koordinimit
DAC	Development Assistance Committee – Komitetit i Asistencës për Zhvillim
DC	Development Cooperation – Bashkëpunimi për Zhvillim
DRCRP	Drin River Cascade Rehabilitation Project - Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit
EBRD	European Bank for reconstruction and Development - BERZH
EC	European Commission – Komisioni Evropian
EIB	European Investment Bank - Banka Evropiane e Investimeve
EU	European Union – Bashkimi Evropian
FC	Federal Chancellery ( <i>gjermanisht: BKA - Bundeskanzleramt</i> ) – Kancelaria Federale
GTZ	Gesellschaft für technische Zusammenarbeit – Shoqata për Bashkëpunim Teknik
IDA	International Development Association – Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
IFAD	International Fund for Agriculture Development – Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor
IMF	International Monetary Fund – Fondi Monetar Ndërkombëtar
MDG	Millennium Development Goals – Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MFA	Ministry of Foreign Affairs ( <i>gjermanisht: BMAA</i> ) – Ministria e Punëve të Jashtme
NGO	Non-Governmental Organisation – Organizatat Jo-Qeveritare
NIS	newly independent status
NSSED	National Strategy for Socio-Economic Development - SKZHSE
ODA	Official Development Assistance – Asistenca Zyrtare për Zhvillim
OECD	Org. for Economic Co-operation and Dev. – Org. për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OZA	Ostzusammenarbeit – Bashkëpunimi me Vendet e EJT
COOF	Austrian Office for Technical cooperation – Zyra austriake e Bashkëpunimit Teknik
PCM	Project Cycle Management – Menaxhimi i ciklit të projektit
PRSP	Poverty Reduction Strategy Paper – Strategjia për Reduktimin e Varfërisë
SAA	Stabilisation and Association Agreement – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
SAP	Stabilisation and Association Process – Procesi i Stabilizim-Asociimit
SEE	South East Europe – Evropa Juglindore
SEVAL	Swiss Evaluation Society – Shoqata Zvicerane e Vlerësimit
SDC	Swiss Development Cooperation – Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim
SECO	(Swiss) State Secretariat for Economic Affairs – Sekretariati për Çështjet Ekonomike
SIDA	Swedish Agency for Inter. Development – Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ToR	Terms of Reference – Termet e Referencës
WB	World Bank – Banka Botërore

**FALENDERIM**

---

Autorët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë stafin e ADA në Vjenë si dhe Zyrën e Kooperimit në Tiranë për ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij raporti. Falenderime të veçanta për Mag. Barbara Torggler dhe Mag. Peter Kuthan nga Njësia e Vlerësimit tek ADA dhe M.E.S. Florenc Qosja (ADC në Tiranë) që e mbështetën më së miri vlerësimin. Falenderime gjithashtu edhe për ish-stafin e COOF, veçanërisht Mag. Irene Kaufmann, Mag. Florian Raunig, Mag. Klaus Kapper dhe Dr. Hubert Neuwirth për konsultimet e tyre të vlefshme si para punës në terren ashtu edhe për reagimet e tyre për rezultatet.

Në vazhdim ekipi i vlerësimit dëshiron të falënderojë të gjithë personat e intervistuar gjatë vlerësimit, duke përfshirë edhe partnerët e projektit, përfaqësuesit e qeverisjes qendrore dhe lokale, agjencitë implementuese në Vjenë dhe Shqipëri, organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë donatore për gadishmërinë dhe vullnetin për të ndarë me ne informacionin.

Së fundi, falenderime pjesëtarëve të tjerë të ekipit të vlerësimit: Edlira Muedini (CIVET), Marika Shtembari, Eriola Shingjergji, and Paul Hardegger (Universiteti i shkencave të aplikuara, Rapperswil). Autorët përfituan mjaft nga ndarja formale dhe informale e informacionit dhe rezultatet, si dhe nga forca e përgjithshme e frymës së ekipit që u tregua gjatë periudhës së vlerësimit.

---

## 0.1. Rezultatet kryesore

Vlerësimi i Programit të Austrisë me Shqipërinë është i pari në llojin e tij për Bashkëpunimin Austriak me Vendet e Evropës Lindore. Rezultatet kryesore të vlerësimit janë:

- (1) Performanca e përgjithshme e Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë vlerësohet relativisht e lartë. Përmirësimi i Programit Austriak korrespondon në një masë të konsiderueshme me procesin transformues në Shqipëri. Gjithashtu ai përfiton mjaft mirë nga një staf tepër kompetent dhe i angazhuar. Asistenca teknike bilaterale ka qenë mbështetur më tepër në një rrjet të mirë se sa në mbështetjen institucionale, për shkak se strukturat qeveritare të kufizuara në Shqipëri të cilat ishin mjaft të dobëta për të mundësuar një model partneriteti. Prandaj dhe baza kontraktuale ishte hartuar sipas interesit deliberativ austriak.
- (2) Sektorët e zgjedhur reflektojnë jo vetëm nevojat e vendit në këtë kohë, por demonstrojnë edhe fokusin e Bashkëpunimit Austriak me Evropën Lindore. Aktivitetet e para u desh të fokusohen në mënyrë pragmatike në një nivel bazë; ku kishte vetëm pak hapësirë për zhvillimin e ndonjë strategjie zhvillimi. Në momentin e mundshëm Bashkëpunimi Austriak ndërmoi një zhvendosje drejt një perspektive më afat-mesme, ndërkohë që po përfundonte ndihma humanitare dhe po fillonin masat në infrastrukturë dhe – më vonë – aktivitetet në Arsimin Profesional. Deri në ditët e sotme ato përbëjnë edhe pikat kryesore të Bashkëpunimit Austriak.
- (3) Për shkak të detyrave të shumta të një vendi në tranzicion, kontributi austriak në proceset transformuese ka qenë mjaft i kufizuar. Sidoqoftë shumica e rezultateve të synuara janë arritur. Aktivitetet i përgjigjen kuadrit ligjor dhe politik të Austrisë në atë kohë.
- (4) Viti 2000 shënon një ndryshim thelbësor në Bashkëpunimin Austriak. Si rezultat i zhvillimeve të brendshme kompetencat e Bashkëpunimit me Evropën Lindore (OZA) kaluan nga Kancelaria Federale tek Ministria e Punëve të Jashtme. Me këtë hap Austria ndërmoi edhe një reformë institucionale e cila tashmë përkryhet në një sërë vendesh të tjera donatore të Evropës Perëndimore. Në mënyrë simultane (por jo të ndërlidhur) u hapën perspektiva të reja për Shqipërinë, ndërkohë që ishte shpërblyer me kategorizimin e të qenit “një kandidate potenciale për antarësimin në BE”. Në këtë mënyrë bashkëpunimi me Shqipërinë nuk ishte më çështje e mbështetjes bilaterale, por u kthye në një përpjekje të përbashkët në interes të BE-së.
- (5) Megjithë këtë zhvillim madhor portofoli financiar, rajonal dhe sektorial i Bashkëpunimit Austriak mbetet krahasimisht konstant dhe i balancuar gjatë gjithë kohës së vlerësimit nga 1991/92 në 2004. Zhvillimet e fundit tregojnë se ka ndodhur një zhvillim i rëndësishëm ndërkohë që po fokusohet më tepër në aspektet politike të ndërhyrjeve ndërkombëtare në Shqipëri.

Vlerësimi i projekteve ekzemplare tregojnë kompetencën e lartë të Bashkëpunimit Austriak dhe të agjencive implementuese në ndërhyrjet e bazuar në nevoja. Nga ana tjetër ato demonstrojnë disa dobësi tek Bashkëpunimi Austriak:

- (6) Megjithë drejtimin e mirë në nivelin e projektit, drejtimi i Bashkëpunimit Austriak në nivelin e programit është relativisht i dobët. Ka pak ose aspak dëshmi nëse ka patur

një drejtim sistematik dhe efektiv të PCM. Sot, përfshirja e ngushtë e partnerëve lokalë në PCM shikohet me përparësi dhe është esenciale për zhvillimet në vend. Për këtë arsye implementimi i projektit duhet të kërkojë lidhje me nivelin politik dhe zhvillimin institucional.

- (7) Njohuritë institucionale të Qeverisë Austriake mbetet të kufizuara sepse ndërhyrja dhe monitorimi i projektit janë deleguar (outsourced) që në stadin fillestar. Kjo sjell rrezikun që ADA (të paktën në terren) të reduktohet thjesht në një njësi administrative me kapacitete dhe ekspertizë teknike të limituara ose si një qetësues që kërkohet kur lindin probleme operacionale. Kjo e vështirëson marrjen e vendimeve në nivel programi.
- (8) Vlerësimi i projekteve tregoi se impakti (sistemik) është mjaft i kufizuar për shkak të strukturës fragmentare të Bashkëpunimit Austriak në nivelin e programimit. Në përgjithësi mungon fokusimi i një programi për vendin, duke reduktuar angazhimin austriak në një sërë projektesh të ndryshme.

## 0.2. Rekomandimet kryesore

*KEK CDC Consultants* rekomandon që ADA të ri-konfigurojë Bashkëpunimin Austriak me Shqipërinë mbi bazën e Deklaratës së Parisit mbi Efektivitetin e Ndhmës (Mars 2005) duke implementuar një përfaqëse programore në kuadrin e rezultateve. Programi i Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë në të ardhmen duhet tu përgjigjet në mënyrë eksplicite politikave dhe strategjive të partnerëve shqiptarë dhe duhet të tregojë kontributin austriak në rezultatet specifike të zhvillimit tek vendi partner.

Për të siguruar implementimin e një përfaqëseje programi të orientuar nga partneri, ADA duhet të ndër marr hapat që vijojnë:

- i. *Përqëndrimi tematik* është i nevojshëm duke qenë se përfaqësa programore përfshin përgjithësisht më tepër koordinim brenda një sektori dhe me partnerët lokalë dhe ndërkombëtarë. Orientimi tematik duhet të fillojë nga strategjitë aktuale të Shqipërisë. Për këtë nevojitet një proces konsultimi në nivel partneri. Portofoli ekzistues i projekteve duhet të rishikohet për çdo sektor për të arritur përqëndrimin e aktiviteteve në maksimalisht 3 sektorë.
- ii. *Përfaqësa programore* duhet të ndryshohet tërësisht duke orientuar Bashkëpunimin Austriak drejt strukturave, politikave dhe strategjive lokale. ADA duhet të kuptojë bashkëpunimin e saj si një kontribut ndaj procesit ekzistues të zhvillimit të vendit partner. Kjo mund të garantohet nëse ADA e menaxhon portofolin e saj në kontekstin e kuadrin të rezultateve.
- iii. *Kërkesat organizative* të nevojshme duhet të fokusohen më qartë midis ADA Zyra Qendrore dhe Zyrat e Koordinimit. Kjo përfshin së pari përshtatjen e kapaciteteve dhe kompetencave të COOF duke rritur nivelin e burimeve njerëzore. Së dyti, informacioni i konsulentëve monitorues duhet të institucionalizohet më mirë për të përfutur COOF dhe partnerët lokalë. Së treti, instrumentet e PCM përfitojnë nga disa procedura më tepër të formalizuara – veçanërisht në nivelin e planifikimit dhe monitorimit.
- iv. Rishikimi i sektorit duhet të fokusohet në potencialet dhe efektivitetin e projekteve. Në sektorët energji, infrastrukturë (ujësjellës dhe kanalizime) dhe edukim profesional ADA ka një bazë të mirë për përqëndrimin e bashkëpunimit të saj. Aspektet e shoqërisë civile janë mjaft imanente në projektet e vlerësuara të implementuara nga OJQ-të lokale. ADA duhet të vendosë nëse ato do të mund të vazhdojnë këtë

angazhim në një bazë më intensive, apo do të reduktojnë përfshirjen e tyre në një minimum për të lënë kapacitete të lira për përqendrimin në sektorë të tjerë. Mbështetja e OJQ-ve lokale mund të bëhet me një pagesë të vetme (one-off-payments).



## 1.1 Qëllimi dhe objektivi i Vlerësimit

Brenda komunitetit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, aktivitetet dhe projektet po përmbledhen gjithnjë e më tepër në programe të cilat kanë një orientim strategjik dhe fokusohen më tepër në impaktin strukturor duke kontribuar në proceset e transformimit dhe zhvillimit. Për komunitetin ndërkombëtar mbetet një shqetësim kryesor se si të rrisin eficiencën e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe si të përshtatin politikatat e donatorëve me objektivat kombëtare të vendit përfitues të shprehura në “strategjitë respektive të reduktimit të varfërisë”. E parë nga ky këndvështrim vlerësimet e programeve kanë një rëndësi të veçantë.<sup>1</sup>

Vlerësimi i Programit Austriak me Shqipërinë është i pari në llojin e tij për Bashkëpunimin Austriak me Evropën Juglindore. Qëllimi i vlerësimit është të identifikojë mësimet e nxjerra nga asistenca dhe bashkëpunimi gjatë më shumë se 10 vjetëve dhe të nxjerrë prej tyre rekomandimet specifike që do të japin kontributin e tyre në strategjinë dhe programin e zhvillimit në të ardhmen të Austrisë në Shqipëri.

Sipas termave të referencës vlerësimi duhet të gjenerojë rezultatet specifike si më poshtë:

- Rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit përbëjnë një bazë për zhvillimin e ardhshëm të një strategjie dhe të Programit të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë.
- Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim ka një mirëkuptim në rritje për sfidat e ndryshme të lidhura me punën e tij të Vendet e Evropës Juglindore kundrejt bashkëpunimit me Vendet në Jug.
- Procesi i vlerësimit ka përforcuar partneritetin midis aktorëve të interesuar të Bashkëpunimit shqiptaro-austriak dhe ka rritur mirëkuptimin reciprok të pikave të forta, të dobëta dhe të mundësive në punën e tyre të përbashkët.
- Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë dhe partnerët e tij shqiptarë janë në gjendje të përmirësojnë punën e tyre në të ardhmen dhe të rrisin relevancën, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e këtij bashkëpunimi.

Fokusi i vlerësimit është përqendruar më tepër në përjasjen e ndërhyrjes se përgjithshme austriake, se sa në vlerësimin e projekteve të veçanta. Gjithsesi ADA ka përzgjedhur projektet e mëposhtme për vlerësim ekzemplarik:

- *Sektori i ujësjellësave*: Ujësjellës-Kanalizime në katër fshatra në Veri të Shqipërisë
- *Arsim*: Shkollat profesionale bujqësore dhe të turizmit
- *Demokracia dhe shoqëria civile*: Mbështetja e grave në politikë
- *Zhvillimi urban*: Rehabilitimi urban dhe integrimi i komuniteteve të vendbanimeve informale të Kënetës, Durrës
- *Rikonstruktion*: Rikonstrukcioni i shkollave
- *Energji*: Projekti i rehabilitimit të Kaskadës së Drinit

<sup>1</sup> Karakteristikat specifike të vlerësimit të një programi janë renditur në Shtojcën 4

Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit (DRCRP) përbën jo vetëm projektin më të madh në termat e vëllimit financiar, por edhe një projekt të përbashkët të Austrisë, Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim (seco) dhe aktorëve të tjerë. Rëndësia e projektit për sa i përket angazhimit financiare, relevancës padyshim të lartë (ndërkohë që mbulon 85% e nevojave të vendit për energji) dhe për sa i përket aspekteve të koordinimit të donatorëve, justifikon një vlerësim më të detajuar të projektit.

Që në fillimet e tij në fillim të viteve '90 Bashkëpunimi me Evropën Lindore ka pasur gjithnjë një rëndësi të madhe për Austrinë. ADA – duke qenë një aktore relativisht e re – duhet të gjejë vendin e saj në skenën e Zhvillimit Austriak. Objektivat e vëna këtij vlerësimi kanë më tepër karakter strategjik, duke përmendur faktin se ADA dhe MFA ndajnë midis tyre përgjegjësinë për këtë vlerësim. Në këtë mënyrë, fokusi është përqendruar më tepër në një proces të përbashkët të mësuarit për Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim në tërësi, se sa të japë dëshmi për përgjegjësi të veçanta të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë.

Vlerësimi i programit për Shqipërinë ka për ADA karakter pilot. Ai supervizohet nga Njësia e Vlerësimit e ADA-s, e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe përhapjen e mëtejshme të rezultateve dhe rekomandimeve të tij.

Termet e përdorur në raportin e vlerësimit janë në të shumtën e rasteve termat e përdorur zakonisht në kontekstin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Gjithsesi për të lehtësuar të kuptuarit sa më të mirë termat e paraqitur më poshtë shoqërohen nga specifikimet përkatëse:

Bashkëpunimi Austriak	Bashkëpunimi Ndërkombëtar Austriak, përfshi këtu edhe Aktivitetin për Zhvillim në vendet e Jugut (gjermanisht: <i>Entwicklungszusammenarbeit</i> ) dhe Bashkëpunimin me vendet e Evropës Lindore (gjermanisht: <i>Ostzusammenarbeit</i> )
OZA	Bashkëpunimi bilateral me Evropën Lindore (gjermanisht: <i>Ostzusammenarbeit</i> )
Bashkëpunimi për Zhvillim	Bashkëpunimi bilateral me vendet e Jugut (gjermanisht: <i>Entwicklungszusammenarbeit</i> )

*Termet e Referencës (ToR) së vlerësimit janë bashkangjitur në Shtojcën 2.*

## **1.2 Kompozimi i grupit të Ekspertëve dhe periudha e Vlerësimit**

ADA mandatoi KEK CDC Consultants me vlerësimin. Ekipi përbëhej nga ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë:

- Claudia Conrad, Master Shkenca politike dhe Vlerësuese e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Drejtuese e ekipit, Koordinatorë dhe hartuese e raportit të përgjithshëm
- Markus Engler, M.Sc. Inxhinier civil, Post-diplomuar në çështjet e zhvillimit, projektet e infrastrukturës/Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit
- Paul Hardegger, M.Sc. Inxhinier civil, Universiteti Teknik i Rapperswil, Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit

- Edlira Muedini, Konsulente për Arsimin Profesional
- Marika Shtembari, B.A., Konsulente Infrastrukturë/Ujësjesllës
- Eriola Shingjergji, PhD, Çështjet gjinore/Shoqëria civile

Drejtuksi i ekipit sqaroi ToRs dhe mandatin tek zyra qendrore e ADA-s në Vjenë më 4 dhe 5 Korrik 2005. Kjo periudhë u shfrytëzua gjithashtu edhe për të zhvilluar intervistat e para përfaqësuesit kryesorë të ADA-s, të MFA dhe ish-stafin e ADA-s. Studimi në terren u zhvillua në dy faza, në përputhje me disponibilitetin e partnerëve lokalë. Gjatë periudhës së parë (6 – 22.07) u vlerësuan projektet e zgjedhura në sektorët e infrastrukturës / ujësjesllsave / arsimin / zhvillimit urban. Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit u vlerësua gjatë periudhës 29.08 deri më 05.09. Gjatë dy fazave janë intervistuar përfaqësues të agjencive donatore ndërkombëtare, ministrive kombëtare, komunave lokale – dhe aty ku ishte relevante – organizatat joqeveritare për të gjitha zonat e zbatimit të projekteve.<sup>2</sup>

Më datën 5 Shtator 2005 u zhvillua një workshop për paraqitjen e rezultateve të para në Tiranë. Të gjithë aktorët në vendin partner të përfshirë vlerësim ishin ftuar të komentonin rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit.

Detyrat e vlerësimit u zhvilluan së bashku brenda ekipit, për aq kohë sa ishte e mundur. Gjithsesi, për shkak të kufizimeve të periudhës së zgjedhjeve dhe pushimeve verore që pasuan nuk mund të aplikoheshin sistematikisht gjatë gjithë kohës parimi i “katër syve” (“Four-Eyes”). Për këtë arsye disa intervista u zhvilluan vetëm nga një konsulent.

### 1.3. Metodologjia e Vlerësimit

Për grumbullimin e të dhënave dhe për analizimin e informacionit relevante janë përdorur metodat e mëposhtme:

- Vrojtimet elektronike
- Analiza e literaturës relevante sekondare dhe e dokumentacionit të projektit
- Intervista me personat kyçë (gjysmë e strukturuar me shënime)
- Intervistë grupi të fokusuar gjysmë të strukturuar
- Intervista telefonike
- Vlerësime teknike
- Transete
- Vrojtim i drejtpërdrejtë
- Analizat SWOT

Faza e parë e vlerësimit konsistoi në sistematizimin e dokumentacionit të disponueshëm projekteve. Bazuar në vrojtimet e para të brendshme, u ndërmor një studim elektronik për të marrë informacion të mëtejshëm në perceptimin e aktiviteteve në nivel programi të Bashkëpunimit Austriak. Pyetësorët u analizuan dhe interpretuan para studimit në terren. Kjo

<sup>2</sup> Saranda (Shkolla e hotelerisë), Durrës (zhvillimi urban), Qarku Shkodër (4 Fshatrat), Fier (Shkolla bujqësore) dhe Fierza (Hidrocentrali mbi lumin Drin)

i ndihmoi vlerësuesit të zhvillonin tezat e para të punës të cilat ishin përdorur në intervistat e mëvonshme.

Përqindja e pyetësorëve të kthyer ishte mbi 50% (krahasuar me një mesatare prej 30% në përgjithësi). Eksperienca tregon se kjo kuotë mund të konsiderohet si mjaft e mirë – gjithashtu edhe pse nuk kishte kohë të mjaftueshme për rikthim.

Projektet ekzemplare u vlerësuan për të pasur një tablo të aktiviteteve aktuale “tipike” të Bashkëpunimit Austriak. Përmbledhja e të dhënave në terren është bërë nga ekspertët lokalë të sektorit. Bazuar në rezultatet, ekspertët lokalë hartuan një draft-raport fillestar, i cili u rishikua më vonë nga KEK CDC Consultants. Për të thjeshtësuar procesin e leximit, u hartua një version i shkurtuar i lexueshëm i raportit nga KEK CD Consultants dhe është i është shtuar raportit të përgjithshëm (Shtojca 3). Raportet e plota origjinale mund të kërkohen tek KEK CDC Consultants.

Një listë e detajuar e partnerëve të intervistuar është bashkëlidhur në Shtojcën 1.

Principet dhe Kriteret ekzistuese për vlerësim (DAC 1998, SEval 2002) janë marrë gjerësisht në konsideratë.

#### **1.4. Përfshirja e Zyrës së Koordinimit dhe e partnerëve**

Në Tetor 2004 u zhvillua një seminar përgatitor në Tiranë. Pothuajse të gjithë partnerët relevantë mundën të merrnin pjesë dhe të kontribuonin në një mënyrë apo tjetër për hartimin e Termave të Referencës. Interesi për vlerësimin ishte i madh – megjithëse partnerët lokalë u fokusuan në projektin e tyre përkatës. Interesi në vlerësim u konfirmua edhe një herë me pjesëmarrjen e mirë dhe të vazhdueshme në feedback-workshop (shtator 2005). Të gjithë partnerët relevantë ishin të pranishëm: partnerët lokalë të nivelit qeveritar, përfaqësuesit e agjencive donatore dhe të agjencive implementuese. Sugjerimet e tyre për rezultatet dhe vlefshmërinë e tyre ishin mjaft të vlefshme për vlerësuesit.

Mbas dorëzimit të raportit të vlerësimit tek zyra qendrore e ADA, u zhvillua një prezantim tjetër në Vjenë në Tetor 2005. Përfaqësues nga ADA, Ministria e Punëve të Jashtme, agjencitë partnere dhe partnerë të tjerë të intervistuar patën mundësinë të diskutonin rreth rezultateve dhe rekomandimeve. Një pikë e veçantë interesi ishte zhvillimi i mëtejshëm i një përqasjeje rajonale, ankorimi më i mirë i çështjeve ndër-sektoriale, sfidat e politikave të decentralizimit dhe privatizimit në Shqipëri dhe modelet e bashkëpunimit ekonomik për të kontribuar në strategjitë e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

#### **1.5. Faktorët kufizues gjatë Vlerësimit**

Vlerësimi u zhvillua në një periudhë jo ideale. Zgjedhjet parlamentare ishin planifikuar për në datën 3 Korrik 2005. Megjithëse mediat kombëtare dhe ndërkombëtare deklarorin z. Sali Berisha dhe Partinë Demokratike si fitues të zgjedhjeve, u deshën më shumë se tre javë për të konfirmuar rezultatin përfundimtar. U deshën edhe dy muaj të tjerë për të formuar qeverinë e re. Si pasojë, përfaqësuesit zyrtarë e administratës “së vjetër” qeveritare ishin në një pozicion “presim dhe shohim”, duke mos ditur për një kohë të gjatë nëse ato do të zëvendësoheshin ose jo. Kjo i pengonte në një farë mase intervistat e zhvilluara në nivel qeveritar ndërkohë që disa herë interesi ishte i përqendruar në një drejtim tjetër.

Vendimi për zhvillimin e vlerësimit gjatë muajve të verës solli disa vështirësi logjistike. Jo të gjithë partnerët ishin të disponueshëm për intervistë, disa ishin të disponueshëm por

ndërkohë në pushime. Shkollat në Sarandë dhe Tiranë ishin të mbyllura. Drejtorët dhe disa mësues u takuan individualisht sipas disponibilitetit të tyre. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Austri sapo kishin filluar pushimet. Në këto raste u zhvilluan intervista telefonike në vend të takimeve të planifikuara.


Dokumentacioni i projekteve dhe programi i vendit në tërësi nuk ishte në përputhje me standardet e zakonshme. Ndërkohë, që një pjesë e mirë e materialeve është vetëm në Gjermanisht dhe përbënte një problem për dokumentacionin e konsulentëve lokalë. Materialet e pakta në Anglisht dhe Shqip pjesërisht ishin të pamjaftueshme dhe për një vrojtim të hollësishëm dhe të përshtatshëm.

Vlerësuesit ndërkombëtarë duhet të prioritarizonin një sasi të madhe materialesh për veten e tyre. Dokumente të rëndësishme që në fillimet e programit me Shqipërinë (p.sh. *Lukesch-Papier* e vitit 1994) nuk ishin më të disponueshme. Nuk ekzistonin dokumente planifikimi të angazhimeve të mëparshme në Shqipëri. Edhe projektet aktuale që do të vlerësoheshin nuk kishin dokumentacion të konsiderueshëm. Vlerësuesit ishin në gjendje të ri-ndërtonin historinë e programit mbi bazën e intervistave, pagesave financiare dhe vlerësimeve elektronike. Duket se kalimi i kompetencave nga Kancelaria Federale në Ministrinë e Punëve të Jashtme ka çuar në një humbje madhe të dokumenteve. Kjo jo vetëm që e pengoi vlerësimin por edhe dobëson njohuritë institucionale.

## 2.1 Kuadri Politik, Ekonomik, Shoqëror dhe Kulturor

*Një vështrim i shkurtër në proceset e tranzicionit në Shqipëri që nga viti 1991*

Shqipëria e filloi procesin e saj të tranzicionit në kushte mjaft specifike dhe shumë të disfavorshme. Ndarja e saj nga Perëndimi mbas Luftës së Dytë Botërore dhe nga të gjitha vendet socialiste (Jugosllavia: 1948; Bashkimi Sovjetik: 1961; Kina: 1978) rezultoi në një izolim dhe një përpjekje për të arritur autarkinë e vendit të vogël – dhe më të varfrin në Evropë. Për tranzicionin e saj Shqipëria nuk mund të mbështetej në shumë asete dhe eksperiencën të vlefshme të grumbulluara në dekadat e kaluara. Mbas rënies të sistemit komunist, në vitin 1991, vendi u përball me një krizë të madhe. Ai u fut në një periudhë çrregullimesh dhe trazirash. Varfëria dhe uria në masë detyruan mijëra shqiptarë të përpiqeshin të largoheshin nga vendi, ndonjëherë në rrugë mjaft të dëshpëruara, duke shkatërruar infrastrukturën lokale publike për të shprehur dëshirën e tyre për mos u kthyer, si dhe pakënaqësinë e tyre me kushtet e tyre aktuale. Por shpesh, emigrantët u konfrontuan dhimbshëm me faktin se ata nuk ishin të mirëpritur jashtë vendit. Shumë shqiptarë – të gatshëm për migrim, apo që dëshirojnë të qëndrojnë në vend – kishin premisa jorealiste në lidhje me rimëkëmbjen e përgjithshme të shpejtë ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies individuale. Kjo rezultoi në zhgënjim të gjerë, në ndjekjen e strategjive individuale (sesa pjesëmarrje në përpjekjet kolektive), dhe në përpjekjet e vazhdueshme për të migruar. Një krizë e dytë e madhe u desh të përballohej në vitet 1996/97, me rënien skemave piramidale të kursimeve ku shumë shqiptarë humbën paratë dhe perspektivën për të ardhmen e tyre të afërt dhe të mesme. Kriza disa herë rezultoi edhe në konfrontime dhune dhe përfshiu gjithashtu edhe shtetin, duke rezultuar në një ndryshim të Qeverisë dhe krijimin e një kushtetute të re. Si pasojë e instabilitetit në ritje, agjencitë donatore bilaterale ndërprejnë ose zvogëluan bashkëpunimin e tyre me Shqipërinë, dhe e vazhduan përsëri atë ose e sollën në nivelin e mëparshëm në vitin 1998. Që në fund të viteve '90 gjendja e ekonomisë shqiptare – si në nivelin makro- ashtu edhe mikroekonomik po përmirësohet, procesi i tranzicionit po përshejtohet, dhe duken të jenë të orientuar më qartë – ndër të tjera falë edhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social dhe perspektivës në Procesin e Stabilizim-Asociimit.



### Shteti

Aktorët kryesorë të 15 viteve të para të tranzicionit në Shqipëri – ndryshe nga shumë vende të Evropës Qendrore – përfaqësoheshin nga shteti; ata kishin dalë nga strukturat e mëparshme. Gjatë regjimit komunist nuk kishte qenë e mundur të formohej një opozitë, nuk lejohej të krijoheshin organizata të shoqërisë civile. Kjo rezultoi në vështirësi për procesin e tranzicionit. Debatet dhe betejat politike ishin më tepër për personat dhe pushtetin se sa për mënyrat e organizimit të tranzicionit dhe në lidhje me përmbajtjen. Pra, asnjë traditë para-komuniste nuk mund të udhëhiqte proceset politike dhe vendimmarrjen, nuk mund t'i referoheshë ndonjë modeli historik të demokracisë lokale për të konfiguruar Shqipërinë e re. Politikat kuptohen kryesisht – dhe vazhdojnë të kuptohen në këtë mënyrë nga shumë

shqiptarë – në një traditë para-moderne: një parti kontrollon pushtetin dhe, mundësisht, edhe ekonominë. Ndërkohë numri dhe cilësia e aktorëve është rritur. Megjithatë gjenerata e politikanëve të trajnuar në sistemin e kaluar vazhdojnë ende të kontrollojnë partitë kryesore dhe në këtë mënyrë edhe jetën politike në vend, aktorët më të rinj – disa prej të cilëve të trajnuar jashtë vendit – janë kthyer dhe janë gatshëm të luajnë një rol të rëndësishëm në rritje në procesin e tranzicionit të vendit.

Në vitin 1998 u aprovua Kushtetuta e re, e cila garanton të drejtat dhe përcakton detyrimet sipas standardeve moderne. Pavarësisht nga kjo, praktika sociale është shpesh larg këtyre rregullave. Për shembull, gratë shpesh nuk gëzojnë të njëjtin status si edhe burrat, gratë nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike, atyre u paguhen paga më të ulëta se kolegëve të tyre meshkuj. Gjithashtu gratë duket të vuajnë gjithnjë e më tepër nga dhuna. Megjithë përparimet legjislative të rëndësishme, zbatimi i reformave të rëndësishme nuk është kryer tërësisht. Pika më e rëndësishme është implementimi i planeve ekzistuese dhe siguria e forcës së ligjit. Administrata publike ende nuk e ka kuptuar rolin e saj si një ofrues i shërbimit publik, decentralizimi dhe i kompetencave në nivel lokal mbetet në nivel të ulët, dhe korrupsioni vazhdon të mbetet një problem, duke krijuar pabarazi në aksesin tek burimet (Shqipëria renditet në venin e 108-të në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2004).

### *Ekonomia*

Mbas vitit 1993 ekonomia e Shqipërisë – me një nivel mjaft të ulët dhe një inflacion pre 230% në vitin 1992 – filloi të rimëkëmbet dhe të tregojë tendenca pozitive. Vetëm ngjarjet e pazakonta të vitit 1997, kur rrëzimi i sistemeve piramidale çuan në një krizë të thellë financiare, sociale dhe politike, ngadalësoi zhvillimin ekonomik. Një progres respektiv mbështetej më tepër në privatizimin e shpejtë të tokës dhe banesave që në fillimet e viteve '90. Por ajo u ndesh edhe me probleme të mëdha: trashëgimia bujqësore – prodhimi parësor akoma mbetet sektori më i rëndësishëm ekonomik i vendit, duke kontribuar më tepër se 45% të GDP-së – që ishte e ngadaltë në adaptimin e metodave të reja të prodhimit dhe akoma ka nevojë të adaptohet. Institucionet financiare të besueshme dhe funksionale mungonin në vitet e para të tranzicionit, aksesin për kredi ishte dhe vazhdon të mbetet i vështirë për sipërmarrjet. Ekonomia e zezë vazhdon të sjellë një pjesë të rëndësishme të GDP-së, dhe transfertat nga jashtë ende përbëjnë burimet kryesore për familjet për të kapërcyer problemet e tyre të përditshme financiare. Megjithëse forca e punës – krahasuar me standardet evropiane – është e lirë, investimet e huaja janë të pakta – për shkak të mungesës së madhe të forcës së ligjit dhe reputacionit të vendit si një vend transit për trafikim (të lëndëve narkotike, qenieve njerëzore, etj.). Deficitet teknologjike kanë qenë dhe ende mbeten një sfidë e rëndësishme për ekonominë shqiptare dhe bizneset në brendësinë e tyre nuk funksionojnë domosdoshmërisht në përputhje me parimet e tregut, por më tepër në bazë të një logjike familjare. Tregu i punës është pak i zhvilluar dhe jo të gjithë njerëzit që kërkojnë punë kanë pasur mundësinë të trajnojnë aftësitë e tyre. Madhësia e kufizuar e tregut të brendshëm është një faktor tjetër kufizues për ekonominë kombëtare dhe eksportet kufizohen vetëm në disa degë

<b>Zhvilimi i</b>			
<b>Produktit të Brendshëm në</b>			
<b>Shqipëri-</b>		<b>Për-frymë</b>	
<b>Produkti</b>		<b>Të ardhurat*</b>	
1989	100	1989	1127
1990	90	1990	1014
1991	65	1991	730
1992	60	1992	678
1993	66	1993	743
1994	71	1994	804
1995	81	1995	911
1996	88	1996	994
1997	82	1997	925
1998	89	1998	998
1999	85	1999	1071
2000	103	2000	1155
2001	109	2001	1230
2002	116	2002	1304
2003		2003	
2004		2004	

\* në US\$  
Marrë nga: EBRD

<b>GDP për frymë</b>	
<b>rritja ekonomike vjetore (%)</b>	
1975 – 2002	0.3
1990 – 2002	6.0

**Asistenca zyrtare për Zhvillimi (OD) (disbursimet neto)**

Totali 2002 (US\$ milion)	317.0
Për frymë 2002 (US\$)	100.9
% e GDP 2002	6.6

Marrë nga: Rapori i Zhvillimit Njerëzor 2004

specifike, siç janë tekstilet dhe disa produkte bujqësore.

### Shoqëria

Shoqëria shqiptare është bërë shumë ngadalë aktore pozitive e tranzicionit. E fokusuar në detyrën e vështirë për të siguruar mirëqenien e saj dhe me një mungesë totale të eksperiencë për pjesëmarrje në vendimmarrje, njerëzit me vështirësi mund të merrnin pjesë në procesin e tranzicionit, duke përjashtuar përdorimin e lirive të reja ekonomike që u propozuan atyre. Ndërkohë, shërbimet që u ofrohen atyre nga ofruesit publik janë poshtë niveleve të fituara nën regjimin komunist, kjo referuar si sasisë ashtu edhe cilësisë. Përkeqësime respektive ka pasur veçanërisht në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. Indeksi i Zhvillimit të Qenieve Njerëzore rikuperuar midis viteve 1990 dhe 2000 nga 0,702 në 0,733 dhe në vitin 2002, ai u rrit në 0,781 (vlera nga 0>1,000). Në të njëjtën kohë, Shqipëria, ndryshe nga republikat fqinje jugosllave, nuk pati një luftë civile. Homogjeniteti gjuhësor i popullsisë (minoriteti grek përbën 3% të numrit total të popullsisë dhe nuk ka ndonjë frymëzim për autonomi apo lidhje me Greqinë, minoritetet e tjera (vllahët, romët, etj.) shtojnë vetëm 2% të popullsisë) përbënte një faktor të rëndësishëm në integrimin e vendit gjatë periudhës së tranzicionit dhe nuk mund të sfidohet nga diferencat fetare (70% myslimanë, 20% ortodoksë, 10% katolikë) ose nga diferencat dialektore (Toskë dhe Gegë) dhe sociale midis Veriut dhe Jugut. Konflikti kosovar (1999) nuk e rrezikoi stabilitetin e Shqipërisë, madje ai solli krijimin e burimeve shtesë. Nëse integrimi dhe stabiliteti i vendit ishte i rrezikuar në vitet '90, kjo ishte për shkak të paaftësisë së shtetit për të garantuar forcën e ligjit – pushteti juridik nuk mbulonte dhe vazhdon të mos mbulojë të gjithë vendin, grupe kriminale kontrollojnë pjesë të popullsisë dhe vendit – mungesa e marrëdhënieve të besueshme midis popullsisë dhe autoriteteve qeveritare, dhe rritja e ndarjes sociale për sa i përket të ardhurave dhe mirëqenies. Disa pak dominues të tranzicionit janë bërë shumë shpejt të pasur, ndërkohë që për një pjesë të madhe të popullsisë tranzicioni para së gjithash ishte një eksperiencë e varfërimit.

<b>Zhvillimi Njerëzor i Shqipërisë</b>		
Shqipëria është një vend mesatarisht i zhvilluar (vendi 65)		
Popullsia:	1975	2.7 Mio.
	2002	3.1 Mio.
	2015	3.4 Mio.
Jetgjatësia në lindje (years, 2002)		73.6
Popullsia urbane (% e totalit)		
	1975	32.7
	2002	43.2
	2015	51.2
Popullsia nën moshën 15 (% e totalit)		
	2002	28.5
	2015	22.9
Popullsia me moshë 65 e sipër (% e totalit)		
	2002	6.2
	2015	8.1
Arsimi i të rriturve (&, 2002)		98.7
Kombinimi I raportit të regjistrimit në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë (% , 2001/02)		69
Marrë nga: Rapori i Zhvillimit Njerëzor 2004		

### Analizë e përmbledhur e tranzicionit – ndërhyrjet lidhur me Zhvillimin

Të kërcënuar nga krizat sociale masive, projektet e incuara u përqendruan në mënyrë pragmatike në nivelin bazë. Kishte shumë pak hapësirë për hartimin e ndonjë strategjie zhvillimi. Asistenca Humanitare kërkohet – dhe në të shumtën e rasteve ofrohet. Kjo fazë duhet të analizohet në kushtet ekzistuese si një përpjekje për të stabilizuar vendin dhe për të parandaluar eksodin masiv. Përgjithësisht në një situatë të tillë çdo sektor ishte i pranueshëm – për sa kohë që ndërhyrja siguronte rehabilitimin e infrastrukturës esenciale për të siguruar shërbimet bazë minimale.

Mbas rënies së firmave piramidale një kaos i madh u përhap të gjithë vendin dhe çoi në evakuimin e gati të gjitha agjencive ndërkombëtare që operonin në vend. Asistenca teknike u ndërpre për disa muaj përpara se të rifillonte përsëri puna e mëparshme. Një tjetër rënie e konsiderueshme u provua me krizën kosovare në vitin 1999, duke sjellë dhjetëra mijëra persona të larguar në vend. Në këtë kontekst, Aktivitetet Humanitare kishin prioritet, në



përgjigje të saj u dhanë ndihma ndërkombëtare. Agjencitë donatore sikurse ishin Austriakët iu desh të konfrontohen me faktin e përfundimit të punëve të nisura në rehabilitimin e infrastrukturës esenciale dhe në shërbimet publike bazë. Në kontekstin e fokusimit të komunitetit ndërkombëtar në luftën e Kosovës, Qeveria Shqiptare u përpoq të rindëronte atë çka ishte shkatërruar në vitet 1996/97. Reforma kushtetuese dhe rimëkëmbja e forcës së ligjit kishin një rëndësi mjaft të madhe.

Këto përpjekje u shpërblyen me arritjen e përparimeve minimale ekonomike dhe me krijimin e vendeve të punës. Agjencitë që merreshin me çështjet e zhvillimit u inkurajuan e vazhdonin aktivitetet e tyre. U ndërmorën reforma institucionale dhe u prezantuan mundësitë e para për planifikimin e programeve me bazë afatmesme dhe afatgjatë. Që nga ai moment ekzistonte një perspektivë principiale për integrimin qeveritar në procesin e ndihmës. Gjithsesi mungesa e përgjegjësisë së njësive dhe strukturave qeveritare çoi në vazhdimin e një procesi relativisht autonom të aktiviteteve për zhvillim në vend.

Hartimi i draftit të parë të PRSP – ndjekur nga SKZHES – do t'i jepte fund Zhvillimit-me-2-drejtime në Shqipëri duke identifikuar sektorët prioritarë për rritjen ekonomike, reduktimin e varfërisë, përmirësimin e shërbimeve publike bazë dhe kuadrin e kushteve. Por shtytja kryesore ka qenë konfirmimi i Shqipërisë si një vend i SAP – i identifikuar si kandidat potencial për anëtarësim në BE.

Këto zhvillime në 1999/2000 kanë pasur edhe pasojat e tyre – ose duke sjellë programet e donatorëve kryesorë në vend (p.sh. Programi CARDS i BE-së), ose duke sjellë një rritje të projekteve të paracaktuara (earmarked) nga ODA për Shqipërinë. Respektivisht, ndërtimi institucional dhe politikat dhe përjasjet sektoriale u bënë gjithë e më të rëndësishme.

## **2.2 Analizë e shkurtër e sektorëve relevantë**

### **2.2.1 Ndihma humanitare**

Gjatë viteve '90 aktorët e ndihmës po tregoheshin gjithnjë e më të interesuar për rrugët me anë të cilave të lidhej më mirë ndihma dhe zhvillimi. Pjesa e racionalitetit që fshihej mbas këtij debati ishte se ndihma e mirë për zhvillim do të ndihmonte në reduktimin e dobësive të komuniteteve. Afrimi i investimeve do të mundësonte popullsinë të ndëronte asetet në të cilat mund të përdroreshin në rast krizash. Gjithashtu ndihma lehtësuese mund të mbronte asetet dhe të ofronte bazën për punën zhvilluese në të ardhmen. Implicite në këtë ide “të vazhdimësisë” ishte që ndihma lehtësuese nuk duhet parë si një qetësim, po edhe si një trampolinë për rimëkëmbje.

Në shumicën e vendeve DAC Mbështetja Humanitare është pjesë e integruar e Ndihmës për Zhvillimi. Përveç kësaj, Ndihma Humanitare në vendet donatore është kryesisht pjesë e Politikës së Jashtme të vendit. Kjo deri diku është e favorshme sepse kjo lidhje ofron një formulim specifik të qëllimeve dhe synimeve jo vetëm brenda punës për zhvillim, por edhe në asistencën humanitare. Për këtë arsye Mbështetja Humanitare është parë e lidhur me konceptet e Zhvillimit Human (demokratizimi, edukimi, çështjet gjinore, të drejtat e njeriu, mbrojtja e mjedisit, shoqëria civile, etj.). Veçanërisht në situata emergjente të lidhura me krizat, shumë donatorë aplikojnë konceptin e “asistencës humanitare zhvilluese”. Kjo përjasje koherente ofron perspektivën e një rehabilitimi të përshpejtuar social, politik dhe fizik brenda vendit të prekur.

Një tipar tjetër i Mbështetjes Humanitar të viteve '90 është fakti se duket qartë se afërsia gjeografike ose afiniteti historik ndaj rajoneve të krizës ndikojnë vendimmarrjen në nivelin e donatorëve. Shembuj për këtë janë përfshirja e fuqishme e ECHO dhe e vendeve evropiano-

perëndimore gjatë krizës në Ballkan, por gjithashtu edhe aktivitetet humanitare të Australisë, Zelandës së Re ose Japonisë në Azinë Juglindore ose angazhimi i SHBA-së, Kanadasë dhe Spanjës gjatë Uraganit Miç.

Në Shqipëri, aktivitetet e Mbështetjes Humanitare të Austrisë në fillim të viteve '90 duhet fillimisht të vlerësohet në kuadrin e përgjigjes imediate përpara se sa të jepej një përgjigje e gjerë politike. Ato fillimisht drejtoheshin për të penguar përhapjen e krizës ekzistuese dhe për të stabilizuar rajonin. Në momentin që u krijua mundësia u morën masa rehabilituese me qëllim që të përforconin përpjekjet për stabilizimin e vendit. Në këtë mënyrë aktivitetet e Bashkëpunimit Austriak i përgjigjen kërkesës ndërkombëtare për drejtimin e Mbështetjes humanitare sa më shpejt të jetë e mundur në mekanizma përkrahje efektive afatgjatë dhe strukturorë.

### 2.2.2 Energjia

Burimet kryesore për energji janë nafta dhe energjia hidroelektrike. Ka gjithashtu edhe disa depozita të vogla të gazit natyror dhe qymyrit. Para vitit 1990 qymyrdruri ishte ende një burim i rëndësishëm energjie për ngrohjen në vend. Në atë kohë konsumi i energjisë për frymë ishte gati 20% i konsumit në Evropën Perëndimore.

Para vitit 1990 Shqipëria ka qenë një eksportues neto i energjisë elektrike në Greqi, Maqedoni, Kosovë dhe Malin e Zi. Eksporti i produkteve të naftës dhe energjisë elektrike ishte një burim i konsiderueshëm në të ardhurat e vendit. Mbas vitit 1990 eksporti i energjisë ra dukshëm, duke ulur nivelin e të ardhurave nga 50 milion dollarë në 1/3 në vitin 1992, ndërkohë që mori fund eksporti i produkteve të naftës.

Kjo thekson rëndësinë e sektorit të energjisë hidrike për ekonominë e vendit. Në vitin 1992, Shqipëria kishte një kapacitet të instaluar prej 1445 MW, i cili i përgjigjet 88% të kapacitetit të përgjithshëm të prodhimit të energjisë, duke lënë 12% që vijnë nga termocentralet. Potenciali teknik i shfrytëzueshëm i energjisë hidrike vlerësohet të jetë rreth 3200 MW. Përveç 9 hidrocentraleve të mëdhenj ekzistojnë edhe rreth 80 hidrocentrale të vegjël, megjithëse vetëm një pjesë e vogël e tyre janë në punë. Për të balancuar burimin e energjisë elektrike, momentalisht është planifikuar të ndërtohet një termocentral në Vlorë, me një kapacitet prej rreth 200 MW.

Ndërkohë që më parë industria arrinte gati 80% të konsumit të brendshëm, skema ndryshoi në mënyrë drastike mbas vitit 1990 me një rritje të shpejtë në konsumin e konsumatorit duke rezultuar në ndryshim e skemës së konsumit. Nga ana teknike prodhimi i energjisë dhe shpërndarja nuk i përgjigjen më kësaj shtate të krijuar (p.sh. mungesa e matësave private, kapacitete të pamjaftueshme dhe kompatibiliteti i rrjeteve, furnizimi jo i qëndrueshëm).

Shumica e hidrocentraleve (përveç Komanit mbi lumin Drin, 1986) si dhe rrjeti i transmetimit të tensionit të mesëm janë ndërtuar me teknologji të vjetruar, nga vitet 1950 deri 1970. Për këtë arsye rehabilitimi i hidrocentraleve ekzistuese dhe rritja e kapacitetit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes përbëjnë prioritetet në sektorin energjetik. Linjat e reja ndërkombëtare me vendet fqinje janë gjithashtu pjesë e përbushjes së detyrimeve në kuadrin e Memorandumit të Athinës në kontekstin e krijimit të Komunitetit Energjetik në Evropën Juglindore.

Me rënien e regjimit të vjetër dhe me rënien drastike të ardhurave u bë e qartë se mirëmbajtja mbeti në vend dhe nuk kishte investimet për rehabilitimin e sistemit. Situata financiare ra menjëherë mbas vitit 1995, kur çmimet, përveç atyre të energjisë, u liberalizuan. Çmimi i lirë dhe mungesa e një grumbullimi efektiv të ardhurave rezultuan në një kërkesë artificiale në rritje nga 2,3 TWh në vitin 1993 në 5,6 TWh në 1999 dhe në humbje të mëdha jo-teknike.

Për të krijuar një kuadër të përshtatshëm institucional për sektorin energjetik, Qeveria, me mbështetjen e donatorëve (bankave), ndërmoi në mesin e viteve '90 një reformë sektoriale e cila rezultoi në një Deklaratë për Politikën e Sektorit Energjetik nga Qeveria në Prill 2002 dhe solli hartimin e një strategjie energjie dhe një plan strategjik të investimeve për periudhën 2003-2015. Reforma sektoriale përbën gjithashtu bazën për mekanizmin e një tregu tranzitor, që çon gradualisht në privatizimin e ndërmarrjeve energjetike.

### 2.2.2 Sektori i furnizimit me ujë

Furnizimi me ujë në zonat rurale nuk është një detyrë e thjeshtë. Është e rëndësishme të theksohet se shërbimet ujore nuk kufizohen vetëm në furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonat rurale. Aktualisht ka interesa të shumtë konkurrues për ujë – ujë i pijshëm, larje, vaditje, energji dhe lundrim. Komunitetet kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në menaxhimin dhe madje edhe në shpërndarjen e shërbimeve, por kompleksiteti dhe kosto e kësaj çështje kërkon rolin e qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat, dhe gjithashtu të donatorëve.

Infrastruktura e furnizimit me ujë në Shqipëri është përkeqësuar që në fund të viteve '70. Institucionet e furnizimit me ujë ishin të dobëta dhe të paqëndrueshme për shkak të një kombinimi të një tarife uji të ulët të imponuar politikisht, humbje në masë nga konsumatorët, mungesa e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe sistemit, dhe mungesës së nxitjes për performancë. Këto tendenca u përkeqësua nga izolimi politik i Shqipërisë. Nuk është e tepruar të theksohet se gjatë dekadës së kaluar, shumica e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve arriti fundin e jetës së saj, duke qene larg riparimeve me kosto efektive.

Mbas vitit 1990 rrjetet e furnizimit me ujë në zonat urbane dhe rurale ishin shkatërruar plotësisht. Menaxhimi i dobët dhe mungesa e planifikimit nënkuptonte “ që rrjeti urban i furnizimit me ujë ishte mirëmbajtur mjaft keq dhe gjendja e tij nuk mund t'i bënte ballë urbanizimit të shpejtë. Në zonat rurale sistemi i vaditjeve ishte shkatërruar për mungese të mirëmbajtjes dhe ishte bërë pengesë për bujqësinë. Kanalizimet ishin të mjerueshme, atje ku kishte.”<sup>3</sup>

Një rishikim i fundit i projekteve të furnizimit me ujë të Bankës Botërore<sup>4</sup> tregon se përfshirja e komunitetit lokal në vendimmarrjen për shërbimet, implementimin dhe menaxhimin e këtyre shërbimeve është e lidhur me kënaqje më të madhe të përfituesve me shërbimet dhe një gatishmëri më të madhe për të paguar. Përfshirja domethënëse e aktorëve lokalë lidhet me një riprodhim dhe qëndrueshmëri më të mirë të rezultateve dhe të impaktit. Një masë me e ulët pjesëmarrjeje – p.sh. vetëm duke ofruar materialet dhe punën – shoqërohet me një qëndrueshmëri më të ulët.

### 2.2.3 Arsimi dhe Formimi Profesional

Në shumicën e ish-vendeve komuniste she vendet socialiste, arsimi finançohej nga shteti dhe ishte falas për të gjithë. Në vitet '80, Shqipëria kishte arritur disa progres esencial, p.sh. ulje të theksuar të analfabetizmit dhe respektivisht një rritje të regjistrimeve në arsimin fillor. Arsimi fillor dhe i mesëm kishte një cilësi të mirë. Gjithsesi, para tranzicionit ishte mjaft e përhapur ndërhyrja politike, kurrikula te ngurta dhe të bazuara në fakte, arsimi i të rriturve ishte pak i zhvilluar. I gjithë sistemi vuante nga joeficienca dhe mungesa e motivimit të nxënësve dhe stafit.<sup>5</sup>

Fillimet e procesit transformues çuan në një fund të këtyre zhvillimeve pozitive. Shume shkolla – veçanërisht në zonat rurale – u mbyllën për mungesë fondesh. Që nga vitet 1996/97 numri i nxënësve ra ndjeshëm. Arsyet janë për shkak të shpenzimeve të larta, infrastrukturës katastrofale dhe për shkak se fëmijët nevojiteshin të punonin në arë. Pra,

<sup>3</sup> Shqipëri: Reforma urbane dhe rurale e ujesjellës-kanalizimeve. Shanghai 2004

<sup>4</sup> Banka Botërore, Ujesjellës-Kanalizime. Fpsi Strategji për Afrikën 2002.

<sup>5</sup> UNICEF 1995

ekzistonte një skepticizëm i qartë i banorëve në zonat rurale se kualifikimi në shkollë do të krijonte mundësi më të mëdha në tregun e punës dhe do të rriste mundësitë për ekzistencë. Mendohet se rreth 60 % e popullsisë rurale futet në tregun e punës pa formim profesional.

Në ditët e sotme, ndërtesat shkollore ndodhen në gjendje të mjerueshme, shpesh mungojnë materialet mësimore. Mungojnë mësuesit e kualifikuar, një pagë mesatare prej 150-200 Euro në muaj është mjaft e ulët për të qenë atraktive. Ata që kanë mundësi të ndryshojnë shkojnë në sektorin privat. Në vendet të tranzicion me shume se 60% e mësuesve janë femra, si dhe për familje, pune shtëpiake dhe punë të tjera, ato nuk janë mjaft mobile.<sup>6</sup>

Shqetësim në shumicën e vendeve në tranzicion përbën reforma e përgjithshme e sistemit arsimor dhe adaptimi i tij për një shoqëri pluraliste dhe të bazuar në tregun e lirë. Prezantimi i përfaqesjes “dual-track” në sistemin shqiptar – në të cilin kombinohet teoria me praktikën dhe mësimdhënia zhvillohet në shkollë dhe në kompani – nënkupton gjithashtu një ndryshim në besimin se formimi profesional është në radhë të parë një përgatitje për në universitet. Përveç krijimit të infrastrukturës në shkolla dhe përshtatjes së materialeve mësimore kanë rëndësi të madhe kontaktet me bizneset dhe kompanitë. Ata duhet të konsiderohen si partnerë në procesin e ndryshimit

Shkalla e formimit profesional është reduktuar në disa vende në tranzicion për shkak të mungesës së financimeve nga bazat prodhuese të kontraktuara.

### 2.2.5. Zhvillimi social

Periudha e tranzicionit solli jo vetëm “lirinë e re” dhe një sasi të madhe të produkteve të konsumit, por gjithashtu edhe një përkeqësim dhe varfërim real të shumicës së popullsisë në Shqipëri. Shumë njerëz, sot, janë të detyruar të jetojnë në situata të pasigurta. Kosto sociale e tranzicionit është shumë e lartë. Veçanërisht të moshuarit, të larguarit nga shkolla, që nuk kanë mundësi të gjejnë një vend pune, gratë dhe grupet e marginalizuara vuajnë varfërinë në rritje. Në kontrast, shërbimet qeveritare nuk janë të fuqishme të sigurojnë një rrjet social të sigurt. Shërbimet sociale – nëse ofrohen – ofrohen me cilësi të dobët. Mungojnë burimet njerëzore të kualifikuara. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, implementimi i reformave institucionale vuan nga mungesa e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore dhe institucionale.

Në Shqipëri, 25% e popullsisë jeton nën minimumin jetik. Përkeqësimi i zhvillimit social paraqet evidencat e tij në lëvizjet migruese. Zhvillimi dhe implementimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES) synon të zgjidhë këto probleme.

Shqipëria është një nga shembujt e rrallë të lokalizimit të MDG-ve. Duke marrë parasysh karakterin multidimensional të varfërisë, Qeveria Shqiptare vendos prioritetet të qarta në uljen e varfërisë:

Fusha prioritare	Fokusi në ndërhyrje
Rritja e mundësive për të varfrit	Stimulimi i rritjes ekonomike, rritja e aksesit në shëndetësi, arsim, infrastrukturë urbane dhe rurale
Rritja e pjesëmarrjes së të varfërve në shoqëri	Reforma institucionale duke adaptuar rrugë dhe metoda për të përfshirë të varfrit në procesin e vendimmarrjes
Rritja e sigurisë për të varfrit	Programe të asistencës ekonomike, kujdesi social, mbështetje për të varfrit, nxitje e punësimit, forcimi i kapitalit social

Marrë nga: UNDP Albania 2004, *Development Projects System*

<sup>6</sup> OECD 1996

## 2.3 Analizë e shkurtër e kuadrit institucional

### 2.3.1. Partnerët kombëtarë

Megjithëse udhëheqësit shqiptarë e u fokusuan në ndryshimet e shpejta në fillimet e procesit të tranzicionit, ndërkohë që në prezantimin e një programi reformash ambicioze dhe radikale institucionet qeveritare mbetën mjaft të dobëta dhe mosrespektimi në masë i forcës së ligjit ishte çështje e ditës. Skandali i shoqërive piramidale në vitin 1997 shkaktoi një krizë të rëndë socio-ekonomike dhe politike, kolaps të sistemit shtetëror dhe mosrealizimin e shumë arritjeve të viteve të para të reformës. Që nga kjo krizë, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm drejt konsolidimit të sistemit të shtetit duke krijuar stabilitet politik. Me Kushtetutën e re shqiptare, e cila hyri në fuqi në vitin 1998, klima politike përparoi dukshëm.

Gjatë periudhës së viteve 1997-2001 u aprovuan dhe/ose u rishikuan një sërë ligjesh që kishin të bënin me çështje të tilla si taksat, privatizimi, buxhetimi, decentralizimi, administrata civile, universitetet etj. Në të vërtetë, presioni i grupeve të krijuara të interesit bënë të domosdoshme rinegociimin e shumë reformave që ishin ndërmarrë me shpejtësi në fazën fillestare të tranzicionit. Gjithsesi ky progres legjislativ nuk duhet të çojë në supozimin e gabuar se administrata publike u reformua totalisht. Mungesa e respektimit të ligjit mbetet një problem serioz në Shqipëri. Sistemi juridik ende konsiderohet si i paqëndrueshëm. Korrupsioni ende prek të gjithë sistemin. Në vitin 2003 indeksi i korrupsionit i Transparency International e rendiste Shqipërinë në vendin e 92-të nga 122 vende

E parë në retrospektivë bashkëpunimi me njësitë qeveritare vlerësohet si i vështirë. Në fillim të viteve '90 bashkëpunimi ishte i kufizuar në disa korrespondenca formale dhe në një takim vjetor në nivel sektorial. Asnjë financim direkt ose indirekt nuk kanalizohet nëpërmjet nivelit ministerial.

Koordinimi i përgjithshëm i asistencës teknike duhej të ndiqej nga Ministria e Ekonomisë. Një marrëveshje kuadër midis një agjencive të veçanta donatore dhe Ministrisë së Ekonomisë rregullon parimet e koordinimit. Në parim Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për koordinimin e Asistencës Teknike me ministritë e tjera dhe për të vlerësuar nëse projektet i përgjigjen prioritetëve dhe nevojave të vendit. Gjithsesi në bashkëpunimin midis Bashkëpunimit Austriak dhe institucioneve qeveritare ishte më përcaktuese të merrte dritën jeshile nga ministritë implementuese. Bashkëpunimi ka qenë i rregulluar mbi bazën e një marrëveshje trepalëshe midis ministrive të linjës, agjencisë implementuese dhe Bashkëpunimit Austriak (krahaso edhe 3.6). Pavarësisht nga kjo në rastin e projekteve infrastrukturore në Veri të Shqipërisë dhe më vonë në aktivitetet në sektorin e arsimit, ministritë kanë luajtur një rol aktiv në planifikimin e projekteve dhe në implementimin e aktivitetëve. Motivime – si vizita okazionale në Austri – kanë ndihmuar pozitivisht në forcimin e bashkëpunimit

Në projektet e implementuara nga partnerët e qeverisë shqiptare, është ngritur zakonisht një *Njësi e Implementimit të Projektit* ose *Njësi e Menaxhimit të Projektit* (PIU / PMU). PIUs / PMUs janë instrumente drejtues në nivel programi, të aplikuara zakonisht në projektet e Bankës Botërore<sup>7</sup>. Qeveria cakton një ekip nga stafi qeveritar, i preferuar nga agjencia implementuese për kohëzgjatjen e projektit. Ky ekip është përgjegjës për implementimin e aktivitetëve të projektit, ndërkohë që stafi i rregullt i agjencisë përgjigjet për operimin e rregullt. Në projektet teknike ose të nivelit të lartë PIU / PMU shpesh mbështetet nga një ekip i veçantë konsulentësh, i cili ofron asistencë teknike dhe menaxheriale për PIU / PMU. Në përgjithësi PMUs shfaqin rrezikun e krijimit të strukturave paralele gjatë kohës së zhvillimit të

<sup>7</sup> Ekzistojnë dy modele kryesore të drejtimit në nivelin e programimit: PIU-të ose mbështetja në strukturat ekzistuese qeveritare. Kjo e fundit përdoret zakonisht në vendet afrikane SWAPs.

projektit, ndërkohë që stafi përgjegjës për operimet e rregullta nuk është direkt i përfshirë. Kjo kufizon angazhimin e stafit të rregullt për të marrë përgjegjësi mbas përfundimit të projektit. Megjithatë në rastin e Projektit të rehabilitimit të Kaskadës së Drinit, ky disavantazh i përgjithshëm i PMUs nuk ishte kaq kritik, sepse shumica e stafit, duke filluar që nga mekanikët deri tek drejtori i hidrocentralit ishin të përfshirë në implementimin e projektit.

### 2.3.2 Partnerët implementues

Procedura më e aplikuar e Bashkëpunimit Austriak në Evropën Juglindore është ajo e delegimit të planifikimit, implementimit dhe supervizimit në kompanitë konsulente austriake. Është në përgjegjësinë e tyre të nënkontraktjnë kompani (lokale) për të kryer detyra specifike në projekt. Si përzgjedhja e konsulentëve austriakë, ashtu edhe e nënkontraktorëve lokalë bëhet mbi bazën e proceseve tenderuese.

#### *Njësitë e qeverisjes lokale*

Reformat institucionale dhe politika e decentralizimit i kthyen bashkitë dhe komnat në partnerë të rëndësishëm implementimi në nivel lokal. Ndërkohë që u formulua mjaft shpejt një kuadër legjislativ për qeverisjen lokale<sup>8</sup>, kalimi i vërtetë i autoritetit administrativ dhe fiskal në njësitë e qeverisjes lokale po ndodhte më ngadalë. Faktor pengues ishte një mungesë e përgjithshme vullneti e pushtetit qendror, një angazhim i ulët i politikanëve dhe mungesa e kapaciteteve të kufizuara në nivel lokal. Dobësitë e institucioneve të qeverisjes lokale ende ekzistojnë dhe e bëjnë edhe më të ndjeshëm instabilitetin politik.

Megjithatë procesi i decentralizimit është duke bërë një progres gradual por të pakthyeshem. Njësitë<sup>9</sup> shqiptare të qeverisjes lokale kanë fituar një shkallë të autonomisë politike dhe autoritetet funksionues. Këshillat lokalë dhe bashkiakë janë zgjedhur direkt nga qytetarët nëpërmjet votimit të fshehtë. Kështu që pushteti dhe interesat politike janë të lidhur me zhvillimet rajonale dhe lokale. Njësitë lokale po ofrojnë shërbime publike lokale dhe po grumbullojnë të ardhura bazuar në sistemin autonom të vjeljes së taksave.

Gjithsesi kapacitetet e pamjaftueshme të njësive të qeverisjes vendore për të marrë të gjitha përgjegjësitë konsiderohet gjerësisht si një nga pengesat kryesore të zbatimit të strategjisë së decentralizimit. Kjo i bën njësitë e qeverisjes vendore, partnerë të Bashkëpunimit Austriak dhe – në të njëjtën kohë – grupin e synuar për ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitetet e zhvillimit organizativ.

#### *Organizatat e shoqërisë civile*

Në vitet '90 financimi direkt i OJQ-ve nuk konsiderohej si një opsion me vlerë. Përjasja teknike në vitet '90 kërkonte njohuri të veçanta të specializuara, të cilat mund të siguroheshin më mirë ose nga kompani konsulente ose institucione të specializuara. Për më tepër edhe çështja e përgjegjësisë është një aspekt përcaktues kur është fjala për Asistencë Teknike në sektorin e infrastrukturës.

Ka vetëm pak OJQ shqiptare, të cilat janë në gjendje të përmbushin kërkesat e partneritetit me agjencitë donatore ndërkombëtare. Vetëm kohët e fundit Bashkëpunimi Austriak shprehu dëshirën e kontraktimit direkt të një OJQ-je shqiptare (Co-Plan). Faktori përcaktues ishte më pak karakteri përfaqësues që duhet të ketë një OJQ në shoqëri, sesa standardi i lartë i

<sup>8</sup> Procesi i ngritjes së vet-qeverisjes locale filloi menjëherë mbas zgjedhjeve të para pluraliste në Shqipëri, në Mars 1991, ndërkohë që u miratuan ligjet përkatëse (Ligji Nr. 7570, Nr. 7572) për të krijuar bazën për autonominë politike lokale

<sup>9</sup> Njësitë përbëjnë në të gjithë vendin 65 bashki, 309 komuna dhe 12 këshilla qarku.

performancës dhe njohuritë teknike të Co-Plan, e cila ka një nivel të krahasueshëm me një kompani private.

## **2.4 Vlerësimi i kushteve që lidhen me programimin**

Shqipëria përbën sot vendin më të varfër në Evropë. Kushtet e kuadrit politik dhe social-ekonomik kanë qenë problematike gjatë gjithë periudhës së vlerësimit. Efektet e instabilitetit politik të zgjatur, i lidhur me disa rënie të konsiderueshme financiare dhe sociale – çuan në një rënie të situatës ekonomike, e cila e kufizoi ndjeshëm hapësirën për perspektiva të mira zhvillimi. Shumica e popullsisë shqiptare në zonat rurale dhe urbane jeton në kushte të vështira nën nivelin e varfërisë.

Situata e përgjithshme e varfër në vend sjell një nevojë të madhe për aktivitete zhvilluese në të gjitha fushat e jetës. Gjatë viteve '90, kushtet e kuadrit ekzistues institucional pengonin një bashkëpunim eficient me nivelin qeveritar. Agjencitë Qeveritare si Bashkëpunimi Austriak konfrontoheshin me dilemën për të mos zëvendësuar strukturat qeveritare që mungonin në Shqipëri; dhe nga ana tjetër ata u mbështetën deri diku në kushte të favorshme për të përmbushur mandatin e tyre dhe të punonin me eficiencë.

Në këtë situatë, Bashkëpunimi Austriak në Shqipëri mund të shikohet në kuadrin programeve sektoriale, i cili ofron mundësinë e implementimit të projekteve pa u mbështetur shumë në vendimet qeveritare.

### 3 BASHKËPUNIMI AUSTRIAK ME SHQIPËRINË

#### 3.1 Principet

Politika Austriake për Zhvillim ka ndërmarrë ndryshime të mëdha në dekadën e fundit, sikurse ilustron më poshtë:

<b>Baza ligjore</b>	<b>1991/92 – 2002</b> Ligji për Bashkëpunimin për Zhvillim 1974	<b>2002 – 2004</b> Akti i Bashkëpunimit për Zhvillim 2002
<b>Përgjegjësia politike</b>	<b>1991/92 – 2000</b> Kancelaria Federale	<b>2000 – 2004</b> Ministria e Punëve të Jashtme
<b>Rregullat &amp; Direktivat</b>	<b>1.06. 1994 e më tej</b> „Direktivë e veçantë e Kancelarisë Federale për sigurimin e financimeve në vendet reformuese të Evropës Qendrore dhe Juglindore dhe të Shteteve të pavarura “ <sup>10</sup>	
<b>Konceptet</b>	n/a	<b>Koncepti për vendet e EJL 2001/2002</b> „Mbështetja bilaterale në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL) dhe shtetet e reja të pavarura (NIS)“
<b>Operacionalizimi: Dokumente strategjike dhe të ngjashme</b>	n/a	<u>Niveli i MFA</u> Programe 3 –vjeçare <u>Niveli i ADA:</u> Programe pune 3 - vjeçare <u>Në vend:</u> programi i Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë 2004 – 2005
<b>Fokusi kryesor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqipëria është vend prioritar</li> <li>- Fokusi sektorial: ujësjellës dhe energji</li> <li>- Fokusi rajonal: Veriu i Shqipërisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqipëria është vend prioritar</li> <li>- EU SAP</li> <li>- 3 sektorë: a) mjedis, ujësjellës dhe energji b) ekonomia dhe punësimi c) arsimit</li> </ul>
<b>Agjencia ekzekutuese</b>	<b>1994 - 2003</b> COOF	<b>2004 e më tej</b> ADA

Marrë nga: Tabelë e ndërtuar mbi bazën e dokumenteve të disponuara

Kuadri ligjor dhe politik i Bashkëpunimit Austriak me Evropën Lindore, relevant për periudhën e vlerësimit (1992 to 2004) përmbledh shumë nivele të politikës dhe strategji të cilat ishin të vlefshme për kohën 1991/92 – 2004.

**Për periudhën nga viti 1992 deri 2000**, kuadri ishte dhënë nga Ligji për Bashkëpunimin për Zhvillim i vitit 1974 dhe direktiva e veçantë e Kancelarisë Federale për mbështetje financiare të Shqipërisë. Këto direktiva përcaktuan hapësirën e mbështetjes, parimet e përgjithshme,

<sup>10</sup> “Direktivë e veçantë e Kancelarisë Federale për mbështetjen me grante të vendeve të Evropës Qendrore dhe Juglindore dhe të vendeve të reja të pavaruara”



kriteret për përzgjedhjen e projekteve, si dhe procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes. Për këtë duhet të zbatoheshin kushtet e mëposhtme:

- Vendi që përfiton mbështetje nga Austria duhet të jetë në “Listën e DAC të përfituesve të ndihmës”<sup>11</sup>
- Qëllimi i kontributit austriak ishte mbështetja e proceseve të transformimeve ekonomike, ngritja e strukturave pluraliste dhe demokratike dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Prioritet i është dhënë shërbimeve publike dhe administratës qeveritare, aktiviteteve që forconin prodhimin në sektorin privat, dhe zhvillimit rajonal të integruar.
- Duhej të konsideroheshin efektet ekologjike dhe shoqërore.
- Zhvillimi shoqëror adresoj kryesisht nëpërmjet transferimit të njohurive (Know-How)
- Përjasje e programit në linjë me prioritetet e vendit përfitues dhe me aktivitetet e donatorëve të tjerë.

Për të përkthyer këto direktiva në një program në vitin 2004 u bë një vlerësim i nevojave. Për shkak të mungesës së dokumentacionit nuk ishte e mundur një analizë e thellë në mënyrën dhe në çfarë mase ishin respektuar këto udhëzime në nivelin operativ. Duke gjykuar llojin e ndërhyrjeve dhe fushat tematike, vlerësimi konstatoi se spektri kishte mbetur mjaft e gjerë. Sipas stafit të mëparshëm të Zyrës Austriake të Koordinimit, interferencat politike tek veprimet kanë qenë të pakta, duke lënë në këtë mënyrë hapësirë të mjaftueshme për formësimin e programimit.

Duke parë në retrospektivë, në analizimin e disbursimeve financiare mund të arrihet në përfundimin se sektorët e identifikuar në vlerësimin e nevojave (infrastrukturë, rehabilitim, dhe – me kalimin e kohës – arsim profesional) korrespondojnë me direktivën e përforcimit të procesit të transformimeve duke i dhënë fund Aktiviteteve të Ndihmës Humanitare, duke u futur gradualisht në projektet infrastrukturore, të cilat sigurojnë shërbimet minimale bazë. Sipas intervistave me aktorët kryesorë (ish-stafi i Bashkëpunimit Austriak, partnerët qeveritarë) projektet specifike bazoheshin në prioritetet të ministrisë përkatëse ose të partnerëve lokalë<sup>12</sup> në rajon. Me fjalë të tjera: çdo projekt mbështetet në sugjerimet e partnerëve shqiptarë dhe prandaj mund të konsiderohet si i orientuar nga partnerët.

Me transferimin e kompetencave për Bashkëpunimin Ndërkombëtar nga Kancelaria Federale të Ministria e Punëve të Jashtme (Prill 2000), gjithashtu kompetencat për bashkëpunimin me Evropën Lindore kaluan në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ). Ky ndryshim u shoqërua me reforma strukturore, të cilat përfundimisht çuan në krijimin e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Që prej vitit 2000, qëllimet politike në bashkëpunimin me Evropën (Jug)-Lindore (SEE) formulohen në një mënyrë më të shprehur dhe eksplicite.

**Prej vitit 2000**, bashkëpunimi me Shqipërinë nuk është më vetëm një çështje e mbështetjes bilaterale. Këshilli Evropian i Fiera (Qershor 2000) deklaroi që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) janë “kandidatë potencialë” për anëtarësimin në BE. Ky vendim çoi në një rritje të interesit evropian formësimin e zhvillimit të ardhshëm të Shqipërisë, si dhe të vendeve të tjera. Në vitin 2001 Komisioni Evropian nisi CARDS, një program i ri i dizenuar veçanërisht për vendet e PSA. Komisioni arriti në përfundimin se që nga ky moment kishte ardhur koha të përqendroheshin në Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Shqipërinë. Në vitet që pasuan u adoptuan direktivat e

<sup>11</sup> Shqipëria është shtuar në vitin 1989 në listën e përfituesve të ODA. Në periudhën 1996 – 1999, bënte pjesë në listën DAC të vendeve me të ardhura të ulta (për frymë PKB < \$765); nga viti 200 Shqipëria bën pjesë në kategorinë e vendeve me të ardhura mesatare (për frymë PKB < \$765-\$3030)

<sup>12</sup> në të shumën e rasteve Prefektuar, e cila përfaqëson Qeverinë në nivel lokal. Prefektuar ka vetëm status konsultativ; bashkitë dhe komunat marrin vendime në mënyrë të pavarur nga prefektura.

negocimit për negociimin e MSA me Shqipërinë. Në vitin 2003 u hapën zyrtarisht negociatat për MSA midis BE-së dhe Shqipërisë.

Reforma institucionale – e cila u zhvillua (pak a shumë) në mënyrë spontane – solli ndryshime të rëndësishme politike në nivelin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Austrisë dhe reflekton gjithashtu ndryshime të konsiderueshme politike në Austri. Ligji i ri përcakton bazën ligjore për të gjitha përpjekjet duke synuar një koherencë më të madhe politike.<sup>13</sup> Është në përgjegjësinë të MFA të monitorojë dhe sigurojë që puna për zhvillim të jetë në përputhje me ligjin. Për këtë arsye, është hartuar Programi 3-vjeçar në marrëveshje me Ministrinë e Financave të Austrisë dhe kaluar tek Këshilli i Ministrave. Gjithashtu Programi 3-vjeçar shërben si një mjet informacioni për Parlamentin Austriak.

Këto mekanizma bashkëpunimi bëjnë të domosdoshme të formulohen politika ose strategji sektoriale. Ky proces sapo ka nisur me formulimin e direktivave për sektorin e arsimit (*Bildungszusammenarbeit in Südosteuropa 2002 – 2005*, aprovuar në Tetor, 2002), ndjekur nga strategjia sektoriale për mjedisin, ujësjellësat dhe energjinë (*Ostzusammenarbeit Strategie Umwelt, Wasser und Energie*, aprovuar në Dhjetor, 2003). Këto dokumente politikë përcaktojnë fokusin e Bashkëpunimit Austriak në sektorët respektivë në Evropën Juglindore. Ato shërbejnë si një direktivë e rëndësishme për programimin dhe procesin e identifikimit të projekteve brenda sektorëve për vitet e ardhshme. Ja vlen të përmendësh se analizi i dokumenteve është bazuar në eksperiencat austriake në viteve e fundit. Si pasojë mësimet e nxjerra (*lessons learnt*) përshkruajnë linjat e mundshme të aktivitetit, i cili kërkon për sinergjitë në të gjithë rajonin dhe midis aktorëve austriakë dhe aktorëve lokalë/kombëtarë.

### 3.2 Struktura institucionale

#### *Përgjegjësia institucionale dhe „ndjenja e përkatësisë“*

Fillimisht, bashkëpunimi me Shqipërinë filloi me vendimin bazë politik për të ofruar Asistencë Humanitare për këtë vend. Sipas stafit të mëparshëm të Bashkëpunimit Austriak, ky vendim ishte bazuar në supozimin se kjo mbështetje do të vazhdonte për disa vjet dhe në fund do të arrij në një fund “natyral”. Zhvillimet me të gjitha konsekuencat nuk parashikuan dhe nuk mund të parashikoheshin (vendimmarrësit austriakë të asaj kohe synonin një horizont kohor nga 10 deri 15 vjet). Së fundi me lindjen e luftës në Ballkan dhe ndikimin e saj në rajon, u bë e qartë se bashkëpunimi me Evropën Lindore ishte një çështje që duhej konsideruar në një bazë afatmesme dhe afatgjatë. Kriza në Kosovë (subjekt i diskutimeve ndërkombëtare që në vitin 1997) konfirmoi atë që tashmë ishte bërë realitet: Ballkani dhe Evropa Juglindore po përjetonte ndryshime sociale thelbësore dhe drastike të shoqëruar nga përplasje të dhunshme dhe me rezultate të paparashikuara. Ky proces vazhdon ende.

Si rezultat, Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë duhej të vendosej në një bazë më të vazhdueshme. Kancelaria Federale vendosi të çelë një Zyrë Koordinimi në vitin 1994, për të qenë në një pozicion më të mirë për të monitoruar dhe drejtuar aktivitetet e ndryshme, të financuar nga Kancelaria Federale dhe nga aktorë të tjerë austriakë. Megjithëse kërkesa ishte artikulluar qartë, e parë në retrospektivë nuk dallohet një orientim rajonal në terma konkretë.

Përfaqsa fillestare ishte pragmatike dhe e orientuar nga rezultatet. Zyra e Koordinimit është drejtuar nga një stafi që ka qenë mjaft kompetent, duke njohur në mënyrë perfekte rajonin dhe gjuhën dhe mund të mbështeteshin në një rrjet personash që funksiononin më së miri.

<sup>13</sup> Krahaso klauzolën e koherencës në: *Entwicklungszusammenarbeitsgesetz inklusive EZA-Gesetz-Novelle 2003*, veçanërisht pjesa 5 §28, si dhe kompozimi i Bordit të Drejtorëve tek ADA.

Ndërkohë që të huajt (veçanërisht donatorë të tjerë) e perceptonin COOF si një përfaqësim mjaft modest të Austrisë, stafi e përcaktonte vetveten, se punonte në një profil të ulët. Një nga arsyt ishte burimet e kufizuara financiare në dispozicion për Zyrën e Koordinimit. Por fakti që Zyra e Koordinimit nuk mori një status zyrtar ose njohje për të vepruar në emër të Qeverisë Austriake kontribuoi në një farë mënyre në këtë punë me profil të ulët. Kjo gjë ka ndryshuar me kalimin e kompetencave tek MFA. Që prej asaj kohe, Zyra e Koordinimit është pjesë e Ambasadës Austriake – dhe në të njëjtën kohë – nën supervizionin e ADA. Kjo ndërlidhje e ngushtë midis MFA, ADA dhe – midis tyre – Zyra e Koordinimit mund të jetë problematike në rastet kur shfaqen interesa të ndryshme politike midis orientimeve të politikës së jashtme të MFA-së dhe fokusit të ADA-s në politikën e zhvillimit.

Që në fillimet e tij Bashkëpunimi Austriak me Evropën Lindore dhe Juglindore vuante nga pasiguria institucionale. Tradicionalisht Bashkëpunimi për zhvillim me vendet në zhvillim ka qenë kompetencë e MPJ (vitet '80). Në vitet '90 bashkëpunimi për zhvillim provoi një legjitimitet në rritje, i cili çoi në një rritje institucionale. OZA e ngritur më vonë nuk ishte pjesë e këtij zhvillimi. I krijuar si një departament i veçantë Bashkëpunimi Austriak në Evropën Lindore fillimit shikohej si një aktivitet i kufizuar me interesa sociale politike dhe ekonomike. Prandaj Bashkëpunimi Austriak ishte pjesë e Kancelarisë Federale. Me këtë vendim, bashkëpunimi Austriak me vendet në tranzicion në Lindje ishte e ndarë formalisht nga Bashkëpunim për Zhvillim me vendet në Jug. Për një kohë të caktuar, gjatë krizës në Ballkan, stafi i departamentit u rrit në 12 anëtarë në zyrën qendrore në Vjenë me struktura korresponduese (COOF) në vende të ndryshme prioritare. Për shkak të ndryshimeve politike në Austri në vitin 2000, iu dha fund ndarjes institucionale me shkrirjen e Bashkëpunimit për Zhvillim me Bashkëpunimin Austriak në Evropën Lindore nën përgjegjësinë e MPJ, e ndjekur nga krijimi i ADA-s.

I gjithë ky proces ndarjeje dhe shkrirje është shoqëruar me (dhe vazhdon ende) skepticizëm. Nga këndvështrimi i jo vetëm reduktimit të konsiderueshëm, por edhe të shkrirjes së “Njësisë së Bashkëpunimit me Lindjen”, shkrirja institucionale vazhdon të konsiderohet si një turrje e pakuptueshme e burimeve. Numri i stafit është reduktuar nga 12 në 3 poste duke mbajtura pothuasje të njëjtat projekte dhe programe. Për momentin, diferencat ndërmjet Bashkëpunimit Austriake me Evropën Lindore dhe me kontekstin e zhvillimit janë lënë pas dore duke e reduktuar dhe shkrirë në një degëzim të “thjeshtë” institucional. Duket qartë se këtu kemi të bëjmë me një problem të pozicionimit të Bashkëpunimit Austriake me Evropën Lindore në tërësinë e arkitekturës së ndihmës për zhvillim. Fokusimi i fortë ekonomik dhe dhënia rëndësi e modeleve të partneritetit publik dhe privat krijojnë një kontrast të madh me perspektivën tradicionale të zhvillimit social të Bashkëpunimit Austriak me vendet e Jugut. Ky problem koherence duhet të zhgjidhet në një të ardhme sa me të afërt.

#### *Diferencat në punë midis Evropës Lindore dhe vendeve të Jugut*

Për shkak të situatës gjeopolitike, Bashkëpunimi i Austrisë ( dhe i vende të Evropës Perëndimore në përgjithësi) me vendet e Evropës Lindore ndryshon nga bashkëpunimi me vendet e Jugut. Ndërkohë që objektivat strategjike (reduktimi i varfërsisë, paqja dhe stabiliteti, mbrojtja e burimeve natyrore) vlejnë për të dy zonat e bashkëpunimit, fokusi dhe përfaqesja janë të ndryshme. Në bashkëpunimin me “Lindjen” shqetesimet kryesore janë tranzicioni politik dhe ekonomik me objektivin afatmesëm të integritimit në BE. Kjo e bën fokusimin të përqëndrohet në zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e stabilitetit politik. Për sa i përket përfaqesjes bashkëpunimi mes partnerëve austriakë (sektori privat dhe OJQ-të) dhe partnerët lokalë kanë një prioritet të lartë dhe projektet teknike janë po aq të rëndësishëm sa projektet sociale. Në bashkëpunimin me “Jugun” fokusi kryesor janë zhvillimi social dhe reduktimi i varfërsisë, ndërkohë që bashkëpunimi direkt ekonomik midis Austrisë dhe vendeve partnere është dytësor. Tabela e mëposhtme ilustron diferencat

	Asistenca për Vendet e EJL & NIS	Bashkëpunimi për zhvillim me vendet e Jugut
Misioni kryesor	Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në kuadrin e tregut të lirë dhe në përputhje me principet/demokratizimin social	Nxitja e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social
Fokusi kryesor / Perspektiva	Antarësimi në BE	Zhdukja e varfërisë
Përqasja	Orientuar nga rezultatet	Bazuar në temë
Sektorët kryesorë	Zhvillimi i tregtisë dhe aktivitetit të sektorit privat <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ekonomia e biznesit dhe punësimi</li> <li>▪ Arsimi</li> <li>▪ Mjedisi (me theks të veçantë tek uji dhe energjia)</li> <li>▪ Administrimet publike, demokracia dhe të drejtat e njeriut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Arsimi</li> <li>▪ Bujqësia</li> <li>▪ Uji</li> <li>▪ Zhvillimi rural</li> <li>▪ Biznesi i vogël</li> </ul>
Temat Crosscutting	Krijimi i lidhjeve funksionale midis <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Mjedisit dhe arsimit</li> <li>▪ Mjedisit dhe ekonomisë/punësimit</li> <li>▪ Arsimit dhe ekonomisë/punësimit</li> <li>▪ Arsimit dhe të drejtave të njeriut</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Varfëria</li> <li>▪ Demokracia</li> <li>▪ Çështjet gjinore</li> <li>▪ Mjedisi</li> </ul>
Kriteret për identifikimin e prioriteteve	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kontribut për përmbushjen e kriterëve të kopenhagenit (antarësimi)<sup>14</sup></li> <li>▪ Njohuritë sektoriale të Austrisë</li> <li>▪ Interesat politike dhe ekonomike të Austrisë (veçanërisht ndaj zgjerimit të BE-së në lindje, zhvillimi i qëndrueshëm dhe nxitja e tregut të lirë mbështetur në principet sociale)</li> <li>▪ Sinergjitë dhe komplementaritetet me PSA</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit</li> </ul>

### *Roli i Zyrës së Koordinimit*

Zyra Austriake e Koordinimit në Tiranë është krijuar në vitin 1994. Ajo përgjigjet për menaxhimin e aktiviteteve të programeve të zhvillimit me porosi të Kancelarisë Federale dhe që prej vitit 2000 respektivisht për MPJ.

Që në fillimet e tij Bashkëpunimi Austriak me Evropën Juglindore u mbështet në një ekip të ri dhe mjaft dinamik me njohuri të përkryera në kontekstin rajonal. Duke njohur jo vetëm vendin, por edhe gjuhën ishte një avantazh i qartë dhe një faktor i rëndësishëm i suksesit. Duke njohur mjaft mirë kontekstin Bashkëpunimi Austriak kishte një model mjaft të mirë të orientimit nga rezultatet. Kjo gjë ishte e rëndësishme kontribuar në rezultatet e dukshme në një ambient jo të sigurt. Stafi i COOF jo vetëm që dinte si ta bënte “atë”, por edhe se me kë ta bënte “atë”. Fakti që bashkëpunëtorët austriakë mund të mbështeteshin në një rrjet të fuqishëm kishte vlera të jashtëzakonshme, ndërkohë që nuk ekzistonin struktura institucionale në anën e Qeverisë Shqiptare.

Stafi i Zyrës së Koordinimit në terren dhe në zyrat qendrore tregonte një qëndrueshmëri të admirueshme duke marrë në konsideratë ngarkesën e lartë në punë dhe infrastrukturën e kufizuar të COOF-it. Gjatë gjithë periudhës së vlerësimit Bashkëpunimi Austriak ka qenë i përbërë kryesisht nga një grup i angazhuar prej 4-5 personash. Ka qenë një avantazh që të gjithë drejtuesit në qendër kanë qenë më parë koordinatorë në terren para se të merrnin postet në zyrat qendrore. Kur kanë ndodhur ndryshime në staf pasardhësit kanë vazhduar

<sup>14</sup> Kriteret janë: 1. Stabiliteti i institucioneve 2. Funkcionimi i strukturave të të ekonomisë së tregut 3. Aftësia për të marrë detyrimet që lindin nga antarësimi në BE

projektet e nisura nga kolegët e tyre. Prandaj dhe rrotacioni i stafit nuk ka ndikuar në vazhdimësinë e programit.

Sipas stafit të dikurshëm, burimet njerëzore mjaft të kufizuara , veçanërisht (por jo vetëm) në terren kanë qenë një pengesë konstante për Zyrën e Koordinimit Austriak. Infrastruktura e disponueshme (zyra, pajisjet, automjeti) është mjaft modeste. Drejtuesi i Zyrës së Koordinimit mbështetej nga një administrator lokal, i cili duhej të përfaqësonte koordinatorin gjatë mungesës së tij, por pa pasur autoritet vendimmarrës.

Partneri i koordinatorit në Vjenë është “desk-u”. Formalisht vendimet merren në Vjenë, mbas konsultimeve me koordinatorin. Në përgjithësi, shkalla e delegimit të autoritetit nga qendra në terren është mjaft e ulët. Gjithsesi, në rastin e Shqipërisë, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi është i organizuar mbi bazën e një modeli *Tandem*, në të cilin secili funksion mbështet tjetrin. Kjo gjë funksionon mirë për sa kohë që ekziston një lloj shpirti i ekipit në stafin e përfshirë. Në rastin e kërkesave për financim, Vjena mandaton zyrën për të vlerësuar situatën. Mbi bazën e vlerësimit, Desk-u dhe koordinatori vendosin së bashku.

Ndërveprimi midis Zyrës së Koordinimit dhe aktorëve të tjerë në terren zhvillohej në bazë të kërkesave aktuale. Zhburizimi (outsourcing) i projektit - monitorimi nga konsulentët austriakë nënkupton që COOF-i merrej kryesisht me administrimin e projekteve dhe me sigurimin e qarkullimit të informacionit.

Për momentin, Zyra Austriake e Koordinimit në Tiranë përbëhet nga një Drejtues i zyrës part-time (50%) dhe një administrator lokal. Një oficer sektori do të punësohet së shpejti.

Duke marrë parasysh se rritjen e mundshme të detyrave dhe përgjegjësi të COOF-it për shkak të rritjes së parashikuar të ODA-s bilaterale për vitet e ardhshme dhe për shkak të nevojës së rritjes së harmonizimit me donatorët e tjerë në terren dhe përshtatja me politikat kombëtare, kapacitetet aktuale duken të pamjaftueshme. Në bazë të informacionit të disponueshëm nuk është bërë një menaxhim sistematik i njohurive (dokumentet e projekteve dhe të programit, kapitalizmi i eksperiencës dhe mësimet e përfituara) deri tani. Prandaj dhe informacioni i grumbulluar deri tani ka qenë mjaft i personalizuar, njohuritë institucionale janë mjaft të ulëta. Kjo paraqet një rrezik të madh të mbetjes prapa – duke u kthyer në rastin e rekrutimit të stafit të ri siç po ndodh sot që kërkesat e donatorëve po shkojnë gjithnjë e më tepër drejt harmonizimit dhe përshtatjes më të madhe.

### **3.3. Portofoli financiar, rajonal dhe sektorial i Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë që në vitet 1991/1992**

#### *Hartimi dhe zhvillimi i portofolit*

Ndihma Humanitare ka qenë pikënisja për Bashkëpunimin Austriak me Shqipërinë. Periudha nga viti 1991 deri 1994 mund të përshkruhet si një periudhë e projekteve me strukturë të kufizuar. Aktivitetet përqëndroheshin kryesisht në paraqitjen e kërkesave të ndryshme nga aktorët austriakë. Në vitin 1994 u hap zyra e parë në Tiranë. Mandati i koordinatorit përfshinte – përveç detyrave të tjera – një vlerësim të projekteve në vazhdim. Si rezultat disa nga projektet u mbyllën për shkak të hartimit jo të përshtatshëm, problemeve me organizatat partnere ose thjesht sepse ato nuk përmbushnin nevojat ekzistuese.

Për të përmirësuar efektivitetin e angazhimit, u zhvillua një analizim i nevojave nga Dr. Robert Lukesch. Rezultatet dhe sugjerimet e bëra në raportin e misionit influencuan në hartimin e plotë të programit në shkallë vendi dhe shërbyen për procesin e vendimmarrjes. Në bazë të rezultateve të misionit, fokusi u vu në masat infrastrukturore në sektorët e ujit/infrastrukturës, energjisë dhe zhvillimit të komunitetit. Më vonë, u zhvillua një


bashkëpunim më i ngushtë me partnerët shqiptarë – veçanërisht për planifikimin dhe hartimin e duhur të projekteve. Bashkëpunimi Austriake ishte kërkuar gjithnjë e më tepër në shërbime konsulence, veçanërisht kur bëhej fjalë për masat infrastrukturore ku kërkohehin njohuri specifike.

Në kontrast me të, numri i projekteve të implementuara nga OJQ-të (austriake) ishte relativisht i kufizuar në vitet '90. Fokusi kryesisht teknik i Bashkëpunimit Austriak pengonte një pjesëmarrje më të fuqishme të OJQ-ve. Specializimi në “faktorët e butë” i kombinuar me menaxhimin e projekteve nuk ishte i mjaftueshëm për të konkurruar me njohuritë specifike të kompanive konsulente. Që prej vitit 2000 e në vazhdim, kjo politikë ndryshoi në favor të rritjes së financimit të OJQ-ve dhe mbështetjes së sektorit të arsimit (zhvillimi i aftësive).

Si përmbledhje, rruga e përcaktuar në vitin 1994 po ndiqet deri në ditët e sotme. Aktivitetet e implementuara gjatë periudhës së vlerësimit mund të shikohen si një vazhdimësi e vlerësimit të nevojave dhe në vitin 1994 e pastaj e sugjerimeve për fokusimin në masat infrastrukturore me orientimet kryesore në ujë, energji dhe zhvillimi i komunitetit.

### Shpërndarja e fondeve

Bashkëpunimi Austriak me Evropën ka qenë në mënyrë krahasuese i dukshëm, siç tregon edhe diagrami i mëposhtëm i DAC.



Marrë nga: DAC Peer Review, 2004

Ballkani (veçanërisht Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi) përbëjnë burimin më të madh të refugjatëve dhe studentëve të financuar privatisht në Austri në vitet e fundit. Nga ana tjetër, Asistenca Teknike bilaterale ka një buxhet mjaft të vogël. Në periudhën 1991/92 deri 2004, financimet austriake në Shqipëri arrijnë vlerën rreth 20'000'000 Euro (në total). Austria bën pjesë në kategorinë e donatorëve të vegjël të cilët janë poshtë donatorëve të vegjël dhe të mesëm si DFID (2004:3.3 US\$), Suedia (2004:1.8 US\$), UNICEF (2004:2.2 US\$) dhe Holanda (2004:4.2 US\$). Zvicra dhe Norvegjia shënojnë nivelin tjetër të lartë (të dyja 2004:7.5 US\$). Donatorët më të mëdhenj janë EC (2004: 105.4), EBRD (2004:52US\$), dhe USAID (2004:28.2US\$).<sup>15</sup>

Në periudhën 1992/93 deri në 1998 përqindja e ODA austriake në Shqipëri arrin me ndryshime të vogla nga 1% deri në 2% të ODA-s së përgjithshme austriake. Në vitin 2002

<sup>15</sup> Banka Botërore, Asistenca e donatorëve sipas programeve dhe shumës së ndihmës (US\$ mn)

dhe 2003 Shqipëria nuk figuron më në statistikat në vendet kryesore përfituese të ODA-s bilaterale të Austrisë.<sup>16</sup>

Tabela e mëposhtme tregon disbursimet vjetore të Bashkëpunimit Austriake me Shqipërinë nga viti 1991/92 deri në 2004:

*Tabela 1: Disbursimet vjetore në të dhënat aktuale në %*

Viti	Shuma në EURO	Përqindja
1991	0.00	0%
1992	0.00	0%
1993	2'648'961.00	13%
1994	232'004.00	1%
1995	1'112'620.00	6%
1996	1'682'712.00	8%
1997	2'806'785.00	14%
1998	3'156'199.00	16%
1999	1'941'493.00	10%
2000	3'340'679.00	17%
2001	1'119'764.00	6%
2002	468'845.00	2%
2003	1'201'724.00	6%
2004	200'247.00	1%
<b>Total</b>	<b>19'912'033.00</b>	<b>100%</b>

*Marrë nga: Tabelë e hartuar mbi bazën e disbursimeve aktuale vjetore të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë në vitet 1990 - 2004*

Disbursimet e para u kryen në vitin 1993 duke mbuluar edhe angazhimet e viteve të mëparshme '91 dhe '92. Në vitin 1994, mbështetja bilaterale arriti nivelin më të ulët. Në këtë vit faza humanitare po përfundonte dhe u desh të zhvilloheshin projekte të reja. Prandaj COOF-i përfitoi nga rasti të përqëndrohej kryesisht në hartimin e programit të ardhshëm me Shqipërinë. Implementimi i projekteve të reja reflektohet në vitet pasardhëse në një rritje graduale të mbështetjes financiare.

Me rënien e firmave piramidale në vitin 1996 dhe me trazirat që pasuan, Shqipëria ra në një krizë të thellë. Shumica e agjencive ndërkombëtare u desh të largohen nga Shqipëria. Zyra e Koordinimit të Austrisë u mbyll përkohësisht. Pavarësisht nga kjo, disbursimet aktuale gati u dyfishuan brenda një viti për shkak të obligimeve kontraktuale në vazhdim në sektorin e infrastrukturës (Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit) dhe një kontribut i vetëm prej rreth 800'000 EURO për aktivitetet e ICRC në vend.


Në vitin 2000, investimet në sektorin e infrastrukturës arritën një kulm tjetër, me disbursimet më të larta për të gjithë periudhën me 3'400'000 EURO.

Vitet në vazhdim deri në vitin 2004 karakterizohen nga një rënie drastike, madje edhe nën nivelin e 1995. Kjo rënie u ndërmor spontanisht me kalimin e kompetencave nga Kancelaria Federale tek MPJ.

Diagrami i mëposhtëm ilustron zhvillimin e disbursimeve aktuale:

<sup>16</sup> Marrë nga: *DAC Peer Review of Austria, OECD 2004*

Diagram 1: Zhvillimi i disbursimeve nga 1991/92 - 2004




### Portofoli sektorial

Sipas disbursimeve aktuale gjatë gjithë periudhës 1991/92 to 2004, bashkëpunimi bilateral u zhvillua kryesisht në sektorët e mëposhtëm:

- Ndihma humanitare (HA)
- Zhvillimi i aftësive (Skill D)
- Zhvillimi rural (RD)
- Të drejtat e njeriut dhe aktivitetet sociale (HR/Social)
- Masat infrastrukturore (Infrastructure)
- Zhvillimi urban / Zhvillimi i komunitetit (TD/CD).

60% e financimeve u kanalizuan në sektorët e lidhur me masat infrastrukturore. Financimet fokusuan në dy projekte të mëdha: Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit dhe sistemet e furnizimit me ujë në rajonin e Shkodrës. Të dy projektet zgjatën disa vite dhe vazhdojnë akoma me shtesat përkatëse.

Tabela 3: Shpërndarja e fondeve për sektor



Shënim: COOF = Zyra e Koordinimit



Prioritarizimi i qartë i shpërndarjes së fondeve në sektorin e infrastrukturës qëndron në kontrast me “modelin tipik të donatorit të vogël”<sup>17</sup> të aplikuar zakonisht nga Bashkëpunimi Austriak në vendet e Jugut. Aty është vënë theksi më tepër në aktivitetet në sektorin social me një kontribut krahasimisht modest në infrastrukturën ekonomike dhe prodhimin.

Financimi i aktiviteteve të Mbështetjes humanitare është sektori i dytë më i financuar. Po në fakt, Ndihma Humanitare ndaloi në vitin 1994. Vetëm shuma e madhe e disbursuar në fillimet e viteve '90 krijon këtë renditje të lartë. Kontributet për sektorin zhvillimit rural janë krahasimisht të ultë, kryesisht të shpërndara në 1994 dhe 1995. Projektet gjatë kësaj kohe nuk kontrolloheshin në detaje (në kuptimin e rezultateve të pritshme, partnerët, premisat e nevojave) dhe si rrjedhim u mbyllën. Financimet për zhvillimin urban dhe respektivisht për zhvillimin e komunitetit tregojnë për gjatë viteve disbursime të ulëta por të rregullta. Kjo lidhet me zhvillimit hap-pas-hapi të aktiviteteve, të nisura me disa studime fizibiliteti në vitet e fillimit, duke çuar në aktivitete trajnuese dhe duke përfunduar me një projekt pilot specifik në kontekstin e planifikimit urban dhe integrimin e vendbanimeve informale. Kontributet ndaj agjencive multilaterale ishin kufizuar me një kontribut disave tek UNDP (mbështetja e zyrës kombëtare të Koordinimit) dhe tek një kontribut tek ICRC gjatë krizës së vitit 1997.

Zyra e Koordinimit (COOF) përfaqëson mesatarisht 5% të buxhetit total për të gjithë periudhën. Kjo përqindje nuk duhet të çojë në supozimin e gabuar se është mbajtur një raport “i shëndetshëm” midis kostos së administrimit (në terren) dhe kostove direkte të projektit. Në fakt, Bashkëpunimi Austriak në Shqipëri punonte me një nivel të dukshëm modest, krahasuar me natyrën e detyrave dhe përgjegjësive. Kryesisht për shkak të angazhimit të madh të stafit lokal dhe austriak, që pranuan kushte pune shumë larg standardeve (ndërkombëtare), u ruajtën strukturat përkatëse.

Nën përgjegjësinë e Kancelarisë Federale u vendosën principet e përgjithshme për të çuar në mënyrë strategjike në përzgjedhjen specifike të sektorëve të ndërhyrjes. Si direktivë ajo përbënte një mbështetje dhe një parakusht për bazën e formulimeve të përbashkëta të Bashkëpunimit bilateral midis Shqipërisë dhe Austrisë<sup>18</sup>. Prandaj përzgjedhja e sektorëve varej nga artikulimi i besueshëm i nevojave dhe prioriteteve lokale dhe vlefshmërinë nga Zyra e Koordinimit Austriak. Përzgjedhja e projekteve specifike shpreh në mënyrë parashikuese pragmatizmin austriak e krijimit të rezultateve të dukshme mbi bazën e burimeve të kufizuara dhe horizontin e planifikimit (linjat buxhetore vjetore). Drejtimi i dhënë nga vlerësimi i nevojave në vitin 1994 u ndoq për disa vite pa pësuar ndryshime dhe adaptime të mëdha.

#### *Interesat ekonomike*

Në kontrast me punën për zhvillim me vendet e Jugut, Bashkëpunimi Austriak në Evropën Juglindore është më i ndërlidhur me interesat ekonomike austriake. Tabela e mëposhtme demonstroi disa shembuj të aktiviteteve në Shqipëri me relevant ekonomike për Austrinë:

	<b>DRCP</b>	<b>Monitorimi/ Konsultime Verbundplan</b>	<b>Ujësjetësi i Shkodrës</b>	<b>Shkollat e hoteleri- turizmit</b>
Kontributi Austriak në EURO	afërsisht 6.4 milion	afërsisht 0.2 milion	afërsisht 7.5 milion	afërsisht 0.9 milion.
Vlera e krijuar për Austrinë (net product)	97%	99%	50-70%	50-60%

*Marrë nga: listë e ADA-s, Prill 2005*

<sup>17</sup> DAC Peer Review 2004, f.28

<sup>18</sup> „Sonderrichtlinien des Bundeskanzleramtes für die Gewährung von Förderungen in den zentral- und Osteuropäischen Reformstaaten und den neuen unabhängigen Staaten“, 1994.

Ka arsye të ndryshme për vendet industriale për të hartuar një politikë zhvillimi brenda një interesi të brendshëm të kuptuar qartë.<sup>19</sup> Një argument kryesor është rëndësia e fuqizimit të proceseve endogjene të zhvillimit me vendet e varfra sepse vendet industriale kanë një interes të natyrshëm për ekonominë në lulëzim, tregjet në rritje dhe njerëzit me para për t'i shpenzuar jashtë “botës së OECD”.<sup>20</sup>

Një aspekt tjetër është fokusi i madh i anëtarësimit në BE i cili e bën një parakusht aftësinë ekonomike (kombinuar me qeverisjen e mirë, transparencën dhe përgjegjësinë).

Fokusi ekonomik paraqet mundësi të reja dhe interesante për Bashkëpunimin Austriak, veçanërisht në kontekstin evropian. Mund të zhvillohen modele të reja për partneritet bashkëpunimi me vendet përfituese për të krijuar kontribute të veçanta evropiane për formësimin e zhvillimit global. Në këtë kuptim, financimet për zhvillim mund të kuptohen si investime në kapitalin social të komunitetit ndërkombëtar dhe “ndihma” për zhvillim zhvillohet më tej drejt *bashkëpunimit* ndërkombëtar (se sa vetëm mbështetje).

#### *Përqëndrimi rajonal i Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë*

Që në fillimet e tij Bashkëpunimi Austriak ka pasur fokus kryesor veriun e Shqipërisë. Kontaktet tradicionalisht të mira në rajon, kombinuar me nevojat e shumta të paplotësuara të njerëzve që jetojnë atje në një varfëri të skajshme paraqesin një pikënisje ideale. Sipas aktorëve të ndryshëm në terren, numri i donatorëve të përfshirë aktivisht në programe në pjesën veriore të vendit mbetet i ulët. Në përgjithësi, ky fokus i Bashkëpunimit Austriak ishte dhe mbetet mjaft i vlerësuar.

#### *Përfaqsjë rajonale e Bashkëpunimit Austriak me vendet e Evropës Juglindore*

Siç është përmendur edhe më sipër, fokusimi rajonal i projekteve në Shqipëri – nëpërmjet një kërkese konceptuale – shprehet sot mjaft qartë në terma praktikë (krahaso 3.2). Pavarësisht nga kjo Bashkëpunimi Austriak e shikon Evropën Juglindore si një rajon politik. Ka përfaqsjë rajonale kryesisht në sektorin e arsimit, të siguruara nga aktivitetet rajonale të partnerit kryesor austriak KulturKontakt. Përveç kësaj ka edhe një linjë buxhetore të veçantë për aktivitetet rajonale.<sup>21</sup>

Gjatë viteve të fundit, Bashkëpunimi Austriak ka bërë përpjekje për të nxitur bashkëpunimin institucional në nivel ministerial midis Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Sipas zyrës qendrore të ADA-s përfaqsjë rajonale është siguruar duke pasur koordinatort për dy (madje tre) vendet që përfaqësojnë Bashkëpunimin Austriak në terren. Koordinatori për Shqipërinë punon me kohë të pjesshme në Tiranë (50%) dhe në Maqedoni (50%). Duke marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësi, që duhet të përmbushë zakonisht një zyrë koordinimi, kjo ndarje nuk është e kuptueshme dhe e provuar si mjaft kontraproductive për drejtimin e programit.

<sup>19</sup> krahaso Dirk Messner/Inge Schulz “Cështje në lidhje me të ardhmen e politikës për zhvillimi”, 2005.

<sup>20</sup> “Investimet e politikës për zhvillim në modernizimin e ekonomisë së vendeve në zhvillim janë për **interesa të qarta ekonomike**, nëse organizatat për zhvillimin tregojnë se aktivitetet e tyre në lidhje me të janë të efektshme.

<sup>21</sup> *ibid*, f.27

<sup>21</sup> Për shak të mungesës së informacionit nuk mund të bëhet një analizë më e thellë për lidhjet rajonale.

### 3.4. Vlerësimi i partnerëve aktualë (Sinteza e vlerësimeve të projekteve)

#### 3.4.1 Agjencitë implementuese

*Kriteret për vlerësim janë: ekspertiza/kompetenca, kapaciteti, menaxhimi i projekteve, performanca dhe aplikimi i principeve të orientuara nga zhvillimi*

Agjencitë implementuese mund të kategorizohen sipas orientimit të tyre sektorial:

- *Projektet teknike (4 – fshatrat, DRCRP):* Në të dy projektet partnerët implementues për kontributin austriak janë kompani inxhinierike austriake (iC, Andritz). Kompanitë janë përzgjedhur mbi bazën e tenderave të hapur në të cilat kosto, ekspertiza teknike dhe eksperiencia e punës në rajon janë kriteret e përzgjedhjes. Në rastin e furnizimit me ujë, detyrat kryesore të kompanisë janë supervizimi i punëve planifikuese dhe ndërtuese, tenderimi dhe nënkontraktimi i kompanive lokale, prokurimi i materialeve dhe përcaktimi i qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve infrastrukturore. Në rastin e DRCRP kompania rehabiliton pjesët mekanike të 3 hidrocentraleve, ndërkohë që supervizimi i gjithë projektit është detyrë e partnerit lokal (KESH), i vili mbështetet në detyrën e tij nga një konsulent ndërkombëtar (Colenco), i financuar me një grant të BERZH-it. Përveç kësaj është mandatuar nga ADA edhe një konsulent austriak (Verbundplan) për monitorimin e kontributit austriak tek DRCRO me porosi të ADA-s. Vlerësimi analizon vetëm performancën e kontraktorit austriak (Andritz) dhe të konsulentit (Verbundplan).
- *Projektet e zhvillimit social (Shkollat profesionale/mbështetja e grave/zhvillimi urban dhe i komunitetit/rikonstruksionet e shkollave):* juridikisht partnerët implementues janë agjencia austriake KulturKontakt, Horizont 3000 dhe organizata shqiptare CoPlan. Agjencia e parë është një shoqatë e lidhur ngushtë me Ministrinë austriake të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Horizont 3000 dhe CoPlan janë të njohura tërësisht si Organizata Jo-Qeveritare. KulturKontakt dhe Horizont 3000 mandatojnë implementimin e aktiviteteve specifike tek ekspertët (lokalë/austriakë) ose tek partnerët lokalë; CoPlan implementon direkt aktivitetet e projektit. Për rehabilitimin e shkollave, partneri implementues është dega shqiptare e CAFOD, e bazuar në një rrjet të gjerë katolik në Evropë dhe më gjerë.

#### *Ekspertiza dhe kompetencat*

Ekspertiza teknike dhe kompetencat e agjencive implementuese janë në përgjithësi të larta dhe të bazuara në një përvojë afatgjatë. Të gjithë janë mandatuar për implementimin e projektit që në fazat fillestare të tij. Njohuritë kontekstuale të kompanive ose organizatave austriake janë të mira duke qenë të përfshira në mënyrë aktive në projekte dhe programe në rajon që në mesin e viteve '90.

#### *Kapaciteti*

Stafet janë të kualifikuar mirë dhe ofrojnë njohuri ekspertësh për partnerët lokalë dhe për implementimin e detyrave të tyre. Në përgjithësi nga partnerët lokalë njihet një angazhim i lartë i stafit të përfshirë në projekte. Buxhetet e projekteve janë planifikuar në mënyrë realiste dhe mbulojnë shpenzimet që lidhen me të drejtat e njeriut, pajisjet, materialet etj.

#### *Menaxhimi i projektit*

Në të gjithë projektet ka struktura të qarta menaxhimi dhe në përputhje me matricën planifikuese. Performanca e agjencive implementuese është efiçente. Ato marrin përgjegjësi efektive për Menaxhimin e Ciklit të Projektit (planifikimi i projektit, implementimi dhe

finalizimi). Roli i KulturKontakt dhe Horizont 3000 është më tepër i një mbështetjeje (backstopper) , se sa i një agjencie implementuese. Për këtë arsye detyra e tyre kryesore është ofrojnë mundësi për ndërtim kapacitetesh dhe për krijimin e përfitimeve afatgjata. Në projektin DRGRP, detyra e Andritz është kryesisht menaxhimi i kontratave, e cila kryhet në mënyrë profesionale dhe me fleksibilitet të lartë, duke marrë në konsideratë kushtet e vështira në lidhje me implementimin e përgjithshëm të DRGRP.

### *Performanca*

Krahasimi i rezultateve të planifikuara me rezultatet e arritura tregon se shumica e rezultateve janë arritur. Planifikimi realist i kombinuar me performancën e mirë dhe një fokusim i qartë në nivelin e projektit kontribuojnë në suksesin e projektit.

### *Aplikimi i zhvillimit – Principet (pronësia, qëndrueshmëria, ndjeshmëria ndaj çështjeve gjinore)*

Komponentët e projektit që nxisin pronësi të partnerëve lokalë dhe një qëndrueshmëri të aktiviteteve të implementuara janë gjithnjë e më tepër pjesë e projekteve teknike. Projektet e zhvillimit social – veçanërisht projekti i grave dhe ai i zhvillimit të komunitetit i aplikojnë këto principe në mënyrë të veçantë, sepse ato janë parakushte të rëndësishme për arritjen e objektivave.

## **3.4.2 Konsiderimi i barazisë gjinore në projektet e financuara nga ADA**

*Kriteret kryesore janë: marrja në konsideratë e aspekteve gjinore në nivelet e analizës, planifikimit dhe implementimit/veprimt*

*Analiza: A ka ndërmarë agjencia implementuese një analizë të grupit të synuar që ndryshon sipas kriterit gjinor dhe socio-ekonomik?*

Mbi bazën e dokumentacionit të projektit vlerësuesit ekzaminuan nëse është bërë një analizë e grupit të synuar – e diferencuar sipas kriterëve gjinore dhe socio-ekonomike – gjatë fazës së planifikimit ose gjatë implementimit të projektit. Projektet “4 – Fshatrat” dhe DRGRP kanë një fokus të qartë teknik me planifikimin dhe dizenjimin e aktiviteteve. Në projektin e 4 fshatrave njerëzit në fshat janë përdoruesit finalë të output-it të projektit (ujë) dhe në këtë mënyrë mund të shikohen si grupi i synuar i projektit. Nuk ka informacion për këtë grup të synuar. Dizenjimi i projektit është strukturuar në mënyrë të tillë që privimi i grupit të synuar është supozuar në mënyrë të kuptueshme për shkak të shpërndarjes së zonës dhe mungesës së infrastrukturës. Informacioni është dhënë në mënyrë mjaft të përmbledhur nga përfituesit e projektit, që janë ministritë, administrata lokale e Shkodrës dhe komunat përkatëse. Gjithashtu edhe projekti i rehabilitimit të hidrocentraleve të Drinit fokusohet në implementimin teknik të projektit. Nuk ka informacion për përdoruesit e energjisë së prodhuar (p.sh. studimet bazë, vlerësimi i ekonomisë shtëpiake etj).

Në sektorin profesional aktivitetet e projektit ndjekin një përfaqëse mjaft instrumentale duke u fokusuar në pajisjet e shkollave, zhvillimin e kurrikulave, trajnimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore. Nuk ka informacione për grupet e synuara (mësues, nxënës). Studimi mbi të diplomuarit e shkollave hoteliere nuk kontribuon në një pamje të diferencuar në lidhje me grupin e synuar. Shkalla e ulët e punësimit të vajzave jepet si shifër, pa u analizuar më tej<sup>22</sup>

<sup>22</sup> Studimi "Ndjekja e ecurisë së të diplomuarve të shkollës së mesme të Hoteleri-Turizmit në Tiranë " kryer nga CIVET 2000 Muedini, Shyti; faqe 6, Kapitulli II – 1;

Në përgjithësi projektet e sipërpërmendura supozojnë edhe një efekt depërtues (trickle-down) të aktiviteteve të tyre, i cili mund të kontribuojë në mirëqenien ekonomike dhe shëndetësore të banorëve.

Në projektin “Ndërtimi i kapaciteteve për drejtueset femra në zgjedhjet lokale” përfituesit direkt janë politikanet femra të cilat kanë mundësinë të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale. Grupi i synuar në këtë kontekst janë partitë përkatëse (anëtares) dhe publiku i gjerë shqiptar. Analiza e partnerëve të projektit përmbush mjaft mirë kërkesat dhe nevojat aktuale të përfituesve. Faktorët e jashtëm që pengojnë barazinë gjinore janë analizuar mirë dhe marrë në konsideratë në hartimin e projektit.

Projekti në Durrës (banesat informale në Kënetë) është për momentin i vetmi projekt i cili aplikon instrumente për të analizuar situatën e përfituesve dhe të grupit të synuar. Për të krijuar një profil social-ekonomik të projektit, CoPlan ka ndërmarë një studim social-ekonomik. Grumbullimi i të dhënave është bërë mbi bazën e intervistave derë me derë dhe bisedave në grupe dhe të kompjuterizuara më vonë në programe SPSS. Përveç grumbullimit të informacionit të rëndësishëm në lidhje me strukturën socio-ekonomike të familjeve të përfshira në studim, CoPlan ishte në një pozicion më të mirë për të reaguar në mënyrë të përshtatshme kur lindin probleme (veçanërisht për sa i përket sjelljes së dyshimtë dhe indiferente të banorëve gjatë fillimit të projektit.

*Planifikimi:* A pasqyron planifikimi i projektit rezultatet e analizës?

Për të ankoruar çështjet transversale si ato gjinore në planifikimin e projektit duhet të merren në konsideratë interesat dhe nevojat e ndryshme të grupit të synuar. Prandaj objektivat e projektit duhet të kenë një lidhje të qartë me grupin e synuar.

Objektivat e projekteve “Ndërtimi i kapaciteteve për drejtueset femra në zgjedhjet lokale” dhe banesat informale në Kënetë/Durrës i referohen në mënyrë të saktë barazisë gjinore të grupeve të synuara. Për më tepër projekti në Durrës tregon një referencë ndaj varfërisë duke synuar në stabilizimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të marginalizuar të vendbanimeve ilegale:

<i>Ndërtimi i kapaciteteve për politikanet femra</i>	<i>Banesat informale në Kënetë /Durrës</i>
Përforcimi i rolit të femrave drejtuese në strukturat politikbërëse.	Kontribut në zhvillimin social dhe përmirësimin e vendbanimeve me të ardhura të ulta, nëpërmjet punës për zhvillimin e komunitetit dhe aktiviteteve përmirësuese me bazë komuniteti.
Rritja e ndërgjegjësimit të drejtueseve femra për nxitur perspektivat gjinore në shoqërinë shqiptare dhe për të rritur kapacitetet e tyre për të integruar çështjet gjinore në institucionet dhe projektet e ndryshme komunitare.	Kontribut për zhvillimin e shoqërisë civile, nëpërmjet punës së organizatave komunitare nga njëra anë dhe nga instituti i Co-PLAN si në aktor i rëndësishëm në terren, nga ana tjetër.
Ndërtimi i kapaciteteve të femrave drejtuese të zgjedhura në qeverisjen qendrore dhe lokale.	Marrëdhëniet midis çështjeve gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm: kjo e fundit është e rëndësishme për shkak të kushteve aktuale ekonomike dhe lëvizjes së madhe të popullsisë së zonave rurale në zonat urbane e bëjnë rolin e gruas më tradicional dhe të shtypur. Për këtë arsye ngritja dhe forcimi i grupit të grave dhe integrimi gradual i tij në grupet drejtuese të lagjeve

	mbetet një prioritet. Gjithsesi çdo ndërhyrje në zonë në përgjithësi do të shikohet nën perspektivën e impaktit në të ardhmen e zonës, dhe në kuptimin e nxitjes së barazisë midis gjinive. Kjo pikë do të ndeshet gjithashtu edhe në çështjen e organizimit potencial të "OCB-të e grave", e cila synon të organizojë dhe të përfaqësojë gratë e zonës së Kënetës në rrugën e tyre të njohjes dhe do të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm në zonë.
--	---

Në të gjitha projektet e tjera të vlerësuara objektivat reflektojnë orientimin teknik të projekteve, i cili është i lidhur më tepër me agjencinë implementuese se sa grupin e synuar.

	<i>Trajnimi profesional</i>	<i>4 Fshatrat</i>	<i>DRCRP</i>
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rehabilitimi i dy shkollave profesionale (Saranda)</li> <li>- Zhvillimi dhe implementimi i kurrikulave për menaxhimin e turizmit/agjencitë e udhëtimit (Tirana dhe Saranda)</li> <li>- Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse i 15-20 mësuesve sipas kurrikulave të hotelit/catering dhe menaxhim turistik/agjenci udhëtimi</li> <li>- Hartimi i materialeve mësimore (në shqip)</li> <li>- Mbështetja e materialeve mësimore; përmirësimi i infrastrukturës; mbështetja e lidhjes mësues-shkollë; futja e ideve të reja të marketingut</li> <li>- Transformimi i shkollës së Fierit në një qendër kompetence</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë në tre komuna në rrethin e Shkodrës</li> <li>- Furnizimi me matësa uji</li> <li>- Përmirësimi i njohurive për menaxhimin e duhur dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Reduktimi i dëmeve ekonomike të shkaktuara nga furnizimi i dobët me energji dhe përmirësimi i administrimit të rezervave ujore</li> <li>- Rritja e prodhimit të energjisë, rritja e jetgjatësisë së hidrocentraleve ekzistues dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së energjisë elektrike</li> <li>- Përmirësimi i kushteve fizike të pjesëve të rëndësishme strukturore (digat) në nivel ndërkombëtare</li> <li>- Përmirësimi i sigurisë së punës në hidrocentrale</li> <li>- Nxitja e burimit të pastër dhe të lirë të energjisë</li> </ul>

Projektet teknike synojnë një ndryshim të drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës së grupit të synuar. Gratë tradicionalisht janë përgjegjëse për ekonominë shtëpiake. Uji i pijshëm i pastër apo furnizimi i rregullt me energji elektrike nënkupton një ndryshim të madh në gjendjen e tyre. Asnjë nga përshkrimet e projekteve nuk reflekton në mënyrë sistematike nevojat e ndryshme në grupin synues. Objektivat e projekteve teknike përmbajnë kryesisht shërbime teknike (konsultative) të agjencisë implementuese dhe injorojnë faktin se përmirësimi i shërbimeve të partnerëve të projektit (shkollë, hidrocentral, menaxhimi i ujës/jellësave lokalë) është i lidhur me kërkesat e ndryshme të grupeve të ndryshme (të synuara). Në të kundërt, projektet e para kanë perspektivën gjinore si një pjesë integrale të gjithë konceptimit të

projektit dhe jo si një aktivitet të vetëm, pa ndonjë referencë për komponentët e tjerë të projektit.

*Implementimi/Veprimi:* A e përdorin projektet informacionin për të përafuar aktivitetet e projektit me kërkesat e femrave dhe meshkujve?

Vizitat në terren gjatë vlerësimit treguan se vetëm ato projekte që synojnë në mënyrë eksplicite barazinë gjinore ishin në gjendje të adaptonin aktivitete në përgjigje të nevojave specifike të femrave ose meshkujve. Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve për drejtueset femra në qeverisjen lokale” mbështesin femrat direkt duke kontribuar në profesionalizmin e tyre. Në bazë të intervistave, implementimi i aktiviteteve përmbush tërësisht pritshmërinë e përfituesve direkt.

Projekti në Kënetë/Durrës bazohet në një strukturë participative të përfituesve të drejtpërdrejtë të Kënetës. Aplikimi i konceptit me bazë komunitare nënkupton pjesëmarrjen e barabartë në proceset e opinionbërjes dhe vendimmarrjes së këtij komuniteti. Duke marrë parasysh informacionin e grumbulluar në fazën e planifikimit (studimi socio-ekonomik) agjencia implementuese ishte e gatshme të vepronte sipas kërkesave të grupit. Përfshirja e grave në strukturat komunitare është bërë mbi bazën e një strategjie të diferencuar e cila është implementuar në faza të vogla. Së pari, u identifikuan personat kyç midis grave dhe zgjedhja e grave u bë në nivel lagje në Kënetë. Pastaj, gratë e zgjedhura iu bashkuan burrave në nivelin e bordeve drejtuese. Në fund e ashtuquajtura Asambleja e Përfaqësuesve (CBO në nivelin më të lartë) përbëhet nga 42% e tyre. Përveç kësaj aktivitetet e tjera në projekt synojnë në aktivitetet e grave ose nënave dhe fëmijëve.

Në projektet e tjera raportet e monitorimit kufizohen në ofrimin e shërbimeve të agjencisë implementuese dhe vlerësimet e saj. Nuk nënkuptohet apo kërkohet nga donatori një vlerësim në lidhje me grupin e synuar. Për këtë arsye nuk ka informacion në lidhje me ndryshimet cilësore të organizatave partnere apo të grupeve të synuara. Deri në kohën e vlerësimit, theksi u duke shoqëruar projektet (nga konsulentët monitorues) dhe vlerësimin e duhur të objektivave të arritur.

#### *Vlerësimi i përgjithshëm*

Mbi bazën e dokumenteve të disponuara, as Kancelaria Federale dhe as Ministria e Jashtme nuk ka artikuluar barazinë gjinore si një direktivë eksplicite për OZA. Ligji i Bashkëpunimit për Zhvillim i vitit 2003 – baza ligjore e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim – sanksionon barazinë gjinore si një parim themelor. Për shkak të mungesës së direktivës, për Zyrën Austriake të koordinimit nuk ishte e nevojshme të operonte në mënyrë specifike për aspektet gjinore në projektet e ndryshme.

Kërkesat e sotme për barazi gjinore (dhe gjithashtu informacionet rreth impaktit të aktiviteteve të barazisë gjinore) kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me kuptimin e viteve '90. Evolucioni konceptual i aktiviteteve të veçanta për gratë bazohet në përvojat që projektet e fokusuara në grupet e synuara e asaj kohe nuk tregojnë shumë ndikim në kushtet predominuese dhe diskriminuese. Projekte “të pastra” për gratë shpesh nuk merren me këtë problem për sa kohë ato nuk kanë një ndikim strukturor.

Për të karakterizuar projektet e vlerësuara, projekti “Ndërtimi i kapaciteteve për drejtueset femra në qeverisjen lokale” dhe projektin “banesat informale në Kënetë/Durrës” e konsiderojnë barazinë gjinore si një objektiv primar dhe shprehin qartë barazinë gjinore në projekt-propozimin dhe objektivat e projektit. Barazia gjinore është qendra e hartimit të projektit dhe projekti kërkon një impakt direkt në zonë. Projektet e tjera nuk janë të lidhura me barazinë gjinore. Asnjë nga projektet nuk e ka barazinë gjinore si një objektiv të dytë të

rëndësishëm (por jo kritike për implementimin). Në raste të tilla barazia gjinore nuk duhet të shprehet në mënyrë eksplicite, por të merret në konsideratë në konceptin e projektit.

Duke qenë se metodologjia e vlerësimit nuk fokusohet në matjen e impaktit nuk mund t'i japim përgjigje pyetjes se sa ka kontribuar projektet në barazinë gjinore në Shqipëri.

Për momentin Zyra e Koordinimit nuk është në gjendje të japë kontribut konceptual për të konsideruar më tej aspektet e barazisë gjinore në projektet e financuara, duke qenë se konceptet dhe direktivat përkatëse janë në proces<sup>23</sup>. Aplikimi i duhur i çështjeve që ndërthuren siç janë barazia gjinore në programim për momentin varet shumë nga kontributi nga jashtë, pikërisht nga ADA zyra qendrore.

### 3.4.3 Cilësia në planifikim

*Kriteret kryesore janë: cilësia e hartimit, procedurat, përqasja e ndërhyrjes, pjesëmarrja (përfshirja e aktorëve/partnerëve lokalë) dhe idetë konceptuale*

#### *Hartimi*

Hartimi i projekteve të vlerësuara i përgjigjet mjaft mirë nevojave të identifikuar. Projektet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që të zgjidhin problemet imediate duke vënë në shërbim sistemet e furnizimit me ujë në zonat e zgjedhura të projektit. I njëjti dizajm është përdorur edhe për projektet e arsimit, të cilët para së gjithash synojnë rehabilitimin e shkollave në mënyrë që të mund të bëhet rregullisht mësim.

Në projektin e CoPlan procesi i legalizimit është një parakusht për planin urban që duhet të hartohet. Për këtë arsye dizajmi i projektit përmban faza që garanton përmbushjen e të gjithë kërkesave ligjore dhe teknike. Një komponent tjetër i rëndësishëm konceptual i projektit është aplikimi i konceptit të CBO<sup>24</sup>. Vlerësimi bën të qartë ka një fokus mjaft të fortë teknik duke injoruar dinamikat e realitetit të komunitetit dhe interesat politike. Kjo gjë çoi në një ndërprerje të përkohshme.

Nuk ka të dhëna nëse planet e zhvillimit rajonal janë marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit.

#### *Procedurat*

Projektet ndjekin procedurat e PCM-së në përputhje me standardet e teknike të pranuar në përgjithësi dhe me kërkesat teknike.

#### *Mënyra e ndërhyrjes*

Përqasja e ndërhyrjes së përzgjedhur i përshtatet kapaciteteve të partnerëve implementues..

#### *Pjesëmarrja*

Në përgjithësi planifikimi i projektit është bërë me përfshirjen e partnerëve lokalë. Tek projektet teknike dhe projektin e CoPlanit është zhvilluar një takim kick-off duke përfshirë edhe partnerët lokalë në nivel bashkie dhe komune si dhe përfaqësuesit përkatës të

<sup>23</sup> Direktivat për reduktimin e varfërisë janë hartuar tashmë. Një strategji e formuluar nuk mund të pritet para vitit të ardhshëm. Për momentin vlerësimi i direktivave gjinore po diskutohen intern, por ende nuk kishte një draft-version të shkruar.

<sup>24</sup> Koncepti i organizatave me bazë komuniteti bazohet në aftësimin e njerëzve për të marrë pjesë në proceset e zhvillimit duke ndikuar aktivisht procesin e ndryshimit sipas prioriteteve të tyre. Prandaj koncepti shikohet si i përqëndruar tej njerëzve dhe i drejtë. Në rastin e Kënetës është krijuar një organizatë e re me bazë komunitare.



qeverisjes qendrore. Në sektorin e arsimit ka pasur një bashkëpunim intensiv midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe partnerit implementues.

ADA (respektivisht COOF ka qenë) e përfshirë vetëm në fazën fillestare të projektit, kur është identifikuar dhe aprovuar sektori. COOF është mandatar nga zyra qendrore të vlerësuesve nëse nevojat janë të argumentuara. Në fazën fillestare ministria përgjegjëse duhet të analizonte nevojat në përputhje me politikat dhe strategjitë shqiptare, vazhdon me një verifikim të informacioneve në nivel bashkie, respektivisht me përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit. Më pas planifikimi i detajuar i projektit është në përgjegjësi e agjencisë përkatëse implementuese. ADA nuk merr pjesë në këtë proces (megjithëse ajo merr pjesë në takimin kick-off). Për të parë nëse projekti i përgjigjet standardeve ndërkombëtare të planifikimit implementimit të projektit ADA mandaton një konsulent monitorues për të bërë vlerësimin.

Reagimet nga intervistat tregojnë se në fazat fillestare të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë, identifikimi i nevojave të projekteve përkatëse varej mjaft nga sugjerimet e bëra nga partnerët austriakë, ndërkohë që Qeveria Shqiptare nuk mund të mbështetëj në një planifikim strategjik sistematik. Këto sugjerime ishin rezultat i kontakteve të mira midis bashkëpunëtorëve austriakë dhe partnerëve lokalë dhe njohja në brendësi e situatës prej tyre. Kjo mund të konsiderohet si një përjasje pragmatike ndaj pjesëmarrjes.

#### *Përfshirja konceptuale e tipareve socio-kulturore*

Rëndësia e aspekteve socio-kulturore në projekte është konceptualisht e përfshirë në mënyra të ndryshme. Ndërkohë që CoPlan i jep prioritet të lartë tipareve social-kulturore në analizën e tij, projektet e tjera nuk i referohen në mënyrë të veçantë këtij aspekti. Gjithsesi duket se të gjithë partnerët e projektit – qofshin ata ndërkombëtarë apo lokalë – tregojnë një ndjeshmëri socio-kulturore gjatë implementimit të aktiviteteve dhe përmbushin nevojat e përfituesve në një mënyrë pragmatiste.

### **3.4.4 Implementimi i projektit**

*Kriteret kryesore janë: rezultatet e planifikuara kundrejt rezultateve të arritura*

Vështrimi i përgjithshëm i rezultateve të planifikuara dhe të arritura reflekton në një nivel të lartë arritjen e objektivave.

Rehabilitimi dhe përmirësimi i sistemeve të furnizimit me ujë është bërë mbi bazën e dokumentacionit të projektit. Konsumatorët familjarë në zonat e zgjedhura furnizohen me ujë të pastër për 24 orë. Menaxhimi i sistemit të furnizimit me ujë është përmirësuar në nivel lokal. Gjithsesi procesi i decentralizimit kërkon hapa të mëtejshëm për të arritur efektivitetin e kostos dhe menaxhimin e qëndrueshëm në nivel lokal dhe implementimin ndarjes së detyrave midis njësive të qeverisjes vendore dhe qendrore. Aktivitetet trajnuese duken si hapat e vetëm në këtë drejtim.

Në DRGRP objektivat e vënë mund të arrihen tërësisht mbas një historie të gjatë dhe të vështirë të implementimit të projektit. Fakti që kjo u bë e mundur megjithë vështirësitë, mund t'i atribuohet kryesisht cilësisë së Bashkëpunimit Austriak të përshkruara kudo në këtë raport (p.sh. angazhimi, fleksibiliteti, partnerë implementues kompetentë

KulturKontakt: Projekti i arsimit profesional solli ndryshime pozitive dhe të dukshme në shkollë:

- Ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës
- Zhvillimi i kurrikulave dhe materialeve mësimore
- Zhvillimi i burimeve njerëzore
- Mbështetjen në kontaktet me komunitetin e biznesit

- Shkëmbim përvoja rajonale dhe evropiane
- Aktivitete publike të shkollës.

Megjithatë bashkëpunimi midis shkollave dhe komunitetit lokal të biznesit (aktorët lokalë relevantë) është përmirësuar vetëm pjesërisht. Arsytet e mëposhtme sqarojnë deri diku vështirësitë: biznesi lokal është i interesuar të bashkëpunojë me shkollat, por ka një nevojë më të madhe për aftësi më të mira praktike të nxënësve dhe njohuri në menaxhimin e hotelit. Nga ana tjetër partnerët e biznesit lokal kanë mungesa në menaxhimin e hotelit dhe në shërbim, i cili shpesh bëhet një problem për bashkëpunimin reciprok.

Co-Plan: Faza e parë e procesit të legalizimit është përfunduar me sukses mbi bazën e kornizës logjike. Gjithashtu të gjitha ndërhyrjet që synonin përfshirjen e komunitetit në procesin e planifikimit janë kryer sipas planit. Gjithsesi projekti erdhi në një ngecje, kur interesat në nivel lokal dolën ndryshe nga ç'ishin parashikuar. Për të siguruar vazhdimësinë e një procesi të integruar të planifikimit urban, duket qartë se duhet ndërhyrje e donatorëve.

Horizont 3000: Ndërtimi i kapaciteteve për drejtueset femra në qeverisjen lokale është fokusuar kryesisht në oferta trajnuese. Këto mundësi janë përdorur gjerësisht dhe janë mjaft të njohura për gratë. Pjesëmarrësit e këtyre seminareve kanë një besim të fuqishëm në vetvete dhe një njohje me të mirë të çështjeve gjinore.

Projekti i rehabilitimit të shkollave ka arritur të gjitha objektivat e vëna.

### 3.4.5 Drejtimi i projektit

*Kriteret kryesore janë: vlefshmëria e të dhënave të kërkuara dhe sistem efektiv monitorimi për drejtimin e projektit*

Sistemi ekzistues i monitorimit dhe i grumbullimit të dhënave është mjaft më i dobët sepse është i lidhur vetëm me agjencinë implementuese. Agjencitë/konsulentët implementuese marrin raportet e projektit të agjencive implementuese dhe raportojnë me formatin e tyre tek Bashkëpunimi Austriak. Ky duket se është një akt mjaft formal. Adaptimet e aprovuara nga ADA ishin kryesisht në nivelin e përshtatjeve kohore ose rishpërndarjen e dedikimit të fondeve.

Prandaj projektet drejtohen në nivelin e agjencive implementuese në bashkëpunim me konsulentët monitorues. ADA është pak e përfshirë në drejtimin e projekteve, veçanërisht në çështjet koonceptuale dhe strategjike. Zakonisht përfshirja e ADA-s në drejtimin e projektit ndodh vetëm në rastin e problemeve serioze (p.sh. DRCP, por edhe në rastin e CoPlan). Në raste të tilla COOF preferon të marrë një rol ndërmjetësimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në problem. Raste si DRCP tregojnë se në situata të tilla raporti i mirë midis COOF dhe zyrës qendrore në kombinim me cilësi të tjera të përmendura më parë janë instrumente për gjetjen e zgjidhjeve efektive.

Gjetja e burimeve të jashtme të monitorimit fillimisht ishte menduar si një përmirësim në efektivitet (për shkak të kapaciteteve të kufizuara të COOF). Gjithsesi shfrytëzimi i njohurive të ekspertëve ka çuar në një balancë kritike në drejtimin e programit në lidhje me përgjegjësinë e përgjithshme. Vendime të rëndësishme strategjike dhe kontrolli shoqëruar i projektit është kaluar tek burimet e jashtme. Ekziston rreziku se roli i ADA/COOF është reduktuar në një aktor qetësues.

### 3.4.6 Impakti lidhur me zhvillimin për burrat dhe gratë

*Kriteret kryesore janë: përfitimi direkt dhe indirekt i burrave dhe grave (objektivat e përgjithshme) dhe qëndrueshmëria*

Rehabilitimi i sistemeve të furnizimit me ujë në zonat rurale çon në përmirësime të ndjeshme në kushtet e jetesës së familjeve. Tashmë ofrohet ujë i mjaftueshëm për të pirë për familjarët me një shërbim 24-orë. Përmirësime të tjera vazhdojnë akoma për të siguruar shërbimin. Rehabilitimi i sigurimit të shërbimit vlerësohet shumë nga familjet që jetojnë në këto zona të izoluar. Sigurimi i qëndrueshmërisë së masave nënkupton forcimin e bashkive dhe komunave lokale për t'u kujdesur për menaxhimin e të gjithë sistemit. Për këtë duhet jo vetëm aftësi teknike, por edhe menaxheriale. Për më tepër qëndrueshmëria është e lidhur ngushtë me implementimin e suksesshëm të politikës së decentralizimit. Të gjitha ndryshimet dhe përshtatjet në nivel lokal duhet të jenë në të njëjtën linjë me ndryshimet në nivelin e qeverisjes qendrore dhe anasjelltas. Ky proces vazhdon akoma dhe ka nevojë për kohë.

Projektet e trajnimit profesional kanë pasur një ndikim pozitiv në shërbimin në turizëm dhe prodhimin në bujqësi në të gjithë vendin, po është vështirë të thuhet se sa kjo ka qenë influencë e projekteve të vlerësuara, sepse edhe faktorë të tjerë luajnë rolin e tyre. Projektet Austriake të trajnimit profesional kanë sjellë risi, veçanërisht me mënyrat e reja të punës në shkolla, si puna me projekte, e cila ka përmirësuar njohuritë e mësuesve dhe nxënësve, kanë nxitur punën në grupe dhe aktivitete që sjellin të ardhura. Megjithëse projektet austriake kanë qenë më pak të financuara se ato të donatorëve të tjerë, ato kanë lënë pas më tepër dokumentacion që mund të përdoret më tej, si materiale mësimore dhe kurrikula.

Projektet e zhvillimit social janë shumë "të reja" për të treguar rezultatet në nivelin e impaktit. Gjithsesi mund të thuhet se çështja e ndërtimeve ilegale është një nga prioritetet e axhendës së bashkisë. Mund të thuhet se CoPlan ka kontribuar në këtë ndryshim në qëndrimin bazë pasi ata mbështesin fuqimisht gjatë fazës fillestare të projektit. Nga ana tjetër për shkak të ndërjegjësimit të lartë janë rritur edhe interesat politike. Ky zhvillimi i ri mund të rrezikojë konceptin dhe të çojë në një rishikim të tij për të garantuar qëndrueshmërinë.

Rehabilitimet e shkollave kanë qenë një kontribut i rëndësishëm për mbështetjen e shkollave në zonat e prapambetura. Gjithsesi ka qenë evidente se bashkitë janë ende mjaft të dobëta për të siguruar mirëmbajtjen e ndërtesave. Për të mos rrezikuar kontributin austriak duhet të gjenden zgjidhje për garantimin e mirëmbajtjes.

### **3.4.7 Rekomandime (lidhur me projektet)**

#### *Opinionet kryesore të rekomandimeve kryesore të vlerësimit të projekteve*

Rekomandohet që rehabilitimi i sistemit të furnizimit me ujë – me përshtatje të vogla – të dyzohet në rajone të tjera të Veriut të Shqipërisë ku njerëzit nuk kanë furnizim me ujë të pijshëm. Duhet t'i vihet theksi më tepër ndërtimit të kapaciteteve dhe aftësive menaxheriale. Shembujt gjermanë të shoqatave të ujit mund të ishin shembuj të vlefshëm për zhvillimet organizative.

Për vazhdimin e mbështetjes në sektorin arsimor rekomandohet që në të ardhmen të fokusohet më tepër në nivelin e sistemit për të rritur impaktin. Përveç fuqizimit të kontakteve me biznesin, ministria duhet të mbështesë praktikën mësimore me ndërmarrjet dhe aktivitetet që gjenerojnë të ardhura.

Projekti i grave duhet të studiojë mundësitë e komercializimit të seminareve të trajnimit në mënyrë që të rrisë burimet e veta dhe të ulë varësinë nga mbështetja ndërkombëtare.

Rekomandimet për projektin e Kënetës janë të fokusuar në komponentë konceptuale, ndërkohë që roli i CoPlan ende mbetet mjaft i fortë duke vepruar si ndërmjetës midis komunitetit të prekur dhe bashkisë. Rekomandohet që ADA të jetë më e përfshirë në nivelin drejtues.

Vlerësimi i DRCRP rekomandon marrjen e hapave për garantimin e investimeve si përmirësimi i sigurisë së digave, rishikimi para përfundimit të projektit për të përcaktuar investimet e mëtejshme dhe për të bërë një studim mbi hidrologjinë e hidrocentraleve për menaxhimin afatgjatë të burimeve hidrike. Vlerësuesit i adresojnë ADA-s një rishikim të angazhimit të mëtejshëm në këtë sektor duke përcaktuar një koncept afatmesëm për mbështetjen e sektorit.

Aktivitetet e rehabilitimit të shkollave duhet t'i japin fund qëndrimit të përgjegjësishë humanitare. Mjaft i rekomandueshëm do të ishte integrimi institucional në planet e zhvillimit rajonal.

### **3.5. Koordinimi dhe Bashkëpunimi i Donatorëve me aktorët relevantë**

#### *Koordinimi i ODA dhe përafrimi me politikat e Qeverisë*

Përveç menaxhimit të tranzicionit dhe zhvillimit socio-ekonomik koordinimi efektiv i Asistencës Teknike është një sfidë madhore për Qeverinë shqiptare dhe për donatorët. Ajo duhet të vlerësohet në kuadrin e ambicieve të Shqipërisë për integrimin në BE. Elementët kyçë për koordinimin e Asistencës Teknike janë:

- Koordinimi midis njësive të Qeverisë Shqiptare dhe midis Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve
- Përshtatja e politikës së donatorëve, mbështetjes financiare, instrumenteve të ndihmës dhe asistencës teknike me politikat e Qeverisë, strategjitë dhe strukturat
- Harmonizimi i politikave dhe procedurave të donatorëve me njëri-tjetrin në sistemin e vendit.

Donatorët bilateralë kryesorë janë Komisioni Evropian (më i madhi me rreth 40-45 milion Euro/vit), Itali, Greqia, Gjermania, Zvicra, Holanda dhe SHBA. Institucionet zhvilluese më të mëdha multilaterale janë Banka Botërore (IDA), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), IFAD, UNDP dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI), bazuar në të dhënat e Oda të viteve 2001-2002, IDA, KE dhe SHABA janë donatorët më të fuqishëm në vend dhe arrijnë gati 57% të donatorëve bilateralë.<sup>25</sup>

Konfliktet rajonale (Kosovë 1999, Maqedoni 2001) përshpejtuan përpjekjet për të afruar Evropën Juglindore më pranë strukturave evropiane. Për komunitetin e donatorëve Shqipëria ka luajtur një rol konstruktiv gjatë konflikteve, e cila është vlerësuar me një interes në rritje nga donatorët për të mbështetur Shqipërinë në procesin e saj drejt integritimit në Evropë. Momentalisht BE dhe Shqipëria kanë filluar bisedimet fillestare. Për BE-në një strategji e qartë qeveritare për procesin e integritimit është një parakusht, i cili nënvizon rëndësinë e koordinimit.

#### *Koordinimi midis njësive qeveritare*

Gjatë viteve '90 koordinimi midis departamenteve të njësive të ndryshme qeveritare pothuajse nuk ekzistonin. Në vitin 1994 asistencë e donatorëve koordinohet me Departamentin e Zhvillimit Ekonomik dhe Koordinimin e Ndihmës së Huaj (DEDFAK) në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Një vit më vonë, ky departament u zhvendos në Ministrinë Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregëtisë (MBET) për të menaxhuar asistencën e granteve, ndërkohë që huatë dhe kreditë administroheshin nga Ministria e Financave. Paralelisht kjo e fundit ishte përgjegjëse për përgatitjen e Programit të Investimeve Publike (të financuara nga buxheti i donatorëve dhe i qeverisë), ndërkohë që Ministria e Financave ishte përgjegjëse për buxhetin vjetor.

<sup>25</sup> [www.AidHarmonization.org](http://www.AidHarmonization.org)

Procesi i SKZHES ofroi një mundësi për koordinimin e politikave dhe aktorëve qeveritarë. Qeveria caktoi Ministrinë e Financave si koordinatore kombëtare për draftin e parë të PRSP. Gjithsesi struktura drejtuese për implementimin dhe monitorimin e SKZHES u krijua në nivelin e Grupit të Punës Ndërmintor<sup>26</sup>. Grupe teknike pune dhe njësi të M&E në të gjitha ministritë e linjës filluan implementimin dhe monitorimin e SKZHES.

Duke i dhënë prioritet të lartë integritit në BE u krijua një Ministri e Shtetit (1999). Në vitin 2001 ajo ishte përgjegjëse për koordinimin e negociatave të MSA me BE-në. Deri me krijimin e Ministrisë së Integritit Evropian, asistenca e BE-së koordinohet nga departamenti i Integritit Evropian i pozicionuar direkt në Këshillin e Ministrave. Gjatë kësaj kohe Qeveria krijoi një Departament të Zhvillimit të Politikave dhe të Koordinimit (DPDC). DPDC është përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të ministrive të linjave për mbështetjen e planit 3-vjeçar të veprimeve. Kjo çoi në një situatë të tillë ku të paktën tre institucione ishin në një farë mënyrë apo tjetër për koordinimin e asistencës së donatorëve, p.sh. Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Integritit Evropian dhe DPDC, duke shtuar dyzimet institucionale dhe konkurrencën.

Sot, duket se komunikimi ndër-ministror dhe shkëmbimi i informacionit është larg së qeni ideal. Secila njësi e M&E grumbullon të dhëna – dhe i mban ato. Ndarja e informacionit nuk është një politikë e zakonshme në Qeverinë Shqiptare. Kjo e bën tejet të pamundur verifikimin dhe vlefshmërinë e të dhënave të disponueshme në nivelin qeveritar.

#### *Koordinimi i donatorëve*

Menjëherë mbas tranzicionit të vitit 1991 asistenca (emergjente) ofrohej kryesisht nga donatorët bilateralë në formë granti. Duke filluar me krizën e 1996/97 (skemat piramidale) koordinimi midis donatorëve u zhvillua në kuadrin e OSBE-së – e udhëhequr nga *Miqte e Shqipërisë* (FoA). Me uljen e nevojës për koordinim politik, koordinimi donator u dobësua dhe arriti gati në një ngecje në vitin 2001. Përfshirja e Qeverisë së Shqipërisë ishte mjaft e ulët. Donatorët vendosën axhendën, ofruan sistemin e informacionit, ndërkohë që nuk kishte një ndarje të përbashkët të informacionit.<sup>27</sup> Në të njëjtën kohë në Shqipëri ishin aktivë 27 donatorë bilateralë dhe 12 multilateralë.

Nevoja përmirësimit të koordinimit të donatorëve u kuptua në fundin e vitit 2001, kur Qeveria Shqiptare, BB dhe UNDP iu desh disa herë të zgjidhnin mbivendosjen inefficente të projekteve në vazhdim. Pasi shpresat për iniciativë të qeverisë për të udhëhequr përpjekjet për koordinimin e donatorëve ishin jorealiste, DFID inicioi një tryezë të rumbullakët të donatorëve në Mars 2003. Diskutimet çuan në një arkitekturë më specifike të sistemit të koordinimit të donatorëve dhe disa propozime për më tepër harmonizim dhe përshtatje. Ky proces çoi në krijimin e Sekretariatit Teknik të Donatorëve (në Dhjetor 2003), i mbështetur nga katër agjenci drejtuese: Delegacioni i KE, OSBE, UNDP dhe Banka Botërore. Një rezultat i parë i prekshëm ishte një faqe interneti<sup>28</sup> nën faqen e Delegacionit të KE me një matricë të donatorëve ku informacioni i standatizuar për projektet dhe programet (kodi DAC, shuma, lloji i financimit, statusi) do të sigurohet nga të gjitha agjencitë. Gjithsesi ky instrument është për aq kohë i dobishëm sa të gjitha agjencitë donatore që punojnë në Shqipëri ofrojnë informacionin e nevojshëm rregullisht.

Sekretariati Teknik i Donatorëve e ndan Asistencën Teknike sipas fushës tematike dhe sektorëve të regjuar më poshtë:

<sup>26</sup> E perbërë nga zv/ministri i ministrive të linjës, kryesuar nga Ministria e Financave

<sup>27</sup> Harmonizimi i Donatorëve në Shqipëri, prezantim nga SDC Tiranë, Qershor 2005

<sup>28</sup> [www.delalb.cec.eu.int/en/eu\\_and\\_albania/other\\_donors/htm](http://www.delalb.cec.eu.int/en/eu_and_albania/other_donors/htm)

Agjencia drejtuese	Fusha tematike	Sektori
Banka Botërore	Zhvillimi social dhe ekonomik	1. Bujqësia dhe zhvillimi rural 2. Menaxhimi i burimeve natyrore 3. Energjia 4. Ujësjellës-kanalizime 5. Transporti 6. Sektori financiar 7. Zhvillimi i sektorit privat 8. Mbrojtja sociale 9. Shëndetësia 10. Arsimi 11. Financat publike 12. Turizmi 13. Telekomunikacioni dhe TIK 14. Koordinimi i ndihmës
Bashkimi Evropian	Roli i ligjit dhe siguria	15. Policia, menaxhimi i kufijve, aksionet e minave 16. Azili dhe migrimi/anti trafikimi 17. Reforma ligjore, gjyqësore dhe penale 18. Mbrojtja dhe çështjet e sigurisë
OSBE	Demokratizimi dhe të drejtat e njeriut	19. Parlamenti dhe zgjedhjet 20. Media, Të drejtat e njeriut dhe avokati i popullit 21. Çështjet e pronave 22. Minoritetet
UNDP	Qeverisja dhe ndërtimi i kapaciteteve	23. Administrata publike/anti-korrupsioni 24. Qeverisja vendore, decentralizimi dhe zhvillimi urban 25. Shoqëria civile 26. Menaxhimi i emergjencave civile 27. Barazia gjinore dhe rinia

Marrë nga: Banka Botërore, 2003

Sot po bëhen përpjekje të mëdha nga Delegacioni i KE për të forcuar koordinimin e donatorëve në Shqipëri duke marrë një rol drejtues qendror. Fokusi në ndryshimin drejt një orientimi sa më të ngushtë në nivelin e qeverisjes, për një përfshirje sa më të ngushtë të njësive qeveritare.

Sfidat principiale të harmonizimit janë:

- Mbështetja e përpjekjeve të qeverisë për të vendosur një politikë strategjike konsistente dhe koherente, në mënyrë që donatorët dhe ministrat e linjës mund t'i referohen një kuadri strategjik (duke punuar me një agjenci qendrore).
- Gjetja e objektivave të përbashkët dhe (idealisht) rënia dakord në ndërhyrjet prioritare, duke pranuar që secila agjenci donatore mund të ketë axhendën “e saj”
- Disa donatorë (përfshi Austrinë) kanë një traditë të fortë të ofrimit të asistencës përmes marrëveshjeve bilaterale. Ekziston një lloj frike se përshtatja mund të dobësojë pikat e forta të bashkëpunimit bilateral dhe implementimi i SKZHES (i drejtuar nga OZHM dhe pjesët relevante të PRSP) mund të nënkuptojë një sërë studimesh dhe dokumentesh – që as nuk janë relevante për implementimin efektiv të projekteve, por edhe nuk janë të njohura jashtë Tiranës.

Në nivelin praktik Arkitektura e donatorëve me 27 sektorë të ndryshëm nuk është e menaxhueshme: numri i madh i takimeve nuk është kompatibël me kapacitetet e shumicës së agjencive. Mungesa e pjesëmarrjes së qeverisë dhe mungesa e çështjeve strategjike ndikuan në një situatë të pakontrollueshme. Prandaj dhe arkitektura e donatorëve u


racionalizua në Qershor 2005. Lista e madhe e sektorëve (shiko tabelën e mësipërme) është rishikuar në 2005 dhe reduktuar në 17 sektorë.

### *Përshatja e politikave*

Që në Mars 2003 midis agjencive donatore ekziston një mendim i përbashkët se përshatje nënkupton krijimin e një kuadri konkret të bashkëpunimit i cili lidhet me procesin e PSA, SKZHES dhe OZHM dhe në të njëjtën kohë siguron koordinimin në nivelin sektoril dhe tematik nëpërmjet grupeve të punës dhe angazhimeve paraprake të donatorëve kryesorë.

Duke u mbështetur në Deklaratën e Parisit për efektivitetin e ndihmës në Mars 2005 Qeveria e Shqipërisë aprovi krijimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS). Jo solli përmirësime të dukshme, sidomos duke sjellë politikat dhe strategjitë e niveleve të ndryshme me horizonte të ndryshme kohore siç janë demonstruar më poshtë:

- Planning Set-Up



Procesi dhe struktura për përmirësimin e koordinimit qeveri–donator dhe donator-donator mbetet e brishtë. Agjencitë donatore e vlerësojnë situatën që ende mbetet e fragmentuar në përfaqshjen e të dyve, qeverisë dhe donatorëve. Raportimi mbi kontributet e donatorëve mbetet i ndarë (jashtë dhe brenda qeverisë) ndërkohë që shumë takime sektoriale fokusohen më tepër në ndërhyrjet në nivel projekti, se sa në çështjet politike dhe strategjitë me bazë të gjerë sektoriale.

Në këtë situatë Bashkëpunimi Austriak kërkon zgjidhje pragmatike duke u bashkuar së bashku në “DACH”. DACH përfaqëson një grup informel të agjencive donatore të ngjashme nga Gjermania (DACH), Austria (DACH) dhe Zvicra (DACH) të cilat ndajnë një kuptim të

ngjashëm të përjasjeve të ndërhyrjes dhe të prioriteteve sektoriale. Grupi shkëmben eksperiencë operacionale në projekte specifike të përbashkëta (Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit / A-CH) ose afërsi relative në politikat e ndërhyrjeve në Sektorin e Arsimit Profesional (A – CH – D). Kohët e fundit me këtë grup është bashkuar edhe Holanda – emri ka mbetur i njëjtë për shkak të thjeshtësisë së tij.

### *Harmonizimi*

Agjencitë donatore i deklarojnë qartë problemet e një mori procedurash që aplikon secili donator. Shembulli i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit konfirmon çfarë është më predominante. Disa donatorë madje pranojnë se këtu përfshihen edhe disa kosto shtesë transaksionesh për Qeverinë Shqiptare. Por qëndrimi bazë skeptik i donatorëve kundrejt përshatjeve është se nuk mund të kemi një thjeshtësim të procedurave pa patur një përmirësim të përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë nga ana e qeverisë. Ka mjaft të ngjarë kjo do t'i lejonte donatorët të bënin këtë ndryshim.

Në bazë të informacioneve të Bankës Botërore agjencitë e mëposhtme donatore janë përfshirë në disa prej sektorëve prioritarë

Sektori	Partneri lokal	Agjencia donatore
Bujqësia/Zhvillimia rural	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	USAID/GTZ/Italia/IFAD/DFID/ EU/Japonia/KfW/ FAO/ SDC-seco/Kuwait Fund/Suedia/ Banka Islamike
Arsimi	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	BE/Italia, GTZ, SDC,
Energjia	Ministria e Industrisë dhe Energjisë	EBRD/EIB/IFC/IMF/Italia/ Austria/KfW/Japonia/Seco/USTDA/USAID/ Cida
Mjedis	Ministria e Mjedisit	DFID/EU/GTZ/ITALIAN COOPERATION/SIDA/SDC/UNDP/CIDA
Sektori Finaciar	Ministria e Financave	IMF/IFC/EBRD/USAID/GTZ
Shëndetësia	Ministria e Shëndetësisë	WHO/Italia/OSBE/GTZ/OSFA
Reforma ligjore dhe juridike	Ministria e Drejtësisë	BE/USAID/Italia/OSBE/GTZ/OSFA
Reforma e Administratës Publike	Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike, Këshilli i Ministrave	BE/OSBE/UNDP/DFID/SIDA ITALIA
Mbrojtja sociale	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	DFID/IMF/Italia
Transporti	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	Italia, EBRD, EIB, EU, Greece, Kuwait Fund/ Banka Islamike/Qeveria e SHBA



Ujësjsellat	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	BE/GTZ/KFW/EIB
-------------	--	----------------

Marrë nga: Banka Botërore, Partnerët e BB në Shqipëri

### 3.6. Mekanizmat drejtues të Programeve kombëtare


Në përgjithësi duhen konsideruar dy nivele për drejtimin e programeve në shkallë vendi: niveli i programit dhe ai i projektit. Siç u përmend edhe me sipër, përfaqësja e Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë deri tani ka qenë pragmatike dhe e orientuar nga implementimi. Ajo është fokusuar në nevojat imediate në nivelin mikro (p.sh. në nivel projekti) dhe në ofrimin e zgjidhjeve konkrete në këtë nivel, ndërkohë që çështjet e lidhura me nivelin institucional dhe politik kanë qenë shqetësime të nivelit të dytë.

Ne përputhje me të instrumentet dhe cilësia e drejtimit në nivel projekti duket se është pika e fortë e Bashkëpunimit Austriak, ndërkohë që drejtimi në nivel programi ende mbetet i dobët.

#### Drejtimi në nivel projekti

Struktura kontraktuale për projektet e asistencë në Shqipëri është rregulluar mbi bazën e marrëveshjeve tre-palëshe (Dreiecksvertrag). Palët kontraktuese të kësaj marrëveshje janë:

- Donatori i Përkrahjes (përfaqësuar sot nga ADA dhe mandatuar nga MPJ)
- Përfituesi i Përkrahjes (zakonisht ministria përkatëse në vendin përkatës)
- Agjencia implementues (zakonisht një kompani ose OJQ austriake e kontraktuar).



Marrëveshja e përkrahjes lidhet midis ADA dhe ministrisë së linjës (dhe autoritetet lokale përkatëse). Në marrëveshje pala austriake merr përsipër përgjegjësinë e subvencionimit të një projekti specifik. Ministria shqiptare është përfituese e përkrahjes. Me sugjerimin e ADA ministria mandaton një agjenci austriake (zakonisht një kompani ose OJQ) për

implementimin e projektit. Një kontratë pune specifikon detyrat që do të kryhen nga agjencia implementuese. ADA merr përsipër përgjegjësinë e kostove financiare (duke përfshirë shërbimet e monitorimit dhe konsulences) të projektit të cilat zakonisht merren në konsideratë nga agjencia implementuese. Një deklaratë e agjencisë implementues kundrejt ADA-s si donator i përkrahjes garanton që projekti do të implementohet në mënyrën për të cilën është rënë dakord në marrëveshje.

Fillimisht marrëveshja tre-palëshe është inicuar nga Ministria austriake e Financave në fillimet e Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë. Struktura kontraktuale siguron një transparencë të lartë, veçanërisht për respektimin e procedurave financiare. Për më tepër ajo tregon se krijon edhe *ownership* dhe përgjegjësi nga pala e përfituesit – aktorët shqiptarë. Mjetet financiarë nuk përbëjnë pjesën kryesore të interesave, por implementimi i projektit përkatës. Sipas të gjithë partnerëve të intervistuar marrëveshja trepalëshe ka dëshmuar se është një instrumenti i dobishëm për bashkëpunimin.

Gjatë viteve '90 kur korrupsioni ishte (dhe vazhdon të jetë) një fenomen mjaft i përhapur në kontekstin shqiptar, marrëveshja tripalëshe si bazë ligjore ishte natyrisht e justifikuar. Marrëveshja ruan kontrollin e kalimit të fondeve tek partnerët shqiptarë. Gjithsesi në të ardhmen për të qenë në linjë me principet e *ownership*-it dhe të partneritetit duhet të gjendet një model i cili rrit përgjegjësinë e partnerëve lokalë në implementimin e projekteve. Kjo do të nënkuptojë gjithashtu edhe një përgjegjshmëri në rritje e partnerëve shqiptarë të cilët kërkojnë mbështetje në përpjekjet ekohëve të fundit për të luftuar korrupsionin.


Marrëveshja garanton që agjencia implementuese në bashkëpunim me partnerin lokal janë përgjegjës për monitorimin. Kështu që partneri implementues të jetë kompetent, kjo siguron drejtimin e duhur të projektit. Në ato projekte ku ADA mandaton një konsulent monitorues këto funksione esenciale janë të garantuara. Disavantazhi i kësaj përjasaje të drejtimin të projektit është se ADA në operimet e rregullta ka pak mundësi kontrolli mbi projektet dhe njohuritë dhe eksperiencat e projekteve të ndryshme nuk grumbullohen dhe kapitalizohen në një mënyrë sistematike. Siç e përmend edhe më sipër ADA zakonisht përfshihet në drejtimin e projektit vetëm kur shfaqen vështirësi.

### *Drejtimi në nivel Programi*

Pavarësisht nga fakti se menaxhimi i projekteve është i mirë (shiko 3.3.3 – 3.3.5) vlerësuesit gjetën pak të dhëna për zhvillimin e një drejtimi sistematik dhe efektiv në nivelin e programimit. Ende ndjehet nevoja e zhvillimit të një “kulture” sistematike e PCM në nivelin e programimit. Kjo gjë mundëson kapitalizimin e eksperiencës për të mirën e programimit dhe zhvillimin e politikave dhe është e rëndësishme për sigurimin koherent të cilësisë.

Në përgjithësi struktura institucionale (p.sh. marrëveshje trepalëshe, konsuletët monitorues) e vendos Bashkëpunimin Austriak me Shqipërinë më tepër në nivelin e programimit sektorial se sa në nivelin e një programimi kombëtar. Konceptualisht kjo ishte justifikueshme për sa kohë nuk ekzistonte një program kombëtar për Shqipërinë - një parakusht për zhvillimin e programeve të dobishme kombëtare. Për më tepër gjithë burimet e jashtme të njohurive të ekspertëve dhe kapacitetet e kufizuara për punë konceptuale rezultoi në një rol kryesisht administrativ – dhe deri diku – koordinues të COOF-it për sa i takon nivelin e programimit.

Figura e mëposhtme demonstroi orientimin sektorial të angazhimeve të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë:



based on: Asche/Lauckner „TZ in neuen Formen der Internationalen Zusammenarbeit“ 2002.

Kutitë e verdha janë sektorët ku Bashkëpunimi Austriak është ende aktiv (sketorët socialë janë formimi profesional dhe projekti i grave). Kutitë me hije të verdhë paraqesin aktivitetet e mëparshme si furnizimet ushqimore dhe Ndihma Humanitare).

Në fund të viteve '90 vihet re një përfshirje më e madhe e partnerëve qeveritarë dhe një lidhje e implementimit të projekteve me zhvillimin institucional dhe politik, kryesisht në lidhje me infrastrukturën (DRCRP) dhe arsimin profesional. Gjithsesi këto përpjekje ishin kryesisht rezultat i vështirësive të lindura në implementimin e projekteve (p.sh. DRCRP) ose e përpjekjeve të kufizuara në bazë projekti për të krjuar lidhje me nivelin institucional (p.sh. arsimi profesional) dhe që vareshin nga angazhimi i individëve. Sfida e sotme është se Bashkëpunimi Austriak merr pjesë në debatin që po zhvillohet. Prandaj një pozicionim drejt një përshtatje të rëndësore, të pjesshme ose jo me SKZHES (si dhe MSA dhe/ose OZHM) do të ishte e dëshirueshme.<sup>29</sup>

Në mungesë të strategjisë së programit dhe duke marrë në konsideratë burimet mjaft të kufizuara në drejtimin e programit në COOF (dhe në zyrën qendrore) duhet pohuar se personat e përfshirë kanë bërë të pamundurën për të lidhur implementimin e projekteve me çështjet politike dhe institucionale duke përfshirë koordinimin e donatorëve aq sa e lejonin kapacitetet e tyre.

### 3.7. Impakti i programit në lidhje me zhvillimin

Për një vlerësimin global të relevancës dhe rëndësisë së aktiviteteve të përfundura dhe në vazhdim janë aplikuar tre kriteret:

<sup>29</sup> Duke krahasuar pozicionimin e donatorëve të tjerë: kufizimet në vend (Italia, Greqia) nuk kanë orientim tek SKZHES (politika e PRSP); Gjermania po kërkon shtegu midis MSA dhe OZHM; DFID është mjaft e angazhuar në ndjekjen e debatit të PRSP; SIDA fokusohet (tradicionalisht) në ndërtimin e kapaciteteve në nivel lokal dhe konsideron SKZHES si jorealiste; USAID është angazhuar jashtë mendimeve gjeostrategjike dhe të politikës së jashtme.

- **Relevanca:** Sa mirë i trajtojnë projektet çeshtjet dhe nevojat prioritare të identifikuar të partnerëve shqiptarë (p.sh. bashkitë, komnat, përfituesit)?
- **Lidhja & Renditja:** A ka një vazhdimësi të përshtatshme për të siguruar efektivitetin e kontributit dhe të aktiviteteve, p.sh. lidhja me zhvillimet institucionale dhe në nivel politik? A janë përsëritur ndërhyrjet dhe modelet pozitivë? A i lidhin donatorë të tjerë aktivitetet e suksesshme me vazhdimësinë dhe përsëritjen?
- **Impakti:** A janë integruar në mënyrë të mjaftueshme aktivitetet e projektit në proceset e zhvillimit në nivel kombëtar apo lokal për të garantuar ndryshime të qëndrueshme? Çfarë duhet bërë për të përmirësuar impaktin?

Ndërhyrjet janë të fragmentarizuara dhe për këtë relevanca e programit kufizohet në atë të projekteve individuale.

Rezultatet e projekteve janë padyshim relevant për atë që ato i përgjigjen nevojave të identifikuar nga partnerët shqiptarë. Projektet mbështesin sektorë dhe çeshtje ku secili prej tyre është relevant për zhvillimin socio-ekonomik dhe për procesin e tranzicionit në Shqipëri. Siç është treguar në vlerësimet e projekteve, ndërhyrjet janë në linjë edhe me aspektet e ndryshme të politikës dhe strategjive austriake për zhvillim. Këto janë për shembull zhvillimi ekonomik dhe punësimi (rehabilitimi i infrastrukturës bazë, arsimit profesional), mbrojtja e burimeve natyrore dhe fuqizimi i zhvillimit të strukturave demokratike. I parë në kohë, mënyra e ndërhyrjes i përshtatet në një mënyrë pragmatike rrethanave.

Nga ana tjetër për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme të zhvillimit institucional dhe dialogut në nivel politik, relevanca e programit ndaj strategjive shqiptare është e kufizuar. Kjo mungesë e lidhjes midis ndërhyrjeve të projektit dhe nivelit institucional (p.sh. kontribut në zhvillimin e sistemit) dhe në nivelin politik (p.sh. kapitalizmi i eksperiencës së mikro-nivelit duke e çuar në zhvillim në nivel politike) e redukton impaktin e përgjithshëm të Bashkëpunimit Austriak pavarësisht një performace të mirë në nivel projekti (“zgjdhje ishull”).

Në tërësi Asistenca Teknike Austriake mund të vlerësohet deri tani si e përshatshme në një mënyrë pragmatiste dhe me një botëkuptim të mirë të situatës në projekte konkrete që i përgjigjen nevojave të dukshme. Duke marrë në konsideratë gjendjen gjatë tranzicionit strategjia austriake korrespondon si më poshtë:

<i>Kushtet kuadër</i>	<i>Fokusi i Bashkëpunimit Austriak</i>
Struktura qeveritare të dobëta dhe jo të qëndrueshme gjatë viteve '90	Vendosja e fokusit të punës operacionale në nivelin më të ulët
Situatë jo e qëndrueshme dhe mungesë e besimit midis njerëzve dhe shtetit	Krijimi i rezultateve të dukshme duke rehabilituar shërbimet/infrastrukturën bazë
Korruptim i aktorëve shtetërorë	Sigurimi i miratimit bazë dhe krijimi i bazës kontraktuale me një situatë fitore-fitore për të gjithë (Qeveria fiton reputacion dhe nderim)

Që nga ky moment pragmatizmi austriak duhet të plotësohet me një perspektivë më strategjike në termat e përfaqësive dhe projekteve. Përfaqësues vetëm teknike i ka ardhur fundi. Projektet si “Kënetat –Durrës” nuk do të kishin ndodhur nëse do të ishte zbatuar një përfaqëse strategjike. Burimet ekzistuese të Zyrës së Koordinimit Austriak duhet të përdoren në mënyrë që të përmirësojnë sinergjitë, harmonizimin dhe përshtatjen me politikat lokale. Parakusht

për këtë është mundësisht njëfokusim më i qartë në programim dhe një pjesëmarrje aktive në koordinimin e donatorëve.

#### 4. PROGRAMIMI NË TË ARDHMEN I BASHKËPUNIMIT AUSTRIAK

##### 4.1. Konkluzione të përgjithshme (mësimet e nxjerra)

- Pikat e forta të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë janë projektet që i përgjigjen efektivisht nevojave bazë të popullit shqiptar dhe që në përgjithësi janë implementuar nga organizata partnere kompetente duke konsideruar siç duhet kontekstin lokal. Projektet janë identifikuar dhe hartuar në një mënyrë pragmatike, ku duhet thënë se angazhimi i individëve të përfshirë dhe njohja e mirë e kontekstit lokal nga ana e tyre kanë qenë përcaktuese për cilësinë e projekteve.

  - \* Këto janë avantazhe krahasuese që duhen ruajtur për zhvillimin e programeve dhe përfaqesat e Bashkëpunimit Austriak në të ardhmen, në linjë me sfidat e reja.
- Si rezultat i kontekstit jo të qëndrueshëm politik dhe mungesë së eksperiencës së partnerëve shqiptarë në përcaktimin e politikave të zhvillimit dhe në vendosjen e prioritetëve përkatëse në fillim të viteve '90, donatorët nuk u udhëhoqën mjaftueshëm nga Qeveria Shqiptare për përcaktimin e mbështetjes së tyre. Nga ana tjetër buxheti austriak ishte i kufizuar, por kërkonte vizibilitet. Një implementim eficient i aktiviteteve të kuptueshme me kosto të ulët transaksioni ka qenë një aspekt i rëndësishëm. Për këtë arsye Bashkëpunimi Austriak u zhvillua kryesisht në bazën e mundësive dhe ndërhyrjeve duke u fokusuar në nivel projekt ose mikro. Rezultati është një portofol i gjerë projektesh i cili është mjaft i fragmentuar në sektorë dhe tematika. Ndërkohë Qeveria Shqiptare ka formuluar strategjinë e saj të zhvillimit (SKZHES, 2001) dhe e përditëson atë në mënyrë periodike (ARP-1 & ARP-2, 2004). Në nivel ndërkombëtar axhenda e OZHM dhe PSA të BE-së ofrojnë kuadrin strategjik të cilat ndihmojnë në përcaktimin e prioritetëve. Me këtë kriteri i "eficences" është zëvendësuar me "efektivitetin".

  - \* Për të rritur efektivitetin e Bashkëpunimit Austriak nevojitet një përshtatje më e mirë me politikat dhe strategjitë lokale në ato sektorë ku ADA dëshiron të jeta aktive. Kjo gjithashtu do të lejojë një përfshirje më të fuqishme në zhvillimin e politikave me partnerët.
- Në fakt Programi Austriak përmban dobësi konceptuale për shkak të heterogjenitetit të tij të paargumentuar dhe lidhjes jo të qartë me kuadrin në nivel politike ndërkombëtar. Bashkëpunimi Austriak i përgjigjet pak a shumë vetëm direktivave të tij strategjike (strategjia e OZA) dhe është përgjithësisht në linjë me prioritetet shqiptare (SKZHES). Angazhimet specifike me axhendën politike ndërkombëtare (p.sh. reduktimi i varfërisë, OZHM) mbeten të paqarta. Nuk janë të qarta opinionet austriake në lidhje me PSA, të cilat ndikojnë jo vetëm Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim por edhe angazhimet në të ardhmen të politikës së jashtme dhe të sigurisë.

  - \* Për të rritur koherencën e programeve të Bashkëpunimit Austriak me politikat relevante, nevojitet më tepër qartësi se ku dhe si është pozicionuar programi në kuadrin politik.
- Eksperienca e fituar nga implementim i projekteve nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm dhe kthyer në koncepte dhe strategji. Arsyet janë të shumëllojshme. Në nivelin implementues besimi i fuqishëm tek partnerët implementues dhe zhburizimi i

- funksioneve monitoruese shoqëruar me kapacitetet e kufizuara të COOF e bëjnë të vështirë grumbullimin sistematik dhe të përpunimit të informacionit, në mënyrë që ai të jetë tek ADA në formën e mësimëve të nxjerra / eksperiencave të konsoliduara. Tek zyrat qendrore (ende) nuk janë institucionalizuar qartë procese specifike, struktura (p.sh. diskutime) dhe burime për kapitalizimin e eksperiencave. Zhvillimi i direktivave për sektorin energjetike (Enregjia për zhvillimin e qëndrueshëm, direktiva e OEZA, draft 2005) shënon një ndryshim në këtë drejtim.
- \* Për të siguruar që strategjitë dhe programet janë relevante dhe realiste, ato duhet të zhvillohen mbi bazën e eksperiencave të konsoliduara dhe të dokumentuara (praktikë e mirë). Prandaj kapitalizimi sistematik i eksperiencës është një parakusht për hartimin / zhvillimin koherent të programit të ADA-s, si dhe për dialogun politik me partnerët dhe donatorët e tjerë.
  - Për implementimin, bashkëpunimi Austriak ende mbështetet në një masë të konsiderueshme tek OJQ-të dhe kompanitë Austriake (ose ndërkombëtare). Me përmirësimin gradual të partnerëve potencialë shqiptarë dhe për të qenë në linjë me angazhimet e bëra “Deklaratën e Parisit për Efektivitetin e Ndhmës” (p.sh. donatorët përdorin më tepër sistemet kombëtare) është i nevojshëm një kalim drejt implementimit lokal.
    - \* Kërkohet më tepër theks në ndërtimin e institucionave lokale dhe rritjen e kapaciteteve dhe kompetencave lokale.
  - Deri tani koordinimi i donatorëve nënkuptonte bashkimin e forcave të donatoreve të ngjashëm për të zgjidhur problemet në lidhje me projektet, ose shkëmbimi i eksperiencës në disa sektorë, ose pjesëmarrja në grupet e dialogut politik. Me nënshkrimin e “Deklaratës së Parisit” donatorët dhe vendet partnere angazhohen në një përcaktim të qartë të koordinimit të donatorëve në lidhje me harmonizimin.
    - \* Implementimi i këtij angazhimi kërkon ndryshime thelbësore në përfaqësimin e implementimit të programit duke vendosur kërkesa të reja ndaj COOF-it. Prandaj është i nevojshëm një përqendrim i portofolit dhe rritje e kapacitetit konceptual të COOF-it dhe të zyrës qendrore të ADA-s.


## 4.2. Rekomandimet

### 4.2.1 Nga projektet tek Programi për mbështetjen e strategjisë së partnerit

(1) *Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë është hartuar si një program<sup>30</sup> në mbështetje të strategjisë së partnerit.*

Ne rekomandojmë ri-dizenjimin e Bashkëpunimit Austriak në mënyrë që të zëvendësohet tërësia e projekteve aktuale me një program që i përgjigjet në mënyrë të qartë politikave dhe strategjive – që ekzistojnë ndërkohë – të partnerëve shqiptarë. Dizajni i programit tregon qartë se si Austria kontribuon në tërësinë e rezultateve të zhvillimit të vendit partner, Shqipërisë.

Ky rekomandim i përgjithshëm ka një numër konsekuencash të cilat janë reflektuar në rekomandimet e tjera në lidhje me (a) orientimin tematik, (b) përjasjet dhe (c) kërkesat organizative. Hartimi i Programit të Bashkëpunimit Austriak në të ardhmen me Shqipërinë është një proces iterativ (hap pas hapi): përcaktimi i orientimit tematik është i lidhur ngushtë me përjasjen e treguar për implementimin (p.sh. vendimi i përshtatjes së Bashkëpunimit Austriak me strategjitë qeveritare e fokuson zgjedhjen e sektorët atje ku Qeveria Shqiptare ka strategji të qarta dhe të përshtatshme. Struktura organizative është përgjigja operative për orientimin tematik dhe përjasjen e zgjedhur.



<sup>30</sup> Program do të thotë "tërësia e ndërhyrjeve të përcaktuara kohore që mund të prekin sektorë/tema dhe/ose zona gjeografike" (përkufizimi i DAC).

Programet lidhin aktivitetet në nivelin mikro dhe në nivel projekti me zhvillimin institucional dhe politik (lidhja mikro-meso-makro).

## 4.2.2 Përcaktimi i orientimit tematik

*(2a) Shumëllojshmëria e projekteve është zëvendësuar me një përqëndrim tematik të programit në 2 ose maksimalisht 3 sektorë ose tema.*

Implementimi i një përjasje programi nënkupton që ndërhyrjet janë konceptualisht të lidhura me kuadrin institucional dhe politik (lidhja mikro-meso-makro), edhe nëse ato nuk përfshijnë aktivitete në të gjitha nivelet. Kjo nënkupton një përfshirje më substanciale të burimeve dhe ekspertizës për dialogun politik, zhvillimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve (shiko gjithashtu strategjinë e MPJ (Programi 3-vjeçar 2004 – 06).

Përshtatja dhe harmonizimi i ndërhyrjeve e bën koordinimin më kërkuar. Përqëndrimi lejon luajtjen e një roli më të fortë në një sektor të veçantë.

*(2b) ADC mbështet sektorë që përputhen me prioritetet e partnerëve dhe ndërhyrjet kontribuojnë tek rezultatet e përcaktuara nga strategjitë e partnerëve.*

Me ratifikimin e “Deklaratës së Parisit për Efektivitetin e Dnimes” si Austria ashtu edhe Shqipëria angazhohen në mënyrë të qartë që “programet e koordinuara të përputhen me strategjitë kombëtare të zhvillimit”. Ndryshe nga fillimet e Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë, SKZHES dhe pjesërisht edhe strategjitë sektoriale dhe planet e veprimeve sot përcaktojnë prioritetet e partnerit. Prandaj vendimi se në cilin sektor është më e përshtatshme mbështetja duhet të bazohet në këto strategji. Ndërhyrjet e veçanta të programit Austriak në një sektor duhet të hartohen në mënyrë të atillë që të kontribuojnë në rezultatet (për një sektor) të përcaktuar në strategjitë dhe planet e veprimit shqiptare.

*(2c) Ndërhyrjet dhe përjasjet në sektorë janë koordinuar me ato të donatorëve të tjerë aktivë në sektor.*

Në ridizenjimin e programit në përputhje me prioritetet e partnerëve shqiptarë, duhet të merren në konsideratë kontributet e donatorëve të tjerë në sektor në kuptimin e komplementaritetit dhe përjasjes. Sfidat reale të këtij harmonizimi janë në implementim. Në bazë të Deklaratës së Parisit ajo shkon përtej koordinimit donator, sepse ajo kërkon përshtatjen e procedurave të caktuara të donatorëve të veçantë në një procedurë të përbashkët. Projekti i DRCRP është një shembull i ilustrimit të saj. Donatorët i koordinuan aktivitetet e tyre, por nuk ndryshuan procedurat e tyre. Në këtë rast harmonizimi për shembull nënkupton donatorët bilateralë i largohen ndihmë së angazhuar. Një përjasje praktike drejt harmonizimit mund të ishte propozimi për të aplikuar dhe ndjekur 12 indikatorët e përcaktuar në Deklaratën e Parisit tek Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë.

*(3) Në sektorët ku ADA vazhdon me një përfshirje substanciale, konceptet e thjeshta sektoriale ofrojnë drejtimin për hartimin e ndërhyrjeve dhe për dialogun politik.*

Ne rekomandojmë përkthimin e analizave sektoriale (sektor review) të rekomanduara më sipër në koncepte sektoriale. Pasi të jetë sqaruar orientimi tematik, analizat e sektorëve mund të përdoren për të përcaktuar koncepte të thjeshta sektoriale të cilët përcaktojnë të paktën principet bazë, kuadrin dhe përjasjen e mbështetjes së ADC-së në sektor, mbi bazën e strategjive të partnerëve shqiptarë (përshtatja) dhe të strategjive të përgjithshme sektoriale të OZA (ku ekzistojnë).



## Skicë provizore e hapave për Përqëndrimin Tematik

Hapat	Aktorët Austriakë	Sektori / Partnerët	Interesat specifike	Shqetësimet e përgjithshme
<b>1) Konsultime me BMaA</b>	BMaA dhe ADA		Menaxhimi i përgjigjet rekomandimeve të vlerësimit – vendimet në lidhje me rekomandimet duhen përkthyer në konfirmime veprimi, specifikime të orientimeve strategjike bazuar në strategjitë e OZA dhe në skicën provizore të fondeve të deponueshme për 5 vitet e ardhshme	
<b>2) Konsultime me Partnerët Shqiptarë</b> (mbi bazën e vendimeve strategjike midis BMaA dhe ADA)	COOF	<u>Energji:</u> Min. e Energjisë & Infrastrukturë & KESH	Prioritetet dhe nevojat në sektorin kombëtar të hidroenergjitikës për 5-10 vitet e ardhshme. Identifikimi i fushave potenciale të mbështetjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prioritetet e partnerëve lokalë</li> <li>• Fushta e mbështetjes ku Bashkëpunimi Austriak është më efektiv</li> <li>• Mundësitë tentative për mbështetjen austriake</li> <li>• Lidhjet e mundshme të niveleve mikro-meso-makro</li> <li>• Vlerësim tentativ i kapaciteteve për implementimin lokal dhe nevojat përndërtimin e kapaciteteve</li> </ul>
		<u>Ujësjiellës-Kanalizime:</u> Min. e Energjisë & Infrastrukturë Autoritetet lokale / Ndërmarrjet	Plani i reformave dhe mundësitë për të kontribuar në të përmes projekteve në nivelin lokal.  Potencialët për renditje, përfshirja në reformën institucionale	
		<u>Arsimi dhe Formimi Profesional:</u> Min. e Arsimit / Min. e Punës	Interesi i përgjithshëm për mbështetje për forcimin e tregut lokal (nëpërmjet shkollave) në subsektorët turizëm dhe/ose bujqësi	
		<u>Zhvillimi urban:</u> Min. e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit; Bashkia Durres	Kapacitetet dhe potencialet për të kontribuar në procesin e legalizimit. Prioritetet e bashkisë	
		<u>Barazia gjinore:</u> Financim direkt i OJQ-ve	Financim i OJQ-ve	
<b>3) Konsultime me donatorë të tjerë në sektor</b> (mbi bazën e vendimeve strategjike midis BMaA dhe ADA)	COOF	<u>Energji:</u> a) BB, BERZH, SDC për mbështetjen e autoriteteve kombëtare	a) Potencial dhe përjasje për të koordinuar implementimin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përjasjet, instrumentet dhe zonat (gjeografike) të ndërhyrjeve duhet të krahasohen dhe duhet të identifikohen mundësitë për harmonizim ose dhe implementim të përbashkët</li> <li>• Mekanizmat e koordinimit.</li> <li>• Koordinimi / mundësisht ndarja e detyrave</li> </ul>
		b) KfW & pronarët e hidrocentraleve të vogla për mundësinë e mbështetjes së tyre	b) Potencial dhe risk në nënsektorin e hidrocentraleve të vegjël. Identifikimi i strategjive të mundshme për mbështetje	

Hapat	Aktorët Austriakë	Sektori / Partnerët	Interesat specifike	Shqetësimet e përgjithshme
		<u>Ujësjellës-Kanalizime:</u> GTZ, SDC, BB (?)	Krahaso përqasjet dhe përcakto kërkesat minimale për të mbështetur projekte në nivel lokal Potencial për përqasje të koordinuar	në ndërtim kapacitetesh dhe zhvillim i politikave
		<u>Arsimi dhe Formimi Profesional:</u> CARDS, grupi DACH	Potencial për përqasje të koordinuar dhe zona të ndërhyrjes (gjeografike dhe profesione)	
		<u>Zhvillimi urban:</u>	Krahaso aktivitetet/ndërhyrjet për të forcuar shoqërinë civile Punë rregulluese ekzemplarike	
		<u>Brazia gjinore:</u> <u>(OECD)</u>	Kontribut për shoqërinë civile	
<b>4) Consolidimi analizë sektoriale</b>	COOF - ADA	Workshop ADA-intern	Konsolidimi i analizave sektoriale dhe i draft-propozimit për rihartimin e programit	
<b>5) Consultatme me BMaA</b>	ADA, BMaA		Marrëveshje për linjat e Programit të ri	
<b>6a) Përcaktimi i detajeve të programit</b>	COOF	<ul style="list-style-type: none"> <li>Partnerët lokalë</li> <li>Donatorët e përfshirë në sektor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcakto ndërhyrjet dhe angazhimet implementuese</li> <li>Përcakto zonat e veprimeve të përbashkëta / ndarja e detyrave në sektor /mekanizmat e koordinimit</li> </ul>	
<b>6b) Përcaktimi i detajeve të implementimit</b>	ADA & COOF	<ul style="list-style-type: none"> <li>Partnerët implementues</li> <li>Konsulentët monitorues</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përshtat rolin dhe detyrat me kërkesat e reja</li> <li>Ri-organizo monitorimin</li> </ul>	
<b>7) Koncepte sektoriale</b>	ADA & COOF		Konsolido rezultatet e analizave në koncepte të thjeshta sektoriale	

### 4.2.3 Përfaqset dhe kërkesat operacionale

*(4) Ndërhyrjet austriake janë të përshtatura me strukturat lokale dhe janë implementuar nëpërmjet sistemeve dhe partnerëve lokalë ku është e mundur.*

Nëse përqëndrimi tematik është përcaktuar nëpërmjet procesit të mësipërm, është bërë një hap i madh në përshtatjen e programit austriak me strategjitë dhe prioritetet shqiptare. Gjatë implementimit ndërhyrjet mund të përshtaten më tej në zonat ku ekzistojnë strategjitë rajonale.

Konsekuenca kryesore e përshtatjes është implementimi përmes sistemeve lokale. Kjo mund të mos jetë e mundur deri në një farë mase tek të gjithës sektorët. Furnizimi me ujë (ndërmarrjet lokale) dhe Arsimi dhe Formimi Profesional (shkollat) janë në të përshtatshmet në këtë këndvështrim.

Në varësi të kapaciteteve të partnerëve duhet të konsiderohen instrumentë të ndryshëm për implementim (mbështetje buxheti, SWAp, bashkëpunim i deleguar ose modalitete projekti dhe bashkëfinancim me donatorë të tjerë).

Kjo nënkupton për ADA rishikimin e strukturës së implementimit për të gjitha ndërhyrjet. Në përgjithësi sistemi shqiptar duhet të përdoret pa mbajtur struktura paralele si PIU. Më tej, mandatimi i partnerëve (austriakë) aktualë implementues duhet të përshtatet ndaj ndërtimit të kapaciteteve të implementuesve lokalë.

*(5) Monitorimi është strukturuar në mënyrë që të përmirësojë përgjegjshmërinë për rezultate dhe kapitalizmin e eksperiencave.*

Nëse ADA vendos të implementojë përmes strukturave lokale mbi bazën e strategjive të studiuara të partnerëve, sistemi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të përshtatet në dy mënyra

- a) Forcimi i implementimit përmes strategjive të partnerit nënkupton që rezultatet dhe arritjet e ndërhyrjeve austriake kontribuojnë direkt në arritjet dhe ndryshimet e dëshiruara në ambientin e partnerit siç është përcaktuar në strategjinë kombëtare të partnerit (SKZHES ose planet e zhvillimit rajonal). Bazuar në zinxhirin e rezultateve të cilat identifikojnë impaktin e pritshëm të zhvillimit, arritjet e kërkuara dhe arritjet/rezultatet specifike që kontribuojnë tek arritjet, programi Austriak përcakton rrugën për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Kjo përfaqësohet jo (si më parë) në kontributet në projekt/program dhe në analizën e impaktit, por në arritjet e dëshiruara dhe pastaj duke identifikuar se çfarë kontributesh dhe veprimesh nevojiten për të arritur ato (krahaso 4.2.2.).
- b) Së dyti, kapitalizimi i eksperiencës duhet të sistemizohet për të siguruar që një sintezë e njohurive të fituara ndihmon në formëzimin e mëtejshëm të strategjive dhe politikave të Bashkëpunimit Austriak. Kjo është kryesisht një çështje organizative: kapitalizim sistematik i eksperiencave nënkupton që strukturat dhe proceset janë përcaktuar dhe burimet shpërndahen në mënyrë të tillë që informacioni i monitoruar (praktikat e mira) rishikohen periodikisht dhe sintetizohen.

#### 4.2.4 Kërkesat organizatve / institucionale

**7a** *Ndarja e detyrave midis Zyrës qendrore dhe COOF është sqaruar dhe përshtatur kundrejt kërkesave të hartuara nga harmonizimi dhe përshtatja e ndihmës.*

Përfaqsjë programore dhe axhendat e bashkëpunimit ndërkombëtar (p.sh. harmonizimi dhe përshtatja) e zhvendosin “qendrën e gravitetit” pa drejtimin e programit në nivelin kombëtar. Si rrjedhojë do ishte e përshtatshme një ndarje e detyrave midis BMAA, ADA dhe COOF:

<b>BMAA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktimi dhe drejtimi i pozicioneve të politikës së zhvillimit</li> <li>• Përcaktimi i kuadrit strategjik</li> <li>• Koordinimi midis ODA austriake dhe agjencive të tjera bilaterale dhe multilaterale</li> <li>• Koordinimi me Ministrinë e tjera Austriake (koherenca)</li> </ul>
<b>ADA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja dhe implementimi i programeve dhe projekteve</li> <li>• Drejtimi strategjik i programeve në Shqipëri</li> <li>• Mbështetje, këshillimi i BMAA në përgatitjen e politikave dhe strategjive të zhvillimit</li> </ul>
<b>COOF</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Koordinimi i implementimit të programeve dhe projekteve dhe zhvillimi i dialogut politik në vend</li> </ul>

*Ndarja e detyrave midis ADA dhe COOF për programet kombëtare:*

Detyrat kryesore	Zyra qendrore	Zyra lokale
<b>Zhvillimi i programit</b>	Vrojtimi i kontekstit Orientimi strategjik i programit Strategjitë sektoriale (me COOF) Kapitalizimi i eksperiencave për zhvillimin e politikave dhe strategjive.	Vrojtimi i kontekstit. Identifikimi i mundësive, përgatitja dhe negociimi i projekteve të reja
<b>Koordinimi i Programit / Menaxhimi</b>	Drejtimi strategjik (përfshi monitorim) i programit Kontraktimi i (agjencive Austriake implementuese) Mbështetje konceptuale e COOF Vlerësimi dhe kontrolli	Drejtimi (përfshi onitorimin) i programit dhe projekteve, sigurimi që principet kryesore dhe çështjet ndërtematike janë marrë parasysh dhe janë shfrytëzuar sinergjitë.
<b>Dialogu politik, koordinimi i donatorëve</b>	Mbështetja e BMAA dhe COOF në koordinimin donatorëve dhe në dialogun politik	Ruajtja e çështjeve kryesore. Pjesëmarrja në takimet koordinuese të donatorëve dhe në dialogun politik.
<b>Mbështetje</b>	Mbështetje administrative ndaj COOF	Administrimi/kontabilitetit
<b>Përfaqësim dhe Informacion</b>	Marrëdhëniet me publikun Politikat informuese	Përfaqësimi i ADA-s tek partnerët lokalë dhe publiku

**(7b)** *Kapacitetet dhe kompetencat e COOF i përshtaten kërkesave të harmonizimit dhe të përshtatjes së ndihmës.*

Nevojitet më tepër kapacitet në kuptimin e stafit dhe të ekspertizës për një ndërveprim më intensiv me partnerët shqiptarë dhe donatorët e tjerë. Për sektorët dhe çështjet e mbështetura nga programi, COOF duhet të ketë ekspertizën e duhur për një dialog kompetent me partnerët dhe donatorët në vend. Ajo gjithashtu duhet të ketë burimet për të identifikuar nevojat dhe të organizojë mbështetjen për zhvillimin institucional të partnerëve dhe të përfshihet në dialogun politik në fusha të zgjedhura.

Hapat e parë në këtë drejtim kanë nisur me punësimin e një specialisti për sektorin e infrastrukturës. Bashkë me analizimin e sektorëve dhe përcaktimin e programit ADA ka nevojë të identifikojë më tej kërkesat aktuale për staf të COOF-it.

**(8) *Organizmi i monitorimit përshtatet me kërkesat e implementimit lokal dhe të kapitalizmit të përmirësuar të eksperiencave.***

Nëse monitorimi kuptohet në mënyrë e sqaruar më sipër organizimi i monitorimit duhet të përshtatet. Sistemi i delegimit të kesj detyre tek konsulentët monitorues duhet të rishikohet. COOF ka detyrën e drejtimin të Programit Austriak, ajo duhet të ketë informacionet e nevojshme gati, p.sh. mënjanimi nëpërmjet konsulentit monitorues nuk është shumë praktik. Në mënyrë të ngjashme partnerët lokalë të implementimit kanë nevojë për sistemin e tyre të monitorimit. Prandaj detyra kryesore e konsulentëve monitorues duhet të jetë vënia në dispozicion e mbështetjes metodologjike tek partnerët lokalë për ngritjen e sistemit të tyre të monitorimit.

Në nivelin e COOF arritja e rezultateve të përcaktuara për çdo sektor, duke përfshirë edhe arsyet për (mos-)arritjet, duhet të konsolidohen në nivel projekti në analiza vjetore. Përkrah vrojtimit të kontekstit të përgjithshëm<sup>31</sup> ky informacion i konsoliduar është një instrument i rëndësishëm për drejtimin e programit.

Në nivelin e zyrës qendrore të ADA-s i njëjti informacion i plotësuar me vlerësimet e kontekstit rajonal shërben si një input për drejtimin strategjik të të gjithë programit të OZA. Së bashku me rezultatet e vlerësimeve periodike ai është gjithashtu një kontribut për zhvillimin e një analize periodike të strategjive sektoriale dhe të strategjisë së përgjithshme të OZA. Për këtë kapitalizim të eksperiencave duhet të organizohen grupe ekspertësh ose grupe me fokusim tematik duke përfshirë edhe ekspertët nga terreni, nga zyra qendrore (BMAA dhe ADA) dhe konsulentët.

Rezultatet (strategjite / konceptet sektoriale) janë instrumente të rëndësishme për drejtimin programor dhe dialogun në nivelin e COOF duke respektuar ndarjen e detyrave të rekomanduara më sipër.

**(9) *Instrumentet e procedurave të menaxhimit të projektit aplikohen më sistematikisht nga ADA***

Për të ndërtuar një bazë më të mirë për monitorimin e programit kombëtar, duhet detyrimisht të aplikohen instrumente dhe procedura. Standardizimi duhet të ofrojë të dhëna dhe informacion për kontributin e parashikuar të ADA-s për procesin e zhvillimit të Shqipërisë.

*Procedurat e planifikimit:* Zyra qendrore e ADA-s duhet të përcaktojë elementet e një strategjie kombëtare dhe standardet. Elementet janë p.sh përgjegjësitë, mekanizmat për konsultimet me njësitë brenda ADA-s dhe me njësitë e tjera administrative të administratës qeveritare austriake (koherenca e politikave) për marrjen e vendimeve. Është e rëndësishme që partnerët e ndryshëm implementues të përdorin të njëjtat procedura (format/standard) për PCM se vetëm kështu garantohet krahasueshmëria.

<sup>31</sup> Me harmonizimi duhet të merret parasysh mundësia për vlerësime të përbashkëta të kontekstit në komunitetit e donatorëve.

*Procedurat monitoruese:* Sistemet e monitorimit të projekteve specifike duhet të sistematizohet në mënyrë të tillë që informacioni dhe të dhënat e grumbulluara të furnizojë monitorimin e programit. Në nivel programi, fokusi i monitorimit duhet të jetë tek arritjet, relevanca dhe qëndrueshmëria (impakti strukturor).

*Standardizimi i instrumenteve & formateve:* Zyra qendrore e ADA-s duhet të prioritarizojë instrumentet e kërkuara për programim dhe të prezantojë formate të standardizuara për aplikime të detyrueshme (vlefshmëria, madhësia, volumi dhe struktura e dokumentit, vështrimi retrospektiv – parashikimi, angazhimet – disbursimet financiare të mëparshme – referenca(t) me instrumentet e tjerë për programimin, etj.) për të mundësuar implementimin e programeve.

### 4.3 Opinione plotësuese për implementimin e rekomandimeve

#### 4.3.1 Nevoja e pozicionimit të Bashkëpunimit Austriak në kuadrin politik

Pikënisja për konfigurimin e një skeme të re operacionale të Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri është pozicionimi brenda kuadrit aktual politik. Angazhimet e marra në forumet ndërkombëtare janë udhëzues të rëndësishëm për të përcaktuar përfshirjen specifike austriake në vendin partner. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të përgjithshme të kuadrit politik ku duhet të pozicionohet Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë. Në të njëjtën mënyrë kushtet e kuadrit operacional duhet të merren në konsideratë edhe për përcaktimin e orientimit tematik, modalitetet e implementimit dhe masat organizative të programit të bashkëpunimit austriak..

Kuadri politik	Cështjet relevante për bashkëpunimin Shqiptaro-Austriak
<i>Niveli ndërkombëtar</i>	Axhenda OZHM: reduktimi i varfërise PSA – BE: stabiliteti, integrimi rajonal
<i>Niveli shqiptar</i>	NSEED: Zhvillimi ekonomik dhe social Strategjitë sektoriale kombëtare & planet e masave: p.sh. sektori energjitik
<i>Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë</i>	Politika austriake për Bashkëpunimin me vendet e Evropës Lindore. Koherenca me politikat shqiptare Politikat e tjera austriake: Koherenca

Kuadri operacional	
<i>Niveli ndërkombëtar</i>	Deklarata e Parisit për Efektivitetin e Ndhmës & Romë: Harmonizimi & Marrakech: Menaxhim për rezultatet e zhvillimit: Implikimet në bashkëpunim
<i>Niveli shqiptar</i>	Programi austriak i bashkëpunimit me Shqipërinë: Orientimi tematik / sektorial dhe modalitetet e implementimit
<i>Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë</i>	Programi austriak i bashkëpunimit me Shqipërinë: menaxhimi i programit, monitorimi

#### *Kuadri politik*

Shqipëria është angazhuar në OZHM dhe në të njëjtën kohë kërkon të nënshkruaj Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me BE-në. Sipas Qeverisë (SKZHES, Raporti i

ecurisë 2004) “SKZHES dhe OZHM mbajnë peng axhendën e qeverisë për *zhvillimin ekonomik dhe social*, ndërkohë që MSA ofron një udhërrëfyes strategjik drejt *integritit evropian*. Ekziston një lidhje tematike midis të tre axhendave ... por ato janë edhe të ndryshme sepse OZHM përfaqëson kryesisht një *axhendë politike*, SKZHES përfaqëson një *strategji të gjerë afat-mesme* dhe MSA përfaqëson një *instrument specifik* duke operuar me kuadrin e përgjithshëm të SKZHES”.

#### Prioritetet e MSA, SKZHES dhe OZHM

	MSA	SKZHES	OZHM
<b>Prioritetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtësi</li> <li>• Rendi publik dhe siguria</li> <li>• Kapacitetet administrative</li> <li>• Zhvillimi ekonomik dhe social</li> <li>• Mjedisi dhe burimet natyrore</li> <li>• Stabiliteti demokratik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja ekonomike</li> <li>• Stabiliteti makroekonomik</li> <li>• Shëndetësia</li> <li>• Arsmi</li> <li>• Infrastruktura</li> <li>• Shërbimet publike</li> <li>• Qeverisja</li> <li>• Kujdesi social</li> <li>• Zhvillimi urban dhe rural</li> <li>• Mjedisi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe urisë</li> <li>• Kryerja universale e arsimit fillor</li> <li>• Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas</li> <li>• Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore</li> <li>• Përmirësimi i shëndetit të nënës</li> <li>• Lufta kundër virusit të HIV/AIDS dhe sëmundjeve të tjera</li> <li>• Garantimi i qëndrueshmërisë së mjedisit</li> <li>• Zhvillimi i një partneriteti global</li> </ul>

Duke dhënë këtë listë të gjerë të prioritetëve duhet të sqarohet në konsultime minids partnerëve shqiptarë dhe KE se si janë vendosur këto prioritate të tre axhendave për pesë vitete e ardhshme. Pyetjet janë p.sh. se nëse objektivat e MSA dhe OZHM janë të njëjta për këtë kohë apo ka një zhvendosje drejt prioritarizimit të MSA? Cilat janë prioritetet me atë të cilave Shqipëria synon arritjen e OZHM-ve?

Në nivelin e SKZHES konsiderata të tilla mund të çojnë në renditjen e prioritetve në një linjë kohore. Për përcaktimin e orientimit tematik të Programit të Bashkëpunimit Austriak një sqarim i tillë i kuadrin politik është i nevojshëm për përshtatjen e programit me axhendën e partnerit.

Në nivelin e tretë ka një koherencë të konsiderueshme midis Politikës Austriake për Bashkëpunim me Evropën Lindore (Plani tre-vjeçar 2004-06: Programi Kyresor i Bashkëpunimit Austriak) dhe SKZHES jo vetëm për faktin e listës së gjatë të prioritetëve. Politika austriake ka një fokus të qartë në “axhendën Evropiane” (p.sh. kritere si “integriti në Politikën e Jashtme Austriake”, mbështetja e përbushjes së kriterëve të Kopenhagenit”) e cila është e lidhur ngushtë me orientimet tematike. Ato fokusohen në ekonominë dhe punësimin, projektet infrastrukturore në ujësjelles, energji dhe mjedis dhe në arsimin e orientuar nga punësimi. Këto tema të përqëndruara në ekonomi plotësohen me temën “qeverisje” duke përfshirë edhe rolin e ligjit dhe mbështetjen e shoqërisë civile për parandalimin e krizave.

Kundrejt këtij sfondi dhe portofolit aktual të projekteve çështja kryesore për tu sqaruar në nivelin politik është se cila balancë minids OZHM (reduktimi i varfërisë) dhe Axhendës së BE-së (zhvillimi ekonomik dhe stabiliteti) është e përshatshme. A mund

të përputhen angazhimet e bëra në axhendën e OZHM me një fokus të qartë në zhvillimin ekonomik?

#### *Kuadri operacional*

Deklarimet e bëra gjatë viteve të fundit kërkojnë mjaft qartë implementimin e bashkëpunimit nderkombëtar nepërmjet “sistemeve kombëtare”, aty ku këto sisteme funksionojnë mirë.

Për të vlerësuar se sa mirë janë zhvilluar strukturat lokale, një mundësi do të ishte analizimi i Bashkëpunimit Shqiptaro-Austriak kundrejt 12 indikatorëve të Deklaratës së Parisit si një linjë bazë për vitin 2006, duke rënë së bashku dakord se çfarë synimesh mund dhe duhet të arrihen deri në vitin 2010. Në kombinim me përcaktimin e orientimit tematik / sektorëve që duhet të mbështeten (shiko më poshtë), kjo gjë lejon identifikimin e nevojës për zhvillimin e kapaciteteve tek partnerët shqiptarë në këto sektorë.

### **4.3.2 Analizë e sektorëve potencialë**

Në procesin e propozuar konsideratat e bëra në nivelin politik dhe analiza e propozuar me poshtë e sektorëve potencialë detyrimisht duhet të konsolidohet në një program. Duke parë për mundësitë në sektorë ka një predominancë të zhvillimit ekonomik dhe deri diku të objektivave mjedisorë. Prandaj duhet t'i përgjigjemi pyetjes se deri në çfarë mase dhe se si integrohen në program orientimi i nevojave si dhe objektivat e qeverisjes dhe shoqërisë civile (prioritetet tematike të OZA).

Duke u nisur nga aspekti i përqendrimit tematik ka pak të ngjarë të shtohen sektorë të rinj në program. Prandaj përforcimi i përqasjeve specifike – të grupit të orientuar nga nevoja dhe fokusimet specifike gjeografike brenda sektorëve do të ishin një përqasje e përshtatshme. Qeverisja dhe shoqëria civile e orientojnë vetveten drejt çështjeve ndër-tematike, edhe pse jo në çdo sektor dhe në të njëjtën masë. Duke aplikuar konsideratat e mësipërme të sektorëve të Bashkëpunimit Austriak potencialet dhe mundësitë e fushave aktuale të ndërhyrjes janë si më poshtë:

**Energji:** Veçanërisht energjia hidrike është nga të gjitha këndvështrimet një sektor me prioritet të lartë në Shqipëri. Ndërprerjet e vazhdueshme të elektricitetit dëshmojnë rëndësinë e një furnizimi të qëndrueshëm me energji për ekonominë. Qeveria ka bërë progres të dukshëm në zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator (p.sh. Enti Rregullator i Energjisë, Strategjia Kombëtare e Energjisë) dhe ka nisur reforma institucionale duke ofruar një bazë premtuese për investime të mëtejshme në sektor. Me DRCP ADA është e përfshirë në një projekt domethënës dhe ka zhvilluar një bashkëpunim të mirë me donatorët e tjerë në sektor, ka ndërtuar një reputacion tek partnerët shqiptar. Eventualisht në energjinë hidrike Austria ka një ekspertizë të lartë për të ofruar.

Përfshirja e sapo nisur në energjinë diellore ofron alternativa, por zor se është një kontribut thelbësor në zgjidhjen e problemit të energjisë në Shqipëri. Prandaj dhe nëse “energji” është një nga sektorët ku ADA dëshiron të përqendrojë mbështetjen e saj, duhet të identifikohen me partnerët e saj mundësi të reja në prodhimin e enregjisë hidrike os në shpërndarjes e saj. Analiza e rekomanduar teknike përpara përfundimit të DRCP mund të jetë një mundësi për të vlerësuar vazhdimin e angazhimit në sektor, së bashku me donatorët e tjerë të përfshirë. Në linjë me kërkesat e partnerëve dhe me “Strategjinë për Mjedisin, Ujësjetat dhe Energinë” (2004 – 06) të OZA një përfshirje e mëtejshme nuk duhet të jetë e madhe, “vetëm” investime. Në princip ka dy mundësi. Njëra është të mbështetet projektet e



ndërmarrjes shtetërore (KESH). E dyta është një skemë për rehabilitimin e hidrocentraleve të vegjël. Pavarësisht nga fakti se këto hidrocentrale janë privatizuar, ngritja e një partneriteti privat-publik, ku mund të shfrytëzohet ekspertiza austriake, në kombinim me një skemë të përshatshme financimi (fonde garancie për garantuar aksesin në kreditë e buta komerciale) mund të ishte në linjë me objektivat dhe parimet e ADA-s. Me kusht që pronarët e hidrocentraleve të jenë seriozisht të interesuar për të operuar hidrocentralet e tyre dhe që të krijohet një kuadër i qëndrueshëm rregullator, këto hidrocentrale kanë një potencial për të kontribuar në zgjidhjen e krizës energjetike në një mënyrë të qëndrueshme. Për të dy mundësitë ADA duhet të bashkëpunojë ngushtë me donatorët e tjerë të përfshirë. Në rastin e ndërmarrjes shtetërore ky bashkëpunim është i ngritur mirë, në rastin e hidrocentraleve të vegjël kryesisht mund të ishte KfW, e cila është aktive në këtë fushë.

**Ujësjellës-Kanalizime:** Duke u nisur nga furnizimi i dobët me ujë dhe gjendja e kanalizimeve në Veri të Shqipërisë një angazhim i vazhdueshëm në këtë sektor është koherent si me prioritetet shqiptare, ashtu edhe me strategjinë e OZA. Qeveria po zbaton reforma në këtë sektor. Krahasuar me sektorin energjetik ende nuk kanë përparuar, pjesërisht ngaqë janë të lidhur ngushtë me zbatimin e ligjit të decentralizimit. Nëse do të vazhdojë mbështetja në këtë sektor, përfaqsa teknike duhet të lidhet me reformën institucionale (p.sh. mbështetja e decentralizimit, krijimi i ndërmarrjeve lokale të furnizimit). Rehabilitimi i infrastrukturës duhet të kombinohet me ndërtimin e kapaciteteve të njësive lokale të menaxhimit për operimin dhe mirëmbajtjen (O&M) e sistemit. Duke qenë se funksionimi i ndërmarrjeve lokale varet nga reforma e zhvilluara nga qeveria, do të ishte me vend mbështetja e këtij procesi në aspekte të veçanta. Prandaj bashkëpunimi më i ngushtë me partnerët shqiptarë në nivelin politik dhe me donatorët e tjerë aktivë në sektor (p.sh. KfW, GTZ, SDC) do të ishte parakushti për zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

**Formimi profesional:** Megjithëse projektet konsiderohen si relevantë dhe me prioritet të lartë, fokusi i përgjithshëm mbetet në nivel projekti dhe tërësisht i fragmentuar. Në strategjinë shqiptare – por jo domosdoshmërisht për të rinjtë shqiptarë – trajnimi profesional ndoshta nuk ka patur të njëjtën relevancë si në strategjinë e OZA, ku trajnimi profesional i orientuar drejt punësimit paraqet një prioritet të qartë. Gjithsesi nën projektin CARDS reforma e AFP është duke bërë progres. Ndër komponentet institucionale, Këshilli kombëtar i AFP po bëhet operacional, dhe do të krijohet një Agjenci e AFP. Ndër komponentet e zhvillimit të sistemit janë ndjekur katër çështje: 1) Ngritja e një sistemi të analizimit të tregut të punës; 2) Zhvillimi i standardeve të profesioneve; 3) Zhvillimi dhe përcaktimi i një kuadri kombëtar të kualifikimeve dhe 4) Zhvillimi i kurrikuave në profesione të zgjedhura mbi bazën e standardeve të profesioneve. Projekti CARDS është angazhuar për harmonizimin e reformës së AFP në Shqipëri me procesin evropian dhe bërjen e sistemit kompatibël me EQF (Kuadri evropian i kualifikimeve) dhe më vonë me ECVET<sup>32</sup>. Një proces për zhvillimin e strategjisë kombëtare të AFP deri tani ka rezultuar në një dokument udhëzues, i cili identifikon ato fusha, të cilat kërkojnë mbështetje të mëtejshme të donatorëve, p.sh. pikërisht forcimin e delegimit dhe inovacionit lokal.

Në nivelin e zhvillimit institucional dhe të sistemit CARDS vazhdon të mbetet prtaneri kryesor i Qeverisë Shqiptare.

<sup>32</sup> Në Bashkimin Evropian janë inicuar dy procese për zhvillimin e Kuadrit Evropian të Kualifikimeve (EQF) dhe një Sistem Evropian i Kreditimit për Arsimin dhe Formimin Profesional (ECVET). Proceset njihen me emrin Kopenhagen dhe Mastriht, dhe ato janë procese të ngajshme me procesin Bolonjës për harmonizimin e arsimit. Ato synojnë të fuqizojnë bashkëpunimin në arsimin dhe formimin profesional dhe në njohjen e certifikatave.

Ndryshe nga ky sfond mbështetja për forcimin e delegimit dhe inovacionit lokal në degët që lidhen me turizmin dhe/ose bujqësinë është potenciali më i dukshëm për një përfshirje më të gjerë të Bashkëpunimit Austriak në këtë sektor. Fokusi mund të vendoset në zhvillimin e një portofoli të plotë në këto dy nën-sektorë dhe në sigurimn e cilësisë, duke përfshirë krijimin e një sistemi çertifikimi (p.sh. provimet përfundimtare) në këto degë, bazuar në nivelet dhe standardet e përcaktuara nga projekti CARDS.

Meqenëse turizmi dhe bujqësia janë të lidhur me zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, një përfshirje e tillë nuk do të kontribuonte vetëm në zhvillimin e sistemit të AFP-së, por gjithashtu do të jetë e lidhur me punësimin.

**Zhvillimi urban/rural:** Projekti në Kënetë (Durrës) duket të jetë një ndërhyrje relativisht e izoluar në këtë sektor. Në këtë projekt ADA zgjeroi përjasjen teknike të mekanizmave rregullues të planifikimit dhe rregullimit urban drejt aspekteve të zhvillimit social dhe ligjor të komunitetit. Duke marrë në konsideratë ndërhyrjen ende të vogël në sektor dhe ekspertizën duhur që kërkohet për trajtimin e të gjitha aspekteve të zhvillimit të komunitetit, ADA duhet të rishikojë këtë aktivitet duke vendosur me kujdes se ku do të gjenden burime të mëtejshme (fonde, burime njerëzore) për një ndërhyrje më të gjerë dhe të thelle (p.sh. çështja e tokave dhe pronave). Vazhdimi i këtyre lloj ndërhyrjesh kërkojnë përfshirje më të madhe dhe intensive të ADA. Ose ADA duhet të zvogëlojë aktivitetet në minimum duke bërë një financim të vetëm (one-off payments) tek projektet lokale të cilat kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë civile.

**Ndëtimi i kapaciteteve të grave:** Mbështetja e iniciativave lokale është pa diskutim shumë e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë civile. Mbështetja teknike është siguruar nëpërmjet njësisë së barazisë gjinore tek OSBE. ADA duhet të dedikojë (earmark) fonde të tjera në një bazë afatgjatë, në mënyrë që ky proces të vazhdojë.

**Ndihma humanitare:** Në kontekstin e tanishëm, ky sektor nuk ka më relevancë.

**ANEKS 1**

Lista e të intervistuarve (telefon/me shkrim dhe/ose bisedë direkte)

<b>Emri</b>	<b>Funksioni</b>
Barbara Torggler	ADA Njësia e Vlerësimit
Peter Kuthan	ADA Njësia e Vlerësimit
Anton Mair	MFA Vlerësimi
Ingrid Sager	MFA, Drejtuese e VII/5c Bashkëpunimi me vendet e EJL
Spirik Hermann	MFA , Drejtues i VII/5 Programimi
Linhart Michael	ADA, drejtor ekzekutiv
Raunig Florian	ADA, ish-Desk Albania/Macedonia & ish COOF
Neuwirth Hubert	ADA, Desk Albania/Macedonia & ish COOF
Irene Kaufmann	Kancelaria Federale
Klaus Kapper	Magistrat Vienna
Christopher Opancar	Drejtuesi i Zyrës së koordinimit Tiranë
Florenc Qosja	Drejtues administrativ, Zyra e koordinimit Tiranë
Sokol Avxhiu	Ish-Asistent, Zyra e koordinimit Tiranë
Ergys Papaproko	Ish-Asistent, Zyra e koordinimit Tiranë
Ambasador Klaus Derkowitsch	Ambasada Austriake Tiranë
Pius Rohner	SDC Albania, Drejtuesi i COOF
Eduard Rumani	SDC Albania
Robert Hall	Delegacioni i KE
Ismail Beka	Koordinator i GTZ
Jonas Bergström	Konsulent i SIDA
Altin Ilirjani	Ekspert i shkencave politike
<b>DRCRP</b>	
Philippe Keller	SECO, Zvicër
Stefan Denzler	Programme Officer, SECO Albania
Hadj Djilanji	Programme Officer, SECO Albania
Fatmir Hoxha	Drejtor i KESH-it, Shqipëri
Marialis Celo	PMU KESH , Shqipëri
Helmut Obermoser	Zv/Menaxher i projektit, COLENCO
Ludwig Becke	Konsulent
Bujar Leka	Ministria e Industrisë dhe Energjistikës, Shqipëri
Besim Islami	AKE
Yildiran Murat ev.	EBRD Tirana, Shqipëri
Donald Mishaxhi	EBRD Tirana
Brian Copley	EBRD London
Winfried Schönbacher	Inxhinier projekti, Andritz
Severino Diriwächter	Manager Field Service, Fierza
Piro Trebicka	Zyra e KfW, Tiranë
Edmond Hido	Qendra e Eficiences së Energjisë Shqipëri-BE
<b>Furnizimi me ujë 4 Fshatrat</b>	
Jusuf Tufi	Drejtor i PIU-t, MRRTT
Sadedin Limani	Monitorimi i projekteve, MRRTT
Reme Bujar	Koordinimi i projekteve ndërkombëtare, MRRTT

Merita Kazazi	Programimi dhe Zhvillimi rajonal, Shqipëri
Malaj Bequir	Kryetari i komunës Ana i Malit
Hila Zef	Kryetari i komunës Bushat
Orhan Miloti	Konsulent i IC në Shqipëri
Claudia Link Krammer	Konsulente e IC
Christine Wick	Konsulente monitorizuese Kommunalkredit
<b>Arsimi profesional</b>	
Mott Monika	KulturKontakt, Austria
Sobanski Florian	KulturKontakt, Austria
Tagini Gerlinde	Kulturkontakt, Tirana
Rushdi Recj	Ekspert në Ministrinë e Arsimit
Sotir Rrapo	Drejtuës i Dep. AP, Ministria e Arsimit
Mirela Andoni	Instituti pedagogjik, Tiranë
Astrit Bezati	Drejtori i Shkollës së Hotelerisë Tiranë
Nevila Qurku	Drejtoresha e Shkollës së Hotelerisë Sarandë
Perparim Musa	Ish-Drejtori i Shkollës së Hotelerisë Sarandë
Elvana Lula	Mësuese
<b>Këneta, Durrës</b>	
Shutina Dritan	Drejtor i CoPlan, Tirana
Oriana Arapi	Koordinatore e projektit CoPlan, Kenenta
Indrit Puteci	Shefi i kabinetit, Bashkia Durrës
Doriana Llambiri	Departamenti i Urbanistikës Durrës (Prefekturë)
Silva Akcani	Ministria e Ekonomisë
Marjani Agim	Ministria e Ekonomisë
Sibylla Zech	Trafico Stadtland
Helmut Koch	Trafico Stadtland
<b>Projekti i grave</b>	
Schreiber Elisabeth	Horizont 3000, Vjenë
Eglantina Gjermeni	Qendra e Gruas Tiranë
<b>Rehabilitimi i shkollave</b>	
Samara Brikena	Cafod Albania

## SHTOJCA 2<sup>33</sup>

### Termt e Referecës

#### Vlerësim i Bashkëpunimit Austriak me vendet e Evropës Lindore Shqipëria 1991/1992 – 2004

##### 1. Vështrim në retrospektivë

Tashmë që prej më shumë se dhjetë vitesh Shqipëria përbën një ndër vendet e fokusuara të Bashkëpunimit Austriak me Evropën Lindore. Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë ka filluar pas trazirave politike dhe shkatërrimit të infrastrukturës që shoqëruan atë periudhë, si edhe pas krizës së urisë që pasoi në vitet 1990. Gjatë viteve të para të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë në plan të parë ishte dhënia e ndihmave humanitare, mbështetja e të përndjekurve dhe ndërmarrja e masave fillestare për rehabilitimin e infrastrukturës së nevojshme - në këtë rast mund të përmendnim hidrocentralet në Shkodër dhe në lumin Drin.

Në mënyrë që aktivitetet që ndërmerreshin në Shqipëri të ishin më të strukturuar dhe më sistematike, në vitin 1994 u krijua në Tiranë Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik. Por gjithsesi për shkak të situatës politike dhe humanitare në vend Zyra Austriake e kishte të vështirë që në vitet, të cilat pasuan krijimin e saj, të ndiqte një rrugë sistematike bashkëpunimi dhe zhvillimi.

Madje në fund të vitit 1996, për shkak të situatës politike, zyra u desh të mbyllej dhe u arrit të hapej përsëri vetëm në muajin prill të vitit 1998. Gjatë kësaj kohe shumica e projekteve u pezulluan përkohësisht. Pas rihapjes së Zyrës së Bashkëpunimit në vitin 1998 filluan të ndërmerren përsëri aktivitetet mbështetëse dhe/ose u zgjeruan nëpërmjet një bashkëpunimi intensiv me institucionet partnere në nivel qeveritar/ „Parastatals“. Në portofol u integruan edhe sektorë të rinj. Krahas projekteve në sektorin e furnizimit me ujë, të energjisë dhe të shëndetit, u ndërmorrën edhe iniciativa në sektorin e arsimit dhe në sektorin e zhvillimit të zonave rurale. Me kalimin e viteve krijimi i marëdhënies të ngushta të bashkëpunimit me organizatat partnere lokale - si institucionet publike, ashtu edhe ato private dhe OJQ-të- u bë gjithnjë e më i rëndësishëm.

Gjatë viteve të fundit i është kushtuar më shumë rëndësi problemeve të ngutshme sociale dhe strukturore, me të cilat po përballet shoqëria shqiptare. Këtu mund të përmendnim migrimin nga zonat rurale në ato urbane dhe vendosjen informale në rritje në periferinë e qyteteve të mëdha, pabarazitë gjinore, papunësinë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Shqipëria (sipas FAO-s) është vendi më i varfër i Evropës. Kohët e fundit Qeveria Shqiptare ka hartuar një Strategji Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (NSSD – National Strategy for Social and Economic Development), e cila pritet të shërbejë si grafik pune (program) për arritjen e Synimeve të Rritjes të Mijëvjeçarit (MDGs) dhe anëtarësimi të Shqipërisë në BE, gjë të cilën Qeveria Shqiptare synon ta arrijë në vitin 2015. Hartimi i NSSD dhe klima tashmë më e qëndrueshme në vend kanë kontribuar për krijimin e premisave bazë, të cilat favorizojnë zbatimin e një modeli zhvillimi sistematik, të plotë dhe programatik.

Orvatja e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe për Vendet e Evropës Lindore, që duke u konsultuar dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat partnere shqiptare të sektorit publik dhe atij privat, të krijojë një strategji për programet vendore me Shqipërinë, duhet parë në kontekst me situatën e përshkruar më sipër.

##### 2. Objekti i vlerësimit

**Objekt i vlerësimit është Bashkëpunimi Austriak në EL, dhe në këtë rast me Shqipërinë për periudhën kohore 1991/2 – 2004.** Vlerësimi do të përqëndrohet në tërësinë e mbështetjes dhe ndihmës austriake dhe jo në analizimin e detajuar të projekteve të veçanta. Vlerësimi do të hedhë dritë mbi pikat e forta dhe të dobëta të planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të aktivitetëve të zhvilluara në sferën e caktuar politike, sociale dhe ekonomike.

<sup>33</sup> Termt origjinalë të Referencës janë hartur në Gjermanisht si një pjesë përbërëse e marrëveshjes kryesore midis ADA-s dhe KEK CDC Consultants. Versioni në anglisht i ToR është përkthyer direkt nga ADA mbi bazën e versionit origjinal në gjermanisht.

Vlerësimi do të shqyrtojë bashkëpunimin dhe mbështetjen kryesisht lidhur me rendësinë, ndikimin e tyre afatmesëm dhe afatgjatë (impakti) dhe qëndrueshmërinë e tyre; gjithashtu do të analizohet edhe koordinimi dhe bashkëpunimi me iniciativë të tjera zhvillimi. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet „pronësisë“, „partneritetit“ dhe impaktit socio-kulturor.

Përveç kësaj vlerësimi do të analizojë se si ka reaguar Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim ndaj premisave bazë të ndryshuara dhe sfidave të zhvillimit, e parë kjo nga pikëpamja institucionale/organizative, strukturore, si edhe lidhur me burimet njerëzore dhe të personelit.

Ndërkohë që për krahasimin e të dhënave të grumbulluara mund të shfrytëzohen edhe rezultatet e vlerësimeve, gjithmonë nëse ekzistojnë të tilla, dhe që janë zbatuar për projekte të ngjashme nga organizata të tjera donatore bilaterale, ose nga Komisioni Evropian.

Projekti i vetëm, i cili në kuadrin e vlerësimit konkret duhet parë me imtësi, është rehabilitimi i hidrocentraleve të Drinit (Rehabilitation of the Drin Hydro-Electric Power Plants), i cili nëse i referohemi volumeve të tij financiare, paraqet projektin më të madh austriak në Ballkan. *(Për më shumë detaje shih aneksin për këto TOR).*

### 3. Qëllimi i vlerësimit

**Qëllimi i vlerësimit është që të nxirren mësim nga këto më shumë se 10 vite mbështetjeje e bashkëpunimi, dhe nga kjo eksperiencë të arrijnë të jepen rekomandime specifike, që në këtë mënyrë të jepen kontribute dhe inpute për Strategjinë e Zhvillimit në të ardhmen dhe për programin e bashkëpunimit në të ardhmen midis Austrisë dhe Shqipërisë.** Vlerësimi nënkupton një mundësi për të mësuar së bashku, nga e cila do të përfitojnë si Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim në Shqipëri dhe në Vjenë, ashtu edhe organizatat partnere shqiptare.

Pritet që nga vlerësimi të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- Rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit do të krijojnë një element të rëndësishëm konstruktiv për hartimin e planifikuar të një Strategjie dhe Programi Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë.
- Është rritur mirëkuptimi i Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim lidhur me sfidat e ndryshme që paraqiten gjatë bashkëpunimit me Vendet e Evropës Lindore, krahasuar me ato të Evropës Jugore.
- Proçesi i vlerësimit ka forcuar bashkëpunimin ndërmjet partnerëve austriak dhe shqiptar (stakeholders) dhe ka rritur mirëkuptimin e tyre lidhur me pikat e forta, pikat e dobëta dhe mundësitë e punës së tyre të përbashkët.
- Bashkëpunimi Austriak me Shqipërinë dhe Organizatat e tij partnere shqiptare janë në gjendje që të përmirësojnë punën e tyre në të ardhmen, të rrisin rëndësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e saj.

### 4. Pvetje kyçe

#### Rëndësia:

Deri në ç'pikë kanë përkuar projektet/aktivitetet e mbështetura nga Bashkëpunimi Austriak në Shqipëri me nevojat dhe prioritetet e shqiptarëve dhe të qeverisë shqiptare? Në çfarë mënyre u përshtatën ato me prioritetet dhe strategjitë e atëhershme të rëndësishme kombëtare dhe lokale (përfshirë këtu edhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin social-ekonomik, të hartuar para pak kohësh – NSSD - dhe strategjitë e politikave të rëndësishme sektoriale)? A paraqesin projektet/aktivitetet një kontribut të rëndësishëm për uljen e varfërisë dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë?

Si e vlerësojnë sot partnerët kombëtar dhe lokal (stakeholders) rëndësinë e Bashkëpunimit Shqipëri - Austri gjatë këtyre 10 – 13 viteve të fundit, si edhe rëndësinë e tij lidhur me nevojat dhe prioritetet lokale/kombëtare?

Me sa fleksibilitet ka reaguar Bashkëpunimi Austriak në Shqipëri ndaj ndryshimit të vazhdueshëm të kushteve politike, sociale e ekonomike dhe prioriteve në vend? Cilët faktorë kanë mbështetur ose penguar një bashkëpunim fleksibël dhe të orientuar nga klienti? Sa mirë ishte/ është pajisur Zyra Austriake e Bashkëpunimit Teknik në Shqipëri dhe e gjithë Struktura Mbështetëse Austriake, për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit në Shqipëri?

Deri në ç'masë ishte rakorduar Nisma e Mbështetjes Austriake në Shqipëri me qëllimet, politikave dhe strategjitë e Iniciativave Bilaterale Mbështetëse të atëhershme në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore dhe në shtetet e reja të pavarura (për shembull „Direktivat për Mbështetjen e Shteteve në reformë

të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe të Shteteve të Reja të Pavarura)? Deri në ç`pikë përputhet sot kjo nismë me Bashkëpunimin Austriak Për Zhvillimin në Evropën Lindore, ose a mund të zbatohen këto nisma?

Deri në ç`pikë janë krijuar sinerji ndërmjet projekteve të veçanta që mbështeten nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (BAZH) në Shqipëri, ose ndërmjet aktiviteteve, të cilat mbështeten nga BAZH, dhe atyre që mbështeten nga organizata të tjera që operojnë në Shqipëri (Qeveria Shqiptare, donatorë të tjerë, etj)? Deri në ç`pikë janë bërë orvatje që të rritet bashkëpunimi (komplementariteti), koherenca dhe koordinimi me iniciativat mbështetëse të donatorëve të tjerë? Çfarë roli ka luajtur BAZH në kuadrin e tratativave për harmonizimin e donatorëve në Shqipëri? Çfarë përparësie dhe kontributi komparativ special mund të sjellë BAZH në aktivitetin e komunitetit të donatorëve në Shqipëri? Çfarë faktorësh e kanë mbështetur/ penguar rolin e Austrisë si partnerë zhvillimi për organizatat shqiptare dhe ndërkombëtare (stakeholders)?

Në çfarë raporti ndodhet BAZH në Shqipëri lidhur me mbështetjen që i jep Austria vendeve të tjera të Evropës Lindore dhe në veçanti rajonit të Ballkanit? Deri në ç`masë ka mbështetja e sotme një perspektivë rajonale? A ekziston një lidhje ndërmjet aktiviteteve të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në Shqipëri dhe Programit Rajonal të Bashkëpunimit me Evropën Juglindore, dhe në këtë mënyrë me projektet, që kanë lidhje me iniciativat e ndërmarra në Evropën Juglindore në kuadrin e Paktit të Stabilitetit)?

#### **Efektiviteti dhe efektshmëria:**

Deri në ç`pikë janë arritur qëllimet e përcaktuara në fillim? Çfarë faktorësh të jashtëm (të parë në kontekstin politik, ekonomik dhe social) kanë kontribuar, ose kanë penguar arritjen e qëllimit? Deri në ç`pikë mund të pohohet me siguri që BAZH me Shqipërinë ka kontribuar për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të Qeverisë Shqiptare (ashtu siç është përshkruar edhe në direktiva të rëndësishme, politika dhe strategji), si edhe të qëllimeve të zhvillimit të Bashkëpunimit Austriak me Evropën Lindore?

Cilat kanë qenë pikat e forta dhe të dobëta të Bashkëpunimit Austriako-Shqiptar në stadet e ndryshme të cikleve të projektit dhe lidhur me sfidat që janë paraqitur gjatë menaxhimit të projektit? Kjo ka të bëjë me rolin e BAZH dhe të organizatave të tij partnere gjatë krijiimit/ selektimit të projekteve, hartimit të dokumentacioneve të projekteve, të masave të cilësisë, kohën dhe burimet (njerëzore, financiare, teknike) të nevojshme për organizimin dhe zbatimin e projektit, proceset dhe procedurat e tenderimit, me cilësinë e vlerësimeve që i janë bërë projekteve dhe me shfrytëzimin e rezultateve të projekteve, etj.

A po i ndjekin me përgjegjësi partnerët (Qeveria, OJQ-të, Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik, konsulentët e monitorimit, etj) monitorimin aktual dhe masat për mbështetjen e projektit? Deri në ç`pikë i janë përgjigjur marrëveshjet aktuale të monitorimit kërkesave ekzistuese? A u identifikuan gjatë fazës së planifikimit të projektit indikatorë, të cilët në një fazë të mëvonshme do të mundësonin monitorimin dhe vlerësimin?

Deri në ç`masë dhe me çfarë cilësie është realizuar një shkëmbim informacionesh dhe monitorimi të përbashkët ndërmjet Zyrës Austriake për Bashkëpunim Teknik dhe strukturave kombëtare të monitorimit dhe për sektorë specifik të Qeverisë Shqiptare (duke përfshirë rrjetin shqiptar të monitorimit)?

Cilat janë pikat e forta dhe të dobta të strukturës mbështetëse austriake lidhur me hartimin e projekteve/programit dhe zbatimin në Shqipëri (dhe në vende të tjera të Evropës Lindore) krahasuar me sistemin që shfrytëzon Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim në vendet në zhvillim të Evropës Jugore? Kjo i referohet ndarjes së roleve dhe përgjegjësisë, pikave të forta/ të dobëta të strukturës mbështetëse (përfshirë konsulentët sektorial, të monitorimit dhe ata teknik të „Kontratës tripalëshe“), disponueshmërinë/ përshtatshmërinë e kapaciteteve (për monitorimin, hartimin e programit/ projektit, dialogun për politikën, koordinimin e donatorëve, marrëdhëniet me partnerët (stakeholders), vlerësimin, etj.) të Zyrës Austriake për Bashkëpunim Teknik në Tiranë dhe të Zyrës Qendrore në Vjenë.

Cilat ishin avantazhet/ disavantazhet e projektit (në krahasim me programin) në kontekstin aktual politik, social dhe ekonomik? Çfarë mësimesh mund të nxirren nga kjo për programimin dhe zbatimin në të ardhmen (lessons learned)? Duke ju referuar kontaktit aktual politik dhe socio-ekonomik në Shqipëri dhe zhvillimeve e tendencave aktuale ndërkombëtare, cilat janë cilësitë (fleksibiliteti, pjesëmarrja e partnerëve (stakeholder participation), përfshirja e kapaciteteve lokale, shpejtësia ...), të cilat do të kenë një rëndësi të veçantë në të ardhmen për suksesin e Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri? Sa do të ishte kontributi financiar minimal, i cili do të justifikonte ndërmarrjen e një programi?

Çfarë rekomandimesh mund të jepen lidhur me fokusin e ardhshëm tematik, sektorial dhe gjeografik të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë?

#### **Ndikimet:**

Çfarë mund të thuhet në këtë moment për ndikimet e mundshme të qëllimta dhe të paqëllimta afatmesme e afatgjata (sociale, politike, teknike, ekonomike dhe ekologjike) që do të ketë projekti te popullsia e varfër/ e lënë në hije (dhe të mjedisi) i rajoneve të synuara? Sa kanë ndikuar zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale të potenciali i projekteve që aktivitetet e tyre të arrinin një impakt pozitiv? Si kanë reaguar partnerët austriak dhe shqiptar të projektit ndaj zhvillimeve dhe sfidave në vend, të cilat ndodhen në një ndryshim të vazhdueshëm?

#### **Qëndrueshmëria:**

- **“Pronësia” dhe “partneriteti”:**

Deri në ç`pikë janë marrë parasysh në mënyrë të veçantë “pronësia” dhe „partneriteti“? Deri në ç`pikë janë ndërmarrë masa, në mënyrë që të mbështetj „pronësia“ e partnerëve shqiptar lokal dhe kombëtar? Si u pikasën kërkesat e popullsisë? Kush u përfshi në përcaktimin e tyre? Deri në ç`masë dhe në ç`mënyrë u përfshinë përfaqësuesit e organizatave partnere dhe popullsisë shqiptare në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve? Çfarë roli kishin ata në proceset vendimmarrëse? Si është mbështetur e përkrahur iniciativa dhe përgjegjësia lokale?

Çfarë masash kanë ndërmarrë organizatat partnere lokale/ kombëtare për të siguruar që projektet e Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri të sjellin avantazhe afatmesme dhe afatgjata? A do të vijojnë proceset që ka filluar të ndërmarrë qeveria, ose partnerët e shoqërisë civile dhe/ ose donatorët e tjerë? Çfarë projektsh kanë potenciale që në të ardhmen të përsëriten, ose zgjerohen?

Deri në ç`masë është zhvilluar bashkëpunimi ndërmjet partnerëve austriak dhe shqiptar gjatë viteve si një "partneritet i vërtetë", ku janë marrë përsipër nga të dyja palët kostot, rrisqet dhe përfitimt? Duke ju referuar klimës aktuale politike dhe socio-ekonomike, a mund të konsiderohet si realist zhvillimi i një "partneriteti të vërtetë"?

Deri në ç`pikë janë kapërcyer në të shkuarën situatat e vështira (të personelit, teknike, të sferës së drejtimit, institucionale, etj.) të organizatave partnere dhe deri në ç`pikë mund të pritët që në të ardhmen të ndërmerren masat e nevojshme në këtë drejtim? Sa e favorizon/ vështirëson këtë proces struktura institucionale/ strukturore/ organizative e Bashkëpunimit Austriak?

- **Prioritetet kombëtare/ lokale dhe sfidat:**

Sa kanë kontribuar në zhvillimin dhe/ose përmirësimin e strategjive dhe politikave kombëtare të zhvillimit (p.sh. të NSSD) projektet dhe aktivitetet e mbështetura e të implementuara nga Struktura Austriake e Bashkëpunimit (Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik në Tiranë, konsulentët e monitorimit dhe ata teknik, stafi përgjegjës në Vjenë) dhe nga partnerët e saj shqiptarë? Në çfarë mënyre janë integruar ato në dialogun me donatorët? Çfarë mekanizmash e kanë mundësuar/ penguar këtë proces?

Sa dhe si ka reaguar Bashkëpunimi Austriak në Shqipëri lidhur me sfidat e zhvillimit që ekzistojnë në vend (konflikti, migrimi rural-urban, menaxhimi i qeverisjes, pabarazitë gjinore, menjanimi i minoriteteve, papunësia, etj.)? Çfarë mësimi nxjerrim nga kjo (lessons learned)? Best practices? Si mund t'i përballojmë në të ardhmen këto sfida?

- **Aspekte sociokulturore:**

Sa janë përfshirë vlerat kulturore, normat dhe format e të shprehurit në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve? A i janë përshtatur teknologjitë e përdorura rethanave lokale sociokulturore, në mënyrë që të bëhet i mundur integrimi, hartimi dhe mbështetja e zgjidhjeve lokale? A e inkurajojnë projektet komunitetin lokal, që mënyrën tradicionale të jetesës, normat e vlerat tradicionale t'i analizojë me sy kritik, dhe nëse është e nevojshme t'i përshtasë ato me mënyra të sjelluri dhe sfida të ndryshuara? A u pikas, u shfrytëzua dhe u mor në konsideratë potenciali shoqëror?

Sa kanë ndikuar aktivitetet për "Forcimin" e grupit të synuar dhe të shoqërisë më të gjerë civile dhe në transformimin e strukturave dhe të marrëdhënieve me pushtetin? Në çfarë mënyre janë përfshirë çështjet e përmendura më sipër në planifikimin e aktiviteteve të projektit?



Sa e ka mbështetur puna e Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri procesin e demokratizimit dhe decentralizimit në vend? Në çfarë mënyrë është arritur që me anë të aktiviteteve të ndërmarra, të përmirësohen probleme që lidhen me një qeverisje të mirë (përfshi korrupsionin)?

- **Çështjet gjinore**

Sa kanë kontribuar projektet për çështjet e barazisë gjinore në Shqipëri, ose e kanë penguar atë?

Tashmë që ndodhemi përpara hartimit dhe zbatimit të projekteve, sa vëzhgime studimore janë bërë lidhur me çështjet gjinore dhe sa të dhëna janë mbledhur në këtë drejtim? Sa janë marrë parasysh gjatë zbatimit dhe monitorimit të aktiviteteve ndërhyrjet për barazinë ndërmjet gjinive? A kanë arritur projektet e zbatuara që të plotësojnë jo vetëm nevojat praktike të grave (mundësi për të marrë shërbime shëndetësore, krijimi i mundësive për sigurimin e të ardhurave), por edhe për plotësimin e kërkesave strategjike të grave (barazi politike/ ekonomike/ sociale për t'u arsimuar, e drejta e pronës)?

Cilat janë sfidat e veçanta që shoqërojnë drejtimin gjinor "të parashtruar" nga donatori, ose nga institucioni përgjegjës? A janë ndërmarrë masa për të forcuar përgjegjshmërinë dhe angazhimin e organizatave partnere dhe të komunitetit lokal, në mënyrë që ata të mbështesnin aktivisht çështjet gjinore? A i kanë forcuar projektet kapacitetet që ju nevojiten për këtë partnerëve lokal/kombëtar të projektit dhe organizatave të grave?

- **Impakti ekologjik:**

Sa kanë kontribuar projektet për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri, ose sa e kanë dëmtuar atë?

Sa janë marrë parasysh gjatë planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të aktiviteteve të projektit çështje që lidhen me mjedisin? Për shembull sa rëndësi i është kushtuar metodave ekologjike bujqësore të qëndrueshme, aspekteve të sigurimit të tokës dhe menaxhimit të burimeve? Çfarë strategjish janë hartuar për menaxhimin e konflikteve që janë krijuar (ose që mund të krijohen) për shkak të burimeve të kufizuara, ose konflikteve të interesave? A janë marrë parasysh njohuritë dhe praktikat lokale për ruajtjen e biodiversitetit? A janë ndërmarrë në kohë testimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, dhe nëse po, çfarë dobie sollën ato për zbatimin e projektit?

Sa janë përfshirë në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të projektit tema të rëndësishme? Çfarë bashkëpunimi ekziston ndërmjet sektorëve të ndryshëm prioritar dhe temave të rëndësishme, dhe si u morën ato në konsideratë nga projektet?

## 5. Metodologjia

Vlerësimi do të jetë një vlerësim i jashtëm („Vlerësim i jashtëm, Tipi I“), i cili do të kontraktohet dhe drejtohet nga Zyra Qendrore e Vlerësimit e Agjensisë Austriake për Zhvillim, në bashkëpunim me Departamentin VII/2 të Ministrisë Federale Austriake të Punëve të Jashtme (BMAA).

Si për planifikimin dhe zbatimin e vlerësimit, ashtu edhe për ndjekjen e vazhdimin pas vlerësimit, do të përzgjidhet një mënyrë procedimi pjesëmarrëse, ku do të duhet të përfshihen dhe konsultohen të gjithë partnerët (stakeholders). Këtu bëjnë pjesë punonjës të Agjensisë Austriake për Zhvillim, të BMAA (Departamenti VII), të Zyrës Austriake për Bashkëpunim Teknik në Tiranë, konsulentët austriak të monitorimit, ish-drejtuës të Zyrës Austriake për Bashkëpunim Teknik, konsulentë të dikurshëm austriak për monitorim, partnerë shqiptar të projektit, aktual dhe të dikurshëm, organizata qeveritare dhe struktura monitorimi.

Në muajin tetor 2004 në Tiranë u zhvillua një konsultim fillestar me partnerët e projektit (stakeholder). Këtu u përfshinë Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik, si edhe përfaqësues të OJQ-ve partnere dhe përfaqësues nga ministritë përkatëse. Kontributi i pjesëmarrësve u mor parasysh për hartimin e këtyre termave të referencës. Në dhjetor 2004 u zhvillua një takim tjetër konsultativ për hartimin e termave të referencës. Pritet që pas përfundimit të vlerësimit të organizohet dhe një takim i tretë, gjatë të cilit do t'ju paraqitet partnerëve të rëndësishëm austriak dhe shqiptar projekti bazë i raportit të vlerësimit.

Para studimit në terren grupi i vlerësimit do të studiojë politika, strategji, dokumentacione projektsh dhe literatura të tjera të rëndësishme shqiptare dhe austriake lidhur me këtë çështje. Gjatë studimit në terren do të mblidhen të dhëna cilësore dhe do të interpretohen nga grupi i vlerësimit të dhënat sasiore që ekzistojnë.

Vlerësimi do të përqendrohet në projektet e mëposhtme:

- Rehabilitimi i hidrocentraleve të Drinit (Andritz) – *shih aneksin*
- Sektori i furnizimit me ujë: uji/ujrat e zeza 4 fshatra në Veri të Shqipërisë, rrethi i Shkodrës (konsulentët e IC); ose furnizimi me ujë i fshatrave të Kastratit (GËCC), ose furnizimi me ujë i qytetit të Laçit (konsulentët e IC-së)
- Shkollat Bujqësore dhe të Hotelerisë (KulturKontakt)
- Mbështetja e grave në politikë (Horizont 3000)
- Komuniteti prodhues në Kelmend (Austroprojekt / Cafod, SSB)?
- Rehabilitimi urban dhe integrimi i komunitetit në rrethin e Durrësit (CoPlan)?

## 6. Ekipi i vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet nga një grup ndërdisiplinor, i përbërë nga ekspertë ndërkombëtar dhe 2-3 ekspertë lokal. Nëse do të jetë e mundur ekipi do të ketë një përbërje të balancuar gjinore.

4 – 5 ekspertët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të dhënë ekspertizën e tyre në fushat e mëposhtme: ulja e varfërisë, furnizimi me ujë & dhe kanalizimet e ujrave të zeza, energjia, arsimit dhe zhvillimi i kapaciteteve, çështjet gjinore, menaxhimi i projekteve e programeve dhe planifikimi strategjik, vlerësimi i projektit e programit dhe metodat kërkimore participative. Eksperti/-ja e fushës së energjisë do t'i përkushtohet kryesisht vlerësimit të kontributit austriak dhe zviceran për rehabilitimin e hidrocentraleve të lumit Drin (për më shumë detaje, shih aneksin).

Të gjithë ekspertët duhet të kenë eksperiencë pune në Shqipëri dhe/ose në rajon.

## 7. Raport:

Raporti i vlerësimit do të vihet në dispozicion si në letër, ashtu edhe me CD, në gjermanisht, ose në anglisht, me një përmbledhje në anglisht; i gjithë raporti do të përkthehet në shqip, gjithashtu në gjuhën shqipe do të hartohet edhe një përmbledhje.

## 8. Grupi që do të nxjerrë mësim

Pritet që rekomandimet specifike të vlerësimit të kontribuojnë për hartimin e Strategjisë së Bashkëpunimit Austriak dhe të Programit të ardhshëm për Shqipërinë. Vlerësimi do të shërbejë si një mësim i përbashkët si për Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim në Shqipëri dhe në Vjenë, ashtu edhe për organizatat partnere shqiptare. Personat/organizatat e mëposhtme, që do të përfshihen në vlerësim, ftohen që të marrin masat përkatëse, pas përfundimit të vlerësimit:

ADA	Menaxheri
ADA	Drejtori i Sektorit të programeve & projekteve
ADA	Drejtuuesi i seksionit për Shqipërinë
ADA	Drejtuuesi i Zyrës Austriake për Bashkëpunim Teknik në Shqipëri
BMAA	Drejtuuesi i Sektorit të Programimit
BMAA	Drejtuuesi i Bashkëpunimit me Evropën Lindore
Organizatrat partnere në Shqipëri ( <i>shih më sipër listën e projekteve që do të vlerësohen</i> )	
Partneri zviceran (SECO)	

## 8. Plani kohor:

- |   |                  |
|---|------------------|
| • Takimi i parë konsultativ                       | Tetor 04         |
| • Përgatitja e propozimit për termat e referencës | Nëntor 04        |
| • Takimi i dytë konsultativ në Shqipëri dhe Vjenë | Dhjetor 04       |
| • Përgatitja e termave të referencës              | Janar 05         |
| • Proçesi i tenderimit                            | Shkurt – Mars 05 |
| • Kontraktimi                                     | Prill 05         |
| • Studimi i literaturës dhe përgatitjet           | Prill 05         |
| • Studimi në terren                               | Maj 05           |
| • Raporti dhe takimi i tretë konsultativ          | Qershor 05       |

## 9. Koordinimi dhe përgjegjësia

Zyra Qendrore e ADAs për vlerësim është përgjegjëse për drejtimin e proçesit dhe për marrëveshjen

kontraktuale me vlerësuesit. Gjatë fazës përgatitore do të krijohet një grup konsultativ i përbërë nga Zyra Qendrore për vlerësim e Ada-s, nga Drejtues i seksionit për Shqipërinë, nga Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik në Tiranë, nga partnerë shqiptar dhe përfaqësues të grupeve të synuara.

**Aneks:**

**Rehabilitimi i ujësjellësve të Drinit (Andritz):**

Siç e përshkruam më sipër vlerësimi i Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri do të përqendrohet në tërësinë e Mbështetjes dhe Ndihmës Austriake në Shqipëri dhe nuk do të analizojë në detaje projekte të veçanta.

Projekti i vetëm, i cili në kuadrin e vlerësimit konkret duhet parë me imtësi, është rehabilitimi i hidrocentraleve të Drinit, i cili nëse i referohemi volumeve të tij financiare, paraqet projektin më të madh austriak në Ballkan.

Hydrocentralet e Drinit mbështeten nga shumë donatorë. Këtu bën pjesë edhe Sekretariati Zviceran i Shtetit për Ekonominë (SECO). Vlerësimi do të analizojë si kontributin austriak, ashtu edhe atë zviceran, që është dhënë për rehabilitimin e hidrocentraleve të Drinit. Pritet që ai të ndihmojë për një qartësim më të mirë të rolit të projektit në kontekstin e sektorit; të ndihmojë që të realizohet koordinimi i masave të ndryshme mbështetëse; të kontribuojë që të rritet bashkëpunimi ndërmjet partnerëve të projektit; dhe të kontribuojë që të reduktohet kostoja e vlerësimit për donatorin dhe kostoja e transaksionit për vendin që merr mbështetjen.

Eksperti/-ja e fushës së energjitikës (*shih më sipër të ekkipi vlerësues*) do t'ia kushtojë kohën e tij/e saj kryesisht vlerësimit të kontributit austriak dhe zviceran për rehabilitimin e hidrocentraleve të Drinit. Detyra e tij/ e saj është në kontekst me vlerësimin e të gjithë Programit të Bashkëpunimit Austriak në Shqipëri, pyetjet kyçe të të cilit u përshkruan në pjesën më të madhe të këtyre termave të referencës.

Eksperti/-ja kryesisht:

- do të analizojë se sa të përshtatshme ishin për arritjen e qëllimit mbështetja (planifikimi, metoda, vendi, kohëzgjatja), menaxhimi dhe organizimi, sasia dhe cilësia e materialit;
- do të analizojë se deri në ç' masë është realizuar në kuadrin e projektit një transferim i njohurive dhe nëse është forcuar kapaciteti i institucioneve/ ekspertëve përgjegjës për një menaxhim të qendrueshëm dhe të efektshëm;
- do të përcaktojë shkallën e zhvillimit që kanë marrë institucionet pas fillimit të projektit;
- do të analizojë rezultatet e projektit në lidhje me a) rezultatet e Austrisë /SECO-s, b) rezultatet e përfituesve direkt, c) rezultatet e organizatave implementuese, d) rezultatet e vendimmarrësve, e) faktorët ekzogjen;
- do të vlerësojë bashkëpunimet me projektet e tjera.

Eksperti/-ja e energjitikës do të bashkëpunojë ngushtë me anëtarët e tjerë të ekipit të vlerësimit.

Në kuadrin e punës së tyre konsulentët duhet që të bëjnë një përshkrim të projektit të propozuar teorik dhe praktik për vlerësimin e hidrocentraleve të Drinit, si pjesë e dokumentacionit.

ANNEX 3 / (1)

---

**Vlerësimi i  
Projektit të Rehabilitimit të Kaskadës së Drin-it  
Shqipëri**

**Raporti i vlerësimit**

---

Me porosi të:  
***Austrian Development Agency ADA***

Njësia e Vlerësimit  
Zelinkagasse 2  
A - 1010 Wien  
Austria

KEK-CDC Consultants  
Universitätsstrasse 69  
CH – 8006 Zurich  
Switzerland  
engler@kek.ch  
++41 44 368 58 58

Zurich / Rapperswil  
14 Dhjetor 2005

## CONTENTS

<b>PËRQASJA E VLERËSIMIT</b> .....	FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.
Sfondi i vlerësimit .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Objektivat	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Pyetjet thelbësore .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Përqasja ndaj vlerësimit.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Fusha e vlerësimit.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
<b>KONTEKSTI</b> .....	FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.
Sektori Energjistik: Prodhimi, transmetimi, shpërndarja, aspektet mjedisore ..	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Konteksti politik dhe institucional i sektorit energjistik.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Origjina e projektit.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Llojet e punëve dhe financimi .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Historia e implementimit .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
<b>PROJEKTI: VLERËSIMI TEKNIK</b> .....	FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.
Specifikimet teknike të hidrocentraleve .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Statusi aktual.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Vrojtime të përgjithshme.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Fierza	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Hidrocentrali i Vaut të Dejës .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Hidrocentrali i Shkopetit.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Hidrocentrali i Ulzës.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Konkluzione.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
<b>PROJETI: ASPEKTET INSTITUCIONALE</b> .....	FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.
Relevanca e Projektit të Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Relevanca për Shqipërinë .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Relevanca në lidhje me Strategjinë e Bashkëpunimit Austriak ...	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Relevanca në lidhje me strategjinë e seco .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Përfaqja implementimit/ Struktura e Projektit....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Manaxhimi i Projektit / Organizimi .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Mobilizimi i Partnerëve lokalë (Ministria, KESH, PMU, etj.) .....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>
Përfaqja ndaj Koordinimit të donatorëve.....	<b>Fehler! Textmarke nicht definiert.</b>

Transferimi i njohurive, Ndërtimi i kapaciteteve, Zhvillimi Institucional ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Zhvillimi Institucional..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Zhvillimi i Kapaciteteve ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Sinergjitë **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Konkluzione dhe Vlerësime të Përgjithshme ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Efektshmëria (arritjet e objektivave) ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Qëndrueshmëria ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Eficienta ( lidhja input - output ) ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

**MËSIMET E NXJERRA / REKOMANDIME** ..... **FEHLER! TEXTMARKE NICHT DEFINIERT.**

Mësimet e nxjerra (Lessons Learned) ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Në përgjithësi..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Specifike për ADA ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Specifike për seco ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Rekomandime ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Rekomandimet lidhur me DRCP ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Përfshirja e ADA në Sektorin e Energjisë ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

përfshirja e seco në Sektorin e Energjisë ..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

Drejtimi i Programit të ADA-s..... **Fehler! Textmarke nicht definiert.**

#### **Shtojë:**

Lista e personave të intervistuar

Lista e dokumentacionit

Kosto e DRCP

Dokumentacion fotografik i hidrocentraleve të Fierzës, vau i Dejës, Shkopeti dhe Ulza

Termet e referencës

Pamje të përgjithshme të Hidrocentraleve mbi lumin Drin dhe Mat

**SHKURTIME**

ADA	Austrian Development Agency - Agjensia Austriake për Zhvillim
CEEC	Central and Eastern European Countries - Vendet e EQLQ
DC	Development Cooperation - Bashkëpunimi për Zhvillimi
DRCRP	Drin River Cascade Rehabilitation Project - Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit
EBRD	European Bank for reconstruction and Development - EBRD
EC	European Commission - Komisioni Evropian
EU	European Union - Bashkimi Evropian
HPP	Hydro Power Plant - Hidrocentral
ID	Institutional Development - Zhvillimi Institucional
KESH	Electricity Corporation of Albania - Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau, Germany - Banka Gjermane për Rindërtim
MFA	Ministry of Foreign Affairs - Ministria e Punëve të Jashtme ( <i>BMAA - Bundesministerium für Auswärtige Angelegenheiten</i> )
MW	Megawatt – MW
NSSD	National Strategy for Socio-Economic Development – Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
ODA	Official Development Assistance – Asistenca Zyrtare për Zhvillimi
O & M	Operimi dhe Mirëmbajtja
OZA	Ostzusammenarbeit – Bashkëpunimi me vendet e EQL
öBTZ	Austrian Office for Technical cooperation – Zyra Austriake për Bashkëpunim Teknik
PCM	Project Cycle Management – Manaxhimi i Ciklit të Projektit
PMU	Project Management Unit – Njësia e Manaxhimit të Projektit
PRSP	Poverty Reduction Strategy Paper – Strategjia e Reduktimit të Varfërisë
SAA	Stabilisation and Association Agreement – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
SAP	Stabilisation and Association Process – Procesi i Stabilizim-Asociimit
SEE	South East Europe – Evropa Juglindore
SDC	Swiss Development Cooperation – Bashkëpunimi Zvicëran për Zhvillim
seco	(Swiss) State Secretariate for Economic Affairs – Sekretaria (zvicërane) e Shtetit për Çështjet Ekonomike
ToR	Terms of Reference – Termet e Referencës
TWh	Terawatt hours – teravat/orë
WB	World Bank – Banka Botërore

## PËRMBLEDHJE

### Projekti

Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit (DRCRP) ishte konceptuar në vitet 1993/94. Ai synon rehabilitimi i e katër hidrocentraleve në lumin Drin dhe Mat të cilët kanë një kapacitet të kombinuar të instaluar prej 810 MW, që përbën 50% të kapacitetit të fuqisë hidrike të instaluar në Shqipëri. Projekti është bashkëfinancuar nga EBRD, nga Qeveria austriake, zvicerane dhe japoneze, si dhe nga Mediocredito Centrale dhe KESH. Objektivat e tij janë rritja e prodhimit të energjisë, të rrisë jetgjatësinë e hidrocentraleve ekzistuese, të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike dhe të përmirësojë shfrytëzimin e rezervave ujore

Për shkak të vështirësive të ndryshme implementimi është ndërprerë dhe vonuar në mënyrë të përsëritshme. Gjithsesi, momentalisht është planifikuar përfundimi i suksesshëm në mesin e vitit 2007.

### Rezultatet kryesore

Projekti ka një relevancë të lartë në lidhje me zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë duke kontribuar substancialisht në një gjenerim të qëndrueshëm të burimit kryesor primar të energjisë. Hidrocentralet do të rehabilitohen në një ngjendje të kënaqshme teknike e cila rrit jetgjatësinë dhe siguron një prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Në kombinim me projektet në reformën sektoriale dhe zhvillimin institucional paralelisht zhvillohen me fondet e Bankës Botërore dhe EBRD kontributi për modernizimin e prodhimit të gjenerimit si një bazë edhe për integrimin në tregun rajonal të furnizimit me energji.

Rehabilitimi i hidrocentraleve ekzistuese përbën një përqsasje eficiente për përmirësimin e prodhimit të energjisë në Shqipëri. Megjithatë efienca e përgjithshme e projektit është ndikuar negativisht nga 1) mungesat e fondeve në organizimin e projektit të cilat shkaktonin zvarritje dhe si pasojë edhe kosto shtesë për pretendime financiare (claims), kosto shtesë për KESH-in dhe humbje në grumbullimin e të ardhurave si pasojë e furnizimit inefficent të hidrocentraleve, 2) nënvlerësimi i koston së përafërt në lidhje me rehabilitimin e hidrocentraleve kombinuar me një kuadër të kufizuar financiar (fonde fikse, fonde rezervë të pamjaftueshme) dhe 3) impakti i ndikimeve politike në Shqipëri.

Kompletimi i suksesshëm i projektit ka ardhur më tepër si rezultat i përpjekjeve të palodhshme të individëve të besueshëm se sa i mekanizmave institucionalë të përdorura për supervizimin e projektit.

Për të siguruar qëndrueshmërinë e rehabilitimit duhet të ndërmerren një sërë hapash (shiko rekomandimet).

### Rekomandime

#### *Në përgjithësi në lidhje me DRCRP*

- Mbrojtja e digës: është në proces një studim për të analizuar të gjitha aspektet në lidhje me sigurinë e digave. Duke qenë se çështja e sigurimit të digave është kritike masat e identifikuar duhet të implementohen. Duke konsideruar potencialin e lartë të riskut të disa aspekteve të hidrocentraleve, rekomandohet sa më shpejt të prioritarizimi dhe lëvizje e disa "pikave të nxehta" që janë identifikuar tashmë.
- Rishikim para-fundit-të projektit: partnerët e përfshirë duhet të iniciojnë një rishikim para përfundimit të projektit për të identifikuar investimet dhe masat që nevojiten në të ardhmen për të siguruar qëndrueshmërinë e investimeve aktuale. Për sa kohë që hidrocentralet nuk janë rehabilituar tërësisht, është e nevojshme të identifikohen tipet dhe sekuencat për rehabilitime të mëtejshme për të siguruar operimin e vazhdueshëm dhe jetgjatësinë maksimale.
- Operimi dhe Mirëmbajtja: rishikimi mund të kombinohet me zhvillimin e një koncepti të qartë Operimi dhe Mirëmbajtje. Rezultatet e arritura në ndërtimin e kapaciteteve duhet të shfrytëzohen për ngritjen e një koncepti të qartë për aspektet teknike dhe manaxheriale të O&M.
- Studim mbi hidrologjinë: Për një manaxhim afatgjatë optimal dhe eficient të burimeve të energjisë hidrike, duke përfshirë edhe rritjen e kapaciteteve të Hidrocentraleve ekzistuese rekomandohet të iniciohet në studim mbi hidrologjinë e rajonit.



### **Angazhimi i ADA-s ne Sektorin Energjitik**

- Rishikimi i mundësive të ADA-s në të ardhmen në sektorin e energjisë, duke konsideruar relevancën e sektorit në bashkëpunimin e ADA-s me Shqipërinë në perspektivë afatmesme dhe afatgjatë.
- Zhvillimi i një koncepti sektorial afatmesëm (për ADA), i cili merr në konsideratë çështjet e mëposhtme:
  - Hapat e mundshëm pasues të DRCRP: ADA merr pjesë në rishikimin e rekomanduar më sipër. Në kuadrin e konceptit të saj sektorial, ADA do të vendosë nëse dhe si do të përfshihet në më tej në vazhdimin e DRCRP.
  - Duke u fokusuar në energjia e rinovushme, p.sh.:
    - Duke vazhduar mbështetjen në zhvillimin dhe rehabilitimin e hidrocentraleve, p.sh. duke riaktivizuar idenë e mbështetjes së rehabilitimit të hidrocentraleve të vegjël.
    - Energjia diellore – nje ndërhyrje e planifikuar – të diversifikojë përfshirjen në këtë sektor.
- Përfshirja e zhvillimit institucional / ndërtimi i kapaciteteve duke maksimizuar sinergjitë me programet e tjera.

### **Angazhimi i seco-s në Sektorin e Energjisë**

- Ndërhyrjet për zhvillimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve duhet të marrin një vëmendje më të qartë në të ardhmen. Kjo nënkupton p.sh. një fokusim në masat për vendosjen e O&M në katër hidrocentralet e rehabilituara në një bazë të qëndrueshme.
- Të rishikojë mundësitë për të kontribuar në masat shtesë që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë e katër hidrocentraleve, përpara se të identifikohen projekte të reja.

## PËRQASJA E VLERËSIMIT

---

### Sfondi i vlerësimit

Vlerësimi i “Projektit të Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit” (DRCRP) është pjesë e një vlerësimi të madh të “Programit të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë nga viti 1992 në 2004”. Duke qenë se bashkëfinancimi austriak i DRCRP përbën investimin më të madh unik në bashkëpunimin e saj me vendet e EJT, u konsiderua si mjaft i nevojshëm një vlerësim i detajuar i këtij projekti, në kuadrin e vlerësimit të të gjithë programit. Rezultatet e këtij vlerësimi janë pjesë e integruar e vlerësimit të programit.

### Objektivat

Objektivat e vlerësimit ishin:

- Relevanca e projektit
  - për Shqipërinë
  - duke iu referuar objektivave të Bashkëpunimit Austriak
- Cilësia dhe përshatshmëria e rezultateve duke iu referuar
  - Aspekteve teknike
  - Zhvillimit të kapaciteteve / Transferimit të njohurive (Know-how transfer)
  - Zhvillimi Institucional
  - Organizimi, Manaxhimi i projektit
  - Inputet tek partnerët e ndryshëm (teknikë, financiarë)
- Eficiencia
- Qëndrueshmëria
  - Teknikisht
  - Institucionale / Manaxhimi
- Sinergjitë & Bashkëpunimi me donatorët (bi-lateral)

### Pyetjet thelbësore

Vlerësimi analizoi si cilësinë e implementimit në pjesët teknike ashtu edhe aspektet institucionale të projektit.

Për sa i përket pjesës teknike fokusi u përqëndrua në përshatshmërinë dhe eficiencën e zgjidhjeve teknike, cilësinë e implementimit dhe qëndrueshmërinë e punimeve rehabilituese.

Për sa i përket aspekteve institucionale pyetjet thelbësore ishin relevanca e një projekti infrastrukturor për zhvillimin e Shqipërisë si dhe duke iu referuar objektivave strategjikë të Bashkëpunimit Austriak. A janë të qëndrueshme masat e implementuara? Si është manaxhuar transferimi i njohurive? Cilat rezultate mbështesin një manxhim eficient dhe të qëndrueshëm të hidrocentraleve? Çfarë është arritur në termat e zhvillimit institucional? A ka patur këtu sinergji midis pjesëve të tjera të programit dhe DRCRP? Cilat janë eksperiencat specifike në bashkëpunimin e dy donatorëve bilateralë?

Vlerësimi kishte synim të jepte rekomandime për zhvillimin në të ardhmen të programit të Bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë.

### Përqsja ndaj vlerësimit

Për të mbuluar në thellësi si aspektet institucionale dhe ato teknike, u mobilizua një ekip vlerësimi me ekspertizë specifike në të dyja këto çështje.

Vlerësimi teknik u drejtua nga një ekip nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara, të Rapperswil, Zvicër, eksperte për hidrocentralet dhe çështjet mjedisore.

- Paul Hardegger, M.Sc. Engineering, Asistent Profesor, Specialist për aspektet mjedisore
- Peter Lier, M.Sc. Engineering, Asistent Profesor, Specialist për hidrocentralet

- Andreas Huber, PhD. M.Sc., Engineering, Specialist për pjesët hidraulike
- Jürg Meier, M.Sc. Engineering, Profesor, Specialist për pjesët elektro-mekanike

Njëri prej anëtarëve të ekipit, (P. Hardegger) mori pjesë në mision në terren që u përgatit nga e gjithë skuadra.

Vlerësimi institucional u bë nga një ekspert i zhvillimit institucional Markus Engler (M.Sc.) i KEK-CDC Consultants të Zyrh, Zvicër. Ai mori pjesë gjithashtu, në misionin në terren.

Përpara misionit në terren u vlerësuan dokumentet e disponueshme dhe u mbajtën intervistat me përfaqësues të donatorëve (ADA, seco, EBRD), konsulentëve (Colenco, Verbundplan, L. Becke) dhe kontraktuesve (Andritz) (shih aneksin 1). Ekipi i vlerësimit e analizoi projektin mbi bazën e dokumenteve dhe studimeve teknike të disponueshme, (Lahmeyer, 1993, Sogreah, 1995) dhe përgatiti listat e detajuara të kontrollit për misionin.

Gjatë misionit në terren (29 Gusht deri në 05 Shtator '05) të dy anëtarët e ekipit të vlerësimit së bashku, drejtuan intervistat me përfaqësues të agjensive donatore (ADA, seco, EBRD, BB), autoriteteve lokale (Ministry of Energy, KESH) dhe ekspertëve të sektorit të energjisë (KfW, EEC). Gjatë vizitës në të katër hidrocentralet u vlerësua puna në vazhdim dhe pjesët e përfunduara si dhe u intervistuan inxhinierët e kontraktuesve dhe drejtorët e hidrocentraleve.

Rezultatet fillestare të vlerësimit u prezantuan në fund të misionit, në Tiranë, në një workshop në praninë e një audience të gjerë të përbërë nga donatorë dhe partnerë lokalë.

### **Fusha e vlerësimit**

Në princip, vlerësimi lidhet me programin e bashkëpunimit Austriak me Shqipërinë dhe si i tillë dhe kontributin Austriak ndaj DRCRP. Duke qenë se kontributi është një pjesë integrale e rehabilitimit vlerësimi vlerësoi gjithashtu, aspekte të projektit të cilat lidhen me partnerë dhe donatorë të tjerë të përfshirë në projekt. Në rastin e kontributit Zvicerian ky madje është dhe një efekt i dëshiruar dhe mbi të cilin ADA dhe seco kanë rënë dakort si një lloj bashkëvlerësimi. Në një linjë me këtë, rekomandimet morën në konsideratë gjithë DRCRP dhe jo vetëm kontributin Austriak.

#### ***Mirënjohje***

*Ekipi i vlerësimit vlerëson lart diskutimet e hapura dhe informative të mundësuar me të gjithë partnerët e intervistuar. Veçanërisht, mbështetja e administratorit të ADA Coordination Office in Tirana dhe nga njesia manaxhuese e DRCRP (KESH & konsulenti) ka qenë mjaft e vlefshme në organizimin një mision të suksesshëm në terren.*

## KONTEKSTI

---

### Sektori Energjitik:

#### Prodhimi, transmetimi, shpërndarja, aspektet mjedisore

Shqipëria ka një potencial të lartë të fuqisë hidroelektrike. Në vitin 1992 ajo kishte një kapacitet të instaluar prej 1445 MW i cili përbënte 88% të kapacitetit total të prodhimit të energjisë (12% hidrocentralet me energji termike). Përpara 1997 Shqipëria ka qënë një eksportuese neto e energjisë në Greqi, Maqedoni, Kosovë dhe Mal i Zi. Përdorimi i brendshëm i energjisë, ishte nën vlerën mesatare të vendeve Evropiane, duke patur industrinë si konsumatorin më të madh. Shumica e hidrocentraleve (përveç atij të Komanit mbi Lumin Drin, 1986) si dhe një rrjet transmetimi me voltazh të mesëm u ndërtuan me një teknologji të vjetër, në periudhën nga 1950 deri 1970.

Ndryshimi i sistemit politik në vitet 1989/90 pati pasoja tepër të rënda për sektorin e energjisë dhe ekonomisë. Eksporti i energjisë ra ndjeshëm duke ulur të ardhurat nga 50 Mio. \$ në 1986, në një të tretën në 1992. Ndërsa më parë industria llogariste rreth 80% të përdorimit të brendshëm, pamja ndryshoi në mënyrë drastike pas 1990, me një rritje të shpejtë të përdorimit të konsumit, duke rezultuar në modele të ndryshuara të përdorimit. Teknikisht, sistemi i shpërndarjes nuk ishte i mjaftueshëm për këtë situatë të re (p.sh mungesa e matësve, rrjete të pamjaftueshme). Prandaj, krahas rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese, prioritet ishte zgjidhja e problemeve në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit.

Me kolapsin e sistemit të vjetër politik dhe rënien e theksuar të të ardhurave, u duk që mirëmbajtja dhe investimet për rehabilitimin e sistemit nuk ishin të disponueshme, gjithashtu. Situata financiare u përkeqësua me shpejtësi pas 1995-ës, me liberalizimin e çmimeve, përveç atyre të energjisë. Cmimi i ulët dhe mungesa e një grumbullimi efektiv të pagesave elektrike, rezultoi në një kërkesë artificiale, rritjen nga 2.3 teravat/orë në 1993, në 5.6 teravat/orë në 1999 dhe në një humbje të madhe për arsye jo-teknike.

#### Konteksti politik dhe institucional i sektorit energjitik

Ndryshimet politike çuan në një krizë institucionale (mungesa burimeve dhe e lidhshimit politik, sfidat për riorganizimin e gjithë administratës, korrupsioni tejet i përhapur), e cila arriti kulmin me trazirat e 1997/98. Në sektorin e energjisë institucionet përgjegjëse (ministritë dhe ndërmarrjet) u ndeshën me sfida të tjera shtesë, që vinin nga kërkesat e përcaktuara nga bankat dhe donatorët për privatizimin e ndërmarrjeve. Një inisiativë e parë e Bankës Botërore për privatizimin e një pjese të rrjetit të transmetimit, iu desh të qëndronte pezull, për shkakun se struktura institucionale akoma nuk e lejonte një privatizim të plotë. Ashtu sikundërse privatizimi i rreth 83 hidrocentraleve të vogla ende nuk është përfunduar (rreth 50% janë privatizuar) dhe deri tani investime private për rehabilitimin e këtyre hidrocentraleve nuk janë bërë.

Një nga arsyet për këtë është se në kushtet mungesës së rregullatorëve të besueshëm lidhur me koncesionet dhe tarifën, është gati e pamundur gjetja e investitorëve.

Nga mesi i viteve 90-të Qeveria me mbështetjen e donatorëve (bankat) ndërmori një reformë sektori e cila rezultoi në një Dokument të Politikës së Sektorit Energjitik adoptuar nga Qeveria në Prill 2002

Elementët kryesorë të reformës së sektorit janë:

- Dokumenti i Politikës së Sektorit Energjitik
- Përmirësimi i legjislatcionit
- Stabilizimi i një Rregullatori nën kontrollin e Parlamentit.
- Reforma tarifore, duke përfshirë politikën e subvencionit për zbutjen e impaktit ndaj grupeve shoqërore në nevojë lidhur me rritjen e tarifës së energjisë
- Task forc-at që do të meren me (i) çështjet e pronësisë në sektorin e energjisë, (ii) të drejtat e shfrytëzimit të ujit, (iii) përgatitja e kodit të rrjetit; dhe (iv) përgatitja e standardeve të qëndrueshme dhe eficiente për aplikimet elektrike
- Zhvillimi i një Modeli të tregut në tranzicionin i cili plotëson karakteristikat specifike aktuale të sektorit energjitik Shqiptar, duke patur parasysh Udhëzimet relevante të BE-së si dhe kërkesat e Memorandumit të Athinës. Së fundi një pajtueshmëri e plotë me Udhëzimet e BE, do të arrihet në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.

- Riorganizimi i KESH-it dhe përgatitja për zgjidhjen e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes si një hap përgatitor drejt privatizimit të ndërmarrjeve
- Stabilizimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) si një kompani aksionare me KESH-in si një kompani holding. OST është regjistruar në 14 Korrik 2004.
- Zhvillimi i një Strategjije të Energjisë.

Bazuar në strategjinë e Ministrisë dhe të KESH u zhvillua një plan investimi strategjik për periudhën 2003-2015, i cili parashikon investimet prioritare prej 1.2 bio \$, për rehabilitimin dhe ndërtimin e hidrocentraleve (800-900 MW) si dhe të linja të reja ndërkombëtare me vendet fqinje si pjesë e përbushjes së detyrimeve të Memorandumit të Athinës në planin e kontekstit të stabilizimit të Komunitetit Energjistik në Evropën Juglindore

### **Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit**

#### **Origjina e projektit**

Kur filloi bashkëpunimi me Shqipërinë në fillim të viteve 90-të, rehabilitimi dhe zhvillimi i infrastrukturës bazë, si themel për ripërtëritjen socio ekonomike, ishte një prioritet që shihej qartë. Në sektorin e energjisë ku investimet janë veçanërisht të shumë të larta, EBRD dhe BB morën udhëheqësinë dhe ngritën projekte që u bashkëfinancuan nga donatorë të tjerë.

Projekti i Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit (DRCRP) u krijua në 1993/94 bazuar në një studim (Rehabilitimi dhe Rritja e Kapaciteteve të Hidrocentraleve.) të Lahmeyer. Të katër hidrocentralet mbi lumin Mat dhe Drin, të përfshira në projekt, kanë një kapacitet total të instaluar prej 810 MW. Së bashku me hidrocentralin e Komanit (600 MW) mbi Lumin Drin they arrijnë më shumë se 90% të kapacitetit hidro energjetik të instaluar në Shqipëri. Hidrocentrali i Komanit ka filluar punën në vitin 1987. Prandaj, DRCRP ishte projekti më i rëndësishëm në përpjekjen për shtimin e prodhimit të energjisë dhe për përmirësimin e qëndrueshmërisë së energjisë elektrike, i cili hap pas hapi, zvogëlon dëmtimet ekonomike të shkaktuara furnizimi i dobët me energji dhe e fundit por jo më pak e rëndësishmja, për përmirësimin e shfytëzimit të rezervave ujore.

Objektiva të tjera të projektit të cilat, në mënyrë të njëpasnjëshme ndjekin njëra tjetrën janë:

- Përmirësimi i kushteve fizike të pjesëve strukturale të rëndësishme (digat) sipas standarteve ndërkombëtare
- Përmirësimi i sigurisë së punës në hidrocentrale.
- Nxitja e një burimi të pastër dhe të lirë të prodhimit të energjisë.

## Llojet e punëve dhe financimi

Puna në katër hidrocentralet është shpërndarë në nëntë paketa kontratale

Paketa	Përshkrimi	Burimi i financimit	Lloji i financimit	Kontraktuesi
1R	Shërbime Konsulence për Pjesën A	EBRD	Kredi e butë	Colenco / CH
2 A	Punimet për Sigurinë e Digës	EBRD	Kredi e butë	TRISS / AL
2 B	Punët Civile	KESH	Lokal	
3	Pajisje Mekanike për Fierzën	Qev. Zvic	Grant	VA Tech / CH
4	Pajisje Mekanike për Vau i Dejes, Ulz dhe Shkopet	Qev. Aust.	Grant	Andritz / A
5	Rehabilitimi i Hidrocentralit të Selitës	EBRD	Kredi e butë (anuluar)	
6	Electrical Equipment për Fierza and Vau i Dejes	JBIC Mediocredito It	Kredi e butë	Alstom / It
7	Pajisje Mekanike për Ulzë dhe Shkopet dhe Instrumentalizim dhe Kontroll për Shkopet	EBRD	Kredi e butë	Koncar / Cr
8	Instrumentalizim dhe Kontroll për Fierz, Vau i Dejës	EBRD	Kredi e butë	Alstom / Fr

Investimi total i buxhetuar për projektin ishte rreth 67 Mio. Euro. Nga të cilat, kontributi Austriak është rreth 7.07 Mio. Euro dhe kontributi Zvicërian rreth 8.0 Mio. Euro.

Në sajë të faktit që çmimi i tenderit më të vogël e kaloi buxhetin e JBIC, një pjesë e kontratës së pajisjeve u ngri deri në gjetjen e fondeve shtesë. (Banka Italiane Mediocredita)

### Historia e implementimit

Në fazën fillestare nga 1994 deri në 1997, implementimi i projektit u ndikua negativisht nga problemet e shkaktuara nga konsultanti i caktuar në periudhën para 1998-ës si dhe nga paqëndrueshmëria politike të cilat ndikuan edhe në performancën e Qeverisë. P.sh për shkak të problemeve të pazgjydhshme midis konsultantit fillestar të mandatar (Sogreah) dhe EBRD projekti dhe mandati konsultativ u ndërmorën nga Colenco në 1998. Në 1997 EBRD e pezulloi huadhënien për shkak se KESH nuk ishte në gjendje të plotësonte gjitha kërkesat e marrëveshjes së huadhënies. Marrëveshja tjetër e huadhënies midis Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JBIC) me KESH dhe marrëveshjet e grantit midis KESH dhe Qeverive Austriake dhe Zvicëriane mbeten në fuqi. Pjesë të pajisjeve janë instaluar, të tjerat janë në depozitim (në vendet furnizuese dhe në objekte).

Në Dhjetor 1999 huaja e EBRD-u anulua dhe një marrëveshje e re huadhënie midis EBRD dhe Qeverisë Shqiptare u bë efektive në Korrik të vitit 2000. Për pasojë paketat të cilat do të financoheshin nga EBRD mund të tenderoheshin dhe kontratat mund të vendoseshin.

Megjithatë, implementimi tërësor i kombinuar në objekte nuk mund të fillonte menjëherë duke qenë se kontrata për paketën 8, Monitorimi i Sistemit dhe Kontrolli u bënë efektive në Korrik të vitit 2002. Koha e furnizimit sipas kontratës ishte 12 muaj.

Për shkak të kësaj vonese në implementim, kostoja shtesë për kontraktorët e paketave nr 3,4 dhe 6 u rrit, rritje për të cilët kontraktorët nuk do të ishin përgjegjës. Pretendimet lidhur me furnizuesit Zvicërianë dhe Austriakë u vendosën në Qershor 2001 me fondet shtesë të Qeverive respektive Austriake dhe Zvicëriane. Kostot shtesë për shkak të pretendimeve për vonesa, lidhur me paketën 6 u financuan nga KESH:

Në një takim bashkëpunimi mbajtur në Dhjetor 2000 në Tiranë, midis të gjitha palëve u ra dakort që fillimi i implementimit duhej të kishte qenë 13 Qershor 2001 për Hidrocentralin e Fierzës dhe 2 muaj më vonë për atë të Vaut të Dejës.

Megjithatë, implementimi u vonua edhe më tej për shkak të kontraktuesit Italian (paketa 6: Puna elektrike për Vau i Dejës dhe Fierzë) i refuzonte të vazhdonte punën para shtrimit të pretendimeve të përmendura më sipër.

Megjith ndërhyrjet e niveleve të larta situata nuk mund të zgjidhej deri nga fundi i vitit 2001. Në një takim Donator / Kontraktues në mars 2002 në Tiranë që Ministria e Energjisë dhe KESH do të çonin përpara një plan Implementimi si dhe një Plan Financimi për Pretendimet e papaguara. Në maj 2002 Qeveria Austriake dhe ajo Zviceriane treguan një shqetësim serioz lidhur me debatin e pazgjidhur midis KESH dhe kontraktuesin Italian, duke e nxitur fuqimisht Qeverinë Shqiptare për mobilizimin e një përkushtimi të nevojshëm politik.

Si një mjet të fundit, donatorët bilateralë konsideruan strategjitë e largimit. Eventualisht nga Qershor 2002 negociatat e vazhdueshme midis donatorëve, KESH dhe Qeverisë, caktimi i pretendimeve nga Alstom dhe financimi për rehabilitimin e vinxhave në Fierzë nga KESH dhe përqsja pragmatike nga ana e furnizuesve Austriakë dhe Zvicerianë bënë të mundur vazhdimin e projektit në periudhën 2003/2004. Ndërkohë rehabilitimi i hidrocentraleve të Ulzës dhe Shkopetit ka përfunduar dhe është parashikuar që puna në hidrocentralet Vau i Dejës dhe Fierzë të përfundojë nga mesi i vitit 2007.

## PROJEKTI: VLERËSIMI TEKNIK

---

Ky seksion jep vlerësimet dhe konkluzionet lidhur me aspektet teknike të DRCRP. Rekomandimet përkatëse janë dhënë në seksionin 5.2. Vlerësimi është bazuar në raportet dhe dokumentet e, siguruar nga klienti, nga informacionet e marra në intervistat dhe nga kontrolli fizik në katër hidrocentralet gjatë misionit në terren në Shtator 2005

### Specifikimet teknike të hidrocentraleve

Siç është përmendur në seksionin 2.3.1, të katër hidrocentralet e rehabilituara sipas DRCRP prodhojnë afërsisht 810 MW, vlerë kjo e barabartë me 50 - 55% të energjisë së prodhuar në vend. Kjo nënvizon rëndësinë e projektit për furnizimin e Shqipërisë me energji.

Puna për rehabilitimin teknik është bazuar kryesisht raportin e ecurisë të përgatitur nga kompania Lahmeyer, në vitin 1993 dhe raporti fillestar u përgatit nga Sogreah, në 1995. Gjithashtu, DRCRP përmbush një kërkesë të rëndësishme të planit të veprimit për Shqipërinë, iniciuar nga Banka Botërore.

### Fierza

Hidrocentrali i Fierzës është kaskada e parë mbi lumin Drin në Shqipëri, që do të thotë rezervuari i parë mbi lumin Drin. Rezervuari është krijuar nga një dige me materiale vendi me berthame argjili, mbushje me zhavor dhe gure 152 m e lartë dhe 380 m e gjatë me një kapacitet prej 2.7 bilion m<sup>3</sup>. Vepra e marrjes në krahun e majtë të digës, përfshin katër tunele të veçanta, secili me rrjeta dhe portat hidraulike të operueshme. Ka dy tunele shkarkimi, në anën e djathtë të digës, secili me porta shërbimi dhe ruajtjeje. Nuk ka dalje të poshtme; tunelet nr 1 dhe 2 u mbyllën pas ndërtimit. Të katër njësitë e njëjta vertikale Francis me nga 125 MW secila, ndodhen në godinen e centralit në këmbën e digës. Lartësia nominale e turbinës është 118 m dhe prodhimi mesatar vjetor i energjisë është 1326 GWh. Gjithë pajisja u projektua dhe u manifakturua në Kinë. Hidrocentrali u ndërtua në periudhë 1978 – 1979.

### Vau i Dejës

Hidrocentrali Vau i Dejës është kaskada e tretë dhe e fundit mbi lumin Drin. Rezervuari është krijuar prej tre digash dhe ka një kapacitet prej 319 milion m<sup>3</sup>. Të pesë njësitë e njëjta vertikale Francis, me 52 MW secila ndodhen në godinën e centralit në këmbën e digës qendrore, diga Qyrmaq. Lartësia nominale e turbinës është 52 m dhe një prodhimi mesatar vjetor i energjisë është 878 GWh. Hyrjet e ujit ndodhen në anën e majtë të digës kryesore (Qyrmaq) dhe përfshijnë pesë tubacione metalike të veçanta, secila me rrjeta dhe portat hidraulike të operueshme. Ndodhen dy sisteme të shkarkimit. Derdhja në anën e djathtë të digës kryesore përfshin tre porta me hapje radiale dhe tjetra një digë dytësore, diga e Zadrimës, rreth 3 km larg digës kryesore, përfshin dy porta me hapje radiale. Diga Qyrmaq është e pajisur me dy porta me hapje fundore. Gjithë pajisja kryesore u projektua dhe u manifakturua në Kinë. Hidrocentrali u ndërtua në periudhën 1971 – 1973.

### Shkopeti

Hidrocentrali i Shkopetit është hidrocentrali më i ulët mbi lumin Mat. Rezervuari është krijuar nga një digë e tipit me beton me gravitet e lehtësuar me fuga të, 53 m e lartë dhe 90 m e gjatë, e përbërë nga gjashtë monolite. Ai ka një sistem shkarkimi të përbërë nga tre porta, me difuzor energjie me "ski jump" në fund të shkarkimit. Të dy njësitë e njëjta Kaplan me 12MW secila, ndodhen në ndërtesën e centralit e cila ndodhet afërsisht 250 m në pjesën e poshtme të digës, pas headrace dhe tunelit të presionit. Lartësia nominale është 48.5 m. Prodhimi mesatar vjetor i energjisë 94 GWh. Turbinat u siguruan nga ish Cekosllavakia; pjesa tjetër e pajisjeve u sigurua nga ish BS Hidrocentrali u ndërtua në vitet 1960 – 1963.

### Ulza

Hidrocentrali i Ulzës është hidrocentrali më i lartë mbi lumin Mat. Rezervuari është krijuar nga një dige prej betoni e tipit me gravitet 64 m e lartë dhe 126 m e gjatë e përbërë nga 16 monolite me një kapacitet prej 124 milion m<sup>3</sup>. Katër monolite bashkojnë të katër portat e derdhjes së nivelit të lartë. Katër njësitë e njëjta vertikale Francis me 6.7 MW secila ndodhen në central në fund të këmbës së digës. Lartësia nominale është 54.8; prodhimi mesatar vjetor është 120 GWh. Turbinat u siguruan nga një prodhues austriak, të gjitha pajisjet e tjera janë prodhim rus. Hidrocentrali u ndërtua në vitet 1956 – 1957.



## Statusi aktual

### Vrojtime të përgjithshme

Dokumente të ndryshme lidhur me projektin , respektivisht hidrocentralet nuk mund të gjenden përsëri, ose duken se kanë humbur. Prandaj sqarimet të detajuara në thellësi, kanë një rëndësi parësore.( p.sh lidhur me gjendjen e trasesë së digave). Duket se dokumentet hidrologjike, kaq të rëndësishme për operacionet efëçente dhe efektive të hidrocentraleve, nuk janë të disponueshme – të paktën për ata që janë përgjegjës për operacionet.

Fakti që asnjë mirëmbajtje nuk u është kryer që nga 1993 ( raporti Lahmeyer) dhe kohës kur DRCRP filloi në Korrik 2002 në lumin Mat dhe Janar 2003 në Lumin Drin, ( Hidrocentrali i Vaut të Dejë – Janar 2003; Hidrocentrali i Fierzës Prill 2003) është pa dyshim një shkak për një keqësim të mëtejshëm.

### Fierza

#### a) Godina e centralit dhe vepra e marrjes

Konstrukti i godinës së centralit nuk është në kushte të mira. Veçanërisht struktura e çatisë, pikon në shumë vende në ditët me shi. Strukturat e betonit nuk janë ndërtuar siç duhet duke shkaktuar një mplakje të parakohshme të dëmtimeve korrensponduese. Megjithatë, nisur nga termat mesatare konstrukti nuk është në rrezik. Por gjendja jo e qëndrueshme e shpateve malore nën trasenë e digës, janë një rrezik i mundshëm. Në rast të një rrëshqitje toke madje dhe nën kushtet aktuale (dukuria sedimentare pranë rrymës së urës) kulla e kontrollit mund të përmytet nga uji i mbetur.

Në qëllimet e projektit nuk është planifikuar ose implementuar asnjë punë për rehabilitim strukturor.

Një sitemt i ri kontrolli është instaluar në portat e prurjes nga Alstom. Përveç katër vjet më parë u rehabilitua vinçi.

#### b) Traseja e digës dhe strukturat përkatëse

Në raptin e vlerësimit të Lahmeyer vlerësimi për trasenë e digës mungonte. Studimi i veçantë i “Sigurisë së Digë” nuk ishte i disponueshëm. Në këtë mënyrë, informacionet e detajuara jepen vetëm nëpërmjet strukturave përkatëse (tunelet për shkarkimin e plotave, tunelet e shpërndarjes)

Skica e disponueshme tregon vetëm seksionin e kryqëzimit të trasesë së digës, e cila duket se është ndërtuar me metodat e sotme të zakonshme inxhinierike. Nga 30 piezometrat e planifikuar për monitorimin e nivelit të ujit në trupin e digës vetëm 20 janë instaluar, nga të cilat vetëm 5 janë ende në punë. Deformimet e mundshme të digës nuk janë regjistruar. Por brenda strukturës së projektit në vazhdim, janë parashikuar vetëm investime të vogla për rehabilitim dhe zgjerimin e sistemit të monitorimit.

Gjendja e shkarkimve të plotave të mëdha mund të konsiderohet e kënaqshme. Shkarkimet në raste plotash nuk mund të inspektohen sepse tunelet e shkarkimit operohen pjesërisht. Gjendja e betonit në konstrukte të tjera tregon tunelet e shkarkimit shfaqin aspekte erozioni. Plus kësaj, portat e mbyllura kanë pikime serioze. Nuk është plotësisht e sigurtë, nëse mund të mbyllet pas hapjes, porta në kullën e ekuilibrit. Rrëshqitjet në bjefin e poshtëm si rezultat i shkarkimeve përgjatë bregut të djathtë, vështirë se mund të shmangen dhe rrezikon operimin e sigurtë të strukturës së shkarkuesve.

Tunelet e shpërndarjes (nr 1 dhe 2) janë ndërtuar pa integrimin me një dalje të poshtme. E vatmja mundësi për të ulur oso ndikuar në nivelin e depozituar, është nëpërmjet tunelit 3 i cili ndodhet në nivelin 220 m. Duke konsideruar orteqet dhe rrëshqitjet e tokës në liqen, apo problemet me portat e shkarkimit, kjo është një situatë që mbart rrezik.

Gjatë kohës së projektit egzistonte mundësia për të mbrojtur vetëm ato tunele të cilat ishin prekur më shumë nga filtrimet.

Tuneli nr 2 kishte rrjedhje dhe u mbyll përsëri.

#### c) Pajisjet mekanike dhe elektrike

Me rehabilitimin e turbinës prodhimi i energjisë mund të rritet me rreth 4 % 5 për njësi vetëm nëpërmjet rrotave të reja të punës. Edhe pse rrotat kanë shfaqur dëmtime më të vogla se ato të stacionit të Vaut të Dejës, duhen rehabilituar të gjithë motorët. Në kohën e vizitës tonë u rinovua një njësi (njësia Nr 4, me një turbinë të re.), njësi Nr 1 (e vjetër) ishte në operim, njësi Nr 2 ishte në procesin e rehabilitimit dhe njësi Nr 3 është në pritje të rehabilitimit. Dy rrota pune do të vihen të reja dhe dy do të riparohen. Përveç kësaj disa pajisje elektrike, si statorë do të rinovohen.

Vizita tregoi që puna për rehabilitimin ishte bërë sipas teknologjive të sotme moderne; megjithatë ky pohim nuk mund të zëvendësojë testin final teknik në përfundimin e punimeve

Vlerësuesit e konsideruan të kënaqshëm gjithë rehabilitimin dhe cilësinë e punës për vendosjen e pajisjeve mekanike dhe elektrike. si të mirë. Opinioni ky i ndarë nga specialistët në terren. Megjithatë montimi i rrotave të reja do të kishte çuar në përmirësimin e qëndrueshmërisë. Me një mirëmbajtje të përshtatshme agregatet e rehabilituar do të kishin një jetëgjatësi deri në 60 vjet. Megjithatë rrotat e reja të punës, dhe rinovimi i pajisjeve elektrike do të kishin patur një kosto më të ulët se rehabilitimi i pajisjeve egzistuese (afërsisht 20 vjet jetëgjatësi).

**d) Koncepti i funksionimit dhe i mirëmbajtjes**

Duket se nuk egziston një koncept sistematik i vënies në punë dhe mirëmbajtjes. (O & M). Përveç 5 piezometrave të përmendura tashmë në zonën e digës, vetëm brigjet e lumit që tentojnë të rrëshkasin afër digës, dhe godina e centralit janë nën mbikqyrje.

Rrugët e aksesit për në stacionin elektrik nuk janë të kënaqshme. Ato nuk garantojnë hyrje me makinë në çdo kohë.

**e) Aspektet mjedisore**

Zona pellgmbajtëse e stacionit elektrik ka një popullsi të rrallë. Duke patur parasysh rrëshkitjet e tokës, rënien e masave të orteqeve si edhe përmytjet përreth rezervuarit, risku për banorët e kësaj zone është relativisht i ulët. Influenca e gjendjes së ujrave nëntokësore në zonën pellgmbajtëse nuk është e përfillshme, por luhatjet e nivelit të ujit afër bregut të liqenit janë të konsiderueshme.

Vënia në punë e një trageti në Liqenin e Fierzës, do të ishte e dobishme dhe e mundur. (e ngjashme me atë të liq. të Komanit)

**Hidrocentrali i Vaut të Dejës**

**a) Power house and intake structure**

Godina e centralit paraqet shumë dëmtime të betonit të njëjta me ato të Fierzës. Gjithashtu mungojnë shumë mbulesa metalike duke patur një rrezik për personelin.

Pas një tragjedie zjarri në transformatorin Nr 2 ( 22 korrik 2005) i gjithë centrali duke përfshirë edhe pjesët mekanike dhe elektrike, duhej pastruar dhe rinovuar. Shumica e telave elektrike duhej zëvendësuar. KESH bëri një punë të konsiderueshme duke e riparuar dëmin në pothuajse vetëm një muaj. Në kohën e vizitës sonë shkaku i zjarrit ishte aktualisht i paqartë.

**b) Diga dhe strukturat përkatëse**

Të tre digat e skemës së hidrorcentralit janë rehabilituar pjesërisht në vitet nëntëdhjetë. Aktualisht digat përsëri do të kishin nevojë për rehabilitim po të kemi parasysh gjendjen e sistemit të kullimit dhe pamjen në bjeftin e sipërm.

Digat e stacionit të Vaut të Dejës janë të pajisura gjithashtu me piezometra, ( rreth 40 aparate në total) të cilat monitorojnë gjendjen e ujit në tokë. Sisteme të tjera monitoruese për të garantuar sigurinë e digave nuk egzistojnë.

Shkarkuesi është në gjendje të kënaqshme. Megjithatë ai ka të njëjtat dëmtime si ai i Fierzës. (egzekutimi fillestar i pamjaftueshëm i punëve, plasaritje të betonit, rrjedhje etj.).

Diga Qyrfaq ka një shkarkim të poshtëm me dy porta radiale të cilat kurrë nuk janë vënë në punë. Informacione të tjera lidhur me kapacitetin, kushtet operative, mirëmbajtjen etj aktualisht nuk egzistojnë.

Egzistojnë probleme të sigurisë (humbja e rjetave mbrojtëse në platformën sipër daljes) për punëtorët dhe vizitorët jashtë godines së centralit, në anën e bjeftit të poshtëm.

**c) Pajisjet mekanike dhe elektrike**

Në kohën e vizitës tonë dy nga pesë motorët ishin në përdorim, një i tretë ishte gati për aktivitetet e rehabilitimit dhe të komisionimit, një motor (njësia nr 3) ishte në ngritje. Motori i pestë (njësia nr 4) për momentin nuk ishte në përdorim për shkak të dëmtimeve nga zjarri.

Zjarri në transformatorin nr 2 solli vonesa të tjera të veprimtarisë rehabilituese, duke çuar në një humbje prej rreth 100'000 € në ditë si rezultat i vërshimit të ujit, i cili nuk mund të shfrytëzohej për prodhimin e energjisë.

Vizita tregoi që punimet e rehabilitimit ishin kryer konform teknologjive të sotme moderne megjithatë ky pohim nuk mund të zëvendësojë provën përfundimtare teknike të përfundimit të punimeve.

Vlerësuesit e konsideruan rehabilitimin në tërësi si të kënaqshëm dhe cilësinë e punës për pajisjet elektrike dhe mekanike si të mirë. Një opinion i dhënë nga specialistët në objekt.

**d) Koncepti i funksionimit dhe i mirëmbajtjes**

Përveç 40 piezometrave nuk ka një sistem egzistues të sigurisë së digës. Mungon një koncept i detajuar i vënies në punë dhe i mirëmbajtjes.

Vetëm një sasi e vogël e totalit të përgjithshëm është investuar për instalimin e instrumenteve të reja matëse, ndërsa zëvendësimi i aparturave egzistuese matëse ka patur një interes prioritar.

**e) Aspektet mjedisore**

Brigjet e liqeneve relativisht të sheshta, ofrojnë një mbrojtje më të mirë ndaj rrëshkitjeve.

Gjithashtu, shkarkimi nga portat e shkarkimit në bjeftin e poshtëm përcaktohet nga udhëzimet e KESH. Megjithatë shkarkimi mund të shkaktojë dëmtime në bjeftin e poshtëm nëse akumulohet me shkarkimet e mëdha të sistemeve të parregulluara të lumenjve të afërt.

Hyryra në stacion elektrik nuk përbën asnjë problem dhe është e mundur në çdo kohë.

Influenca e kushteve të ujrave nëntokësor në zonën pellgmbajtëse nuk është e rëndësishme dhe luhajtjet e nivelit të ujit pranë bregut të liqenit janë të papërfillshme.

**Hidrocentrali i Shkopetit**

Puna për rehabilitimin e hidrocentraleve të Shkopetit dhe Ulzës, pothuaj kish mbaruar në kohën e kryerjes së misionit, përjashto disa punë riparuese për të ndaluar rrjedhjet e vajit. Komentet janë kufizuar vetëm në vëzhgime të bëra gjatë kohës që turbina nuk ishte në punë.

**a) Komente të shkurtra lidhur me vëzhgimet**

- Në përgjithësi punë e mirë rehabilituese (rritje e energjisë 20%)
- Instalim i një Sistemi të Ri të Kontrollit dhe Monitorimit

- Zgjedhje e mirë për rehabilitimin e gjeneratorëve. Në vend të rehabilitimit të një statori të gjeneratorit , për të njëjtin çmim Koncar instaloi një të ri, ku i vjetri mund të përdorej si pjesë rezervë.
- Ndriçim i pamjaftueshëm në dhomën e droselave
- Hyrje me lehtësi në godinën e centralit
- Duhet bërë ende shumë punë civile, për rinovimin e pjesëve strukturore.
- Hidrocentrali është një shembull i një mirëmbajtjeje me kujdes (siç duhet të jetë)
- Rreziqe të rrëshkitjes së tokës dhe të shkëmbinjve përgjatë rezervuarit.

## Hidrocentrali i Ulzës

### a) Komente të shkurtra lidhur me vëzhgimet

Komente shih 3.2.3

- Transformatorët të rinovuar
- Sistemi i eksitimit i rehabilituar
- Celësa te rinj ne nestacion
- Eshtë kryer rehabilitimi i sistemit të droselave
- Hyrje me lehtësi në godinën e centralit
- Duhet bërë ende shumë punë civile, për rinovimin e pjesëve strukturore.
- Komandim me dore i rregullatorit te shpejtesise
- Në përgjithësi pajisje shumë të vjetra
- Praktikisht nuk ka rreziqe serioze të rrëshkitjes së tokës
- Nga të katër Hidrocentralet e vizituara, i vetmi ku transformatorët janë të mbrojtur nga dielli

## Konkluzione

Mbi bazën e dokumenteve, intervistave si dhe përshtypjeve të mara gjatë misionit, u nxorrën konkluzionet mëposhtme mbi aspektet teknike të situatës aktuale:

- Raporti i statusit të përgatitur nga kompania Lahmeyer në vitin 1993, është një dokument i detajuar në thellësi. Arsyeja përse kompania Sogreah nxorri një raport shtesë në vitin 1995, mbetet ende e paqartë.
- Investitorët me plot të drejtë, janë mbështetur në raportet e Lahmeyer dhe Sogreah për përcaktimin e kontributeve të veçanta. Megjithatë, fondet e kufizuara bënë që disa zgjidhje të veçanta të shndërroheshin në mundësi. Në fund disa nga këto mundësi duhet të realizoheshin përsëri, me fondet shtesë të donatorëve bilateralë dhe KESH (shih 0 gjithashtu). Ndonëse fondet shtesë kërkuan anulimin e disa çështjeve të tjera për pasojë
- Një koordinim dhe komunikim më i mirë midis investitorëve / donatorëve tashmë në fazën fillestare të DRCRP si edhe marrja më shumë në konsideratë e rekomandimeve të bëra nga konsulentët (Colenco) gjatë periudhës së fizibilitetit dhe fillestare nga zotëruesi do të kishte lejuar ndoshta, për zgjidhje më të mira teknike. Megjithatë, zgjidhje të tilla do të kishin patur nevojën e më shumë fondeve, të cilat për atë kohë nuk ishin të disponueshme.
- Një alokim më i përshtatshëm paketave të kontratave do të kishte lejuar një manaxhim më të mirë të ndërhyrjeve. Organizimi i projektit nuk garanton një ndarë të qartë të përgjegjësi

dhe mbart rrezikun e keqkuptimeve përsa i përket komunikimit, kompetencës dhe ndërhyrjes.

- Disa punime rinovuese janë duke mbetur mbrapa, për arsye të ndryshme. Megjithatë, në bazë të informacionit të të manaxhimit të projektit, këto punime duhet të përfundohen nga fillimi i vitit 2007.
- Me përfundimin e projektit do të eliminohen operacionet e rrezikshme, në të katër hidrocentralet. Për një funksionim të sigurt dhe për rritjen e jetëgjatësisë së hidrocentraleve, shtrirja e rehabilitimit deri në trasetë e digave, strukturave të tyre dhe pajisjeve mekanike si portat e punës, portat e remontit etj është esenciale. Në rastin e Ulzës do të ishte me vlerë marrja në konsideratë e rehabilitimit të atyre pjesëve të cilat ishin parashikuar në planin origjinal, por që u shtynë për shkak të fondeve të kufizuara.
- Nga vëzhgimet e bëra, shumë prej dëmtimeve të strukturave, nuk janë pasojë e vjetërimit, por pasojë e një planifikim ose ekzekutimi joprofesional të punës, në kohën e fillimit të ndërtimit të hidrocentraleve.
- Pa një koncept lidhur me funksionimin dhe mirëmbajtjen, është gati i pamundshëm, një funksionim ekonomik dhe qëndrueshëm i hidrocentraleve (shih gjithashtu 0)

## **PROJETI: ASPEKTET INSTITUCIONALE**

---

### **Relevanca e Projektit të Rehabilitimit të Kaskadës së Drinit**

#### **Relevanca për Shqipërinë**

Nuk ka asnjë dyshim që DRICRP është një projekt me një relevancë të lartë për zhvillimin socio ekonomik të Shqipërisë. Nisur nga një perspektivë ekonomike, rehabilitimi i katër hidrocentraleve me një rëndësi parësore për një furnizimin të besueshëm, ishte një prioritet i dukshëm në fillim të viteve 90-të. Mosha dhe kushtet e hidrocentraleve përbënin një rrezik të konsiderueshëm për furnizimin me energji në Shqipëri. Për më tepër se për shkak se në atë kohë importimi i energjisë nuk mund të garantohej për shkak të kushteve të lidhjeve ndërkombëtare dhe pjesërisht për shkak të kolapsit të tregut të eksportimit të mëparshëm.

Edhe pse industria e vendit vazhdoi prodhimin në fazën fillestare të tranzicionit, energjia elektrike ishte një kërkesë themelore për zhvillimin dhe rimëkëmbjen që pritej. Në të njëjtën kohë, duheshin përmbyshur nevojat bazë të një shoqërie që filloi lëvizjen drejt standarteve të jetesës, që ndyshonin shumë me ato të kohës së izolimit.

Këto ishin arsye të mira për tu fokusuar jo vetën në prodhimin e energjisë por gjithashtu edhe në transmetimin dhe shpërndarjen e saj, siç në përpjekjet e përbashkëta të donatorëve. Krahasuar me fillimin e viteve 90-të situata në vitin 2005 është komplet ndryshe. Përdorimi shtëpiak është rritur në mënyrë drastike, ndërsa përdorimi industrial është ende i ulët në sajë të kushteve të vështira ekonomike.

Prandaj Shqipëria është kthyer në një importuese të energjisë. Ka të ngjarë që kërkesa të vazhdojë të rritet. Përveç hidrocentralit termal që do të ndërtohet në Vlorë, me qëllim ruajtjen e balancës / diversitetit të caktuar, për burimet primare të energjisë, fuqia hidrike do të mbetet mundësia kryesore për Shqipërinë.

Fillimisht të zvogëlojë importin në periudhë afatmesme, ti kthehet eksportimit të energjisë si një burim i rëndësishëm të ardhurash në Shqipëri.

Kjo do të thotë që relevanca e DRICRP vazhdon të mbetet e lartë dhe përdorimi shtesë i potencialeve të mëdhatë fuqisë hidrike duhet të jetë një prioritet për ekonominë e Shqipërisë.

## Relevana në lidhje me Strategjinë e Bashkëpunimit Austriak

Bashkëfinancimi i DRCRP është i vetmi investim më i madh në kontekstin e bashkëpunimit Austriak me vendet e Evropës Lindore. Prandaj, relevanca dhe efektiviteti i projektit nga perspektiva e zhvillimit duhet vlerësuar në mënyrë kritike, veçanërisht lidhur me objektivat e bashkëpunimit Austriak.

Vlerësimi fillestar i projektit ( fillimi i viteve 90-të) u bë nga një person i Bashkëpunimit të Zhvillimit Austriak me vendet lindore (EZA) me një fokus të orientuar nga zhvillimi projekti u konsiderua të ishte një kontribut me relevancë për infrastrukturën bazë, si një kusht themelor për zhvillim.

Për shkak të situatës së saj gjeo-politike, Austria ka një interes të qartë për një situatë të qëndrueshme politike si dhe për një zhvillim të shpejtë social ekonomik dhe ekologjik të vendeve të Evropës Lindore.

Mbështetja e procesit të tranzicionit, që siguron stabilitet në rajon dhe që përfundimisht çon në një integrim të plotë të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian, është një përjasje e rëndësishme e bashkëpunimit Austriak. Sipas objektivave strategjike të OZA (me fjalë të tjera, ulja e varfërisë, mbrojtja dhe siguria njerëzore, ruajtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore), në relevancën e DRCRP duhen bërë diferencime.

Relevanca e DRCRP, në këtë mënyrë dhe e kontributit Austriak, është dhënë veçanërisht, lidhur me prioritetet e mëposhtme tematike të Bashkëpunimit Austriak.(OZA)

- .Ekonomia dhe zhvillimi: furnizimi i qëndrueshëm i vendit me energji, relativisht të lirë dhe ekologjike, ishte një nga kërkesat kyçe për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e ekonomisë Shqiptare në fillim të viteve 90-të. Ishtë dhe është baza e krijimit të punësimit në të gjithë sektorët e industrisë dhe të tregtisë. Si e tillë ajo hedh themelin për prioritetin tematik 'zhvillimi i kapacitetit ekonomik dhe social i ekonomisë Shqiptare'. Projekti është në një linjë të plotë me kriterin përzgjedhës të fondeve të OZA, që do të thotë, ai merr parasysh interesat e veçanta ekonomike të Austrisë në rajon, dhe eksperiencën (teknike) njohuri të industrisë Austriake. Deri në një masë të kufizuar, ai gjithashtu ka potencialin për të përdorur fondet e OZA, për nxitjen e investimeve nga sektori privat Austriak. Në këtë mënyrë rehabilitimi hidrorcentraleve Small-Scale mund të jetë akoma një fushë me interes për bashkëpunimin Austriak në të ardhmen.
- Në kombinim me projekte të tjera në sektorin e energjisë, ( linjat e transmetimit në vendet fqinje) projekti gjithashtu ka një relevancë të caktuar lidhur me integrimin ekonomik rajonal, nëse ai ndihmon për ngritjen e potencialeve për eksportimin e energjisë. Duke marrë parasysh lidhjet ndërkombëtare rajonale, një standart i përshtatshëm i gjithë sistemit të energjisë ka një relevancë të lartë.
- Mbrojtja dhe qëndrueshmëria e burimeve natyrore: Fuqia hidrike duket qartë që është burimi primar ekologjik në Shqipëri, që aktualisht mund të shfrytëzohet në një masë të madhe. Rehabilitimi i infrastrukturës egzistuese, është një mënyrë efiçente për vënien në baza të qëndrueshme të prodhimit të energjisë hidrike. Ky është objektivi strategjik i OZA, ku DRCRP jep një kontribut të rëndësishëm dhe të drejtpëdrejtë.

DRCRP ka kontribuar gjithashtu, për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve (detaje shih 0). Këto nuk ishin objektivat primare të DRCRP dhe të kontributit Austriak, por ato u evoluan pjesërisht nga nevoja dhe pjesërisht nga projektet e sektorit të energjisë, të cilat përqëndrohen veçanërisht në këto çështje dhe kanë një impakt në gjithë gjerësinë e sektorit

## Relevanca në lidhje me strategjinë e seco

Ndryshe nga ADA, për seco çështja e relevancës është më e drejtpërdrejtë, kjo falë fokusit të qartë të seco's lidhur me bashkëpunimin për zhvillimit *ekonomik*. dhe brenda kësaj financimi i infrastrukturës bazë. Brenda strategjisë së vendit për Shqipërinë përkrahjaja ndaj DRCRP, është pjesë e një pakete më të gjerë mbështetjeje, për sektorin energjistik Shqiptar, e cila gjithashtu përfshin projektet për nënsektorin e shpërndarjes dhe transmetimit të energjisë. Në strategjinë aktuale seco të vendit, sektori i energjisë është njëri prej dy sektorëve prioritarë. Për këtë arsye, DRCRP mbetet një element relevant në portofolin e seco's.

## **Përçqasja implementimi/ Struktura e Projektit**

Krahas faktorëve të jashtëm, d.m.th asaj paqëndrueshmërie politike në fillim të viteve 90-të, implementimi ose organizimi i projektit duket se është shkaku kryesor për shumë komplikime që çuan në një proces implementimi të gjatë, të vështirë, ndonjëherë nervshkatërrues dhe mbi të gjitha inefficent nga ana ekonomike.

Investime të tilla si ai i DRCRP, zakonisht kërkojnë një marrëveshje bashkëfinancuese pasi ai e kapërcen kapacitetin e një donatori të vetëm. Megjithatë, kombinimi i 6 burimeve financuese me kushte të ndryshme huadhënie si dhe alokimi i 8 kontratave në tërësi, në të katër hidrocentralet, rezultuan në një numër të madh ndërhyrjesh dhe ndërvarësish midis kontratave. Rezultati është që pothuaj çdo problem ose vonesë me një kontratë, ka implikime negative në kontratat e tjera, si një lloj reaksioni zinxhir, duke çuar në vonesa të përsëritura të punimeve dhe pretendimeve nga ana e kontraktorëve. Marja hap pas hapi me këto pretendime, çonte në pretendime të tjera. Ekipi i vlerësimit nuk mund të përvijonte më në detaje arsyen fillestare ndaj zgjedhjes së këtij lloji organizimi.

Një problem tjetër ishte që shuma egzakthe e punës së përfshirë për rehabilitimin e hidrocentraleve është e vështirë të parashikohet. Prandaj, buxheti ose duhet të jetë fleksibël (duke lejuar një procedurë 'hap pas hapi') ose duhet të ketë përcaktime të përgjithshme për fondet rezervë (ekspertët deklarojnë 30 – 50 %) që të bëhet i mundur një proces rehabilitimi sa më i saktë. Kushte paraprake këto, që nuk ishin dhënë me kushtet e huadhënies së fondeve. Buxhetet ishin të fiksuara dhe kontigjentet nuk ishin të disponueshme (JIBC) ose vetëm me rradhë, zakonisht të përdorura vetëm për ndërtime të reja. Gjatë negociatave kontraktuese në vitin 1997 tema të caktuara madje, duhet të spostoheshin në opsione, kjo për shkak të buxheteve fikse.

## **Manaxhimi i Projektit / Organizimi**

Nga pala e donatorëve, mbikqyrja e projektit u organizua në mënyrë konvencionale. EBRD 'luajti rolin e kordinatorit lidhur me gjithë mbikqyrjen e projektit', donatorët Japonezë u mbështetën tek EBRD për supervizimin e projektit dhe donatorët Zvicëranë dhe Austriakë mandatuan nga ana tyre konsulentë për mbështetjen e projektit, që do të thotë të supervizonin implementimin e kontratave respektive, të vepronin si agjentë prokurimi dhe të mbikqyrnin përdorimin e fondeve.

Kapaciteti lokal i donatorëve ishte i mjaftueshëm për një pjesmarrje në përsëritjet periodike të projektit. Përsa i përket marrëveshjeve me EBRD, agjensitë bilaterale ADA dhe seco, fillimisht u mbështetën gjithashtu tek donatori kryesor (EBRD) dhe tek konsulentët, për ndjekjen e çështjeve kontraktuale dhe teknike të implementimit Kur implementimi i sukseshëm u kërcënua ADA dhe seco 'futeshin në rrezik' dhe luanin tre karta të forta: që do të thotë koordinim, raport i mirë me aktorët dhe kontekstin lokal, fleksibilitet në financim dhe të ngjashme me këto. Kjo dhe përkushtimi personal i individëve përfaqësues të donatorëve, konsulentët dhe KESH ishin mjetet për vënien e projektit përsëri në rrugë të mbarë.

Në mënyrë të ngjashme, nga pala e klientit u zgjodh një metodë tradicionale, me fjalë të tjera, klienti caktoi një Njësi të Manaxhimit të Projektit (PMU) përgjegjës për prokurimin dhe supervizimin e implementimit, mbështetur nga një konsulent. Megjithatë numri i madh i aktorëve të përfshirë në procesin e nxitjes së projektit dhe alokimi i paketave kontraktuese krijuan në supervizim kaq shumë ndërhyrje dhe nivele të përfshirjes, sa që edhe një PMU me eksperiencë do të kishte patur vështirësi të përballej (për më shumë detaje, shih kapitulin 3: Vlerësimi Teknik). Në fazën fillestare të projektit, mungesa e eksperiencës lidhur me projektet e financuara nga donatorët dhe kërkesat e lidhura me to, ishin sigurisht një tjetër sfidë për klientin / PMU.

Duke qenë se fillimisht të gjithë partnerët e përfshirë u mbështetën në një organizim konvencional të manaxhimit të projektit që realisht nuk ishte adekuate në rrethanat egzistuese, me fjalë të tjera, paqëndrueshmëria politike, mungesa e eksperiencës nga ana e klientit, projekti teknikisht komplikuar, metoda e komplikuar e implementimit, ishte e vështirë për manaxhimin e projektit të identifikonte incidentet kritike në kohën e duhur, si dhe t'arrinte në marrëveshjen e të gjitha palëve për veprimin e duhur.

Përveç kësaj situate të vështirë të DRCRP, një PMU mbart zakonisht rrezikun e vendosjes së një strukture paralele gjatë kohës së projektit, ku përgjegjësia e stafit për operacionet e zakonshme nuk përfshihet direkt. Kjo e kufizon përkushtimin e stafit të zakonshëm për marrjen e përgjegjësisë mbas përfundimit të projektit. Në rastin e DRCRP, kjo tërheqje mbrapa e PMU-ve nuk ishte kritike, sepse në fund të fundit (shih gjithashtu ndërtimi kapaciteteve) shumica e stafit nga mekaniku deri te drejtori i hidrocentralit u përfshinë në implemnetimin e projektit.

### *Konkluzione*

Përfundimi i sukseshëm i projektit (që është arritur tashmë) është më shumë rezultat i përpjekjeve të palodhura të individëve të përkushtuar, sesa i mekanizmave institucionalë të përdorur për supervizionin e projektit.

Nga këndvështrimi i sotëm, është e vështirë të gjykosh arsytet që çuan në zgjedhjen e kësaj strukture. Megjithatë, egziston një dyshim i caktuar lidhur me faktin që vështirësitë mund të ishin parashikuar. Kjo është relevante, sepse nënvizon rëndësinë e kapacitetit të donatorëve për vlerësimin e një projekti si dhe influencën e kërkesave të tyre për implementimin e suksesshëm të projektit.

Mekanizmat institucionale dhe kërkesat e agjensive të donatorëve për dhënie e fondeve, ishin pjesërisht pengesa për gjetjen e zgjedhjeve më të mira. Në kushtet e mungesës së një kompetence teknike, të specializuar për vlerësimin e projekteve të komplikuar, mobilizimi i hershëm i monitorimit / konsulentëve mbështetës dhe përfshirja e tyre në vlerësim, mund të kishin ndihmuar në hartimin e organizimit të implementimit, në fillim të projektit. Në të njëjtën mënyrë, në fazën e negociimit të një huadhënie të re, një fleksibilitet më i madh në buxhetim mund të lejonte një rishikim të zgjedhjeve teknike në kuadrin e situatave të ndryshuara. Në fillim të projektit jo të gjitha detajet e nevojshme të projektit ishin të njohura dhe për më tepër, gjendja e hidrocentraleve në vitin 2002 ishte sigurisht ndryshe nga ajo e vitit 1993, koha në të cilën u bë dhe studimi i parë. Ekzistonte mundësia për identifikimin e një zgjidhje të qëndrueshme dhe eficiente.

Për projekte me kërkesë të lartë teknike dhe komplekse si ai i DRCRP, çështja shrohet se deri në ç'masë donatorët si ADA dhe seco mund të kalojnë burimet / zëvendësojnë funksionet e tyre supervizore me konsulentët monitorues, duke mbetur përsëri kompetentë suficientë dhe në kontroll për identifikuar dhe vepruar në kohë ndaj incidenteve kritike.

### **Mobilizimi i Partnerëve lokalë (Ministria, KESH, PMU, etj.).**

Një çështje kritike për mobilizimin e partnerëve lokalë, sigurisht ishte dhe mungesa e eksperiencës me kërkesat e menaxhimit të granteve dhe kredive me prokurim ndërkombëtar, në fazën fillestare, respektivisht supozimi i nënkuptuar që kjo kompetencë ishte e arritshme me partnerët lokalë.

Në ngjasim me këtë, në rastin e ngritjes së punëve për pjesët elektro-mekanike, pritishtëritë lidhur me kompetencën e kontraktorëve lokalë ishin në dukje jorealiste. Në këtë mënyrë, duheshin gjetur zgjidhje të reja në stafin e KESH për ngritjen e punës. Nga ana tjetër kontraktuesi lokal për punët civile (siguria e digës ) ishte i shpejtë dhe kompetent.

Përgjatë fazës së parë të projektit deri në zgjidhjen e bllokimit të vitit 2002, çështjet politike patën një impakt negativ në performancën e Ministrisë dhe të KESH (p.sh përpjekjet për ritenderimin e kontratave për pajisjet elektrike, duke çuar në vonesa të tjera). Duket që performanca e PMU u përmirësua ndjeshëm me caktimin e manaxherit aktual të Projektit që prej muajit Qershor të vitit 2002. Në vazhdim të kësaj, prezenca e vazhdueshme e të njëjtit Manaxher Projekti (të huaj) në anën e konsulentit, që nga koha e mobilizimit të konsulentit aktual në vitin 1998, sigurisht e ka lehtësuar punën e PMU aktual.

Në termat e kontributit financiar, sipas shifrave të dhëna në aneksin 3, pjesa e koston lokale është rreth 15 %, e cila përfshin koston direkte të KESH, koston shtesë si rezultat i vonesave në implementim si dhe koston e montimit të egzekutuara nga stafi i KESH. Sipas një informacioni të KESH, marrë pas misionit, në këto shifra nuk përfshihet kostoja e matësive të gjeneratorëve, materialet e nevojshme të izolimit dhe kostoja e mbetur për punët civile deri në fund të projektit e cila do ta çonte raportin deri në 25 %. Duke konsideruar këtë informacion suplementar dhe faktin që dy nga pretendimet për koston shtesë, për shkak të vonesave u paguan nga fondet e donatorëve bilateralë (ADA & seco), dhe koston lokale të montimit për paketat, financuar nga EBRD, u paguan nga huadhëniet, ndarja e koston direkte të KESH është afërsisht 17 % e vlerës totale të projektit.(detaje, shih aneksin 3 ). Megjithatë koston indirekte, të tilla si humbja në prodhim, këtu nuk janë përfshirë.

### **Përqasja ndaj Koordinimit të donatorëve**

Në fillim të projektit, kordinim donatorësh nënkuptonte kryesisht, ndarjen e përgjegjësi midis EBRD dhe Bankës Botërore si dhe gjetjen e bashkëfinancuesve për projektet. Ashtu si me organizimin e supervizionimit, u përdor metoda konvencionale e delegimit të përgjegjësi tek donatori udhëheqës. Fakti që EBRD sipas raporteve nuk i njoftoi donatorët e tjerë për anulimin e huasë së saj (megjithëse dhënia e njoftimit ishte pjesë e marrëveshjes midis Qeverisë Austriake dhe EBRD) e vë në pikëpyetje faktin, nëse EBRD e përbushi në mënyrë adekuate rolin e saj. Në fillim, midis vetë donatorët bilateralë, nuk pati shumë koordinim. JBIC nuk mori pjesë nëpër takime, deri në kohën kur nuk kishin filluar problemet me Alstom Itali.



Vetëm pas impresionit të rritjes së vështirësive, filloi një koordinim më i fortë dhe aktiv midis dy donatorëve bilateralë ADA dhe seco, koordinim i cili pati një influencë më të madhe edhe mbi EBRD. Me fjalë të tjera, koordinimi i donatorëve më shumë ishte produkt i një emergjence, sesa i një procesi sistematik të qëllimshëm. Ndërsa përkushtimi i stafit të përfshirë është i pranuar nga të gjithë partnerët, roli i EBRD si një institucion i koordinimit të donatorëve, akoma shihet me sy kritik. Ndërkohë, koordinimi i donatorëve në sektorin e energjisë është përmirësuar në përgjithësi, por siç duket akoma nuk krahasohet me sektorët e tjerë, ku përpjekjet për harmonizim dhe aleanca e donatorëve me strategjitë dhe politikat lokale sipas raporteve janë më të avancuara.

Së fundmi nëse në rastin e DRCRP, u arrit dhe çoi në rezultate të mira, bashkëpunimi i donatorëve (duke riaktivizuar një projekt kyç), kjo falë një liderशिpi të fortë / përkushtimi i individëve të gatshëm bashkë me një raportim të mirë me zyrat qëndrore, veçanërisht në rastin e dy donatorëve bilateralë.

Në vijim, fleksibiliteti në alokim nga ana e ADA dhe seco / rritja e fondeve, për kthimin sërish në rrugë të projektit dhe përdorimi i 'fondit zviceran kondraparti' për imlementimin e punimeve shtesë, që u identifikuan si të nevojshme, janë një shembull pozitiv për bashkëpunimin midis donatorëve

#### *Konklutione*

Duke konsideruar natyrën dhe rëndësinë e projektit, një bashkëpunim më sistematik dhe aktiv i donatorëve që në fillim të projektit, do të kishte ndihmuar ndoshta për shmangien e disa problemeve. Ai mund të kishte nxitur EBRD për të marrë që në fillim, në mënyrë efektive, rolin donatorit udhëheqës.

### **Transferimi i njohurive, Ndërtimi i kapaciteteve, Zhvillimi Institucional**

#### **Zhvillimi Institucional**

Zhvillimi institucional nuk është një anë e përjashtuar e DRCRP, por mbulohet nga të tjera projekte të EBRD dhe Bankës Botërore, në mbështetjen e sektorit të energjisë. Megjithëse një strukturë institucionale efektive, është një e kërkesë e rëndësishme, e domosdoshme për një investim të tillë si DRCRP, zgjidhja e problemeve institucionale është një çështje që merr kuptim, përmes programeve të veçanta dhe jo vetëm nëpërmjet një projekt me hard-ware, sepse zhvillimi institucional (ID) duhet t'i adresohet gjithë strukturës institucionale, që do të thotë, legjislacionit, reformës strukturore, performancës së Ministrisë dhe KESH si njësitë përgjegjëse. Ajo ç'ka mbetet e rëndësishme, është sigurimi i lidhjes midis DRCRP dhe ndërhyrjeve të ID:

Nuk është brenda qëllimit të këtij vlerësimi, vlerësimi i projekteve për zhvillimin institucional, të implementuara nga EBRD dhe BB. Megjithatë, vëzhgimet e bëra lidhur me DRCR sugjerojnë që, në sfondin e implementimit të shpejtë të fondeve në sektorin e energjisë, dhe të trazirave politike në fazën fillestare, ka të ngjarë të jetë nënvlerësuar rëndësia e zhvillimit institucional, në fillim të bashkëpunimit me Shqipërinë. Eksperienat e BB, lidhur me përpjekjet e para për privatizim, theksuan gjithashtu, se kushtet specifike për zhvillimin institucional në Shqipëri mund të mos jenë marrë në konsideratë sa duhet (sisteme josekzistente, mungesë eksperience lidhur me trajtimin e projekteve donatore dhe huadhënëve / kërkesat e prokurimit / riorganizim i nevojshëm i / ministrive / politikave të sektorit dhe sistemit të tarifave) Vështirësitë në implementimin e Kontratës së Asistencës së Menaxhimit për KESH demonstrojnë gjithashtu një lloj mosgadishmërie nga ana e partnerëve Shqiptarë për zgjidhjen e çështjes së zhvillimit institucional.

Donatorët bilateralë të përfshirë në DRCRP, u mbështetën tek bankat për aspektin e zhvillimit institucional, e cila në princip është një ndarje e përshtatshme e detyrave. Megjithatë, më një përfshirje më të fortë të bilateralëve, përse i përket koordinimit të donatorëve, njohuritë relevante të disponueshme nga donatorët bilateralë mund të kapitalizohej.

#### **Zhvillimi i Kapaciteteve**

Transferimi i njohurive dhe trajnimi është një detyrë eksplicite në ToR të konsulentit të KESH-it, ndërsa e parë nga pikëpamja e kontributeve bilaterale, nuk është një objektiv eksplicit. Në praktikë, ndërtimi i kapaciteteve është bërë kryesisht prej konsulentëve, përgjatë punëve trajnuese dhe tajnimeve në Zvicër për ekuivalentët, që do të thotë kryesisht për inxhinierët. Me punonjësit e stafit të KESH, në ngritjen e punës për pajisjet elektro-mekanike, egzekutuar nga kontraktorët, qëllimi i ngritjes së kapaciteteve ishte shtrirë deri në nivelin e mekanikëve.

Zhvillimi i një 'manuali projekti' ishte një përpjekje për sistematizimin e trajnimeve dhe për vënien mbi baza të qëndrueshme të çështjes së ngritjes së kapaciteteve. Për shkak të mungesës së fondeve, për implementimin e manualit në të gjithë hidrocentralet, ky i fundit nuk u prezantua si një mjet i zakonshëm për funksionimin dhe mirëmbajtjen (O&M) Përshtypja është që zhvillimi i kapaciteteve

është bërë më shumë mbi bazat e domosdoshmërisë dhe të mundësive praktike, sesa mbi bazën e një metode sistematike në sensin e një ndërhyrje të planifikuar dhe implementimi mbi bazën e një koncepti i cili merr parasysh kërkesat dhe perspektivën afat gjatë të ruajtjes së kapaciteteve të ngritura dhe të njohurive (O&M të qëndrueshëm). Si një shembull praktika e ngritjes së rrogave për stafin e punës së projektit mund të jetë me efektivitet për implementimin e projektit, por nga pikpamja e qëndrueshmërisë mund të një çështje e dyshuar, sepse vendos stimuj të gabuar, për rastin kur punëdhënësi nuk është në gjendje të vazhdojë me të njëjtat pagesa për O&M. Një metodë më pak e kritikueshme do të kishin qenë pagesat bonus, pas përfundimit me sukses dhe në kohe, të punëve specifike.

#### **Konkluzione**

Reagimet dhe vëzhgimet tregojnë që cilësia e transferimit të njohurive është e orientuar nga praktika dhe e krahasuar me inputet është arritur mjaft. Kjo për meritë të personelit konsulent dhe kontraktues në të gjitha nivelet që janë të përkushtuar për ndarjen e dijeve të tyre me ekuivalentët lokalë.

#### ***Ndërtimi i kapaciteteve në terren***

*Ndërsa konceptet e ndërtimit të kapaciteteve janë esenciale në zhvillimin e projekteve, egziston rreziku i lënies në harresë të impaktit të praktikantëve të huaj (p.sh mekanikët e palës kontraktore) të cilët punojnë ngushtë me stafin lokal. Ata jo vetëm kanë transferuar njohuri mjaft praktike, por shpesh luajnë rolin e modelit, në termat e përkushtimit profesional, e cila është me rëndësi për transferimin e qëndrueshëm të njohurive*

Megjithatë, madje edhe nëse udhëzimet e O&M mund të egzistojnë, një koncept i qartë për implementimin e tyre, është një kusht i domosdoshëm për tu siguruar që kapacitetet e zhvilluara, mund të ruhen dhe përdoren për një O&M sistematik dhe të qëndrueshëm.

#### **Sinergjitë**

Brenda sinergjisë së DRCRP respektivisht, bashkëpunimi i donatorëve ishte i mirë në momentin që i duhej dhënë zgjidhje një krize serioze. Të dy donatorët bilateralë, bashkuan forcat, për shtyrë të gjitha palët e përfshira për të nderuar përgjegjësitë e tyre respektive ata gjithashtu, vunë në përdorim të mirë gjithë fleksibilitetin e tyre.

Brenda sektorit të energjisë ADA u përpoq të përdorte sinergjitë duke propozuar një fond të vazhdueshëm për rehabilitimin e hidrocentraleve të vegjël (HEC- et e vogla). Ky do të kishte qenë një kapitalizim i ideal i dijeve të ngritura në sektor, duke patur parasysh që ADA vështirë se do të shkonte për një tjetër projekt të tipit DRCRP. Fatkeqësisht këtij propozimi i iku koha. Përshkak të privatizimit të SSHPP-ve, iniciuar nga EBRD dhe BB. Si i tillë, ky është një shembull i një dërrhyrje negative të programeve të donatorëve të ndryshëm. Ai thekson rëndësinë e koordinimit të donatorëve dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë donatorët të përfshirë në një sektor, në politikat e dialogut, Përsa i përket pjesëve të tjera të programit Austriak, portofoli i projektit të ADA nuk siguron sinergji direkte me DRCRP. Për seco sinergjitë brenda sektorit janë dhënë për shkak të fokusit të saj në sektorin e energjisë. Me përfshirjen e saj në pridhimin e energjisë, siedhe shpërndarjen dhe transmetimin, seco ka një impakt më të fortë në sektor, se ADA.

#### **Konkluzione dhe Vlerësime të Përgjithshme**

##### **Efektshmëria (arritjet e objektivave)**

Nëse rehabilitimi i katër hidrocentraleve realizohet siç është parashikuar momentalisht, me fjalë të tjera, përfshirja e gjithë mundësive që mund të implementohen me fondet shtesë të siguruara nga ADA (për Shkopetin dhe njësia 4 Vau i Dejës) dhe nga fondet kontraparti zviceriane, objektivat e caktuara mund të arrihen. Hidrocentralet do të rehabilitohen deri në një standart të kënaqshëm teknik, i cili e zgjat dhe siguron prodhimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike.

##### **Qëndrueshmëria**

Për të siguruar qëndrueshmërinë e këtyre rezultateve, akoma një numër çështjes mbeten për tu zgjidhur (shih gjithashtu rekomandimet):

- Kryerja e studimit të sigurisë së gigës dhe implementimi i matjeve që lidhen me të,
- Kryerja e një rishikimi teknik të projektit para përfundimit të tij me qëllim identifikimin e kerkesave të reabilitimit përtej DRCRP dhe atyre lidhur ngushtë me to,
- Stabilizimi i një koncepti për të ardhmen e O & M të hidrocentraleve.

Përtej aspekteve tenike, rritja e ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe aspektet që lidhen me çështjet mjedisore, duhet të jenë një shqetësim i KESH dhe Ministrisë.

#### **Efienca ( lidhja input - output )**

Në princip rehabilitimi i hidrocentralleve egzistueseshte dhe është një metodë efciente për prodhimin e energjisë elektrike në Shqipëri. Faktorët emëposhtëm kanë patur një ndikim të lidhur me efcencën e DRCRP

Mungesat e fondeve të përmendura më sipër në organizimin e projektit, duke sjellë vonesa, bashkë me pasojat e tyre (penalitetet, kostot shtesë për KESH, humbja e të ardhurave për përdorimit joeficient të hidrocentralleve) kanë ndikuar seriozisht mbi gjithë efcencën.

Nënvlerësimi dhe pasiguritë lidhur me rehabilitimin e hidrocentralleve (eksperiencat relevante nga mesi i viteve 90 akoma nuk ishin mjaft të përhapura) kanë ndikuar efcencën, gjithashtu. Struktura e ngushtë financiare ( fondet fikse, kontigjentet e pamjaftueshme) kapja fort pas planit fillestar penguan kontrollimin e alternativave që mund të kishin qenë më efciente. Arësyet e nënvizuara për ineficencën ishin sigurisht edhe kushtet politike.

## MËSIMET E NXJERRA / REKOMANDIME

---

### Mësimet e nxjerra (Lessons Learned)

#### Në përgjithësi

##### *Financimi me shumë donatorë:*

- Për të minimizuar komplikacionet në projektet me shumë donatorë, alokimi i paketave të kontratave duhet sa më i thjeshtë, duke shmangur ndërvarësitë panevojshme kontraktuale dhe teknike. Konsiderimi i kujdesshëm i organizimit të projektit dhe sigurimi i kompetencave, koha dhe fleksibiliteti për investigimin e alternativave, duhet të jenë një shqetësim i donatorëve dhe klientëve para fillimit të projektit.
- Për hir të manaxhimit eficient të projekteve të tilla, donatorët duhet të jenë në pozitën/ gadishmërinë për fiksuar kushtet e financimit, si lejimi i fondeve fleksibile dhe ndihmës së angazhuar / buxheti (p.sh. mbi bazat e planifikimit të vazhdueshëm 'hap pas hapi')
- Koordinim intensiv midis donatorëve ose, një donator kompetent udhëheqës, i përkushtuar që në fillim.
- Në rastin ideal, në një kontekst me partnerë lokalë me përvojë, harmonizimi i donatorëve, nga institucioni marrës mund të zëvendësojë përfshirjen dhe koordinimin e donatorëve, në nivelin e manaxhimit të projektit

#### Specifike për ADA

Për financimin e projekteve me investime të mëdha dhe të komplikuara nga ana teknike, duhen marrë parasysh kërkesat e mëposhtme:

- Kapacitet adekuate teknik dhe manaxhues pët të monitoruar / nxitur e projektin dhe për të reaguar në kohë, ndaj incidenteve kritike duhet të ekzistojnë që në fillim
- Kapaciteti minimal (koha e stafit dhe kompetenca teknike) duhet të jetë i disponueshëm te ADA, veçanërisht në nivelin lokal, më fjalë të tjera, në zyrën e koordinimit, madje edhe kur këto detyra janë deleguar përgjithësisht tke konsulentët. Kjo është e nevojshme për të vlerësuar dhe vepruar direkt (që do të thotë në nivel lokal, jo përmes zyrave qendrore) përmes informacionit të marrë nga konsulentët dhe partnerët lokalë për vendimet e përkohshme dhe të informuara
- Në një sektor ku investime të tilla të mëdha, janë bërë duhet zhvilluar një koncept në terma afatmesëm për të siguruar një vazhdueshmëri minimale. Përndryshe, shumë eksperiencia që në një farë mënyre 'u blenë me një cmim të lartë' dolën të panevojshme, pas finalizimit të një projekti të madh Ndërkohë një koncept i tillë është hartuar që është „Leitlinien der OEZA, Energie für Nachhaltige Entwicklung“.

#### Specifike për seco

Krahasuar me ADA, për seco kontributi ndaj DRGRP është më shumë se një operacion 'rutinë' në instrumentet e saj të financimeve infrastrukturore. Ajo bazohet mbi një strategji të tërë, për financimin e projekteve të infrastrukturës. Megjithatë, me rrethanat mbizotëruese në Shqipërinë e viteve 90, dy pikat e para të lartpërmendura lidhur me ADA, ishin gjithashtu të vlefshme për seco, me ndryshimin që seco filloi më herët përforsimin e kapacitetit të saj në nivelin lokal.

#### Rekomandime

##### Rekomandimet lidhur me DRGRP

Siç është përmendur në vlerësim, vlerësuesit janë të mendimit që pavarësisht nga qëllimet përfundimtare të rehabilitimit të hidrocentraleve, të tjera hapa të shtesë, për ruajtjen

(qëndrueshmërinë) e investimeve si dhe për një operim të sigurt të hidrocentraleve, janë të nevojshme Për këtë arsye u rekomandua:

*Siguria në digë:* Një studim për të vlerësuar të gjitha aspektet lidhur me sigurinë e digës është në proces. Vlerësuesit rikonfirmuan rëndësinë e këtij studimi për implementimin e masave të nevojshme. Duke marrë parasysh riskun e lartë të mundshëm, lidhur me çështje të caktuara të hidrocentraleve, vlerësuesit rekomanduan prioritetin dhe largimin e 'pikave të nxehta' tashmë të njohura që në fillim, nga KESH. (p.sh. rrëzimet lidhur me rrëshkitjet e tokës, rreziku i përmytjes në Fierzë). Kjo në veçanti, lidhet me përmirësimin e sigurisë së pritave malore dhe zhvillimin e një koncepti të monitorimit apo mbikqyrjes sipas direktivave të Komisionit Ndërkombëtar të Digave të Mëdha. (KNDM). Investigimet lidhur me këtë çështje janë tashmë në proces.

- *Rishikim para përfundimit të projektit:* Vlerësuesit rekomanduan që partnerët e përfshirë të kryejnë një rishikim para përfundimit të projektit, me qëllim identifikimin e investimeve dhe masave të nevojshme në të ardhmen, për të siguruar qëndrueshmërinë e investimeve aktuale. Duke qenë se hidrocentralet nuk ishin rehabilituar maksimalisht, është e nevojshme identifikimi i tipit dhe sekuencës së rehabilitimit të mëtejshëm, për të siguruar operimin e vazhdueshëm dhe një jetëgjatësi maksimale. Ky rishikim mund të rezultojë në një plan investimi nga ana e KESH, në bazë të së cilit Odonatorët mund të konsiderojnë përfshirjen e tyre të mëtejshme. Çështje të veçanta vënë në dukje nga vlerësuesit janë:
  - Mungesa e portës zbrazëse fundore, rreziku i përmytjes përshkak të sedimentarizmit në bjeftin e poshtëm të centralit si dhe duhen parë rrëshkitjet në zonën e portave të shkarkimit dhe nën godinen e centralit hidrocentralit të Fierzës të cilat duket problematike.
  - Gjendja e tubacioneve të ujit në hidrocentralin e Vaut të ndejës duhet ndjekur.
  - Punimet rehabilituese në Ulzë të cilat nuk u implementuan për shkak të mungesës së fondeve.
  - Aksesit për në Fierzë duhet përmirësuar, të sigurohet ndërhyrja në çdo kohë, madje dhe pa ndihmën e trazitit në Koman.
  - Rinovimi i pajisjeve të ndryshme mekanike të veprës së marrjes, spillways dhe daljet e poshtme. Përveç operimit të qëndrueshëm, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar dëmtimeve të mundshme dhe parandalimit të korrozionit.
- *Funksionimi dhe mirëmbajtja:* Pavarësisht nga rishikimi vlerësuesit rekomanduan zhvillimin e një koncepti funksionimi dhe mirëmbajtje të përgjithshme. Kjo është e nevojshme për ruajtjen e sigurisë operacionale. Për këtë, rezultatet e arritura, në termat e ndërtimit të kapaciteteve, (manuali i projektit, kompetenca e stafit) dhenë kohën e mbetur duhet përdorur për stabilizimin e një koncepti të qartë për aspektet manaxhuese dhe teknike të O&M, bashkë me trajnimin sistematik
- *Studim mbi hidrologjinë:* Për një manaxhim optimal dhe të një efikasiteti afatgjatë të burimeve fuqisë hidrike, duke përfshirë mundësinë e rritjes së kapaciteteve të të Hidrocentraleve egzistuese, apo projektimin e hidrocentraleve të reja, rekomandohet kryhet një studim hidrologjik dhe hidroekonomik në zonën pellgmbajtëse të lumit Mat dhe Drin. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit që siguron informacion lidhur me prurjet e pritshme, kapacitetet ujëmbledhese dhe projektet e shkarkimit të ujrave të hidrocentraleve, një studim i tillë është esencial. Në rastin kur këto të dhëna egzistojnë, ato ka shumë të ngjarë të kenë nevojë për ngritjen e kapacitetit. Qëllimi i këtij studimi mund të jetë mbi lumin Mat dhe Drin, ose për Shqipërinë, madje dhe për gjithë rajonin e Evropës Jug-Lindore.

### **Përfshirja e ADA në Sektorin e Energjisë**

Vlerësuesit rekomanduan rishikimin e mundësive të ardhshme të ADA në sektorin e energjisë. Kjo duhet bërë mbi bazën e një planifikimi të tërë strategjik, (shih gjithashtu vlerësimin e gjithë programit ) i cili siguron një perspektivë afatgjatë dhe afatmesme lidhur me relevancën e sektorit përbashkëpunimin e ADA me Shqipërinë.

- Koncept afatmesëm sektorial për vendin (për ADA), i cili merr parasysh është e mëposhtme:

- Ndjekje e mundshme e DRGRP: Even though or because this project absorbed comparatively huge funds, time and energy, we recommend that ADA participates in the review recommended above. Edhe pse ose sepse ky projekt mori fonde, kohë dhe energji, krahasimisht të mëdha. ne i rekomandojmë ADA të marrë pjesë në rishikimin e përmendur më sipër. Në strukturën e konceptit të saj të sektorit, ADA atëherë mund të vendosë nëse dhe si mund të përfshihet në një fazë vazhdimësie të DRGRP. (shih gjithashtu raportin kryesor)
- Energjia e rinovueshme ,sigurisht që do të mbeten fokusi I një përfshirjeje të mëtejshme të ADA në sektor, bazuar në eksperiencën dhe principet e saj. Prandaj një mbështetje e vazhdueshme për zhvillimin dhe rehabilitimin e fuqisë hidrike, duhet konsideruar seriozisht.

Rivlerësimi i idesë për mbështetjen e rehabilitimit të hidrocentraleve të vogla: Mbështetja për rehabilitimin e hidrocentraleve të vogla, duket të jetë akoma, një mundësi tërheqëse. Kjo do të ndihmonte Shqipërinë për mobilizimin e një burimi të rëndësishëm dhe në të njëjtën kohë ka një potencial të mirë për përfshirjen e sektorit privat Austriak. Fakti që Qeveria është duke bërë progres lidhur me legjislacionin dhe rregullat në sektorin e energjisë, si edhe që Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) është gati për lancimin e një programi në këtë sektor (pra, garantimi i fondeve për investitorët), mund të justifikojë kapjen e idesë të hedhur më parë. Mund të sigurojë mundësinë për metoda të reja partneritetit publik-privat.

– Energjia diellore:

Nëse ADA mbetet aktive në sektorin e energjisë, merr kuptim diversifikimi siç është parashikuar me përfshirjen në energjinë solare

- Ne rekomandojmë më tej që, përfshirja e ardhshme në sektor të përfshijë ndërhyrjet për zhvillimin institucional dhe rritjen e kapaciteteve si dhe rritjen në maksimum të sinergjisë me programet e tjera (p.sh lidhja me arsimin profesional me qëllim ngritjen e kapaciteteve)

Fakti që seco do të vazhdojë përfshirjen e tij në sektorin e energjisë dhe në të njëjtën kohë në sektorin e furnizimit me ujë, një bashkëpunim më ngushtë i tij me KfW, duhet parë nën perspektivën e sinergjive midis donatorëve të ngjashëm gjatë procesit të konceptualizimit të konceptit të ardhshëm të ADA, për të dy sektorët.

### **përfshirja e seco në Sektorin e Energjisë**

Ndryshe nga ADA, në strategjinë e saj për Shqipërinë, seco e ka përcaktuar si prioritet, përfshirjen e tij të ardhshme në sektorin e energjisë, për Shqipërinë. Prandaj, rekomandimet më shumë lidhen me implementimin e kësaj përfshirjeje.

- Ne rekomandojmë që në të ardhmen, ndërhyrjet për zhvillimin institucional dhe ndëtimin e kapaciteteve, të jenë nën një fokus më eksplicit. Kjo për shembull mund të nënkuptonte, fokusimin e seco mbi masat e rekomanduara, për vënien në baza të qëndrueshme të O & M në të katër hidrocentralet e rehabilituara.
- Ne gjithashtu rekomandojmë që seco para identifikimit të projekteve të reja, të shqyrtojë mundësinë për kontribut ndaj masave shtesë të nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë në të katër hidrocentralet. (shih 5.2.1),

### **Drejtimi i Programit të ADA-s**

Rekomandimet e mëposhtme, të cilat u zhvilluan gjatë vlerësimit të DRGRP, por që kanë më shumë lidhje me gjithë manaxhimin e programit, janë reflektuar në detaje në raportin e vlerësimit të të gjithë projektit.

- Përmirësimi i kapacitetit nxitës në strukturën e programit (Vienë, Zyrat e Koordinimit )
- Një përfaqje më e fortë programore
  - Perspektivë më afatgjate
  - Kërkimi i sinergjive
  - Pozicionim në zonën / sektorin tematik

## Shtojcë

### Lista e personave të intervistuar

Organizata	Emri	Pozicioni	F2F	Telefon
Agjensia e Zhvillimit Austriak	<ul style="list-style-type: none"> <li>Torggler, Barbara</li> <li>Kuthan, Peter</li> <li>Raunig, Florian</li> <li>Neuwirth, Hubert</li> </ul>	Vlerësimi Vlerësimi Shqipëri, Maqedoni, Kosovë (desk) Drejtor i Njësisë: Shqipëri, Maqedoni, Kosovë	X X X X	
EBRD	<ul style="list-style-type: none"> <li>Copley, Brian</li> <li>Mishaxhi, Donald</li> </ul>	EBRD, Londër, Oficer Teknik EBRD, Tiranë,	X	X
seco, Sekretaria Zviceriane e Shtetit për Cështjet Ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hadj-Djilani,</li> <li>Denzler, Stefan</li> <li>Keller, Phillippe</li> <li>Rohner, Pius</li> </ul>	Oficer Programi, Shqipëri (- 2001) Oficer Programi, Shqipëri (- 2004) Oficer Programi, Shqipëri Country Director, seco/SDC, Tirana	X X X X	X
Banka Botërore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Guxho, Artan</li> </ul>	Oficer Projekti, Infrastrukturë & Energji	X	
Ministria e Energjitikës & Infrastrukturës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Leka, Bujar</li> <li>Bregasi,</li> <li>Islami, Besim</li> </ul>	Drejtor Drejtor i prodhimit Ekspert Teknik	X X X	
KESH	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hoxha, Fatmir</li> <li>Celo, Marialis</li> <li>Myftar Musa</li> <li>Naim Muca</li> </ul>	Drejtor i Përgjithshëm KESH Manaxher Projekti DRCP (PMU) Drejtor Fierza Drejtor Vau i Dejes	X X X X	
<u>Konsulentë:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>Colenco</li> <li>Colenco</li> <li>Colenco</li> <li>Colenco</li> <li>Verbundplan, Austria</li> <li>Freelance Consultant</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Obermoser, Helmut</li> <li>Edwards, Allen</li> <li>Iturri, Pablo</li> <li>Bjegovich, Nicholas</li> <li>Faast, Rudolf</li> <li>Becke, Ludwig</li> </ul>	(Assistant) Project Manager DRCP Inxhinier, Fierza Inxhinier Vau i Dejes Inxhinier, Shkopet Konsulent Monitorimi i ADA Konsulent i seco	X X X X X	
<u>Kontraktues:</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>Andritz, Austria</li> <li>VA Tech, Switzerland</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Schönbacher, Winfried</li> <li>Diriwächter, Severino</li> </ul>	Inxhinier Projekti Menaxher i shërbimeve në terren, Fierza	X X	
Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Trebicka, Piro</li> </ul>	Zyra KfW Tiranë	X	
Albania-EU Energy Efficiency Centre	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hido, Edmond</li> </ul>	Drejtor, Tiranë	X	
Komisioni Evropian	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hall, Robert</li> </ul>	ECD, Harmonizimi i donatorëve, Tirana	X	

## Shtojcë

### List of Main Documents consulted

- Shqipëria, Studimi i rehabilitimit dhe rritjes së kapaciteteve të hidrocentraleve; Lahmeyer International, Shtator 1993
- Reportet e sigurisë së digave; Korrik/Gusht 1993, Prill 1994
- Raportet e progresit Andritz
- DRCRP Raporti fillestar; SOGREAH Engineering / EPD Consultants; Tetor 1995
- Albania Drin River Cascade Operations Committee Final Review; EBRD;Tetor 1993
- Note de Décision: DRCRP; seco; Janar 1994
- Marrëveshjet, Shtesat e kontratave, Memorandumi i Mirëkuptimit midis Kancelarisë Federale të Austrisë dhe EBRD; 1995
- Termat e Referencës për konsulentët të PMU-KESH; 1995
- Përmbledhje e projekteve për österreichische Kontrollbank; Verbundplan Vjenë; Korrik 2004
- Minuta të ndryshme të Takimeve Koordinuese; BmAA / ADA
- Dokumenta të ndryshme të përgatitura nga Konsulentët e Monitorimit; Verbundplan Wien
- Raportet e Misionit; Supervizimi i Rehabilitimit të Sektorit energjetik dhe Projekti i Ristrukturimit & Prodhimi dhe Ristrukturimi i Sektorit Energjetik; Banka Botërore; 2004 & 2005



**Shtojcë****Përmbledhje e kostos**

**Financimi i Projektit** sipas përmbledhjes së österreichische Kontrollbank; Verbundplan Vjenë; Korrik 2004

<b>Contract</b>	<b>Burimi</b>	<b>Kontrakues</b>	<b>Monedha</b>	<b>Kostoja</b>	<b>Kursi</b>	<b>EUR</b>
<b>DRCRP 1 Shërbime konsulence për Pjesën A</b>	EBRD	Colenco	DEM	2.006.227	?	1.080.301
	EBRD	Mr. Defourneaux	EUR	50.000		50.000
	EBRD	Colenco	CHF	79.000	?	52.667
	EBRD	Colenco	CHF	77.000	?	51.333
	EBRD	Colenco / Electrowatt	EUR	2.129.333		2.129.333
<b>DRCRP 2 Punime Civile</b>	EBRD	TRISS Albania	DEM	1.467.030	?	836.626
<b>DRCRP 3 Pajisje Mekanike Fierza</b>	Swiss Gov.	VA TECH HYDRO	CHF	11.800.000	?	7.866.667
<b>DRCRP 4 Pajisje Mekanike Vau i Dejes, Ulza, Shkopeti</b>	Austria Gov.	Andritz	ATS	84.500.000	?	6.140.854
<b>DRCRP 6 Pajisje Elektrike Vau i Dejes, Fierza</b>	JIBIC	Alstom Italy	YEN	1.681.000.000	?	12.930.998
	MDC (frozen Part)	Alstom Italy	EUR	2.440.455	?	2.440.455
	KESH		USD	1.600.000		
<b>DRCRP 7 Pajisje Elektrike Ulza, Shkopeti</b>	EBRD	Koncar	DEM	5.027.200	?	3.255.027
<b>DRCRP 8 Pajisje Elektrike Ulza, Shkopeti</b>	EBRD	Alstom France	EUR	6.325.181		6.325.181

## Shtojcë

### Përmbledhje e kostos

Korrik 2005, Tabela e KESH-PMU


#### TOTAL VALUE OF THE DRCRP

CONTRACTS	Currency	Foreign Cost	Local Cost	In LEKE	
				Foreign Cost	Local Cost
DRCRP-1	DEM	2'006'227		124'907'693.02	
	EUR	50'000		7'009'000.00	
	CHF	20'000		1'930'400.00	
	CHF	74'411		7'182'149.72	
	DEM	1'063'520		66'214'755.20	
	DEM	2'287'107		142'395'281.82	
	EURO	1'551'730		217'521'554.86	
	EURO	2'997'410		420'176'933.80	
DRCRP-2A	EUR	783'959		109'895'372.62	
DRCRP-2B					39'300'381.00
DRCRP-3	CHF	11'800'000		1'138'936'000.00	
DRCRP-3, erection					110'000'000.00
DRCRP-3, claim	CHF		293'695		28'347'441.40
DRCRP-4	ATS	87'679'000		775'959'150.00	
DRCRP-4,Claim	EURO		182'239		25'546'263.02
DRCRP-4, erection					197'913'000.00
DRCRP-4, additional costs	EURO	700'000		98'126'000.00	
DRCRP-6	YEN	1'681'000'000		1'894'487'000.00	
DRCRP-6, frozen part	EUR	2'440'455		342'102'981.90	
DRCRP-6,crane	USD		140'000		18'723'600.00
DRCRP-6, claim	USD		1'600'000		213'984'000.00
DRCRP-6B	USD		1'647'695.00		220'362'729.30
DRCRP-7	EUR	3'934'855		551'587'973.90	
DRCRP-8	EUR	6'325'081.16		886'649'877.01	
DRCRP-8, claim	EUR		899'466		126'087'143.88
DRCRP-8, erection	LEKE	28'992'100.32		28'992'100.32	
DRCRP-8, claim	LEKE		2'262'595		2'262'595.00
Counterpart fund	CHF		3'502'610		338'071'917.20
<b>TOTALI</b>				<b>6'814'074'224.16</b>	<b>1'320'599'070.80</b>

EURO 48'609'460.87 9'420'738.13

**Value of the Project** EURO 58'030'198.99

### Hidrocentralet mbi lumin Drin dhe Mat



Hidrocentralet mbi lumin Drin dhe Mat  
me zonat ujëmbledhese dhe kufizuese të Shqipërisë

## SHTOJCA 3 / (2)

### Furnizimi me ujë për katër fshatra

#### Në rrethin e Shkodrës

(Barbullush, Ana e Malit, Bushat dhe Ranxa)

Botuar nga KEK CDC Consultants

Gusht 2005

### PERMBLEDHJE

Projekti përfshin në masat rehabilituese për pajisjet e furnizimit me ujë të komuniteteve rurale në rajonin e Shkodrës. Të gjitha familjet e synuar përdorin ujë të pastër, kushtet e jetesës u përmirësuan në një masë të konsiderueshme. Megjithëse në konceptin e projektit në fazën e dytë u shtuan edhe aktivitetet trajnuese, qëndrueshmëria e masave nuk është e sigurtë. Një përfshirje më e madhe e komunitetit është e nevojshme gjithashtu, edhe për implementimin me sukses të procesit të decentralizimit të qeverisjes. Idetë konceptuale rreth fuqizimit të përqasjeve të udhëhequr nga komuniteti mund të nxitnin sensin e pronësisë brenda komunave të përzgjedhura. Për momentin, komunitetet janë disi të pavullnetshëm në marrjen e përgjegjësisë së plotë. Kështu që, për të shoqëruar këtë proces të vështirë, është e nevojshme një prezencë afat gjatë.

### 1 METODAT

Misioni i vlerësimit u mbajt në Shqipëri nga java 28 deri në javën 30, ku u përfshi edhe një udhëtim në terren nga data 12 deri 17 Korrik 2005. Studimi përfshiu hapat e mëposhtëm:

- Studimi i dokumentacionit të disponueshëm në shqip e anglisht
- Hartimi i udhëziesve të intervistimit
- Intervista me stafin administrativ të rajonit dhe komunës, këshilltarë lokalë dhe ndërkombëtarë si dhe me pushtetin qendror (Ministrinë).
- Vizita në terren me banorë vendas, intervista me stafin e projektit, organizatat partnere, autoritetet lokale dhe aktorë të tjerë relevantë.
- Sesion këshillimi dhe raportimi me ekipin e vlerësimit.

Udhëtimi në terren përfshiu komunat e Barbullushit, Ana e Malit, Bushatit dhe Ranxës. Udhëtimi u shoqërua pjesërisht edhe lideri i skuadrës. U vizituan gjithsej 20 shtëpi. Përfituesit u zgjodhën në mënyrë të rastësishme.

Drafti i parë i këtij raporti u punua nga Marika Shtëmbari-Martini (Tiranë) dhe më pas u rishikua nga këshilltarët e KEK CDC. Për të lehtësuar procesin e leximit, një version i shkurtër i lexueshëm, i botuar nga këshilltarët e KEK CDC, iu shtua si aneks raportit kryesor. Raporti origjinal mund të kërkohet tek këshilltarët e KEK CDC.

## 2 PARAQITJE E SHKURTËR E PROJEKTIT

<b>Titulli i Projektit</b>	Sistemi I furnizimit me ujë i 4 fshatrave: Bushat, Barbullush, Ana e Malit dhe Rranxa
<b>Agjensia zbatuese</b>	iC Consulanten, Ziviltechniker GMBH, Kaiserstraße 45, A-1070 Wien
<b>Partnerët lokalë</b>	Ministria e Turizmit dhe Rregullimit të Territorit Rrethi i Shkodrës Komunat e Bushatit, Barbullushit, Ana e Malit dhe Ranzës, Këshilltarë lokalë
<b>Konsulent monitorues</b>	Kommunalkredit Austria AG, Türkenstraße 9, A-1090 Vienna
<b>Donator</b>	Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Austrisë, Hohenstauffengasse 2, A-1014 Vienna
<b>Numri i projektit</b>	7630
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	Faza I: Janar 2000 – Gusht 2002 Faza II: Shkurt 2003 - Shkurt 2004 Shtesa e fazës së dytë II: Maj 2004 - Prill 2006
<b>Grupi i synuar</b>	rreth 8'400 banorët e fshatrave
<b>Objektivat e projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Synon në përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë në tre komunitetet e rajonit të Shkodrës.</li> <li>• Pajisja me matësa shtëpiakë të ujit.</li> <li>• Program trajnimi.</li> </ul>
<b>Rezultatet të Pritshme</b>	Ujë 24 orë në ditë Staf i aftë manaxherial për ujësjellësin.
<b>Buxheti i Projektit</b>	Faza I : 965,929.12 Euro Faza II: 363,018.50 Euro Shtesa e fazës së dytë II: 300,000 Euro
<b>Kontributi i ADA</b>	

### 3 KONTEKSTI

Në veriun malor të Shqipërise, shumë familje, jetojnë në një varfëri gati mesjetare. Sipas të dhënave të INSTAT-it, këto vitet e fundit demografia Shqiptare ka ndryshuar në mënyrë radikale, si pasojë e vërshimit të popullsisë rurale në zonat urbane në kërkim të punës dhe arsimimit më të mirë. Më shumë kanë lëvizur më të arsimuarit. Sipas INSTAT-it, më shumë se 70% e gjithë të diplomuarve janë në Tiranë. Të tjerët lënë fshatin për të provuar fatin e tyre jashtë kufirit. Veriu ka vuajtur më shumë nga ky ndryshim, kjo pjesërisht edhe për shkak të mungesës së investimeve të reja publike dhe private dhe faktit që është konsideruar gjithmonë rajon i prapambetur.

Sipas ekspertëve të ekonomisë, investimet në biznesin e vogël në veri, janë 30% më të ulëta se në Shqipërinë qendrore ose jugore. Po kështu dhe infrastruktura është në gjendje më të keqe. Në një vend ku të dhënat e mundshme janë të rralla, është e vështirë të sigurohet një informacion i detajuar mbi problemet sociale të veriut. Është vlerësuar se të ardhurat mesatare për banorët e zonave rurale në veri, janë 80 \$ në muaj, krahasuar me 130\$ që janë në qendër dhe jug, ku turizmi është më i zhvilluar dhe ku shumë i kanë rritur fitimet duke punuar në Greqi. Sipas studimeve të bëra nga UNDP, vetëm 45% e fuqisë aktive për punë, punojnë konkretisht në rajonin e Shkodrës, qytetin më të madh verior. Aty, emigracioni është ende rruga kryesore për sigurimin e të adhurave.

Sistemi i furnizimit me ujë, në zonat rurale në Shqipëri, është në kushte të mjerueshme. Në fund të vitit 1989, 75% e popullsisë rurale kishte akses në tubacionet e ujit (në të gjitha mënyrat e mundshme). Në ditët e sotme, kjo është reduktuar në më pak se 50% të popullsisë rurale. Cilësia e këtij shërbimi në zonat që kanë tubacione uji, është e dobët. Furnizimi me ujë zakonisht është vetëm disa orë në ditë dhe në periudhën e verës, pothuajse fare. Më shumë nga kjo goditet pjesa më e varfër e popullsisë. Mesatarisht, furnizimi i tyre është i pakët dhe kostot e blerjes së tij janë të larta në vlerë relative dhe absolute. Dekompozimi i rritjes së ujit dhe paisjeve sanitare, ka bërë të mundur shpërthimin e disa sëmundjeve epidemike në dekadën e fundit dhe mendohet të jetë bërë një nga faktorët kryesorë të rritjes së vdekshmërisë foshnjore në Shqipëri.

Gjendja e keqe e sistemit ujor rural në Shqipëri është rezultat i:

*Mungesës së të ardhurave:* Tarifa është më e ulët se kosto reale e sistemit të shpërndarjes dhe mungesa e imponimit për grumbullimin e këtyre tarifave, ndërkohë nevojat e viteve 90 ndërprejnë furnizimin e ndërmarrjeve me burimet e nevojshme për mirëmbajtje.

*Konsumit të tepërt:* Struktura tarifore rezultoi në një humbje masive të ujit duke sjellë një kërkesë kaq të lartë të sistemit të furnizimit me ujë, duke ardhur në kufinj të kolapsit e më tej se kjo. Nga njëra anë, kalimi nga sistemi kooperativist i vaditjes në një bujqësi mbijetese të tokave për kopshte dhe kolapsi i sistemit të vaditës nga ana tjetër, rezultoi në një përdorim masiv të ujit të pijshëm për qëllime vaditje. Kjo e kompromentoi më tej integritetin teknik të sistemit të ujës-jellës-kanalizimeve.

*Pamjaftueshmërisë së infrastrukturës fizike:* Gjatë viteve 80 u bënë përpjekje për përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave rurale. Mungesa e materialeve të përshtatshme dhe mosmarrja në konsideratë e aspekteve ekonomike gjatë projektimit të sistemeve egzistuese e bënë të kushtueshëm menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tij, që shpesh dëshmon se është më e kushtueshme se rehabilitimi fizik i sistemit ekzistues.

## 4 VLERËSIMI

### 4.1 Relevanca

ADA njohu saktësisht nevojën e veprimeve implementuese për përmirësimin e sistemit publik të furnizimit me ujë në zonat rurale veriore. Projekti është relevant në shumë nivele të ndryshme:

- Zona e projektit ka një sistem të pamjaftueshëm të furnizimit me ujë: në komunitetet e Barbullushit, Bushatit dhe Ranxës, nuk kishte fare sistem publik të furnizimit me ujë. Banorët vendas e siguronin ujin e tyre kryesisht, nga burimet private. Sistemi i furnizimit me ujë të komunitetit Ana i Malit kishte nevojë të përmirësohej dhe zgjerohej.

- Rajoni verior i Shqipërisë “tradicionalisht”, është neglizhuar si nga qeveria ashtu dhe nga Agjensitë (donatorët) ndërkombëtare, të cilët kanë tendencën të jenë aktivë në rajonet qëndrore, bregdetare apo jugore të vendit.
- Autoritetet lokale kanë demonstruar interes të lartë dhe gadishmëri për të kontribuar me burimet e tyre (fuqi punëtore) për implementimin e aktiviteteve. Vlerësimi i nevojave prioritare u bë nga vetë komunat.
- Cdo përmirësim i kushteve të jetesës është një formë e parandalimit të migrimit nga rajonet veriore në pjesët qëndrore, rajonet bregdetare ose emigrimit jashtë kufijve.
- Uji është jetësor jo vetëm për konsumatorët privatë por edhe në stimulimin e pavarësisë ekonomike midis komuniteteve rurale.

Me procesin e reformave dhe decentralizimin e qeverisjes, kompetencat si për furnizimin me ujë në zonat rurale ashtu edhe për vaditje, u janë transferuar grupeve të komunitetit, me vendimmarrje të bazuar në nivel lokal. Theksi është në vënë mbulimin e kostos dhe qëndrueshmërinë dhe në krijimin e një kuadri institucional të përshtatshëm. Duke marrë në konsideratë këto objektiva strategjikë, projekti korrespondon plotësisht me politikat aktuale dhe ato të ardhme të qeverisë Shqiptare.

#### 4.2 Eficenca

Projekti është implementuar sipas marrëveshjes tripalëshe të Qeverisë Austriake. Strukturat dhe mekanizmat e punës janë projektuar në mënyrë të tillë që të sigurojnë supervizionimin e implementimit të një projekti, me orientim kryesisht teknik. Partnerë të projektit janë autoritetet kombëtare dhe bashkitë (komunat) lokale. Inxhinierët që mbikqyrin ndërtimet, janë mandatuar nga iC-Consultants, një grup inxhinierësh dhe ekspertësh Austriakë në sektorin e sistemeve Sanitare të Ujit. Projekti monitorohet nga Kommunalkredit Austri në periudha të rregullta 3-mujore.

U ngritën dy organizma që të kontribuonin me sukses në implementimin e projektit: Komiteti i Vëzhgimit dhe Ekipi i Zbatimit të Projektit.

Komiteti drejtues: Ky grup, supervizoi implementimin e gjithë projektit së bashku dhe me përfaqësues të Ministrisë Shqiptare, Administratës rajonale të Shkodrës, kryetarët respektivë të komunave të targetuara, Agjensisë implementimit, Agjensisë së monitorimit dhe të OBZ (sot ADA). Gjatë periudhës së implementimit u kryen një sërë takimesh ku u diskutua për progresin apo vonesat e projektit. Ky grup ishte i dobishëm në kohën e diferencave midis aktorëve të ndryshëm të projekti

Ekipi i zbatimit të projektit: Meqënëse detyra kryesore e këtij grupi ishte fokusimi në implementimin konkret të projektit, anëtarët ishin tërësisht nga niveli i operacional.( stafi i projektit dhe ekspertët e iC Consulting ). Ka pasur një vëzhgim të rreptë nga ana e iC Consulting me qëllim sigurimin rezultateve të mira teknike.

#### 4.3 Efektiviteti

Projekti është implementuar në 2 faza me një shtesë në vazhdim. Rezultatet e aktiviteteve janë si më poshtë:

Faza 1:

- Sic u nënvizua, një workshop u zhvillua në fillim të projektit. Për planifikimin dhe dizajnimin u diskutua dhe u ra dakort me të gjithë aktorët e përfshirë.
- Të gjithë aktorët ranë dakord për formën e tenderimit të materialeve dhe punës.
- Puna ndërtuese u bë sipas planit. Si rezultat, afërsisht 4'000 banorë të fshatit Barbullush dhe mbi 500 banorë në Bushat kanë akses në ujin e pastër të pijshëm nga instalimi i sistemit publik të furnizimit me ujë. Në Ranxë Komuniteti hapi me sukses pusët; afërsisht 4'000 banorë vendas u furnizuan me ujë të pastër të pijshëm nga sistemit publik i instaluar.
- Aktivitetet e ndërgjegjësimit publik u ndërmoren, me synim reduktimin e humbjeve të brendshme.
- Punonjësit e komunës ndihmuan me disa punë të mirëmbajtjes.

- Vendosja e një sistemi për faturat, bëri që konsumatorët të paguajnë vetë faturat e tyre. Në mungesë të matësave të ujit, u caktua një vlerë nga 80-100 lekë për person në muaj.

#### Faza 2:

- U përfundua përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë në komunat e Barbullushit, Petugolit, Guradecit, Bri Maliit, Ana I Malit, Bushat dhe Ranxë.
- Trajnimi teknik për aftësimin e punonjësve për mirëmbajtje të përshatshme të sistemit u krye me sukses. Për më tej, u zhvilluan dhe trajnime për të fuqizuar partnerët lokalë (p.sh.përpunimi i planeve të biznesit)
- PIU lehtësoi koordinimin midis donatorëve dhe organizmave të qeverisë. Për më tepër u punua në nivel komune që të komunikojë strategjia e qeverisë në decentralizimin dhe në furnizimin me ujë.
- Kontributi vullnetar i komunitetit ( hapja e kanaleve të shpërndarjes, fiksimi i lidhjeve shtëpiake dhe te tjera te ngjashme me keto)

#### Vazhdimi i shtesës së Fazës 2:

- Janë bërë trajnime në nivel komune me qëllim përmirësimin e aftësive manaxheriale të stafit përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë.

Instalimi i planifikuar i matësave të ujit është nën proces. Vetëm gjysma e instalimit të planifikuar është kryer. Mungesa e burimeve të vetë komunës, pengon implementimin me sukses të këtij komponenti të projektit.

#### 4.4. Impakti

Duke hedhur një vështrim mbi arritjet e qëllimit të projektit, situata është si vijon:

- Pronarët e synuar në të 4-rt fshatrat kanë akses në sistemin e furnizimit me ujë..
- Dizenjimi i sistemit të furnizimit me ujë u bë bazuar në nevoja dhe sipas të rritjes demografike të numrit të popullsisë.
- Komunat e synuar, kanë tashmë 24 orë ujë .
- Cilësia e ujit është provuar që është e mirë.
- Komuniteti ka kontribuar me punë krahu.

Në intervistat e bëra me banorët vendas, theksohet se situata e tyre ekonomike është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Të kesh akses në ujin e pijshëm do të thotë të ulësh rrezikun e shëndetit në sajë të standarteve më të mira higjienike. Gratë pohuan një lehtësim të madh që nga përdorimi i ujit të rrjedhshëm.

Duhet të përmendim patjetër se nuk u bë dallim midis grupeve të përdoruesve të ujit në nivelin e banorëve që gjatë procesit të planifikimit të aktiviteteve. Banorët vendas të komunitetit u perceptuan si grupe homogjene pa ndonjë ndryshim në nevoja, interesa, zakone ose të ngjashme me këto. Nuk është bërë asnjë analizë e grupit të synuar (përpara ose gjatë impleentimit të projektit) për të mbledhur të dhëna në lidhje me seksin, madhësisë së familjes, kombësisë, moshës, besimit, etj... Rrjedhimisht , të gjitha të dhënat e monitorimit janë të fokusuar vetëm në implementimin teknik dhe nuk mund të japin asnjë informacion mbi impakte pozitive dhe/apo negative të aktiviteteve të projektit.

#### 4.5. Qëndrueshmëria

Objektivi afatgjatë i politikës decentralizuese të qeverisë është të sigurojë një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimet sipas standardeve evropiane në zonat rurale. Me këtë, komunat bëhen aktorët qëndrorë në sistemin e furnizimit me ujë. Në thelb, reforma mbeshtetet në sipërmarrjeje e popullit shqiptar. Për momentin, komunat, bashkitë, dhe qeveria nuk janë të aftë të sigurojnë mirëmbajtjen e plotë të sistemit të furnizimit me ujë, me burimet e veta financiare. Ka një mungesë të madhe vullneti nga ana e komunave lidhur me marrjen e përgjegjësisë ë plotë, nga frika e



mbingarkimit në përgjegjesi. Për këtë arsye, sensi i pronësisë mund të konsiderohet me të vërtetë i ulët.

Komunat kanë caktuar një tarifë fikse për shërbimin e furnizimit me ujë ( rreth 80-100 Lek për person në muaj ). Njerëzit janë të gatshëm të paguajnë pasi kjo sasi konsiderohet shumë e ulët. Gjithsesi, kostot e mirëmbajtjes të shërbimit ( duke përfshirë edhe pagat) ende nuk mbulohen. Komunat duan të rishikojnë sistemin e pagesave pasi të jenë instaluar të gjithë matësat e ujit .Në të njëjtën kohë ekziston frika se mos banorët do të ulin konsumin e ujit me qëllim konsumim personal dhe kërkesa bujqësore: sidoqoftë uji i mirë të përdoret vetëm të pirë dhe larë, ujitja e ngastrave të bëhet nëpërmjet puseve te vogla. private

## 5 KONKLUZIONE

---

Ky projekt kontribuon në një fushë të rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë, ndërsa synon shërbimin e furnizimit me ujë duke përfutuar këte menyrë të varfrit në zonat e largëta rurale. Kushtet e jetesës së atyre që janë lidhur me furnizimin me ujë, janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme.

Në sajë të procesit të decentralizimit, projekti u fokusua jo vetëm në anët teknike por gjithashtu edhe në ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimit, me qëllim përmirësimin e aftësisë manaxheriale në nivel komuniteti. Gjithsesi projekti është mbështetur në një përjasje të drejtuar nga furnizimi. Pyetja është nëse kjo është e përshtatshme për të përballuar sfidat e ditëve tona. As qeveria e lartë as komunat nuk kanë burime të mjaftueshme për të siguruar mirëmbajtjen adekuatë në afate të mesme dhe të gjata. Për të shmangur kostot e rezultuara, nevojiten mendime më konceptuale.

Shembujt nga një rishikimi i fundit i shërbimit të furnizimit me ujë nga Banka Botërore, tregojnë që përfshirja e komuniteteve lokale në vendimmarrje në nivel të shërbimeve dhe në implementimin dhe menaxhimin e atyre shërbimeve që janë të lidhura me rritjen e kenaqësisë të përfituesve ndaj shërbimeve, dhe në këte mënyrë edhe me rritjen e gatishmërisë për të paguar. Përfshirja e dukshme e aktorëve shoqërohet me një shumëfishim më të mirë dhe qëndrueshmëri të rezultateve dhe impaktit. Një shkallë më e vogël pjesëmarrjeje shoqërohet me një mundësi më të vogël qëndrueshmërie.

Frika e komunës për një ulje të konsumit të ujit tregon perceptime të ndryshme në përdorimin e ujit. Në zonat rurale, furnizimi me ujë është më shumë një e mirë e përbashkët ndërkohë që higjena trajtohet si një e mirë private në nivelin individual të banorëve. Aspekte të ndryshme të zhvillimit bashkohen dhe cojnë në një kompleksitet të projektit (ve) dhe nevojën për një prezencë afatgjatë gjatë implementimit. Një Zhvillim i Mbështetur në Komunitet (CDD) mund të jetë i dobishëm lidhur me gjetjen e mënyrave për nxitjen e sensit të pronësisë brenda komunave

## 6 REKOMANDIME

---

Vlerësuesit rekomanduan

- të vazhdohet projekti (zgjatja) sipas planifikimit
- të vihet më shumë theks në aspektet e qëndrueshmërisë, ndërkohë që kërkohen rrugë më të mira për të integruar përjasjen CDD me konceptin e projektit aktual
- të planifikohet një prezencë më afat të gjatë për arsyen se ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve lokale nuk është një proces afat shkurtër
- të harmonizohet përjasja me përjasjet e aktorëve të tjerë në sektorin e ujit.

### **Aneksi 3 / (3)**

---

Hapa drejt rehabilitimit urban dhe integritit të komunitetit të zonës informale të  
Kënetës, Durrës

Botuar nga KEK CDC Consultants

Gusht 2005

---

#### **PËRMBLEDHJE**

Projekti ka filluar në Maj 2004 dhe është në fund të fazës së parë. Koncepti i projektit është konsideruar të jetë relevant për komunitetin në kuadër të legalizimit dhe integritit në sistemin formal të sigurimit shoqëror, dhe për bashkinë në kushtet e trajtimit specifik dhe praktik të kësaj çështjeje komplekse. Më tej, koncepti vlen dhe për zhvillimin e mëtejshëm i cili përfshin para furnizimet për zhvillim të qëndrueshëm.

Pikat kritike janë reflektuar për faktin që fokusi është përqëndruar kryesisht në implementimin teknik dhe është injoruar dinamika reale e komunitetit. Kjo të çon në një pezullim të përkohshëm të projektit. Pamvarësisht nga kjo projekti tregon rezultate specifike në fazën e parë (përgatitja për legalizim) ku mund të vazhdohet por me ndryshime amenduese. Ndryshime do të ndodhin gjithashtu edhe në nivel monitorimi që të matet impakti dhe të intesifikohet përfshirja më e mirë e ADA.

#### **1 METODA**

Misioni i evaluimit u mbajt në Shqipëri nga jave e 28 deri në javën 30 përfshirë dhe një udhëtim në terren nga 12-17 Korrik . Studimi përmbante hapat e mëposhtëm:

- Studimi i dokumentave të disponueshëm në anglisht
- Intervista me Agjensinë e implementimit ,Perfaqësues të Bashkisë dhe përfitues.
- Vizitë në terren në vendbanimet informale në Kënetë me vizita tek banorët, intervista me stafin e projektit, organizata partnere, autoritete lokale dhe të tjerë aktorë të mundshëm.
- Sesione informuese, udhëzuese në ekipin vlerësues.

Drafti i parë i këtij raporti u punua nga Eriola Shingjergji (Tiranë) dhe më pas u rishikua nga KEK CDC Consultants. Që të thjeshtëzohet procesi i leximit , një variant i shkurtër i lexueshëm i raportit u botua nga KEK CDC Consultants dhe u shtua si një aneks raportit të plotë. Raporti original do të kërkohet nga KEK CDC Consultants.

## 2 PARAQITJE E SHKURTËR E PROJEKTIT

Emri i projektit	
Agjensia implementuese	Co-Plan
Partnerët lokalë	Bashkia, Durrës
Numri i projektit	7688-00/2003
Kohëzgjatja e projektit	1 Maj 2004 – 30 Prill 2007
Grupi i synuar	Afërsisht 4.200 – 5.000 residentë të 50 ha zonë pilote
Objektivat e projektit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zhvillim shoqëror dhe rehabilitim urban të zonës , nëpërmjet punës për zhvillim dhe inisiativat e komunitetit për përmirësim infrastrukturor.</li> <li>2. Ndërtimi i kapaciteteve të qeverisë lokale për përgatitjen e planit urban nëpërmjet pjesëmarrjes së komunitetit.</li> <li>3. Zhvillimi i komunitetit nëpërmjet përmirësimit të burimeve njerëzore dhe organizative të strukturës së komunitetit.</li> <li>4. Stimulimi i partneritetit qeveri lokale- komunitet nëpërmjet procesit të planifikimit urban.</li> <li>5. Ndërhyrje në infrastrukturë nëpërmjet kontribuimit dhe bashkëfinancimit të komunitetit.</li> </ol>
Rezultatet e pritshme	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgatitja e planit pjesor urban të zonës.</li> <li>2. Përgatitja e Guidelines në legjislacion.</li> <li>3. Ndërhyrje Direkte në infrastrukture, bashkëfinancimit të komunitetit.</li> <li>4. Përgatitja e axhendës së zhvillimit per lagjen.</li> </ol>
Buxheti i projektit	Total 566,415 Euro, Co-PLAN = 38,000 Euro në projekt dhe 24,342 Euro si fond garancie për projektin. Bashkia Durrës =52,500 Euro
ADA Contribution	451,848 Euro

## 3 KONTEKSTI

“Këneta” në Bashkinë e Durrësit konsiston si vendbanimi informal i 2-ti nga madhësia në Shqipëri. Zona, e lokalizuar në skaj të bashkisë Durrës, numëron në total pothuaj 35,000 banorë, të shpërndarë në gjithë zonën periferike juglindore të qytetit të dytë Shqiptar nga madhësia. Nga madhësia e territorit të zënë, Këneta të çon virtualisht në dyfishin e Durrësit për nga sipërfaqja dhe popullsia. Këneta është provë e një intesiteti të lartë të migrimit në Shqipëri. Në të njëjtën kohë tregon dhe paaftësinë e qeverive lokale të menaxhojnë realitetin e ri socio-ekonomik. Ndërkohë që situata në zonat periferike rurale të vendit përkeqësohet (sidomos në verilindje), të ardhur të rinj vijnë cdo ditë në lagjen e Kenetës.

Specifikisht , vendbanimi i komunitetit të Kenetës në Durres është nën një proces të vazhdueshëm urbanizimi i cili ndjek “rregullat” e zhvillimit informal gjë që mund ta shohim edhe në Amerikën Latine. Mungesa e infrastrukturës bazë, shpërndarja e plehrave dhe mbeturinave nëpër gjithë zonën, keqësimi i kushteve sanitare ambjentaliste , karakterizojnë vendbanimin. Varfëria është qartë e pranueshme kudo. Autoriteteve lokale u mungojnë aftësitë bazë dhe instrumentat që të merren me këtë realitet. Meqënëse ardhjet vazhdojnë, situata në zonën ekzistuese keqësohet gjithmonë e më shumë , duke cuar në rreziqe të konsiderueshme ambjentaliste dhe sociale.

Ekzistenca e Kënetës s,i vendbanim ka një kuptim të madh për qindra njerëz që jetojnë aty dhe përpiqen të sigurojnë një minimum të kushteve të jetesës. Mungesa totale e aksesëve rrugorë , furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe sistemit të qëndrueshëm të mbledhjes së mbeturinave, e transportit dhe telefonave publikë, e infrastrukturës sociale si shkolla, kopshte, qendrave shëndetësore dhe sociale, parqeve të lojrave, etj, është një rrezik serioz për një izolim të qartë social. Megjithatë duhet theksuar se vetë banuesit kanë bërë investime të shumta.

Zona e Kënetës është një nga vendbanimet më të reja informale të zhvilluara në periferi të Durrësit, ku mungesa e lehtësive bazë si infrastruktura fizike dhe sociale është prezent në mënyrë tepër të dukshme, përfshi dhe një sistem funksional kanalizimi, një sistem manaxhimi të mbeturinave, rrugë dhe furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike.

## 4 VLERËSIM

### 4.1 Relevanca

Aktivitetet e projektit janë të një rëndësie të lartë në nivelet në vazhdim:

*Banorët e Kënetës:* Në mendjet e banorëve ,zona do të bëhet një vendbanim i përhershëm. Aktivitetet e projektit filluan dhe bënë të mundur proesin e legjislacionit. Njohja formale e zonës dhe pronësia e tokës dhe shtëpive respektive mbi të, është një parakusht i rëndësishëm për përfshirjen në sistemin formal dhe të ketë akses në shërbimet bazë të bashkisë.


*Bashkia Durrës:* Vendbanimi informal i Kënetës con në një dyfishim të qytetit në të dy kuptimet si sipërfaqe dhe si numër popullsie. Me qëllim që të parandalohen krizat sociale dhe politike , bashkia duhet të kërkojë rrugët me anë të të cilave të perballojë situatën. Megjithëse ligji jep kuadrin e duhur për procesin e legalizimit, implementimin e projektit e bën bashkia. Pengesat më të mëdha janë mungesa relative e burimeve njerëzore të kualifikuara me eksperiencë operative në fushën e legjislacionit dhe planifikimit urban si dhe aplikimi i pamjaftueshëm i mjeteve ekzistuese. Aktiviteti i projektit kontribuon në një trajtim të sistematizuar të kësaj çështjeje të ndjeshme duke u fokusuar më tepër tek gjetja e zgjidhjes se sa tek problemi.

*Niveli i zhvillimit:* Është deklaruar shpesh se pronësia e tokës dhe shtëpive është thelbësore në reduktimin e varfërisë, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e jetës. Në nivelin politik , projekti është në përputhje me qëllimet e Paktit të Stabilitetit i cili në mënyrë aktive inkurajon planifikim/menaxhim të qëndrueshëm urban dhe strehim të përballueshëm në Europën Lindore. Është bërë e njohur gjithë e më tepër se adresimi i vendbanimeve ekzistuese (si dhe parandalimi) të zhvilluara në mënyrë informale përreth qyteteve të mëdha do të jetë pjesa më e madhe e cdo programi strehimi në rajon gjatë 5 ose 10 viteve të ardhme.<sup>34</sup> Më tej, është bërë e njohur botërisht që aksesit legal mbi tokën dhe sigurimi i shërbimeve bazë urbane janë parapërgatitje strategjike për sigurimin e strehimeve të pershtatshme për të gjithë – sidomos grupeve vulnerabël ose të margjinalizuara – dhe për zhvillimin e vendbanimeve njerëzore të qëndrueshme.

### 4.2 Eficenca

*Mekanizmat e punës:* Mekanizmat e punës dhe rregullimi institucional i projektit janë përshtatur nga koncepti i planifikimit urban qëndror i njerëzve. Element qëndror është përfshirja e aktorëve të kapitalit, të bashkisë nga njëra anë dhe komunitetit të synuar nga ana tjetër. Përkrah ekspertizës teknike në planifikimin urban, roli i CoPlan është dhe ai i ndërmjetësit dhe lehtësuesit mes dy grupeve.

<sup>34</sup> compare *Stability Pact for South Eastern Europe, Ministerial Conference on informal Settlements in South Eastern Europe*, Vienna 28.September – 01 October 2004.



Rregullimi është bazuar në parimet e partneritetit dhe pronësisë në ndërhyrje. Komuniteti është përfaqësuar në ato organizma ku marrin pjesë aktive në procesin e planifikimit. Mekanizmi drejtues më i lartë politik prezantohet kryesisht nga donatorët dhe organizmat përgjegjës.

Mekanizmat e punës korrespondojnë me aspektet e çështjeve të menaxhimit të brendshëm (p.sh. planifikim strategjik, buxhetim, personel, strukturim etj.). Gjatë vlerësimit, projekti ishte në një në vend marsh për arsye të interesave politikë të kapitalistëve në atë kohë (periudhë zgjedhesh). Kjo thekson karakterin e fortë politik të projektit dhe tregon një vulnerabilitet të veçantë ndaj faktorëve të jashtëm. Projektit i duhej të përballej me menaxhimin e një sërë çështjesh të ndryshme dhe komplekse.

#### 4.3 Efektiviteti

Megjithëse një projekt i ri, u arritën rezultatet e prekshme si më poshtë:

Rezultatet e pritshme	Resultatet e arritura
Pregatitja e udhëzimeve për legalizimin	Përfundoi me sukses faza e parë e procesit të legalizimit.
Pregatitja e planit urban parcial të zonës pilot	Linja bazë e studimit dhe drafti i ToR u zhvillua me sukses
Ndërhyrje direkte në infrastrukturë, nëpërmjet bashkfinancimit të komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- U ndërtua 1,2 Km rrugë e mbuluar</li> <li>- Përmirësimi i kenderit të lojrave të shkollës</li> <li>- Lyerje muresh</li> </ul>
Pregatitja e Axfordës së zhvillimit të lagjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>- U vendosën OBKs</li> <li>- U rrit pjesëmarrja e grave</li> <li>- Bashkia e trajton si prioritet temën e Kënetës</li> <li>- Raportimet e medias mbi komunitetin e Kënetës</li> </ul>

Më tej, qëndrimi i përkohshëm në vend i projektit ngre pyetjen e efektivitetit të koncepteve të aplikuara në projekt. Veprimet e bazuara në komunitet janë politikë dhe pjesë e një ripozicionimi strategjik që një OJQ duhet të bëjë në mardhëniet e saj me njerëz me të cilët ajo punon, përfituesit. Një OJQ lëviz nga roli i saj i suportimit financiar dhe shpërndarjes në rolin e forcimit të organizatave dhe iniciativave popullore. Projektin u ndërpre në momentin kur bashkia kërkoi një shtrirje të aktiviteteve për gjithë zonën e Kënetës. Kjo kërkesë iu drejtua direkt OJQ-ve (dhe indirekt donatorëve) dhe bllokoi të gjithë procedimet.

#### 4.4. Impakti

Koncepti i Projektit ndjek një strategji të dyfishtë:

- Pjesëmarrje e fuqishme e aktorëve
- Sensibilizimi i publikut (“going public”).

Projekti është krahasimisht i ri. Prandaj, niveli i impaktit mund të komentohet vetëm si më poshtë:

- Lidhjet familjare –sidomos si klane – janë relativisht të forta në shoqërinë shqiptare dhe determinojnë jetesën sociale. Një sens kolektiv i përbashkët sic është bërë pjesë e pjesës më të madhe të shoqërive perëndimore evropiane është disi i panjohur si një kërkesë e re e shfaqur në periudhën e tranzicionit. Duke marrë këtë në konsideratë , nuk është e cuditshme që njerëzit më mirë preferojnë të gjejnë zgjidhje individuale sesa të bëjnë zgjidhje në grupe sipas interesave të përbashkëta. Gjithsesi, vendosja e organizatave me bazë komuniteti (OBK) si një strukturë pune në Kenetë është krijuar një mjet i ri komunikimi për për dhënë formë një opinioni të bazuar gjerësisht. Sipas banorëve të Kënetës ky mjet është vlerësuar ndërmjet tyre. Në këtë stad të projektit është tepër herët për të deklaruar nëse është bërë një ndryshim në strukturën e vendimmarrjes.
- Në thelb ka dy procedura të ndryshme të dukshme që realizojnë një ndërhyrje në përgjithësi: E para, një ndërhyrje mund të bazohet në eksperiencën dhe traditën e vet( ne gjithmonë e kemi bërë kështu) ose së dyti, një procedurë mund të bazohet planifikim ose racionalitet. E fundit është një formë regullative e cila është aplikuar sidomos në Evropën Perëndimore. Shumë shpesh deklarohet si një rregul i përgjithshëm i cili mesa duket është më efektiv dhe eficient se format e tjera – pavarësisht faktit që shoqëri të tjera mund të kenë rregulla të tjera dhe mund t'i konsiderojnë ato të sakta. Sipas CoPlan, puna rregulluese e ofruar nga projekti duhet të ketë pasur impakt në mentalitetin e njerzve pasi ata duhet të binden me rezultatet konkrete të avantazhit nga paraplanifikimi. Do të jetë shumë e vështirë të gjendet ndonjë provë e nivelit të këtij impakti gjatë projektit sepse aspekti qëndror i projektit nuk është “planifikimi urban dhe manaxhimi” por nëse dhe si si të integrojnë njerëzit nga sistemet informale në sisteme formale. Për këtë arsye ky fokus është më shumë politik dhe më pak teknik dhe duhet trajtuar si i tillë.
- Sipas planit të CoPlan, strategjia e rritjes së ndërgjegjësimit tregon impakt në nivelin frekuencës së raportimeve. Trajtimi në shtyp dhe televizion i temës “Kënetë” është rritur që nga fillimi i projektit. Gjithsesi, nuk ka tregues monitorimi që të masin në mënyrë cilësore nëse ka ndryshim imazhi në favor të banorëve të Kënetës.
- Balanci gjinor është një çështje e përcaktuar në konceptin e projektit. Meqë pjesëmarrja e grave ishte relativisht e ulët në fillimet e projektit, CoPlan ndryshoi procedurat e implementimit ndërkohë që afronte burra dhe gra vec e vec. Më tej, një nga kriteret (e detyrueshme) për prezantimin e komunitetit ishte një përbërje e balancuar e gjinive të OBK. Kjo është përmbushur. Projekti, kishte edhe qëllimin e kryerjes së një studimi gjinor gjatë implementimit të projektit. Gjithsesi, në fazën fillestare nuk u vendos asnjë sistem monitorimi për të matur impaktin e projektit tek gratë(dhe /ose grupe vulnerabël)

#### 4.5. Qëndrueshmëria

*Qëndrueshmëria Financiare:* Përfshirja i komunitetit kërkon gjithashtu dhe mobilizimin e burimeve të veta dhe redukon kostot e aktiviteteve shoqërore dhe të infrastrukturës. Bashkia caktoi 17'500 EURO/në vit si bashkëfinancim. Këto kontribute tregojnë angazhimin e financuesve në projekt. Njëkohësisht duhet të përmendim se CoPlan në thelb ka vetëm dy donatorë (ADA dhe – shumë më të vogël (në shtrirje - NOVIB). Kjo sjell risk të madh në operativitetin e projektit në rast parafinancimi.

*Qëndrueshmëria e rezultateve të projektit:* Procesi i legalizimit nuk është vetëm parakusht për planifikimin dhe integrimin urban të vendbanimit në rrjetin e sigurtë formal. Por gjithashtu do të thotë :

- Mënjanton mundësinë e largimit arbitrat

- Ofron shtëpi me asete që mund të përdoren si garanci për kredi të mëvonshme
- Ofron hapësira për aktivitetet ekonomike familjare
- Përmirëson kushtet e jetesë, mjedisit (veçanërisht hapësira, kanalizimi dhe furnizimi me ujë).

## 5 KONKLUZIONE

---

Vendbanimi informal i Kënetës nuk është një fenomen i përkohshëm: Njerëzit që janë vendosur do të qëndrojnë. Është e nevojshme të gjenden zgjidhje në strukturën urbane të Durrësit.

Kursi i projektit tregon se nuk është vetëm temë teknike me të cilën duhet të përballesh ( zhvillimi dhe planifikimi urban). Projekti është gjithashtu i përcaktuar në një shtrirje të gjerë nga interesat politikë të aktorëve të ndryshëm. Këtu, interesat specifike të bashkive çuan në një ndalesë të përkohshme të projektit. Kjo ndryshoi automatikisht rolin “ndërmjetësues” i CoPlan nga një (pak a shumë) shpërndarës shërbimesh në një aktor projekti me interesa të vetat.

Projekti tregoi se veprimet e bazuara në komunitetin janë tej mase të vështira të arrihen. Implementimi, realizimi dhe menaxhimi i zhvillimit i cili ka konceptin “komunitet” në thelb ka qënë problematik. Do të ishte e rëndësishme të rregjistrohet procesi i gjetjes së zgjidhjeve ( në sensin e mësimëve të nxjerra në p.sh. si të mobilizohen dhe organizohen njerëzit mbi bazat e një mirëqenjeje komunitive) që japin disa pamje të rëndësishme të brendshme mbi rrugët se si OJQ-të në Shqipëri përmbushin rolin e tyre.

Një shtrirje e aktivitetit të projektit në të gjithë zonën e Kënetës jo vetëm i tejkalon kapacitetet e CoPlan si agjensi implementimi, por do të ndryshojë dhe konceptin e projektit totalisht. Përmbajtja dhe procedurat/mekanizmat e punës duhen riparë sipas kërkesave të reja. Një plan për legalizimin si proces dhe planifikimin urban ka limitet e tij dhe prej kësaj ai i injoron totalisht dinamikat e komunitetit.

## 6 REKOMANDIME

---

Në nivelin e CoPlan:

- CoPlan duhet të rishohë aplikimin e konceptit të OBK me qëllim që të përcaktojë një shtesë të strategjive fuqizuese. Sipas rrethanave OBK duhet të integrohet në procesin e vendimmarjes.
- Gjithashtu CoPlan duhet të rishikojë rolin e saj dhe të qartësojë gjithsesi fokusin vetëm në shpërndarjen e shërbimeve ose në një përfshirje aktive ndërkohë që ka marrë persipër një rol avokatie për interesat e banorëve të Kenetës.
- CoPlan duhet të përpunojë faktorët e nënvizuar të suksesit për vendosjen organizatave të reja të bazuara në komunitet në Shqipëri. Ata mund të ofrojnë pamje të brendshme interesante në aspektin e shoqërisë civile në Shqipëri. Mësimet e nxjerra duhet të shpërhapen ndërmjet atyre agjensive që punojnë në sektorin e zhvillimit në Shqipëri.
- CoPlan duhet të rishohë sistemin monitorues ekzistent dhe duhet të shtojë indikatorë dhe një mekanizëm për impakt monitorimi.
- Ndërkohë që po bën një model të procesit të legalizimit dhe planifikimit urban, CoPlan (dhe eksperti i monitorimit) duhet të marrë në konsideratë mekanizma për t’iu përgjigjur dinamikës së komunitetit.

Në nivel ADA:

- ADA duhet të rishohë përfshirjen e saj me kujdesin për gjithë detyrimet. Meqë projekti është shumë politik, është i nevojshëm një përfshirje më i fortë i COOF. Kjo përfshirje nuk duhet të kufizohet (vetëm) në qënien e donatorit të CoPlan por duhet të synojë në karakterin inovativ e aktiviteteve të projektit.
- Për këtë, më shumë kapacitete nevojiten në nivelin COOF. Personi i ngarkuar duhet të kontribuojë përmes njohurive të bazuara mirë mbi menaxhimin e projektit, drejtimin dhe koordinimin dhe më pak njohuri eksperte mbi legalizimin dhe planifikimin urban. Për këtë – dhe gjithashtu për shkak të kontakteve të tij me platforma të ndryshme të donatorëve – drejtuesi i COOF është personi më i përshtatshëm.
- COOF duhet të punojë se si të lidhë (konceptualisht) aktivitetet e projektit në nivel makro dhe politika kombëtare. Kjo detyrë nuk duhet tu lihet në dorë konsulentëve. ADA duhet të ketë avantazhin e grumbullimit të njohurive institucionale të cilat mund të përdoren edhe në fusha të tjera.



**Shtojca 3 / (4)**

**Programi i Arsimit profesional në Shqipëri**  
**Shkollat e Hoteleri-Turizmit në Tiranë dhe Sarandë**  
**Shkolla Bujqësore në Fier**

Botuar nga KEK CDC Consultants

Gusht 2005

**PËRMBLEDHJE**

Programi Shqiptaro-Ausriak në fushën e arsimit profesional, bashkëfinancuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe implementuar nga KulturKontakt ka sjellë rezultate të dukshme në arsimin bujqësor dhe turistik, rezultate këto mjaft të vlerësuara nga të dyja palët: përfituesit dhe partnerët.

Për shkak të pjesëmarrjes së partnerëve në procesin e planifikimit, nevojat dhe problemet e arsimit bujqësor dhe të turizmit janë miradresuar. Ka rezultate të dukshme në infrastrukturë, në zhvillimin e kurrikulave, në trajnimin didaktik dhe profesional të mësuesve si dhe në zhvillimin e materialeve mësimore. Shkollat e mbështetura nga projektet janë identifikuar si “modele” të shkollave profesionale në Shqipëri. Menaxhimi i Projektit ishte eficient. Faktorët kryesorë të kësaj efience ishin kontributi dhe bashkëpunimi i mirë me Qeverinë Shqiptare dhe donatorë të tjerë. Menaxhimi i projektit dhe komunikimi i mirë midis partnerëve kanë kontribuar për arritjen e rezultateve të mira.

Por ka akoma disa sfida. Cilësia e mësimdhënies dhe aftësitë profesionale të të diplomuarve lenë për të dëshiruar. Ka disa rezultate pozitive lidhur me bashkëpunimin midis shkollave të përfshira, komunitetit lokal të biznesit, si edhe partnerëve të tjerë, por aspektet ligjore të partnerëve të brendshëm kanë ende nevojë për përmirësim dhe përshtatje. Sfida kryesore sot, është siguri i një qëndrueshmërie të arritjeve të programit.

**1 METODAT**

Misioni i vlerësimit u mbajt në Shqipëri në periudhën 7 Korrik - 11Gusht. Për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve përkatëse u përdorën metoda të ndryshme.

- *Pyetje:* Intervista individuale dhe diskutime në grupe të vogla me përfitues dhe partnerë të projekteve aktuale dhe të mëparshme në Tiranë, Sarandë dhe Fier; intervista me stafin e ADA dhe Kultur-Kontakt në Tiranë.
- *Vizitat në terren:* Skuadra e vlerësimit gjithashtu, vizitoi disa institucione të cilat në mënyrë direkte ose indirekte përfituan nga mbështetja Austriake (si p.sh. Shkolla e Hoteleri-turizmit Tiranë dhe Sarandë, Shkolla Bujqësore në Fier, bizneset etj.)
- *Diskutime:* Diskutime me partnerët dhe përfaqësuesit kryesorë të sektorit të AP Vëmendje e vecantë i është kushtuar mbledhjes së pikëpamjeve lidhur me ndërhyrjen Austriake në nevojat dhe prioritetet e sektorit të AP
- *Analiza:* Analiza e dokumenteve të disponueshme të projektit si dhe materialeve shtesë të mbledhura nga vlerësuesit kanë kontribuar në mirëkuptimin e kontekstin lokal

- *Puna në grup*: Raportime/konsultime të rregullta u zhvilluan brenda skuadrës së vlerësimit në zyrën e ADA në Tiranë.

Një draft i parë i këtij projekti u përpunua nga Edlira Muedini (CIVET, Tiranë) dhe më pas u rishikua nga KEK CDC Consultants. Për lehtësuar procesin e leximit një version i shkurtër i lexueshëm i projektit u hartua nga Konsulentët e KEK CDC, duke ju bashkangjitur si shtojcë përmbledhjes së raportit. Raporti origjinal mund të kërkohet tek Konsulentët e KEK CDC.

## 2 SHIKIM I SHKURTËR I PROJEKTEVE

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Zhvillim dhe mbështetje për shkollat e hotelerisë, menaxhim turizmit dhe, Catering . (Shkollat e H-T) në Tiranë dhe Sarandë, Shqipëri.</b>
<b>Agjencia e mandatuar</b>	KulturKontakt Austri
<b>Partnerët Lokalë</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike
<b>Numri i Projektit</b>	7580-00/98
<b>Kohëzgjatja e Projektit</b>	1.11.1998-31.12.2000 (shtyrë në 15.11.2002)
<b>Grupi i Synuar</b>	Shkollat e Hotelerisë dhe Catering Tiranë dhe Sarandë
<b>Objektivat e Projektit</b>	- Rinovimi i dy Shkollave Profesionale (Sarandë) - Zhvillimi dhe implementimi i kurrikulës menaxhim turizmi/ agjensi udhëtimi (Tiranë dhe Sarandë) - Trajnimi i 15- 20 mësuesve në përputhje me kurrikulën hotel/catering dhe menaxhim turizmi/agjensi udhëtimi. - Zhvillimi i materialeve mësimore (në Shqip)
<b>Buxheti i Projektit</b>	229.806,40 EURO
<b>Kontributi Austriak</b>	218.018,53 EURO

<b>Titulli i projektit</b>	<b>TOUR-NET- Shkollim dhe trajnim Turizmi në Ekonominë e Evropës Jug-Lindore – Shkollim relevant, rrjetet kombëtare dhe Bashkëpunim ndër Kombëtar (Projekt rajonal brenda strukturës së Paktit të Stabilitetit)</b>
<b>Agjencia e mandatuar</b>	KulturKontakt Austria
<b>Partnerët Lokalë</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkollat Pilot të Hoteleri-Turizmit Tiranë dhe Sarandë
<b>Numri i Projektit</b>	7832-02/00
<b>Kohëzgjatja e Projektit</b>	29.09.2001-30.09.2003
<b>Grupi i Synuar</b>	Shkollat Pilot të Hoteleri-Turizmit në Shqipëri
<b>Objektivat e Projektit</b>	- Mbështetje për materialet mësimore - Përmirësim infrastrukture - Mbështetje e ngritjes së skuadrave të mësuesve - Prezantimi i ideve të reja të marketingut
<b>Buxheti i Projektit</b>	EURO 312.485,56 (for the region)
<b>Kontributi Austriak</b>	EURO 218.018,53

<b>Titulli i projektit</b>	<b>Model për mbështetjen e Arsimit Profesional Bujqësor në Shqipëri (shkolla pilot Fier)</b>
<b>Agjencia e mandatuar</b>	KulturKontakt Austri
<b>Partnerët Lokalë</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>Numri i Projektit</b>	7925-00/02
<b>Kohëzgjatja e Projektit</b>	Tetor 2002-Shtator 2004 (shtyrë Mars 2005)
<b>Grupi i Synuar</b>	Shkolla Bujqësore, Çlirimi, Fier
<b>Objektivat e Projektit</b>	Transformimi i Shkollës së Fierit në një qendër kompetente, përmes zhvillimit të profilit të shkollës.
<b>Rezultate të Pritshme</b>	- Përmirësimi i kurrikulës bazuar në praktikë - Përmirësimi i njohurive profesionale dhe praktike të mësuesve. - Përdorimi optimal i biznesit të shkollës për të trajnuar nxënësit - Ndërgjegjësimi për ekonominë e bujqësisë ekologjike. - Hartim i materialeve mësimore didaktike cilësore - Pjesëmarrje aktive në zhvillimet bujqësore rajonale.
<b>Buxheti i Projektit</b>	227,624 EURO
<b>Kontributi Austriak</b>	226,868 EURO

### 3 KONTEKSTI

Sot, cilësia dhe sasia e sistemit të Trajnimit dhe Arsimit Profesional në Shqipëri (VET) është e ulët. Ka një mungesë të infrastrukturës së duhur; fonde të pamjaftueshme, nivel të ulët të burimeve njerëzore, kurrikula jo-bashkëkohore dhe metoda të vjetra menaxhimi. Më konkretisht:

- Lidhja e Arsimit Profesional (AP) me tregun e punës është akoma shumë e dobët.
- Në shumë raste ndërmarrjet nuk janë në gjendje t'ju përgjigjen kërkesave profesionale dhe teknike të shkollës për praktikantët e nxënësve të tyre. Ky fakt e komplikon dukshëm integrimin e të rinjve në tregun e punës
- Arsimi dhe Trajnimi Profesional akoma veprojnë si dy nënsisteme tërësisht të pavarura.
- Shumë orientime të ndryshme mbi zhvillimin e AP; por jo dokumenta të plotë strategjikë të kuptueshëm.
- Dukuria pilot, në sektorin e AP është themeluar dhe implementuar nga organizata dhe institucione të ndryshme. Nuk ka një përgjithësim të arritjeve dhe dështimeve as edhe një përkufizim të një modeli të mirëpërshtatur të AP dhe implementimit të tij në një shkallë më të gjerë
- Investime kryesore janë bërë në nivel shkolle; ndryshimet lidhur me nivelin e sistemit kanë qenë të një rëndësie të vogël.
- Mungesa e stabilitetit në procesin e ndryshimit: Ndërprerja e mbështetjes së donatorëve bënë që ndryshimet pozitive të "humbin" gradualisht.
- Diferenca e madhe midis shkollave profesionale. Ekziston një pabarazi e konsiderueshme nga pikëpamja e burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore. Në përgjithësi infrastruktura materiale e shkollave profesionale është e varfër.
- Kurrikulat e AP në përgjithësi, janë akoma tradicionale dhe larg realitetit. Ka një mungesë të teksteve dhe materialeve didaktike mbështetëse.
- Mësimdhënia në përgjithësi është e modelit të vjetër dhe trajnimi i vazhdueshëm bëhet në mënyrë sporadike vetëm në shkollat pilot.
- Trajnimi profesional nuk mbështetet nga qeveria (p.sh. mbështetja me pajisje dhe/ose lëndë të parë)
- Arsimi Profesional është ende tepër i mbingarkuar me shumë teori
- Aktet ekzistuese normative kufizojnë aktivitetet prodhuese dhe praktike të shkollave profesionale. Ato gjithashtu, kufizojnë mundësinë e tyre për të ofruar shërbime në përfitim të shkollës ose palët e treta.

### 4 VLERËSIMI

#### 4.1 Relevanca

Projektet kanë një relevancë të madhe me shkollat, mësuesit dhe studentët e përfshirë. Ata përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga aktivitetet e projektit (trajnime, materiale, kurrikula, pajisje, etj.) në procesin e përditshëm të tyre të mësimdhënies dhe të mësuarit. Produktet (si materiale mësimore dhe programe mësimore) e përpunuara gjatë kohëzgjatjes së projektit u janë shpërndarë gjithashtu edhe shkollave të tjera si p.sh. në Durrës dhe Pogradec. Megjithatë, aktivitetet e projektit kanë qenë fokusuar kryesisht, në nivel shkolle dhe si rrjedhojë kishin shumë pak lidhje me zhvillimin e Sistemit Arsimit Profesional në Shqipëri në tërësi.

#### 4.2 Efiçenca

Në sajë të eksperiencës sonë, përdorimi i fondeve të disponueshme përputhet me shpenzimet e zakonshme të masave arsimore, brenda kooperimit teknik. Një tregues i saktë nuk është i mundur pasi të dhënat nuk janë të disponueshme dhe projektet nuk mund të krahasohen brenda detajeve të tyre.

#### 4.3 Efektiviteti

Arritja e Qëllimeve të Projektit:

*Shkolla e Hotel Turizmit në Tiranë and Sarandë*

<b>Planifikimi</b>	<b>Rezultate të arritura</b>
- përmirësime infrastrukturore (pajisje)	- rehabilitimi i shkollave, duke përfshirë pajisjet (reception, kuzhinë, restorant, bar, dhe zyrat e trajnimit për agjensitë e udhëtimit); 8 kompjutera të rinj (duke përfshirë instalimet), 16 kompjutera të dorës së dytë të instaluar;
- zhvillimi i kurrikulave	- përshtatja dhe përdorimi i kurrikulës Austriake me kërkesat lokale; përdorimi i materialeve didaktike Austriake. (të përkthyer)
- Trainime	- Trainimi i 14 mësuesve (duke përfshirë drejtorët e Institutit Pedagogjik) ekonomik financë, turizëm gjeografi, menaxhim, marketing, catering.
- zhvillimi i materialeve të mëtejshme trainuese	- materiale trajnuese të përpunuara për turizmin (të vitit të katërt), ekonomikun dhe, menaxhim biznesin

*TourNet*

<b>Rezultate të Planifikuara</b>	<b>Rezultate të arritura</b>
- Mbështetje për metodat & materialet mësimore	20 seminare trajnimi në të gjithë vendin (trainim profesional, menaxhim projekti, shkollë marketingu, Informatikë, etc). Zhvillimi i materialeve mësimore bazuar në modein Austriak.
- përmirësim infrastrukture	- pajisje të reja të kuzhinës së shkollës
- Mbështetje ngritjes së skuadrës lokale të shkollës	- 13 projekte shkollash të prezantuara në të gjithë vendet. Kjo ka sjellë rritjen e punës në grup, të iniciativës, të kreativitetit si dhe të imazhit të shkollës. P.sh broshura turistike për Sarandën dhe Tiranën, Kuzhina mesdhetare e Shqipërisë, etj.
- Prezantimi i ideve të reja të marketingut	- Ngritja e faqes së internetit të shkollës - Zhvillimi i kontakteve midis shkollës së Tiranës dhe hotel Rogner (Tiranë).

*Shkolla Profesionale Bujqësore Pilot*

<b>Planifikimi</b>	<b>Rezultate të arritura</b>
- Përmirësim kurrikulumi (fuqizimi i orientimit praktik)	- Aprovimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës - përpunimi i raporteve me rekomanduesë
- Përmirësimi i njohurive praktike dhe profesionale të mësuesve të shkollës	- reagimi i të punësuarve (ende të padiplomuar) - nivel punësimi në profesion (ende të padiplomuar) - analizë vjetore studentore
- Përdorimi optimal i biznesit të shkollës bujqësore me qëllim trajnimin e nxënësve	- rritje në fitim - Prodhimi 300kv/ha/vit
- Ngritje e vetëdijes për ekonominë e bujqësisë ekologjike	- plotësimi i pyetësorëve periodikë me fermerë të synuar të zonave fqinje (ende të padiplomuar) - gupet vullnetare bëjnë takime për të diskutuar çështje mjedisore
- Hartim cilësor i materialeve mësimore didaktike	- Vlerësimi i CCSD për materialet didaktike
- Pjesëmarrje aktive në zhvillimet bujqësore rajonale	- Pyetësorë të pjesëmarrësve në kurset apo mësimet e ofruara - Ftesa bërë shkollës nga departamenti i bujqësisë i komunës, takime për të analizuar zhvillimet bujqësore

**4.4. Impakti**

Shkollat të cilat patën një ndikim të drejtpërdrejtë, provuan një shtytje modernizuese dhe ishin në gjendje të përmirësonin cilësinë e disa temave individuale dhe të mësimave praktike dhe teorike të vecanta. Mësuesit e përfshirë janë të ndjeshëm ndaj metodave moderne mësimore. Ata patën mundësinë të jepnin mësim brenda një konteksti arsimor bashkëkohor.

Mund të jetë një kontribut modest i projekteve në sektorët e zhvillimit të Turizmit Shqiptar, përkatësisht të Bujqësisë Shqiptare, në sajë të faktit se janë përdorur metoda dhe inpuete moderne. Por kjo mund të jetë e vështirë për tu matur, pasi nuk ekziston një analizë e përgjithshme e nivelit të sistemit ose të sektorit.

#### 4.5. Qëndrueshmëria

- Implementimi i mëtejshëm i kurrikulës në shkollat të tjera kontribon për një përfitim të qëndrueshëm për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës (MASH) si dhe të vetë shkollave.
- Materialet mësimore, të zhvilluara si portofole të mësuesve janë një produkt i qëndrueshëm dhe i përdorshëm për më tej. Ato janë përdorur dhe akoma vazhdojnë të përdoren nga shkolla të ngjashme. Tani nën TOUR REG po bëhet përgatitja e leksioneve që do të përdoren si nga mësuesit ashtu edhe nga nxënësit
- Metodat mësimore të tilla si "puna në projekte", janë aspekte me një mundësi të lartë për të mbetur edhe pas përfundimit të projektit. Eshtë rritur numri i "punëve në projekt", duke ulur në këtë mënyrë, mbështetjen financiare përmes donatorëve ndërkombëtarë. Shkollat kanë arritur të sigurojnë në mënyrë të pavarur disa nga fondet e tyre (kohët e fundit, në aktivitetet e projektit TOUR REG). Nga ana tjetër, puna në projekte ka fuqizuar kontaktet me bizneset, duke rritur kështu, reputacionin e shkollave.
- Mësuesit e trajnuar janë një aset i fuqishëm për këto shkolla. Kontributi i tyre në projektet e shkollës apo në institucione të tjera mbetet një aset.
- Infrastruktura e shkollës, sigurimi i pajisjeve të reja dhe mirëmbajtja e tyre nga qeveria, mbetet akoma një sfidë për shkak të fondeve të pamjaftueshme.

## 5 KONKLUZIONE

*Relevanca:* Bazuar në hartimin e projektit dhe mënyrën e adresimit të nevojave, programi i TP ka synuar dy elementë të rëndësishëm të arsimit profesional - p.sh. trajnimi profesional në fushën e turizmit dhe të bujqësisë. Për shkak të pjesëmarrjes së partnerëve në procesin e planifikimit u bë një adresim i problemeve dhe nevojave të këtyre fushave. Interesi i pushtetit lokal për bashkëpunim është akoma në nivel të ulët, pasi shkollat mbikëqyren dhe administrohen në nivel kombëtar.

Turizmi dhe bujqësia janë fusha të rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë dhe arsimimi në këto fusha është nevojë dhe prioritet. Nga ana tjetër mbështetja e shtetit për sektorin e TP është akoma e vogël. Në këtë mënyrë programi mbetet aktual dhe relevant.

*Efikasiteti:* Projektet ishin eficientë si rezultat i një bashkëpunimi dhe kontributi të mirë me qeverinë Shqiptare, p.sh me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës: Ky bashkëpunim, megjithëse i arritur me kapacitetet minimale në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, rezultoi si sukseshëm në përbushjen e të gjitha kërkesave të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Ka disa rezultate në shtimin e të ardhurave të shkollës. Egziston një mungesë njohurie dhe eksperience në bashkëpunimin me palët e treta si dhe/ose vështirësi mbi mospasjen e një statusi kombëtar, i cili i jep shkollës më shumë autonomi

*Efektshmëria:* Parë pozitivisht, ndryshimet që këto projekte sollën në shkolla janë të dukshme. Për tu përmendur:

- Ngritja dhe fuqizimi i infrastrukturës
- Zhvillimi i kurrikulës dhe materialeve mësimore
- Zhvillimi i burimeve njerëzore
- Përkrahja ndaj lidhjeve me biznesin
- shkëmbimi i eksperiencës rajonale dhe evropiane
- aktivitete shkollore (marrëdhëniet me publikun)

Megjithatë, bashkëpunimi midis shkollave dhe komunitetit tregtar lokal (partnerët lokalë përkatës) është përmirësuar vetëm pjesërisht. Arsyet e mëposhtme shpjegojnë pjesërisht këtë deficit.:

- Biznesi është i gatshëm të bashkëpunojë me shkollat, por ekziston një nevojë e madhe për aftësi më të mira praktike të studentëve dhe njohur në menaxhimin e hotelit.
- Biznesit gjithashtu i mungon trajnimi në shërbimet dhe menaxhimin e hotelerisë, i cili jo rrallë, përbën problem për një bashkëpunim të ndërsjellë.

*Impakti:* Projektet kanë pasur një ndikim pozitiv në shërbime, në fushën e turizmit dhe të prodhimit bujqësor në të gjithë vendin, por është vështirë të thuhet se c'pjesë e këtij ndikimi ka qenë influenca e projekteve të vlerësuara, sepse luajnë rol edhe faktorë të tjerë -

*Qëndrueshmëria:* Realizimi i materialeve mësimore, zhvillimi dhe implementimi i kurrikulës, zhvillimi i metodave mësimore si dhe i burimeve njerëzore janë rezultate që tregojnë qëndrueshmërinë e projekteve. Nga ana tjetër, shkollat si pjesë e projektit më shumë ishin në pritje të asaj që do të ndodhte, por pa u ndierë akoma pjesë aktive e projektit.

Projektet Austriake të TP kanë sjellë risi, veçanërisht me metodat e reja të punës në shkollë, si puna me projektet, e cila ka pasuruar njohurinë e mësuesve dhe të nxënësve, ka nxitur punën në grup dhe aktivitetet që sjellin të ardhura. Megjithëse projektet Austriake, financiarisht kanë qenë më të vogla se të donatorëve të tjerë, ato kanë lënë pas më shumë dokumentacion si materialet mësimore dhe kurrikula, që mund të përdoret dhe më tej,

## 6 REKOMANDIME

---

Nëse ADA vendos për kontribute të mëtejshme në sektorin e TP, aspektet e mëposhtme duhen marrë në konsideratë.

- Theks i vecantë duhet vënë në intensifikim të bashkëpunimit me komunitetin e biznesit lokal dhe të shtimit të aktiviteteve tregtare, me qëllim gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e mardhënieve më të ngushta me sektorin privat. Një rekomandim i tillë është në një linjë me prioritetet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencave, me strategjinë 2004-2005 të ADA (mbështetje punësimit) si dhe me iniciativat e donatorëve të tjerë, si Programi CARDS, PARSH, SC, ku sinergjitë mund të gjenden me lehtësi.
- Me legjislacionin e përshtatshëm si dhe strukturën e duhur ligjore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të lehtësojë praktikën me ndërmarrjet si për aktivitetet që gjenerojnë të ardhura.
- KulturKontakt ka një eksperiencë të shquar në arsimin profesional në Shqipëri dhe në rajon. Kontributi dhe bashkëpunimi me institucionet e reja të AFP-sëVET; si KKAFFP dhe mbështetja në krijimin dhe funksionimin e AKAFP, në bashkëpunim me programin CARDS, do të ishte me interes. Ky mund të jetë një hap i nevojshëm drejt lidhjes së nivelit makro me mikro

## Shtojca 3 / (5)

---

### Ndërtimi i kapaciteteve për gratë drejtuese

#### në Pushtetin Lokal

botuar nga KEK CDC Consultants

Gusht 2005

---

#### PËRMBLEDHJE

---

Vlerësimi shqyrton projektin “ Ndërtimi i Kapaciteteve Për Gratë Udhëheqëse në Pushtetin Lokal” përsa i përket rëndësisë, efikasitetit, efektivitetit, impaktit dhe qëndrueshmërisë. Projekti është imlementuar në periudhën Korrik 2003 - Qershor 2004. Ai është një kontribut për zhvillimin e shoqërisë civile shqiptare. Projekti fokusohet në nxitjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen politike në dy nivelet e mëposhtme:

- Në nivelin individual: Fuqizimi i grave përmes trajnimeve specifike me qëllim rritjen e profesionalizmit.
- Në nivelin shoqëror: Rritja e ndërgjegjësimit publik rreth pabarazisë gjinore.

Masat e projektit përfshinë sesione të ndryshme trajnimi për femrat politikane, (përfaqësuese të dhjetë partive të ndryshme Shqiptare), kontribute për televizionin lokal dhe publikime në media të ndryshme të shkruara, gjithashtu edhe përkthimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese ndërkombëtare një grupi të zgjedhur të synuar. Për më tepër një numër i kufizuar pjesëmarrësish në projekt, patën mundësinë të udhëtonin në Austri për shkëmbim vizite.

Projekti ka një relevancë të lartë në nivel individual: pjesëmarrësit në seminarët trajnuese pohuan se aftësitë e tyre u përmirësuan ndjeshëm në sajë të trajnimeve dhe diskutimeve. Gjithashtu është pohuar se gratë luajnë rolin e “shumëfishuesit”, pasi ato ishin në gjendje të përdornin njohuritë e reja edhe në mjedisin e tyre të punës. ( aplikimi i menaxhimit të ciklit të projektit apo i lidershipit modern.)

ADA-ës i është rekomanduar të vazhdojë mbështetjen e projektit, pasi ai përfaqëson një ndër kontributet e pakta drejt zhvillimit të shoqërisë civile. Lidhur me arritjen e një qëndrueshmërie më të mirë financiare, duhen bërë disa përshtatje të vogla, duke ecur drejt komercializimit të seminareve trajnuese. Një hap i tillë do të çonte në fuqizimin e burimeve të vetë Qendrës së Gruas si dhe do të ulte varësinë ndaj mbështetjes ndërkombëtare.

Në verë të 2004-s, projekti u vlerësua nga Dr. fil Caroline Milow, OSBE, Këshilltar i Zhvillimit të Shoqërisë Civile dhe i çështjeve Gjinore. (aktualisht në Tiranë). Asnjë pikëpamje e re (apo e ndryshme) nuk është shtuar në strukturën e vlerësimit të ADA-s. Qendra e Gruas ndoqi pothuaj të gjithë rekomandimet e bëra nga Dr. Milow (p.sh përpunimi i një kornize-logjike me indikatorë, përfshirja e burave). Duke shërbyer si një pikë mbështetjeje, Dr. Milow akoma e mbështet projektin, si një ekspert i jashtëm i çështjeve gjinore. Projekti tashmë është në një fazë të dytë, duke pasur si synim femrat politikane në nivelin qeveritar. Ky projekt, ende në vazhdim nuk ka qenë objekt i vlerësimit të ADA-



## 1 METODAT

Misioni i vlerësimit u mbajt në Shqipëri në periudhën 7 Korrik –11 Gusht. Gjatë vlerësimit u përdorën metoda të ndryshme:

- Studim në tavolinë i dokumentacionit të disponueshëm
- Intervista me pjesëmarrës të trajnimeve dhe parterë të projektit

Një draft i parë i këtij projekti u përpunua nga Eriola Shingjergji (Tiranë) dhe u rishikua më pas nga Konsulentët e KEK CDC. Për të lehtësuar procesin e leximit, një version i shkurtuar i projektit u hartua nga Konsulentët e KEK CDC duke ju bashkangjitur si një shtojcë raportit të përgjithshëm. Raporti origjinal mund të kërkohej tek Konsulentët e KEK CDC

## 2 SHIKIM I SHKURTËR I PROJEKTEVE

<b>Titulli i Projektit</b>	Ndërtimi i kapaciteteve për gratë udhëheqëse në pushtetin lokal
<b>Partneri Austriak / Agjensia Implementuese</b>	Horizont 3000
<b>Partneri Lokal/ Implementuesit Aktualë të Project</b>	Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim (e njohur më parë si Qendra e Gruas)
<b>Numri i Projektit</b>	8000-00 / 2003
<b>Kohëzgjatja e Projektit</b>	1 Korrik 2003 – 30 Qershor 2004
<b>Grupi i synuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Audiencë e gjerë Shqiptare për një Fushatë të Ndërgjegjësimit Publik</li> <li>• 40 gra nga 10 Forume politike grash, pjesëmarrëse në seminarët trajnuese</li> <li>• 16 gra nga 10 Forume politike grash, pjesëmarrëse në Vizitën Studimore në Vienë</li> </ul>
<b>Objektivat e Projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fuqizimi i rolit të grave udhëheqëse në strukturat e bërjes së politikave.</li> <li>• Rritja e ndërgjegjësimit të grave udhëheqëse për të stimuluar perspektivën gjimore në shoqërinë Shqiptare si dhe rritja e kapacitetit të tyre me qëllim integrimin e çështjes gjimore në projekte të ndryshme institucionale dhe komunitare.</li> <li>• Ngritja e kapacitetit të grave udhëheqëse të zgjedhura në pushtetin qendror dhe lokal.</li> </ul>
<b>Buxheti i Projektit</b>	<p><b>Total = 81,72252 Euro</b></p> <p>Horizont 3000 = 19.493,56 Euros</p>
<b>Kontributi ADA</b>	62.228,96 Euro

## 3 KONTEKSTI

Megjithë përpjekjet e qeverisë dhe të shoqërisë civile, gjendja dhe pozicioni shoqëror i gruas në Shqipëri, nuk ka ndryshuar dukshëm. Ekziston një hendek gjithmonë në rritje midis të varfërve dhe të pasurve, mundësive ekzistuese dhe përfitimeve ndërmjet burrit dhe gruas, po ashtu edhe midis

sektorëve ruralë dhe urban të shoqërisë. Pabarazia gjinore shprehet në përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në strukturat e vendimmarrjes dhe të lidërshiptit, në mundësinë e pabarabartë të punësimit dhe të modaliteteve të pagesës, në shërbimet arsimore dhe shëndetësore si dhe në dhunën në familje dhe trafikimin e grave. Pas gjithë kësaj janë qëndrimet tradicionale të shoqërisë që e synon mbajtjen e gruas në vend të dytë në shoqëri, larg menaxhimit dhe jetës aktive publike.

Në 1998, u aprovua një kushtetutë e re, e cila garanton të drejtat dhe përcakton detyrimet sipas standardeve moderne. Megjithatë, një nga shqetësimet kryesore lidhur me çështjen gjinore në Shqipëri duket se është lidhja e teorisë me praktikën lidhur me aksesin për punësim, biznes si dhe shërbime arsimore dhe shëndetësore. Megjithë procesin e rëndësishëm të adaptimit të ligjeve dhe ratifikimit të konventave ndërkombëtare, reforma të rëndësishme akoma nuk janë realizuar plotësisht.

Megjithë përpjekjet në vazhdim për demokratizimin e jetës së vendit, numri i grave të përfaqësuara në vendimmarrje është ende i ulët. Nga 1,949 kandidatë për kryetarë komune dhe bashkie, nga 384 njësi qendrore vetëm 70 (3.5%) prej tyre ishin gra dhe nga këto, vetëm 10 u zgjodhën. Partitë kryesore politike gjithashtu, dështuan në implementimin e kuotave në statutet e tyre, duke garantuar vetëm 25-30 për qind të kandidateve femra për 2003.

Në zgjedhjet parlamentare të Korrik 2005, vetëm 12 gra (8%) (me vetëm 5 gra të zgjedhura direkt) janë zgjedhur anëtare të parlamentit. Në listën direkte të zgjedhësve vetëm 7,7% ishin gra dhe në listën proporcionale, ishin vetëm 8% prej tyre.

Mjaft përpjekje të ndryshme për çështjen e barazisë gjinore, përqëndrohen në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve institucionale. (p.sh udhëzime, lista kontrolli, plane veprimi etj.). Theksi vihet në përpunimin e strategjive praktike dhe specifike për fuqizimin individual dhe praktik të gruas.

## 4 VLERËSIMI

### 4.1 Relevanca

*Krahasuar me nivelin mbarëshoqëror aktivitetet e projektit janë mjaft relevante me nivelin individual, atë të një përfituesi të vetëm. Trajnimi çon në një rritje të kompetencës së grave për një përballje më të mirë me kërkesat dhe sfidat e ndryshme të jetës profesionale, si politikane. Për më tepër, pjesëmarrësit në trajnime mbulonin një spektër të gjerë të skenës politike. (gjithësej 10 parti). Prandaj mund të mendohet se projekti ka një efekt mjaft të përhapur në sensin që pjesëmarrësit veprojnë si shumëfishues në partitë e tyre respektive.*

Së dyti, ambienti i punës së pjesëmarrësve gjithashtu, (institucionet në të cilat gratë e trajnuara punojnë, ose janë të përfshira aktivisht) përfitoi nga rritja e aftësive të grave, përsa i përket metodës moderne të menaxhimit (zbatimi i PCM, metodat e lidërshiptit modern)

Relevanca me nivelin shoqëror duket se është me të vërtetë e ulët. Veçanërisht në ditët e sotme, publiku është i mbingarkuar me çështjen gjinore dhe trajtimin mediatik të saj. Kjo më tepër provokon një ngopje, sesa një shtytje drejt një ndryshimi themelor.

### 4.2 Efçenca

Nisur nga një eksperiencë jona, përdorimi i fondeve përputhet me shpenzimet e zakonshme të masave arsimore brenda bashkëpunimit teknik. Një krahasim (benchmarking) i saktë nuk është i mundur, pasi të dhënat nuk janë të disponueshme dhe projekti nuk mund të krahasohet në detaje.

Sinergjitë u krijuan në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të Qendrës së Gruas me Komitetin Kombëtar për Mundësi të Barabarta (themeluar në 2001). Komiteti punon kryesisht në nivel

kombëtar, duke qenë përgjegjës për implementimin e politikave qeveritare për mundësi të barabarta. Komiteti midis detyrave të tjera, bën edhe koordinimin e programeve të asistencës së agjencive ndërkombëtare që merren me çështjen gjinore. *Komiteti Kombëtar i Mundësive të Barabarta*, kontribuoi në fazën fillestare të hartimit dhe planifikimit të projektit. Për më tepër, pjesëmarrësit u ftuan si folës nderi në trajnime.

#### 4.3 Efektiviteti

Objektivi afat-gjatë i projektit është përmirësimi i raportit të pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes dhe për pasojë, fuqizimin e kapaciteteve të grave të zgjedhura, në strukturat vendimmarrëse lokale dhe qëndore. Të gjitha aktivitetet e projektit i adresohen shpërndarjes së çështjes gjinore në shoqërinë Shqiptare.

Këto synime të projektit u arritën duke pasur një numër të përcaktuar përfituesish. 40 gra nga parti të ndryshme u zgjedhën mbi bazën e kritereve të mëposhtme.

- Të jenë zgjedhur në pushtetin lokal.
- Të jenë aktive në politikë
- Të jenë anëtare të stafit qeveritar.
- Të jenë kandidatë të mundshme, edhe nëse nuk janë zgjedhur në zgjedhjet e Tetor 2003
- Të jenë zgjedhur mbi bazë të një shpërndarje gjeografike. Për partitë me 4 përfaqësues, të paktën 2 prej tyre duhet të jenë jashtë qarkut të Tiranës. Për partitë me 3 përfaqësues, të paktën 1 prej tyre duhet të jetë jashtë qarkut të Tiranës
- Pjesëmarrësit duhet të përfshihen në qeverisjen lokale, gjatë kohës së zhvillimit të projektit.
- Pjesëmarrësit e projektit duhen të sjellin Curriculum Vitae

Aktivitetet e mëposhtme janë implementuar me sukses

- Diskutim publik lidhur me çështjet gjinore në TV kombëtar (4 tryeza të rrubullakëta)
- Publikimi i gjashtë artikujve me temën "Pjesëmarrja e grave në procesin e vendimmarrjes politike" dhe shpërndarja e tyre politikanëve
- Publikimi i një udhëzuesi për trajnuesit, me materiale të zgjedhura si p.sh. publikimi dhe shpërndarja e manualit (*Fushatë për të fituar*)
- Publikimi i një analize krahasuese të Grave Evropiane në Politikë
- Publikimi dhe shpërndarja e broshurës *Gruaja dhe Vendimmarrja*, grave aktive në politikë
- Zhvillimi i kurseve praktike trajnuese për 40 femra politikane lidhur me
  - *Advokaci dhe Lobimi*
  - *Çështjet gjinore dhe Zhvillimi*
  - *Cikli i Projektit nga Ideja në Implementim*
  - *Komunikimi si një celës për Zhvillimin Shoqëror*

○ *Lidershipi dhe Udhëheqësi Modern*

- Shkëmbim vizite në Vjenë dhe Grac për 16 femra politike

Të gjitha aktivitetet u zhvilluan sipas një planifikimi.

#### 4.4. Impakti

Për të vlerësuar impaktin e aktivitetit të projektit, pohimet u mbështetën gjithashtu mbi një vlerësim të mëparshëm mbajtur nga OSBE.

Trajnimi, ka ndikim vecanërisht në nivelin individual:

- Gratë pjesëmarrëse në trajnime pohuan se kishin fituar më shumë njohuri vecanërisht, lidhur me çështjen gjinore, aftësinë konkurruese, aftësinë lobuese dhe të advokacisë. Gratë gjithashtu, pohuan një rritje të vetëbesimit e cila i mundëson ato për një pjesëmarrje më aktive në diskutime dhe për një rritje të gatishmërisë për marrjen e detyrave dhe pozicioneve politike
- Pjesëmarrësit e konsideruan trajnimin si shumë të vlefshëm për fushatën e tyre politike dhe për zhvillimin e përgjithshëm personal intelektual. Shumë partnerë diskutantë pohuan të kenë përdorur materialet e tyre trajnuese gjatë fushatës së tyre elektorale. Cilësia e lartë e trajnimit rezultoi në zgjedhjen e një pjesëmarrëseje si prefekte, një tjetre si zëvendës ministre dhe një e tretë fitoi një vend në parlament gjatë zgjedhjeve elektorale të vitit 2005.
- Të gjitha kryetaret e forumeve të grave të intervistuar si dhe pjesëmarrëset në trajnim, pohuan nevojën e shtrirjes së trajnimeve të tilla cilësore dhe relevante brenda vetë partive, vecanërisht në qytete të vogla dhe zona rurale, ku diskriminimi gjinor është më i dukshëm. Qendra dhe partnerët e saj u konsideruan shumë të përshtatshëm për trajnim të mëtejshëm.
- Ftesa e partive të vogla në trajnim, u vlerësua si një element përbërës shumë demokratik i Projektit. Është shumë pozitive që gra nga parti të ndryshme politike, me shkallë të ndryshme arsimore dhe nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, marrin pjesë në trajnim. Sesionet e trajnimit, puna në grup dhe ngrënia së bashku, kontribuuan për krijimin e një solidariteti femëror duke krijuar / përmirësuar marrëdhëniet midis grave pjesëmarrëse të partive të ndryshme politike. Pjesëmarrësit pranuan nevojën e evenimenteve të ngjashme, duke qenë se gratë kanë ende probleme me çështjen e vetorganizimit, zyrtar apo jo zyrtar.
- Temat e trajnimit ishin me orientim praktik, duke qenë kështu me vlerë për punën e tyre të përditshme në politikë. Shumë partnerë diskutantë pohuan se kishin përdorur gjatë fushatës së tyre elektorale, materialet e tyre trajnuese. Publikimet e hartuara gjatë projektit ishin shumë të mira dhe u konsideruan të vlefshme. Me kërkesën e vazhdueshme të forumeve të partive politike të grave dhe disa organizata të tjera të grave, Qendra ka shpërndarë kopjet e të gjitha publikimeve të hartuara gjatë Projektit.
- Fushatat ndërgjegjësuese përmes TV u vlerësuan me njëfarë skepticizmi, pasi tavolinat e rrumbullakëta janë "një mjet i mbipërdorur" për çështjet politike dhe si pasojë tërheqin vetëm një numër të kufizuar njerëzish.

#### 4.5. Qëndrueshmëria

Trajnimi përmbushte nevojat aktuale të pjesëmarrësve dhe mund të konsiderohet si i hartuar mbi bazë nevojë. Mendohet se gratë pjesëmarrëse në seminarët trajnuese do të përdorin njohuritë e marra për të forcuar pozicionin e tyre ose për të arritur një pozicion të caktuar.

Në projekt përfshihet edhe çështja e qëndrueshmërisë institucionale (Qendrës së Gruas). Për momentin, varësia ndaj fondeve të jashtme është relativisht e dukshme. Një proces i brendshëm duhet ndërmarrë për të zgjidhur perspektivën e ardhshme të Qendrës së Gruas

### 5 KONKLUZIONE

---

Koncepti i projektit duket se u drejtohet në mënyrë të përshtatshme dy prej çështjeve më kryesore gjinore: fuqizimit direkt të grave dhe kontributi për një orientim gjinor në fusha të ndryshme të shoqërisë. Komponentët kryesorë të kombinuar me trajnimet e ofruara, aktivitetet e ndërgjegjësimit publik, dokumentimi i literaturës së specializuar dhe vizita studimore në Austri ishin mjaft të dobishme dhe të vlerësuara nga të gjithë aktorët e projektit.

Projekti mbart potencialin e krijimit të një baze për burimet e vetë Qendrës së Gruas duke i komercializuar pjesërisht, seminarët trajnuese. Seminarët trajnuese të cilat kanë si qëllim fuqizimin praktik të kompetencave individuale, kanë një kërkesë të lartë në Shqipëri. Me qëllim uljen e varësisë financiare nga mbështetja ndërkombëtare, gjetja e rrugëve për komercializimin vecanërisht të këtyre seminareve do ishin të dobishme për një qëndrueshmëri afatgjatë. Për më tepër arsimi për të rritur, është një sektor ku njerëzit janë më se të gatshëm për të shpenzuar para. Qendra e Gruas mund të krijonte në këtë mënyrë një burim të vetin të të ardhurave.

### 6 REKOMANDIME

---

Vlerësuesit i rekomanduan Qendrës së Gruas:

- të përpunojë perspektivën e komercializimit të seminareve trajnuese, duke marrë pagesa të arsyeshme nga pjesëmarrësit.
- të krijojë një set të vetëvlerësimi midis informacionit të mbledhur lidhur me disa aspekte të impaktit të aktiviteteve të projektit.

Vlerësuesit i rekomanduan ADA-s:

- të vazhdojë mbështetjen e një programi të tillë, duke u fokusuar në aspektet e rëndësishme të zhvillimit të shoqërisë civile Shqiptare

## Shtojca 3 / (6)

---

### Rikonstruksioni i Shkollave në Shqipëri

(Schulsanierungen)

botuar nga KEK CDC Consultants

Gusht 2005

---

#### PËRMBLEDHJE

---

Projekti "Restaurimi i Shkollave", rezultat i angazhimit ndaj Shqipërisë, i shumë partnerëve Austriakë qeveritarë dhe private, është një nga më të vjetërit me bashkëpunimin Austriak. Përfshirja e Kancelarisë Federale filloi në vitin 1995 mbas sigurisë politike në nivelin më të lartë. Bashkëpunimi synonte të jepte një kontribut të dukshëm për rehabilitimin e shkollave kombëtare në Shqipëri.

Që prej 1955, në Tiranë dhe në zona të largëta rurale, janë rehabilituar ose ndërtuar të reja 14 shkolla fillore, duke siguruar shkollim normal për rreth 4'000 nxënës. Ndërkohë që në fillim të projektit, cilësia e rikonstruksionit ishte me të vërtetë e ulët, gjatë fazës së dytë në sajë të një monitorimi më të mirë. u bë një përmirësim i dukshëm.

Projekti është konsideruar me një relevancë të lartë. Ai është në përputhje me Planet Arsimore Rajonale dhe përfaqëson qartë një përmirësim të drejtpërdrejtë të gjendjes në zonat rurale, të cilat zakonisht qëndrojnë jashtë fokusit të përkrahjes me ndihmë . Duke konsideruar këtë të fundit, aktivitetet kontribuojnë për zhvillimin ekonomik-social në Shqipëri, ndërsa sigurojnë akses për shërbime arsimore për të marginalizuarit.

Megjithatë, projekti ndjek një metodë teknike selektive, e cila nuk i përmbush plotësisht kërkesat e sotme për qëndrueshmëri. Rekomandohet të nxitet një përfshirje më e madhe e anëtarëve të komunitetit, për të përmirësuar ruajtjen e ndërtesave dhe për të kushtëzuar një lloj sensi pronësie nga vetë-menaxhimi lokal. Konkretisht, Bordi i Prindërve, në mënyrë aktive, mund të menaxhojnë disa fonde të vogla për aktivitete të ndryshme të shkollës.

ADA tashmë ka vendosur t'i japë fund këtij angazhimi. Prandaj, rekomandimet u drejtohen aktorëve që mund të vazhdojnë projektin (Qeveria e Landit të Vorarlbergut, CAFOD )

#### 1 METODAT

---

Vlerësimi u mbajt më 7 Korrik-11Gusht 2005. U përdorën metoda të ndryshme.

- Studim në tavolinë i dokumenteve të disponueshme
- Intervista me partnerë dhe përfitues të projektit
- Transete të shkollave të zgjedhura

U vlerësuan shkollat e mëposhtme u :

- Tiranë: De Rada
- Malësia e Madhe: Bridje, Gradec, Grabon, Goraj
- Lushnjë: Eskaj, Karavasta, Balaj, Mucaj

Shumica e shkollave ishin të mbyllura për shkak të pushimeve. Në këtë mënyrë, nuk mund të bëhej asnjë kontroll teknik nga brenda.

Një draft i parë këtij raporti u përpunua nga Edlira Muedini (CIVET, Tiranë) dhe u rishikua më pas nga KEK CDC Consultants. Për ta lehtësuar procesin e leximit, një version i shkurtër i lexueshëm i projektit u hartua nga KEK CDC Consultants dhe ju bashkangjiti si një shtojcë gjithë projektit. Raporti origjinal mund të kërkohet tek KEK CDC Consultants.

## 2 PËRSHKRIM I SHKURTËR PROJEKTIT

### Vështrim i përgjithshëm

Titulli i Projektit	<b>Rehabilitimi dhe Ndërtimi i Shkollave në Shqipëri</b>
Agjensia Implementuese	CAFOD Shqipëri
Partner Lokal	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoritë Arsimore Rajonale
Numri i Projektit	Faza 1: 7310 Faza 2: 7415 Faza 3: 7536
Kohëzgjatja e projektit	Faza 1: 1995/96 Faza 2: 1997/98 Faza 3: 1998/99
Grupi i synuar	Komunat Rurale të Shqipërisë Veriore
Objektivat e projektit	të kontribuojë në shkollimin adekuat në zonat rurale të kontribuojë në parandalimin e emigrimit të mëtejshëm nga vendi
Rezultate të pritshme	Ambiente shkollore funksionale në fshatrat e zgjedhura
Buxheti i projektit	Faza 1: ATS 1'000'000.00 Faza 2: ATS 1'250'000.00 Faza 3: ATS 2'700'000.00
Kontributi BKA i	Faza 1: ATS 1'000'000.00 Faza 2: ATS 1'250'000.00 Faza 3: ATS 2'700'000.00

## 3 KONTEKSTI

Në fillim të viteve 90, shkatërrimi dhe agresiviteti i njerëzve ndaj gjithë gjurmëve të qeverisjes së mëparshme, nuk ndalej edhe para të mirave publike. Gjatë kësaj kohe u grabitën dhe u shkatërruan veçanërisht, shumë ndërtesa shkollore. Është llogaritur, që të paktën një numër prej 5'330 shkollash, u dogjën dhe u shkatërruan gjatë dy viteve të para. Shumë njerëz uzurpuan ndërtesat ekzistuese duke i përdorur ato për funksione të ndryshme. Drejtorët dhe mësuesit e shkollave u larguan në kërkim të burimeve dhe të punëve të tjera, për më shumë të ardhura.

Këto ndërtesa shkollore ende në përdorim, ishin mbajtur keq; ndërtimi dhe pajisjet ishin jashtë cdo standardi. Vecanërisht të prekura ishin të gjithë ndërtesat shkollore në zonat e largëta rurale. Një numër i madh iniciativash ndihmash ndërkombëtare, filloi mbështetjen duke financuar ndërtimin dhe restaurimin e shkollave. Në vitet 1996/97, sistemi i shkollave përjetoi goditjen e dytë gjatë trazirave mbarëkombëtare. Dëmi i përgjithshëm i asaj kohe llogaritet të jetë të paktën 35 million dollarë.

Vetëm në periudhën pas 1998, ndodhën disa ndryshime pozitive në drejtim të zhvillimit të shkollave. Megjithatë qeveria shqiptare deri sot akoma, nuk është në gjendje të sigurojë mbështetjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve shkollore. Shumë shkolla, vecanërisht në zonat rurale, janë në një gjendje kritike. Duke qenë se as pushteti qëndror dhe as bashkitë nuk mund të sigurojnë nevojat financiare të tyre, inputi kryesor bazohet në ndihmën e jashtme.

Përmirësimet në sistemin e arsimit të detyrueshëm janë një çështje e rëndësishme edhe sot, duke qëndruar në majë të listës së prioriteteve të partnerëve rajonalë (pushteti lokal dhe komunat, bizneset, mësuesit, etj). Aktivitetet në këtë fushë janë përceptuar si leva për modernizimin e jetës dhe uljen e varfërisë.

Shkalla e braktisjes së shkollës në zonat veriore është tepër e lartë. Arsyeja kryesore është emigrimi i të rinjve, me qëllim sigurimin e të ardhura për gjithë familjen përmes dërgesave në para. Fëmijët gjithashtu, duhet të kontribuojnë në ekonominë e familjes. (të punojnë në fusha, të shesin në treg, ose të kujdesen për bagëtinë.) Qëndrimi tradicional ndaj shkollimit të vajzave është akoma pengues, duke e kufizuar "rrezen" e tyre në rrethin e brendshëm familiar. Varfëria egzistuese si dhe perspektiva e kufizuar për të ardhmen përbëjnë një potencial të mundshëm për trafikim.

## 4 VLERËSIMI

### 4.1 Relevanca

Aktivitetet e projektit kanë një relevancë të lartë me subjektet e përfshira direkt: komunitetet e zgjedhura me anëtarët e tyre. Pasi as komuniteti dhe as qeveria, nuk mund të sigurojnë një shkollim normal me burimet e tyre, kontributi Ausriak është i një rëndësie thelbësore për të mundësuar vetëzhvillimin e komuniteteve të synuara, duke ndihmuar në krijimin e shërbimeve arsimore bazë.

Në nivel kombëtar gjithashtu, rehabilitimi i shkollave është një kërkesë paraprake, me një prioritet të lartë, dhe një parakusht për zhvillimin e mëtejshëm social-ekonomik të vendit. Mungesa e aksesit dhe cilësia e ulët e shërbimeve arsimore, vecanërisht në zonat rurale, është një nga treguesit kryesorë i varfërisë në Shqipëri. Ndërsa shkollat janë zgjedhur sipas Planit të Zhvillimit Rajonal, rehabilitimi i tyre është një kontribut zhvillimi për zonat zakonisht të neglizhuara.

### 4.2 Efiçenca

#### *Efiçenca e kostos*

Lidhur me ri/ndërtimin e shkollave të synuara, bazuar në planet e disponueshme të ndërtimit si dhe vlerësimin e kostos përkatëse, shpenzimet korrespondojnë me një input/output të balancuar dhe janë në përputhje me kushtet lokale të tregut. Në përgjithësi projekti është i bazuar në materiale me kosto vërtet të ulët. Për më tepër, në zonat rurale puna është siguruar nga komunitetet e synuara, si një kontribut nga ana e tyre.

Në fillim të projektit, u shfaqën probleme të ndryshme lidhur me cilësinë e lëndës së parë, si dhe cmimin e kompanive të përfshira. Një arsye për këtë mund të jetë edhe niveli me të vërtetë i ulët i biznesit të ndërtimit nga mesi i viteve 90. Profesionalizmi në biznesin e ndërtimit zuri vend pas "bumit të ndërtimit" në 1998 me një rritje të cilësisë, si në materialet ashtu edhe punën e ofruar.

#### *Menaxhimi i Projektit & Drejtimi*



Projekti është hartuar mbi një marrëveshje tripalëshe. Palët e kontratës janë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Shqipërisë (MASH) si përfutues e subvencionit. Partneri Implementues Lokal është CAFOD Shqipëri, një OJQ me bazë katolike. Puna specifike ndërtimore është bërë prej kompanie private lokale, të cilat janë nënkontraktuar pas një procesi tenderimi për çdo projekt. Donatorët kryesorë janë Kancelaria Federale dhe Qeveria e Landit të Vorarlbergut, të cilët mbajnë edhe gjithë përgjegjësinë për procesin e monitorimit dhe të kontrollit

Organizimi i projektit ishte i përshtatshëm për një imlementim fleksibël dhe në kohë të tij

#### 4.3 Efektiviteti

Gjatë periudhës së projektit përfituan shkollat e mëposhtme:

Shkolla	Faza I	Faza II	Faza III	Te dhëna Përfituesit
<u>Tirana dhe rrethinat:</u> De Rada	Rehabilitim i shërbimeve sanitare	Instalim i pompave të ujit		1'050 nxënës
Shkolla 26. Nëntori- Shkolla fillorel Zalldajt	Catia, Rehabilitim i shërbimeve sanitare Rikonstruksion i pjesës së ndërtesës	Dyert, përmirësim i furnizimit me ujë Përfshi lidhjen e rrjetit Palestër, rrethime (mur)		726 nxënës n/a (10 klasa)
Mamurras	Rindërtim dhe Rikonstruksion			n/a (44 klasa)
Malësia e Madhe: Brigje	Ngritja e ndërtesës së re shkollore	Tualete, rrethim		n/a (1 klasë)
Budish		Rrethim		40 nxënës
Goraj	Ngritja e ndërtesës së re shkollore	Rrethim		40 nxënës
Gradec	Ngritja e ndërtesës së re shkollore	Zgjerim ndërtese		80 nxënës
Dobre		Ndërtim i ri		70 nxënës
Grabom		Ndërtim i ri		n/a (2 klasa)
Lushnja: Balaj	Ngritja e ndërtesës së re shkollore	Rrethim		72 nxënës
Mucias	Ngritja e ndërtesës së re shkollore	Rrethim		80 nxënës
Eskaj		Ndërtim i ri		100 nxënës
Kadiaj		Ndërtim i ri		150 nxënës
<u>Skodra &amp; Mirdita:</u> Golem			Rinovim	n/a
Kartund i Vjetër/ Mirdita			Rinovim	n/a (9 klasa)
Bardhaj & Arrëz / Mirdita			Rinovim	rreth 1'500 nxënës

Që prej 1995 mendohet të kenë përfituar nga aktivitetet e projektit, rreth 4'000 nxënës.

Të gjitha shkollat e vizituara gjatë misionit të vlerësimit, ishin në kushte pjesërisht të mira të dhe pranueshme. Disa shkolla kishin dritare, të thyera, ose pajisje të prishura; dyer dhe rrethimet që duheshin rinovuar. Shkollat afër ose në Tiranë, mirëmbahen më mirë se shkollat në veriun e largët. Kjo pjesërisht, në saj të mbështetjes shtesë të donatorëve të tjerë.

#### 4.4. Impakti

Projekti ka kontribuar në një masë të kosiderueshme për sigurimin e shkollimit në nivelin e sistemit fillor. Aktivitetet shpesh, ishin i vetmi implentim në këto zona shumë të largëta, pjesërisht rurale dhe malore. Anëtarët e komunitetit e përjetojnë projektin si një ndryshim të vërtetë në kushtet e tyre të jetesës dhe shfaqin mirënjohjen e tyre .

Aktivitetet kanë një ndikim të madh në zona të veçanta, duke siguruar shkollim për momentin. Nuk dallohet ndonjë ndonjë impakt në nivelin e sistemit arsimor.

#### 4.5. Qëndrueshmëria

Projekti siguron sinergji të mira midis donatorëve të ndryshëm Austriakë dhe. nivelit privat e qeveritar Megjithatë, për të arritur qëndrueshmëri kërkohen si angazhim ashtu edhe/ose fonde lokale Për momentin bashkitë nuk janë në gjendje të sigurojnë kostot e shpenzimit dhe të ruajtjes së pajisjeve të shkollës.

Fakti që në fazën II krahasuar me fazën pati shtim dhe/ose punë suplementare, konfirmon që komunitetet nuk janë në gjendje të garantojnë mirëmbajtjen me forcat e tyre. Përveç ndihmës së dhënë nga Austria, nuk ka një përpjekje aktive nga ana e komuniteteve, për të kërkuar mbështetje. Bashkëpunimi me Drejtoritë Arsimore Rajonale është kufizuar në një analizim të gjendjes dhe një koordinim rajonal të asistencës teknike. Roli i CAFOD Shqipëri, është kufizuar drejt një “shpërndarësi shërbimesh” për komunitetet

NË KËTË MËNYRË, PROJEKTI MBART RREZIKUN E KTHIMIT MBRAPA NË GJENDJEN E MËPARSHME, SAPO MISIONI I MONITORIM/KONTROLLIT TË MBAROJË DHE PARTNERI IMPLEMENTUES TË LARGOHET EKSPERIENCAT NGA SEKTORI I ZHVILLIMIT TREGOJNË QË ME NJË PËRFSHIRJE MË TË MADHE TË KOMUNITETEVE RESPEKTIVE, GJËRAT MUND TË NDRYSHOJNË. NË SHUMICËN E RASTEVE KY PROCES KUSHTËZOHET PREJ OJQ-VE, TË CILAT SI NJË I JASHTËM, VIJNË PËR TË PUNUAR NË KOMPONENTËT E “BUTË” TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT (DUKE RRRITUR SENSIN E PRONËSISË, PUNËS VULLNETARE TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE, DUKE BËRË AKTIVITETE SOCIALE PËR FAMILJET, AKTIVITETE TË VOGLA PËR ZBUKURIMIN E SHKOLLËS/AVE SI LYERJA E MUREVE, MBJELLJE LULESH DHE AKTIVITETE TË TJERA TË NGJASHME) FOKUSI SHTRIHET NË RRRITJEN E PJESËMARRJES SË KOMUNITETIT NË PROCESIN E IMPLEMENTIMIT DHE VAZHDIMIT TË PROJEKTIT

## 5 KONKLUZIONE

Projekti njihet rëndësinë e fokusimit në sistemin arsimor në periudhën pas-shkatërruese. Arsimi, megjithëse shpesh i neglizhuar në përpjekjet për përmirësim dhe përkrahje, është një çështje vitale për integrimin social dhe ekonomik të gjeneratave të ardhshme. Projekti ka filluar në një kohë kur Ndihma Humanitare me Asistencë Teknike ishte hapi më i përshtatshëm për mbulimin e nevojave egzistuese dhe kërkesave lokale. Për më tepër, këto aktivitete kanë mobilizuar me sukses, mbështetje të jashtme private dhe qeveritare.

Gjithsesi, hartimi i projektit është kufizuar vetëm ne Asistencë Teknike. Duke vepruar në këtë mënyrë më tepër nxitet dhe ruhet mentaliteti i përfituesit, se sa stimulohen potencialet e burimeve të vetë komunitet/rajon/vend ose gjetja e rrugëve për forma të tjera zgjidhjeje. Projektet e zhvilluara për rindërtimin e shërbimeve arsimore në zonat me konflikte, përfshijnë një gamë të gjerë aktivitete, si rindërtimin dhe rehabilitimin e ndërtesave shkollore të dëmtuara, ndërtimin e shkollave të reja, programe trajnimi për mësuesit, sigurimin e teksteve mësimore dhe pajisjen e klasave, për shkollat me

nën-nivel burimesh dhe, – ku është e mundur – krijimi i bordeve të prindërve, me qëllim hapjen rrugës së aktiviteteve vetëmenaxhuese

Sot ka një ndryshim në mbështetjen e donatorëve duke i dhënë më shumë prioritet përfshirjes së strukturave lokale. Projekti mund të sjellë një përfitim, në një shkallë të konsideueshme, duke lënë asistencën në favor të kombinimit të AT me komponentët e ndërtimit të kapaciteteve të forta, në nivel lokal.

## **6 REKOMANDIME**

---

Aspektet e mëposhtme duhen marrë parasysh, nëse merren në konsideratë kontribute të mëtejshme:

- Hartimi i projektit duhet përshtatur me standartet egzistuese të përfshirjes së komunitetit.
- Shoqata CAFOD duhet të analizojë sërish projektet (faza 2 dhe 3), duke u fokusuar në ato projekte, komponentët e të cilëve rrisin përfshirjen e komunitetit. Komponentët e ndërtimit të kapaciteteve duhet të integrohen në nivelin e bordeve të prindërve. Krijimi i fondit të granteve të vogla – menaxhuar nga vetë bordi i prindërve – mund të jetë një nga mundësitë e shumta për përmirësimin e shkollës.

## SHTOJCA 4

### Karakteristikat e Vlerësimit të Programit

Dimensioni /Niveli	Vlerësimi i Projektit	Vlerësimi i Projektit
Periudha	Përqëndrim në objektivat afat-shkurtra dhe afat-mesme	Përqëndrim në objektivat afat-gjatat
Objektivat	Përqëndrim në efikasitet,efektshmëri, outpute	Përqëndrim në qëndrueshmërinë impaktin, strukturor, rezultatet
Strategjia	Më pak komplekse	përshtatja normative dhe strategjike është një karakteristikë dalluese e programit
Lidhja me politikën	Jo çështje qendrore	çështje e rëndësishme
Përgjegjshmëria	Ndaj të paktën, dy partnerëve (donator, partner projekti)	Zakonisht ndaj një numri të madh partnerësh
Audienca kryesore	Spektori / Agjensia Implementuese	Menaxhimi/ Politikat
Koherenca / Konsistenca	Jo çështje qendrore	çështje qendrore
Metoda	Matja e arritjes së synimeve Metodat cilësore dhe sasore	Metodat cilësore, interpretative, diagnostikuese

Marrë nga: Përmbledhje mbi bazën e "SEVAL Arbeitsgruppe EZA, Thesenpapier zu Programm-Evaluationen"  
Pierre Walther et. al. Januar 2005